

MODELI I QEVERISJES TERRITORIALE PAS NDRYSHIMIT TË SISTEMIT POLITIK NË SHQIPËRI

Gentian Kaprata

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Juridike, Politike dhe Marrdhënie Ndërkombëtare me profil Shkenca Sociale të Aplikuara për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Ervis Iljazaj

Numri i fjalëve: 69. 567

Tiranë, Nëntor, 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË.

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky punim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar si një i tërë apo pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban pjesë të shkruara nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKT.

Shqipëria, prej tre dekadash, tranziton nga një regjim monist i socializmit stalinist dhe të ekonomisë së planifikimit të centralizuar drejt një vendi të demokracisë liberale të ekonomisë së tregut të lirë. Përgjatë këtyre viteve qeveritë kanë ndërmarrë një sërë reformash dhe politikash, të cilat kanë synuar realizimin e kësaj aspirate të lartë politike, dhe integrimin e vendit në BE. Sot, Shqipëria mbetet larg synimeve të vendosura në fillim të viteve 1990-të. Ndryshe nga çfarë është synuar, qeverisjet shqiptare të tranzicionit, në sektorët që kanë lidhje me zhvillimet territoriale e urbane janë karakterizuar nga qasje koncentruese. Kjo dallohet në tre drejtime kryesore: zgjerimi i rolit dhe fushëveprimtarisë të qeverisjeve në sektorin e zhvillimit territorial; koncentrim i fushëveprimtarisë qeverisëse të këtij sektor në duart e qeverisjes qendrore; dhe përjashtimi të palëve të interesuara dhe qytetarëve të prekur nga zhvillimi nga proceset e planifikimit të zhvillimeve territoriale dhe urbane. Qeverisjet shqiptare të tranzicionit, por në mënyrë të veçantë qeverisja 2013-2020, kanë shkuar në drejtim të kundërt me aspiratat e shqiptarëve për t'ju bashkuar vendeve të demokracive liberale. Në këtë kuptim, Shqipëria e dekadës së ardhshme duhet të ndërmarrë tre reforma të rëndësishme, në lidhje me zhvillimin territorial: reforma e formalizimit të ndërtesave informale, e cila duhet ti japë fund të shpejtë dhe shterueshëm këtij fenomeni; reforma për ndërtimin e një sistemi ligjor për planifikimin dhe zhvillimin territorial, e cila ta fusë vendin në një zhvillim të qëndrueshëm, të zgjuar dhe gjithëpërfshirës dhe; reforma administrativo-territoriale me bazë zhvillimin rajonal policentrik të qendrave të banuara. Të treja këto reforma duhet të frymëzohen nga parimet e liberalizmit klasik të: kufizimit të fushëveprimtarisë së qeverisjeve; decentralizimin e funksioneve qeverisëse drejt qeverisjes rajonale dhe lokale; dhe fuqizimin e qytetarit në proceset planifikuese dhe vendimarrëse në sektorin e zhvillimeve territoriale. Këto parime janë bazike edhe në qasjet politike të Bashkimit Europian për sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial, dhe si rrjedhim edhe në kuptim formal integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian do të jetë më i shpejtë dhe më i qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: *tranzicion, etatizëm, liberalizëm bashkëkohor, liberalizëm klasik, integrim Europian, fushëveprimtari qeverisëse, qeverisje qendrore, qeverisje vendore, sektorë të zhvillimit territorial dhe urban.*

ABSTRACT.

For three decades, Albania has been transitioning from a monist regime of stalinist socialism and a central planning economy to a country of liberal democracy and a free market economy. Over the years, governments have undertaken a series of reforms and policies, which have aimed at achieving this high political aspiration, and the country's integration into the EU. Today, Albania remains far from the goals set in the early 1990s. Contrary to what was intended, the Albanian transitional governments, in the sectors related to territorial and urban developments, have been characterized by a statist approach. This is distinguished in three main directions: expanding the role and scope of governance in the territorial development sector; concentration of the governing scope of this sector in the hands of the central government; and the exclusion of stakeholders and citizens from territorial and urban development planning processes. The Albanian governments of transition, but especially the government of 2013-2020, have gone in the opposite direction to the aspirations of the Albanians to join the countries of liberal democracies. In this sense, the Albania of the next decade must undertake three important reforms, related to territorial development: the reform of the formalization of informal buildings, which must put an end to this phenomenon quickly and exhaustively; reforms for the construction of a legal system for territorial planning and development, which will introduce the country to a sustainable, smart and comprehensive development and; administrative-territorial reform based on the polycentric regional development of inhabited centers. All three of these reforms must be inspired by the principles of classical liberalism of: limiting the scope of governments; decentralization of governance functions towards regional and local government; and empowering the citizen in the planning and decision-making processes in the sector of territorial development. These principles are also basic in the political approaches of the European Union for the sector of territorial planning and development, and consequently in a formal sense the integration of Albania in the European Union will be faster and more stable.

Keywords: *transition, statism, contemporary liberalism, classical liberalism, European integration, governing scope, central government, local government, territorial and urban development sectors.*

DEDIKIMI.

Këtë punim ja dedikoj babait tim!

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE.

Të shumtë kanë qenë njerëzit që më kanë mbështetur në këtë projekt timin. Ai ka qënë i shtrirë në kohë dhe shumë intensiv, çfarë ka kërkuar përfshirjen dhe kontributin e shumë njerëzve, nisur nga familja, vijuar me stafin akademik të UET e deri te stafi administrativ i tij.

Në këtë kuptim, do të doja të falenderoja, së pari familjarët e mi, të cilët jo vetëm janë kënaqur me pak nga koha ime si bashkëshort dhe si prind, në dispozicion të tyre por edhe kanë kontribuar që ky punim ti afrohet pritshmërive.

Falenderime speciale do të doja ti drejtoja edhe stafit administrativ të Shkollës Doktorale UET, dhe në mënyrë të veçantë drejtueses së saj, znj. Vahidije Kadiu. Pa bashkërendimin e saj të aspekteve të ndryshme administrative, ky proces do të ishte i pamundur.

Mirënjohje speciale do të shprehja për drejtuesin shkencor të temës time doktorale Prof. Asoc. Dr. Ervis Iljazaj.

PËRMBAJTJA E PUNIMIT.

KAPITULLI I: HYRJE.

1.1. Prezantim.....	1
1.2. Organizimi i studimit.....	3

KAPITULLI II: METOTOLOGJIA.

2.1. Motivacioni.....	6
2.2. Qëllimi dhe objektivat.....	6
2.3. Metodologjia.....	8
2.4. Pyetja kërkimore.....	9
2.5. Hipoteza.....	9
2.6. Përkufizimi operacional i termave.....	9
2.7. Kufizimet metodologjike.....	10

KAPITULLI III: KUADRI TEORIK; NJË VËZHGIM MBI FILOZOFITË, IDEOLOGJITË POLITIKE DHE LLOJET E QEVERISJEVE.

3.1. Lindja dhe evoluimi i liberalizmit dhe dinamikat e parimeve të tij.....	12
3.1.1. Liberalizmi si një largim nga etatizmi (Hobbes, Filmer dhe Locke).....	12
3.1.2. Evolucionin në dy liberalizma mbi parime të ndryshme (libertarianizëm vs. liberalizëm modern).....	18
3.1.3. Shteti social si një kthesë drejt etatizmit (Rawls, Habermas dhe Mouffe).....	23
3.2. Llojet e qeverisjeve liberale dhe ndarja ideologjike në boshtin ‘majtas-djathtas’.....	31
3.2.1. Rëndësia e ideologjive politike dhe dualizimi “e majtë”/ “e djathtë”.....	31
3.2.2. Kapitalizmi i aplikur sipas filozofive libertariene dhe liberale moderne.....	34

KAPITULLI IV: EFEKTET E QEVERISJEVE TERRITORIALE PËRGJATË TRANZICIONIT.

4.1. Gjendja hapsinore, territoriale dhe urbane e vendit si produkt i qeverisjet territoriale.....	38
--	----

4.2. Modeli demografiko-territorial i tranzicionit në raport me modelet socio-urbane perëndimore.....	42
4.3. Impakti i produkteve të qeverisjeve territoriale në strukturën territoriale të vendit.....	47
4.4. Impakti i produkteve të qeverisjeve territoriale në dimensionin urban të vendit dhe cilësinë urbane të jetesës.....	51

KAPITULLI V: VLERËSIMI I QEVERISJEVE TERRITORIALE TË TRANZICIONIT SIPAS PARIMEVE LIBERTARIANE.

5.1. Vlerësimi qeverisjeve të tranzicionit sipas qasjes ideologjike të partive kryesore qeverisëse.....	55
5.2. Vlerësimi i qeverisjeve të tranzicionit sipas parimit të kufizimit të veprimtarisë qeverisëse.....	61
5.2.1. Parimi libertarian i kufizimit të fushëveprimtarisë qeverisëse.....	61
5.2.2. Pronësia private mbi tokën urbane dhe roli i qeverisë.....	67
5.2.3. Instrumentat e planifikimit territorial dhe roli i qeverisë.....	72
5.2.4. Kontrolli i zhvillimit ndërtimor dhe roli i qeverisë.....	77
5.3. Vlerësimi i qeverisjeve të tranzicionit sipas parimit të decentralizimit të funksioneve qeverisëse.....	81
5.3.1. Parim libertarian i decentralizimit të funksioneve qeverisëse.....	81
5.3.2. Decentralizimi i fushëveprimtarisë së qeverisë si një parim European.....	84
5.3.3. Dinamikat e decentralizimit të funksioneve qeverisëse në Shqipërinë e tranzicionit.....	89
5.3.4. Proçesi decentralizues dhe planifikimi e zhvillimi territorial përgjatë tranzicionit.....	93
5.4. Vlerësimi i qeverisjeve të tranzicionit sipas parimit të fuqizimit të rolit të qytetarit në qeverisje.....	99
5.4.1. Parimi libertarian i fuqizimit të qytetarit nëpërmjet përfshirjes në qeverisje.....	99
5.4.2. Fuqizimi i qytetarit në qeverisje si individ që mbart virtytin qytetar.....	106

5.4.3. Rekomandimet e BE dhe praktikat shqiptare për përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen territoriale.....	111
---	-----

KAPITULLI VI: VLERËSIMI I REFORMAVE DHE LEGJISLACIONIT SEKTORIAL QË PRODHUAN QEVERISJET TERRITORIALE.

6.1. Reforma e legalizimeve të ndërtimeve informale e rikoncetuar mbi parimet libertariane.....	116
6.1.1. Modeli territorial i tranzicionit dhe ndërtimet informale.....	116
6.1.2. Përpjekjet e para për tu përballur me fenomenin e ndërtimeve informale.....	120
6.1.3. Teoria e De Sotos për formalizimin dhe varianti i saj shqiptar.....	124
6.1.4. Qasjet etatiste të qeverisjeve territoriale në lidhje me legalizimin.....	129
6.1.5. Një propozimi nga qasje libertariane për procesin e formalizimit të ndërtimeve informale.....	133
6.2. Reforma e sistemit të planifikimit të territorit sipas parimeve libertariane.....	137
6.2.1. Legjislacioni shqiptar i planifikimit të territorit në tre fazat e para të qeverisjes territoriale, dhe nevoja për një reformim të thellë.....	138
6.2.2. Vlerësim i legjislacionit aktual të planifikimit të territorit dhe domosdoshmëria për një reformë të thellë në këtë sektor.....	143
6.2.3. Propozimi për një reformë libertariane për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	149
6.3. Reforma administrative-territoriale e rikonceptuar sipas parimeve libertariane...	155
6.3.1. Reformat territorialo-administrative në tre fazat e para të qeverisjes territoriale.....	155
6.3.2. Reforma territorialo-administrative 2014 dhe nevoja për një reformë të re.....	158
6.3.3. Propozimi për një reformë administrativo-territoriale nga qasja libertariane.....	164

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.

7.1. Përfundime.....	168
7.1.1. Qeverisja territoriale e Shqipërisë ka nevojë për një qasje libertariane.....	168
7.1.2. Shqipëria ka nevojë për një reform të re në fushën e formalizimit të ndërtesave informale.....	168
7.1.3. Shqipëria ka nevojë për një reformë të re të sistemit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	169
7.1.4. Shqipëria ka nevojë për një reformë të re administrativo-territoriale.....	170
7.2. Rekomandime.....	171
7.2.1. Rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për një reformë ligjore për formalizimin e ndërtesave informale.....	171
7.2.2. Rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për një reformë ligjore për planifikimin dhe zhvillimin territorial.....	172
7.2.3. Rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për një reformë administrativo-territoriale.....	173
BIBLIOGRAFIA	175

LISTA E SHKURTIMEVE.

Albanian Investment Development Agency - AIDA

Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit - AKPT

Banka e Shqipërisë - BSH

Bashkia Tiranë - BT

Gjykata Administrative e Apelit - GjAA

Instituti i Statistikave - INSTAT

Këshilli i Ministrave - KM

Kontrolli i Lartë i Shtetit - KLSH

Ministria e Brendshme - MB

Ministria e Infrastrukturën dhe Energjisë - MIE

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit - MPPT

Revista Monitor - RM

Top Channel Albania – TChA

Banka Botërore - BB

Congres for the New Urbanism - CNW

European Commission - EC

European Union - EU

European Council of Town Planners - ECTP

Libertarian Party - LP

United Nation - UN

United Nation, Economic Commission For Europe - UNECE

World Bank - WB

World Planners Congress - WPC

KAPITULLI I: HYRJE.

Në këtë kapitull do të bëjmë një prezantim të përgjithshëm të punimit dhe të strukturës në të cilën organizohet ai. Kapitulli nis me një prezantim të kontekstit të urbanizimit përgjatë viteve të tranzicionit, dinamikat demografike e faktorët e tjerë që ndihmuan në zhvillimin e modelit demografiko-territorial të tranzicionit, si dhe modelin e qeverisjeve territoriale që lejuan zhvillimin e këtij modeli të dëmshëm territorial. Kapitulli mbyllet me prezantimin e strukturës dhe kapitujve përbërës së tij.

1.1. Prezantim.

Rënia e regjimit monist dhe kalimi i Shqipërisë në një sistem pluralist u shoqërua me prishjen e shumë balancave ekonomike, sociale dhe kulturore të vendosura dhe stabilizuara në një periudhë 46 vjeçare. Në këtë kuptim u prish edhe balanca e shpërndarjes së popullsisë nëpër territorin kombëtar. Regjimi komunist, për interesa të veta, dhe nëpërmjet dhunës e propagandës, kishte synuar të mbante një shpërndarje relativisht përpjestimore të popullsisë dhe të balancuar me burimet natyrore dhe territoriale.

Heqja e shtrëngimesh së ushtruar në funksion të atij synimi politik dhe një sërë normativash ligjore, e shoqëruar kjo me një set reformash liberalizuese dhe demokratizuese të fillim viteve '90-të, do të prodhonin një impakt shumë të lartë në nivelin e popullsisë banuese në Shqipëri dhe shpërndarjen demografike të saj nëpër territorin kombëtar. Dy do të ishin dinamikat kryesore të demografisë në Shqipërinë e tranzicionit. Së pari, ulja e nivelit të popullsisë banuese në vend, si rezultat i uljes së rritjes natyrore dhe masivizimi i fenomenit të migracionit të jashtëm. Dhe së dyti, rritja e shpejtë e nivelit të urbanizimit dhe riformatimi i modelit demografiko-territorial (shpërndarja e popullsisë nëpër territorin kombëtar) si konsekuencë e migracionit të brendshëm.

Fenomeni i urbanizimit në shkallë të gjerë është mbështetur në dy lloje të ndërveprimit shoqëror me territorin: ose nëpërmjet ndërtimitarisë formale, duke ju nënshtruar ligjeve dhe praktikave ligjore e proceduriale të vendit dhe duke u pajisur me një leje ndërtimi; ose nëpërmjet rrugës informale, duke ndërtuar me inisativë individuale dhe jashtë strukturës ligjore dhe administruese të vendit. Ajo që dallohet është se edhe në rastet kur zhvillimi është kryer në përputhje me një *'leje ndërtimi'* të dhënë nga institucionet qeverisëse, ai nuk ka përfaqësuar një zhvillim në përputhje me kushtet mjedisore dhe urbane dhe nuk ka kontribuar në një

zhvillim të qëndrueshëm dhe të zgjuar të qendrave urbane apo rurale. Kjo sepse, ky zhvillim është lejuar megjithëse kanë munguar instrumentat e planifikimit territorial dhe urban që do të siguronin zhvillimin e përgjithshëm të qëndrueshëm të qendrës së banuar. Që do të thotë se, përsa i përket ndikimit urban dhe mjedisor, edhe ndërtesat e lejuara nga qeverisja edhe ndërtesat informale paraqesin të njëjtin impakt potencial negativ në mjedisin urban.

Kjo mënyrë e paplanifikuar dhe e fragmentarizuar e zhvillimit ka prodhuar modelin territorial të koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia, i cili shfaq problematika të mëdha hapsinore, territoriale dhe urbane në qytetet dhe qendrat e tjera të banuara të vendit.

Modeli territorial i tranzicionit me të gjithë dëmet apo impaktet që prodhon, është produkt i qeverisjeve shqiptare të tranzicionit në sektorët që kanë lidhje me zhvillimin territorial. Këto qeverisje, të cilat i kemi ndarë në katër faza sipas partisë politike që i ka drejtuar, nuk e kanë kuptuar rolin e ri që ka qeverisja në demokraci në çështjet urbane dhe territoriale, i cili është shumë i ndryshëm nga ai i një qeverisje moniste të planifikimit të centralizuar.

Në tërësinë e tyre ‘qeverisjet territoriale’ të tranzicionit (sektorët e zhvillimit territorial të qeverisjes) janë shfaqur me një nivel të lartë përqëndruese pushteti, megjithëse duhet pranuar se në faza të ndryshme qeverisëse niveli i etatizmit është prezantuar i ndryshëm. Ky nivel i lartë etatizmi është shprehur në të treja aspektet. Së pari, nëpërmjet rolit dominues dhe madhësisë së qeverisjes në aktivitetet e zhvillimit territorial, e karakterizuar nga: sasi e lartë e legjislacionit dhe ndryshime të shpeshta të tij (hiperlegjislacion); numër i madh institucionesh dhe agjensish qeverisëse; dhe financime të larta buxhetore për këtë sektor. Së dyti, nëpërmjet koncentrimit të fushëveprimtarisë qeverisëse në fushën e zhvillimit territorial në nivelin kombëtar të qeverisjes, duke penguar procesin e decentralizimit në sektorët e zhvillimeve territorial dhe urbane. Dhe së treti, duke mos lejuar fuqizimin e qytetarit në çështjet e zhvillimit territorial, të cilën e kanë synuar nëpërmjet mospërfshirjes së palëve të interesuara dhe qytetarët e prekur nga zhvillimi në proceset vendimare për planifikimin territorial dhe urban.

Në këtë kontekst, sipas këtij punimi dhe kufinjve shkencor të tij, Shqipërisë së dekadës së katërt të tranzicionit i duhen tre reforma të thella në çështjet e zhvillimit territorial, të cilat janë: reformë për formalizimin e ndërtesave dhe zonave informale; reformë për sistemin ligjor të planifikimit dhe zhvillimit territorial; dhe reformë administrative-territoriale. Që këto reforma të mos dështojnë, sikurse ka ndodhur rëndomtë përgjatë viteve të tranzicionit, duhet që të frymëzohen nga parime të liberalizmit klasik, si: zvogëlimi i rolit dhe madhësisë së qeverisjes në çështjet territoriale; ndarje me trend të fortë decentralizues të fushëveprimtarisë qeverisëse

në fushën e zhvillimit territorial; dhe fuqizim të palëve të interesuar dhe qytetarëve në proceset e marrjes së vendimeve në planifikimin territorial dhe administrimin urban.

Këto parime të liberalizmit klasik janë edhe udhëzues dhe kushtëzime të dokumenteve politike të Bashkimit European. Ndërmarrja e reformave mbi këto qasje europiane na siguron se vendi do të shkoj në rrugën e duhur dhe të kërkuar drejt integritit në Bashkimin European, jo vetëm politikisht por edhe si ngjashmëri konkrete me vendet antare të tij.

1.2. Organizimi i studimit.

Kapitulli 1 - ‘Hyrje’. Në këtë kapitull do të bëjmë një prezantim të përgjithshëm të kontekstit të punimit dhe të strukturës në të cilën organizohet ai.

Kapitulli 2 - ‘Metodologjia e punimit’ na njeh me motivacionin, qëllimin dhe objektivat, metodologjinë, pyetjen kërkimore dhe hipotezën e punimit. Ai nis me motivet që shtynë autorin të ndërmarrjen e punimit, vijon me qëllimin dhe objektivat që punimi i vendos vetes. Më tej prezanton pyetjen kërkimore dhe hipotezën e tij, për ty mbyllur me përkufizimin operacional të termave dhe kufizimet metodologjike të punimit.

Kapitulli 3 - ‘Kuatrë teorik i punimit; Një vëzhgim mbi filozofinë, ideologjinë politike dhe llojet e qeverisjeve’ përbëhet nga dy seksione. Në seksionin e parë do të bëjë një vëzhgim të mbi filozofinë politike më të rëndësishme që frymëzojnë qeverisjet liberale. Ai fillon me një prezantim të Liberalizmit Klasik. Vijon me evoluimin e tij në dy rryma të ndryshme dhe mbyllet me përshkrimin e filozofisë së “demokracisë së masave” duke bërë një udhëtim të përciptë por një cikël të plotë në filozofinë liberale. Seksioni i dytë i këtij kapitulli fokusohet në prezantimin e dy llojeve të qeverisjeve liberale në botë: kapitalizmi ‘laissez-faire’ sipas liberalizmit klasik dhe ‘kapitalizmit të administruar’ apo ‘shtetit zhvillues’ të liberalizmit modern. Më tej, vijon me prezantimin e rëndësisë së ideologjisë dhe diferencat ideologjike midis ‘të majtës’ dhe ‘të djathtës’. Synimi i këtij kapitulli është të prezantoj në teori kush ishin dy rrugët ideologjike që mund të ndiqte Shqipëria në frymëzimin e reformave dhe politikave. Duke qenë se Shqipëria e kishte bërë zgjedhjen e saj për të shkuar drejt demokracive liberale me synim të veçantë integritin në BE, qeverisjet e saj duhet të frymëzoheshin nga filozofinë liberale që ndjekin edhe demokracinë liberale perëndimore.

Kapitulli 4 - ‘Efektet e qeverisjeve territoriale përgjatë tranzicionit’ do të prezantoj produktin konkret të qeverisjeve territoriale përgjatë viteve të tranzicionit. Së pari do të argumentojmë se

gjendja hapsinore, territoriale dhe urbane e vendit është produkt i modelit qeverisës së atij vendi. Së dyti do të prezantojmë modelin demografiko-territorial të koncentrim-braktisjes që kjo qeverisje territoriale prodhoi në raport me modelin territorial perëndimor policentrik. Ky kapitull mbyllet me prezantimin e dëmeve hapsinore, territoriale dhe urbane që pësoi vendi përgjatë viteve të tranzicionit. Synimi i këtij kapitulli është të prezantoj produktet konkrete të reformave dhe politikave të qeverisjeve territoriale të tranzicionit. Janë këto reforma dhe politika territoriale që kanë prodhuar këtë realitet hapsinor, territorial dhe urban dhe është ky realitet shumë i dëmshëm për zhvillimin e vendit dhe kombit, shqetësimi dhe arsyeja që na kanë drejtuar të ndërmarrim inisiativën e këtij punimi.

Kapitulli 5- ‘Vlerësimi i qeverisjeve territoriale sipas parimeve libertariane’ do të bëjë një vlerësim frymës së qeverisjeve territoriale të tranzicionit. Ai nis me një vlerësim të përgjithshëm të qeverisjeve të tranzicionit sipas qasjeve ideologjike të dy partive kryesore qeverisëse. Më tej vlerësimi fokusohet vetëm për qeverisjet territoriale në lidhje me tre parimet kryesore libertarian: parimi i kufizimit të fushëveprimtarisë së qeverisjes; parimi i qeverisjes me fushëveprimtari të decentralizuar; dhe parimi i fuqizimit të qytetarit në qeverisje. Këto parime libertariane përputhen me rekomandimet dhe kushtëzimet që vendosin institucionet politike dhe teknike të BE-së dhe të botës perëndimore në dokumentet e tyre politike. Kjo është shumë e rëndësishme për Shqipërinë, e cila prej 30 vitesh kërkon të bëhet “si e gjithë Europa”. Ky është një kapitull shumë i rëndësishëm për këtë punim, gjithashtu, sepse vlerëson nga kënde të ndryshme qeverisjet territoriale të tranzicionit, reformat dhe politikat në lidhje me sektorët e zhvillimeve hapsinore, territorial dhe urbane. Është ky kapitull, që na lejon të kuptojmë kush kanë qenë arsyet e vërteta të dështimit të reformave dhe politikave, të cilat prodhuan këtë model demografiko-territorial dhe dëmet që ai prodhon.

Në kapitullin 6 - ‘Vlerësimi i reformave dhe legjislacionin sektorial që prodhuan qeverisjet territoriale’ do të bëjmë një vlerësim të qeverisjeve territoriale në lidhje me dinamikat e reformave dhe legjislacionin e sektorëve që kanë ndikim në zhvillimin hapsinor, territorial dhe urban të vendit. Në seksionin e parë do të vlerësojmë dinamikat e përballjes qeverisëse me fenomenin e ndërtimtarisë informale dhe formalizimin e produkteve të saj. Në seksionin e dytë do të vlerësojmë dinamikat e sistemit ligjor të planifikimit dhe zhvillimit territorial. Kurse në seksionin e tretë do të vlerësojmë dinamikat e reformave territorialo-administrative, fokusuar në nivelin e decentralizimit të funksioneve qeverisëse në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial. Të treja këto vlerësime do të bëhen mbi parimet libertarian dhe europiane dhe secila prej tyre do të mbyllet me një propozim minimalist dhe modest për rikonceprim të tyre.

Kapitulli 7 - ‘Përfundime dhe rekomandime’ prezanton gjetjet e këtij punimi në formën e përfundimeve dhe jep disa rekomandime modeste brenda kuadrit të këtij punimi. Ai mbyllet me bibliografinë e punimit.

KAPITULLI II: METOTOLOGJIA.

Ky kapitull na njeh me motivacionin, qëllimin dhe objektivat, metodologjinë, pyetjen kërkimore dhe hipotezën e punimit. Ai nis me motivet që shtynë autorin të ndërmarrjen e punimit, vijon me qëllimin dhe objektivat e punimit. Më tej prezanton pyetjen kërkimore dhe hipotezën e tij, për ty mbyllur me përkufizimin operacional të termave dhe kufizimet metodologjike të punimit.

2.1. Motivacioni.

Shqipëria prej 30 vitesh udhëton në tranzicion nga regjimi komunist i ekonomisë së planifikimit të centralizuar drejt një shoqërie të demokracisë liberale dhe të tregut të lirë, me synim integrimin në Bashkimin Europian. Përgjatë kësaj periudhe janë kryer një sërë reformash me synimin për ta strukturuar vendin në një vend të ngjashëm me demokracitë liberale, në shumë sektorë të zhvillimit shoqëror dhe kombëtar, përfshirë edhe sektorët e zhvillimeve territoriale. Megjithatë, përpjekjet kanë dështuar të na japin një model të zhvillimit territorial kombëtar apo qytete me dimensione të tilla humane që ofrojnë cilësi të jetës urbane për qytetarët, të ngjashme me vendet e tjera të Bashkimit Europian.

Motivacioni i këtij punimi kërkimor origjinalizon nga nevoja për tu njohur me arsyet e këtij dështimi për tre dekada tranzicioni, dhe nga nevoja për të gjetur rrugët që duhen ndjekur në përpjekjet e së ardhmes. Në mënyrë që Shqipëria në aspektin e strukturës urbane dhe gjendjes së qyteteve, të ofrojë një cilësi të pranueshme të jetës urbane. Këto synime do të ndihmonin edhe në përsheptimin e realizimit të aspiratës së shoqërisë bashkëkohore shqiptare për një integrim sa më shpejtë në Bashkimin Europian.

Një shtysë tjetër për këtë punim janë njohuritë e mbledhura nga autori përgjatë një periudhe 20 vjeçare kontributi në institucione tekniko-shkencore dhe politik-bërëse të këtij sektori. Ky punim ka në themel rreth 250 shkrime të analizës dhe opinionit teknik dhe dhjetëra intervista dhe debate televizive në tematikat që trajtohen në këtë punim të shtrira në një periudhë kohore dhjetë vjeçare.

2.2. Qëllimi dhe objektivat.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është analizimi i arsyeve politike qeverisëse që prodhuan gjendjen e sotme të qyteteve shqiptare dhe problematikat territoriale kombëtare, si dhe gjetjen e rrugëve politike për një përmirësim të ndjeshëm të kësaj gjendje në të ardhmen.

Në këtë kuptim, studimi së pari synon të kontribuoj në zgjerimin e njohurive mbi lidhjen midis ideologjisë politike dhe çështjeve praktike të qeverisjes në sektorët e zhvillimit territorial. Kjo fushë nuk është shumë e trajtuar në Shqipëri, për arsye të kuptimeve konservative të politikës dhe ekspertizës së fushës, e cila shpesh dhe gjerësisht e sheh zhvillimin territorial si një çështje të projektimit urban. Për ta, një çështje që ka lidhje vizatime dhe projekte shteruese të hartuara nga projektues urban dhe planifikues territorial, të cilat duhet të zbatohen pa asnjë diskutim nga njerëzit, komunitet dhe institucionet qeverisëse, ekzaktësisht sikurse janë përcaktuar nga autoritetet.

Mbështetur në qëllimin kryesor, si dhe mbi dëshirën për të kontribuar edhe në zgjerimin e njohjes së dimensionit politik të zhvillimeve urbane, studimi trajton paaftësinë e qeverisjes për të kuptuar rolin e ri që ajo kishte në këtë realitet të ri demokratik, në çështjet e zhvillimit territorial. Ky rol duhet të ishte përmbledhja e të gjithë kontributeve të sektorit privat dhe publik në një vision të përbashkët dhe të koordinuar për të aritur një zhvillim të qëndrueshëm, të zgjuar dhe gjithëpërfshirës të dimensionit territorial dhe urban të vendit.

Gjetjet e këtij studimi mund të ndihmojnë modestisht në reformimin e sektorëve të zhvillimit territorial që mund të na drejtojnë jo vetëm në një gjendje shumë më të mirë territoriale dhe urbane të vendit, por edhe në një nivel më të lartë të demokracisë përfshirëse dhe një integrimin më të shpejtë dhe më strukturor në Bashkimin European.

Studimi ka për qëllim, së pari, të analizojë parimet, qasjet politike dhe karakteristikat e qeverisjeve territoriale të tranzicionit, të cilat e prodhuan këtë model territorial. Së dyti, të analizojë e vlerësojë qasjet praktike qeverive territoriale në vitet e tranzicionit me secilin nga tre parimet e liberalizmit klasik dhe dokumenteve politike të BE. Së treti, të analizojë dhe vlerësojë në dinamikë tre reformat bazike të qeverisjes në sektorët e zhvillimit territorial me synim propozimin e disa parimeve bazike nëpërmjet të cilave të rikonceptohen këto reforma.

Së fundi, studimi në kufinj të tij modest synon të ofrojë gjetje dhe përfundime të vlefshme për studiues të tjerë të temave urbane dhe territoriale, veçanërisht për ata studiues që janë të fokusuar dhe kanë interes shkencor në marrdhënien e zhvillimeve territoriale me qeverisjen dhe politikën. Studimi synon, gjithashtu, të jetë i vlefshëm edhe për institucionet politike,

qeverisëse dhe përfaqësuese, nëpërmjet rekomandimeve që propozon për reforma në sektorin që studion.

2.3. Metodologjia.

Metodologjia e këtij studimi është bazuar te ajo analitike. Nëpërmjet metodologjisë analitike është bërë e mundur shpjegimi i komponentëve përbërës të fenomenit të modelit të qeverisjes territoriale, duke u bazuar te argumentimi racional, por edhe te indikatorët e nxjerrë për këtë fenomen nga kuadri teorik. Në këtë mënyrë është nxjerrë një *frame work* analitik, që është përdorur më tej në rastin studimor që është Shqipëria për sa i përket këtij fenomeni. Shpjegimi që i është bërë fenomenit në të gjithë përbërësit e tij ka ndihmuar studimin për të marrë më shumë informacion rreth kësaj fushe studimi, dhe ka bërë të mundur realizimin e objektivave dhe qëllimit të studimit. Metodologjia analitike është e parë si më e përshtatshme në këtë studim, pasi shpjegon në mënyrë sistematike dhe të detajuar fenomenin e marrë në studim.

Nëpërmjet saj, në këtë studim analizohen reformat ligjore, politikat dhe programet e qeverisjeve territoriale në vitet e tranzicionit. Analiza kryhet në tre drejtime kryesore: niveli i shtrirjes së funksioneve qeverisëse në çështjet e zhvillimeve territoriale; niveli i shpërndarjes së funksioneve qeverisëse të zhvillimeve territoriale në dy nivelet e qeverisjes (qëndrore dhe lokale); dhe niveli i përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesuara në çështjet e zhvillimeve territoriale dhe urbane. Në këto tre filtra analitikë ne trajtojmë reformat, politikat dhe programet konkrete të secilës fazë të qeverisjes territoriale të tranzicionit.

Gjithashtu, nëpërmjet metodologjisë analitike bëhet e mundur lidhja shkak-pasojë e variablave të marrë në studim, si modeli i qeverisjes dhe ndikimi i tij në zhvillimin urban, që është një nga qëllimet e rëndësishme të këtij studimi.

Metodat e përdorura në këtë punim janë cilësore. Ky punim vlerëson në mënyrë teorike dëmet që kanë prodhuar qeverisjet territoriale në mënyrën sesi është zhvilluar struktura hapsinoro-territoriale e vendit dhe gjendjen urbane të qyteteve shqiptare. Kjo realizohet duke përdorur burime dytësore të autorëve shqiptarë që kanë folur mbi këto tema dhe dokumenta vlerësues nga Institucionet Ndërkombëtare. Punimi përdor burime dytësore për të vlerësuar qasjet ideologjike dhe parimet bazike politike që kanë frymëzuar veprimtarinë qeverisëse të qeverisjeve territoriale të tranzicionit. Kjo analizë, mbështetet në autorë të huaj dhe shqiptarë që kanë trajtuar çështjen e parimeve të filozofive ideologjike të ndryshme liberale.

2.4. Pyetja kërkimore.

Punimi synon t'ju përgjigjet pyetjeve kërkimore që lindin si pasojë e studimit të thelluar të çështjeve në lidhje me zhvillimet territoriale dhe urbane në tranzicion dhe përpjekjeve të qeverisjeve të tranzicionit për ti dhënë përgjigje qeverisëse problematikave dhe disbalancave të krijuara. Në ndjekje të qëllimeve të vendosura në këtë punim, pyetja kërkimore është:

Çfarë modeli të qeverisjes territoriale ka aplikuar Shqipëria dhe çfarë efektesh ka sjellë ai në zhvillimin urban të saj pas ndryshimit të sistemit politik?

2.5. Hipoteza.

Punimi trajton hipotezën:

Pas ndryshimit të sistemit politik, Shqipëria ka aplikuar një model qeverisjeje territoriale të përqëndruar, i cili ka ndikuar në një zhvillim urban të disbalancuar në aspektin demokratik dhe territorial të saj.

2.6. Përkufizimi operacional i termave.

Punimi përdor disa terma të cilat kanë domosdoshmëri përkufizimin e tyre. Ato janë:

Qeverisje territoriale: është termi i përdorur në këtë punim që nënkupton aktivitetin qeverisës të atyre funksioneve, detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore që kanë lidhje me zhvillimet territoriale dhe urbane të vendit. Ato përfshijnë: hartimin dhe miratimin e instrumentave të planifikimit dhe zhvillimit territorial (politikave, planeve dhe rregulloreve territoriale dhe urbane, sipas klasifikimit të tyre dhe nivelit të qeverisjes); kontrollin e zhvillimit (lejedhënien ndërtimore); kontrollin e territorit (mbrojtjen e territorit nga fenomeni i ndërtimtarisë informale). Në kontekst të këtij punimi, termi qeverisje territoriale i përfshin të dyja nivelet e qeverisjes (qëndrore dhe vendore), përveç rasteve kur ato janë diferencuar nëpërmjet cilësimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Zhvillim Urban: është termi i përdorur në këtë punim që ka kuptimin e proceseve të përshtatjes së territoreve për zhvillim, zhvillimin dhe ndërtimin e strukturave dhe infrastrukturave të funksioneve dhe tipologjive të ndryshme. Ai është produkt i gjithë ndërhyrjeve të njerëzve të

veçantë, kompanive dhe organizatave të ndryshme nën rolin drejtues dhe orientues të qeverisjes. Aktivitetet njerëzore për zhvillimin ndërtimor dhe urban nuk mund të kryhet në asnjë rast të palejuara nga autoriteti qeverisës që ngarkon ligji për kontrollin e zhvillimit. Autoritetet që ngarkon ligji për kontrollin e zhvillimit nuk mund ta kryejnë në asnjë rast këtë funksion qeverisës të pambështetur në instrumenta planifikimi dhe projektimi të miratuara më parë nga autoritetet e planifikimit.

Qeverisje e përqëndruar: është termi i përdorur në këtë punim që nënkupton një qeverisje; me shtrirje të gjerë të fushëveprimtarisë qeverisëse; me nivel të lartë të përqëndrimit të funksioneve qeverisëse në nivelin kombëtar/qëndror të qeverisjes dhe si rrjedhojë me nivel të ulët të decentralizimit të funksioneve qeverisëse drejt qeverisjes vendore/lokale; dhe me nivel të ulët të përfshirjes që qytetarëve, komuniteteve dhe grupeve të interesit në proceset e marrjes së vendimeve politike. Në këtë punim, termi qeverisje e përqëndruar vjen si antonim i termit qeverisje libertariane (liberalo-klasike), i cili vjen si një emërtim i qeverisjes mbështetur në parimet e Liberalizmit Klasik. Në kuptimin e termit qeverisje e përqëndruar është përdorur shpesh në këtë punim edhe termi qeverisje etatiste.

Libertarianizëm: është termi i përdorur në këtë punim për të diferencuar liberalizmin klasik nga liberalizmi modern. Ne do të referohemi liberalizmit klasik me emërtimin libertarianizëm, meqë ky punim është i interesuar për parimet mbi të cilat janë të ngritura këto filozofi politike, të cilat libertarianizmi i ka të njëjta me liberalizmin klasik. Sikurse deklarohet në Platformën e Partisë Libertariane Amerikane, të adoptuar në Kuvendin e Korrikut 2018, në Neë Orleans, Louisiana “Ne, libertarianët, sfidojmë kultin e shtetit të gjithëpushtetshëm dhe mbrojmë të drejtat e individit. Ne besojmë se secili individ ka të drejtën monopol për të dominuar mbi jetën e tij, dhe ka të drejtën të jetojë në çdo mënyrë që ai zgjedh të jetojë, derisa ai nuk ndërhyt me forcë në të njëjtën të drejtë të të tjerëve, për të jetuar jetët e tyre në mënyrën që ata kanë zgjedhur.” (LP, 2018).

2.7. Kufizimet metodologjike.

Duke qenë se metodologjia e përdorur në këtë studim është analitike racionale, ai bazohet kryesisht në argumentime teorike dhe modele të përcaktuara konceptualisht. Në këtë kuptim, mungojnë matjet konkrete apo burimet parësore të nxjerra në mënyrë direkte nga studiuesi. Megjithatë, këtë kufizim, studimi është përpjekur ta kapërcejë nëpërmjet raporteve, vlerësimeve dhe studimeve të hartuara nga institucione të besueshme kombëtare dhe

ndërkombëtare që kanë në fokusin e tyre zhvillimet demografike dhe urbane. Gjithashtu, kapërcehet duke u bazuar te autorë që kanë shkruar dhe kanë bërë studime të besueshme për zhvillimin territorial dhe urban.

KAPITULLI III: KUADRI TEORIK; NJË VËZHIM MBI FILOZOFITË, IDEOLOGJITË POLITIKE DHE LLOJET E QEVERISJEVE.

Ky kapitull shërben për prezantuar kuadrin teorik të studimit dhe përbëhet nga dy seksione. Seksioni i parë prezanton spektrin liberal të filozofive politike duke i bërë edhe një kornizim. Ai nis me vendosjen e kufirit midis konservatorizmit dhe liberalizmit klasik, vijon me prezantimin e dinamikave të parimeve të liberalizmit dhe mbyllet me vendosjen e kufirit midis liberalizmit modern dhe neomaksizmit. Kurse seksioni i dytë kujdeset të prezantoj dy tipe qeverisjesh që janë frymëzuar nga dy lloje të ndryshme liberalizmash me synimin për të kuptuar diferencat e tyre në praktikën qeverisëse. Më tej, ai na njeh me konceptin ideologjik politik dhe dualizmin “majtas/djathtas”.

3.1. Lindja dhe evoluimi i liberalizmit dhe dinamikat e parimeve të tij.

Në këtë seksion do të prezantojmë lindjen dhe evoluimin e filozofisë liberale. Ai nis me prezantimin e liberalizmit klasik si një kundërshti ndaj autoritetit absolut, vijon me ndarjen e tij në dy tipologji të ndryshme dhe mbyllet me prezantimin e filozofisë habermasiane të ‘demokracisë së masave’ si një kthesë drejt etatizmit.

3.1.1. Liberalizmi si një largim nga autoriteti absolut (Hobbes, Filmer dhe Locke).

Liberalizmi klasik shfaqet fillimisht si një doktrinë politike në kontekstin e konflikteve të vazhdueshme ndërmjet Kurorës dhe Parlamentit të Britanisë së Madhe në shekullin e 17-të (Locke, 2005: 9-13; Spencer, 2005). Mbi këtë kontekst historik, ai u ngrit si një kundërvënie ndaj përpjekje të Mbretit Carli i II-të dhe klikës së tij për të rivendosur një pushtet monarkik pa kurrëfarë kontrolli (Spencer, 2005: 16; Locke, 2005). Në themel të tij qëndron kontributi teorik i John Locke, i cili së bashku me Hobbes ishin dy filozofët më të mëdhenj britanik dhe përfaqësuesit emblematikë të dy perspektivave të ndryshme ideologjike: konservatore dhe liberale (Locke, 2005: 18).

Hobbes e përshkruante ‘gjendjen natyrore’ si ajo gjendje shoqërore ku secili është kundër secilit, dhe njerëzit janë në frikën e vazhdueshme nga vdekja e dhimbshme (Laskar, 2013: 1; Wolf, 1994), ndërsa Locke mendonte se ‘gjendja natyrore’ ishte e lumtur dhe e karakterizuar nga arsyeja dhe toleranca (Bobbio, 1963). Për Locke, i cili e konsideronte gjendjen natyrore si

“Epoka e Artë”, të gjithë njerëzit në gjendje natyrore janë të barabartë dhe të lirë të gëzojnë jetën, shëndetin, lirinë dhe pronën e tyre, si të drejta të patjetërsueshme të tyre (Laskar, 2013: 3).

Ndërsa Hobbes e vlerësonte ‘kontratën sociale’ si një mënyrë për ti shpëtuar kësaj gjendje të shëmtuar dhe të frikshme (Wolf, 1994: 271-272), Locke e shikonte si “një mënyrë për të siguruar moralitetin natyror të njeriut në mënyrë më eficiente” dhe për të arritur “paqen dhe sigurinë” (Locke, 2005: 19).

Këtu evidentohet edhe diferenca e Locke me Hobbes, që në fakt është thelbi i diferencës midis konservatorëve dhe liberalëve. Hobbes mbështet një autoritet sipëror me pushtet absolut (Laskar, 2013; Wolf, 1994). Sipas Wolf “Sigurisht që Hobbes synon të mbrojë sovranitetin absolut, dhe të ç’vlerësoj njerëzit me pikëpamje false dhe të rrezikshme, të tilla si një “princ që për disa shkaqe mund të shkarkohet nga disa njerëz të caktuar” (Wolf, 1994: 272). Kurse Locke mendonte se pushteti qeveritar duhet të kufizohet (Laskar, 2013: 3). Sipas tij “nëse trupi qeverisës shkel ligjin natyror ai duhet të largohet nga pushteti” (Locke, 2005: 19-20).

Kontributi i Locke do të niste me punimin ‘*Ese për Njohjen Njerëzore*’, e cila merret me përcaktimin e kufinjve të kuptueshmërisë njerëzore në lidhje me Zotin, vetveten, natyrën dhe zejet (Locke, 2005: 13-14). Kurse vepra e parë politike e tij, ‘*Ese për Tolerancën*’, vendos një dallim të qartë midis publike dhe private, kur merr qëndrimin se lidhja ndërmjet njeriut dhe Zotit është një lidhje private, kurse shteti vepron në sferën publike (Locke, 2005: 15-16).

Në këtë ese, Locke do të prezantonte për herë të parë edhe kuptimin e tij mbi rolin e shtetit ndërsa nënvizonte se “Zyrtarit i jepet tërë besimi, pushteti dhe autoriteti jo për ndonjë qëllim tjetër, por veç për të mirën, mbrojtjen dhe paqen e njerëzve”, sepse “vetëm qëllimi për të cilën është ngritur [qeveria] duhet të jetë kuti i veprimtarisë së saj” (Locke, 2005: 21-22). Me pak fjalë, Locke, që në këtë punim fillestar mendon se roli i qeverisë duhet të vendosen në kufinj të nevojës për të arritur paqen dhe sigurinë e shtetasve dhe jo të kthehet në një synim më vete. Sipas Locke “Zyrtari [shteti] është vetëm arbitër ndërmjet njeriut dhe njeriut; dhe ai mund të më mbrojë prej fqinjit tim, por nuk mund të më mbrojë nga Zoti im” (Locke, 2005: 24).

Më tej, kontributi i Locke do të vijoj me dy Traktatet për qeverisjen civile. ‘*Traktati i parë për Qeverisjen*’ u shkrua menjëherë pas botimit të ‘*Patriarcha-s*’ nga sir Robert Filmer, i cili solli disa vepra. Filmer është mbështetës dhe mbrojtës i idesë se pushteti mbretëror duhet të jetë i pakufizuar. Ai besonte se ky pushtet absolut i është dhënë Mbretërve, si trashëgimtarë të Adamit, nga vet Krijuesi në formën e një “dhurimi zanafillor të qeverisjes” (Locke, 2005: 17;

Wallace, 1980: 155-165). Nëse i referohemi Wallace, Filmer beson se “Ligjet pozitive nuk çënojnë fuqinë natyrore [të dhuruar nga Krijuesi] dhe atësore [parternaliste] të Mbretërve” (Wallace, 1980: 159).

Këtë tezë të Filmer do të kundërshtonte Locke në dy nivele. Së pari duke argumentuar se Krijuesi nuk i dha një autoritet sundimtar Adamit, kur nënvizonte se “Sikur ky të ishte “dhurimi zanafillor i qeverisjes”, siç na thotë autori ynë, dhe Adami do të ishte bërë tani monark, atëherë, sido që ta quante sër Roberti [Filmer], është e qartë se Perëndia e bëri një monark shumë të mjerë” (Locke, 2005: 54). Perëndia e detyroi Adamin të punonte për të jetuar, i dha në dorë lopatën për të punuar tokën dhe jo skeptrin për të sunduar mbi banorët e saj (Locke, 2005: 55).

Për Locke, në fjalët e shkëputura nga Zanafilla 3.16, mbi të cilat mbështetet Filmer, “nuk përmendet asnjë dhuratë për Adamin, por, përkundrazi shprehet ndëshkimi ndaj Evës” (Locke, 2005: 56). Sipas tij, Krijuesi nuk i dha asnjë autoritet politik Adamit, as për faktin se ishte burrë dhe këtë e argumenton me mbretëreshat e mëvonshme britanike. Për Locke “Perëndia në këtë teks [që përmend Filmer] nuk i jep kurrfarë pushteti Adamit mbi Evën, ose burrave mbi gratë e tyre, po vetëm parathotë kush do jetë shorti i grave” (Locke, 2005: 56-57). Do të ishin këto argumente të Locke, që do të vërtetonin tezën e tij se Perëndia nuk i dha asnjë pushtet politik Adamit, aq më pak pushtet qeverisës të pakufizuar (Locke, 2005: 53-59).

Locke argumentonte se njerëzit duhet të binden për personin që ka të drejtë të ushtroj pushtet mbi ta, në të kundërt nuk do të kishte dallim midis piratëve që e marrin pushtetin me forcë dhe sovranëve të ligjshëm (Bobbio, 1963).

Locke besonte se Adamit nuk ju bë dhuratë në pronësi tokë, porse Zoti e krijoi njeriun dhe rrënjosi në të, ashtu si edhe në të gjitha kafshët e tjera, dëshirën e fortë të vetëruajtjes dhe për realizimin e shtimit të tij. Që njeriu të mbijetonte Krijuesi e mbushi botën plot me gjëra të përshtatshme për ti përdorur për ushqim dhe për nevoja e kërkesa të tjera jetësore (Locke, 2005: 63). Në këtë kuptim, çdo njeri me synimin e mbijetesës ka të njëjtat të drejta me Adamin për të përdorur gjithçka, përveç njerëzve, që Krijuesi vendosi në tokë (Laskar, 2013: 3).

Locke e trajtoi këtë çështje si të drejtat natyrore të njerëzve dhe në këtë kuptim i dha vlerë edhe konceptit të pronës private e cila “bazohej në të drejtën që kishte [njeriu] për të përdorur ato gjëra që ishin të nevojshme për ekzistencën e vet” (Locke, 2005: 64). Kurse e drejta e trashëgimisë nuk i takon asnjëherë kalimit të pushtetit politik (Locke, 2005: 61-74), por pronës së krijuar nga puna e ushtruar mbi një send natyror (Laskar, 2013: 4), me arsyetimin se “përderisa njerëzit janë të lidhur me një detyrim të tillë që të mbrojnë atë çka kanë lindur, ashtu

siç mbrojnë veten, pinjollët e tyre do të kenë të drejtë ndaj pasurisë që zotërojnë prindërit” (Locke, 2005: 65).

Kështu Locke do të rëzonte tezën e Filmer dhe shumë mbështetësve të monarkisë absolute, me arsyetimin e tij se “Adami nuk ishte monark, as monarkia e tij e përfytyruar nuk ishte e trashëgueshme. Pushteti, që tani ekziston në botë- nuk është ai që kishte Adami, sipas argumentimit të autorit tonë [Filmer], ose në bazë të pronës, ose në bazë të atësisë- do të vdiste medoemos bashkë me të dhe nuk mund t’u kalonte pasardhësve si trashëgim” (Locke, 2005: 75).

Argumenta të ngjashme kishte edhe Wallace, sipas të cilit përsa kohë Filmer tregonte për familjet e Adamit dhe Noes dhe pushtetin e këtyre të dyve mbi familjet respektive, ai ishte shumë i besueshëm. Por “Ai [Filmer] është i vështirë të ndiqet dhe të besohet vetëm kur përpiqet të shpjegojë se si ideja e atësisë, me të gjitha fuqitë dhe prerogativat e saj, i mbijeton peripeçive të vazhdueshme të dinastive mbretërore dhe zhdukjes së shpeshtë të trashëgimtarëve të vërtetë” (Wallace, 1980: 161).

Nëse ‘*Traktati i Parë për Qeverisjen*’ kishte synim refuzimin e doktrinës së të drejtës hyjnore të mbretëve të zhvilluar nga Filmer, sipas të cilës një qeveri e ligjshme është vetëm ‘monarkia absolute’ (Wallace, 1980), ‘*Traktati i Dytë për Qeverisjen*’ është vepra ku Locke ndërton pozitivisht filozofinë e tij (Locke, 2005: 53-59, 61-75).

Ky traktat do të pranohej gjerësisht si themeli i filozofisë politike të lirisë individuale dhe një kontenstim i palëkundur i autoritarizmit (Wolf, 1994; Bobbio, 1963). Do të ishin idetë liberale të kësaj vepre që do të frymëzonin revolucionet që sollën Monarkinë Kushtetuese në Britani, Republikën e Parë Franceze (Locke, 2005) si dhe Pavarësinë Amerikane (Laskar, 2013: 5).

Koncepti i parë që Locke do të na prezantonte në këtë vepër është “gjendja natyrore” e njeriut, e cila sipas tij është një “gjendje e lirisë së plotë [të individëve] për të vendosur për veprimet e tyre si dhe për ta disponuar pasurinë dhe personin e tyre si e mendojnë më të përshtatshme brenda të drejtës natyrore, pa kërkuar leje dhe pa u varur nga vullneti i dikujt tjetër” por gjithashtu “gjendje e barazisë, në të cilën gjithë pushteti dhe juridiksioni janë të ndërsjelltë - askush nuk ka më shumë se tjetri” (Locke, 2005: 79). Për Locke, nuk ekziston gjë më e qartë sesa fakti se krijesat e të njëjtit lloj dhe rang që prej lindjes, sikurse janë njerëzit, janë të barabartë midis tyre pa asnjë nënshtrim a shtypje. Referuar nga Laskar, “Gjendja Natyrore [e Locke] ishte para-politike, por jo e pamoralshme” (Laskar, 2013: 3).

Gjendja natyrore rregullohet nga e drejta natyrore; arsyeja, e cila përbën thelbin e kësaj të drejte, dhe i mëson të gjithë njerëzit se përderisa të gjithë janë të barabartë dhe të pavarur, asnjëri prej tyre nuk duhet të shkaktoj dëm jetës, shëndetit, lirisë ose pronave të tjetrit (Bobbio, 1963). Në këtë kontekst, Locke do të nënvizonte se “përderisa [individi] është i detyruar ta ruajë veten ..., duhet që për po atë arsye, ..., të ruajë me aq sa mundet pjesën tjetër të gjindjes njerëzore” (Locke, 2005: 81). Në këtë kontekst, do të nënvizonte Locke “në gjendjen natyrore secili ka pushtet ekzekutiv, i cili rrjedh nga e drejta natyrore”, ndërsa do të sqaronte se kjo mund të conte në anësi të vendimeve njerëzore apo akoma më keq në ndëshkime shumë të rrepta përshkak të karakterit të keq, pasionit apo shpirtit hakmarrës të njerëzve (Locke, 2005).

Një koncept tjetër po kaq i rëndësishëm i Locke është “gjendja e luftës” (Locke, 2005: 88-91), i cili është “një nga arsyet kryesore që njerëzit formojnë shoqëri [politike] dhe heqin dorë nga gjendja natyrore” (Locke, 2005: 91). Sepse “gjendja natyrore nuk mund të mbahet për një kohë shumë të gjatë” dhe “qeveria civile është zgjidhja” e të gjitha problemeve (Locke, 2005: 85; Laskar, 2013).

Njerëzit heqin dorë nga të drejtat natyrore, për tu bashkuar në një shoqëri politike (Locke, 2005: 127-139). Por meqë asnjë shoqëri politike nuk mund të mbijetojë pa patur pushtetin për të ndëshkuar krimet e të gjithë antarëve të shoqërisë, atëherë “çdo gjyq privat i çdo antari të veçantë përjashtohet dhe komuniteti bëhet arbitri” (Locke, 2005: 132).

Shoqëria politike, sipas Locke funksionon falë rregullave të përhershme, të paanshme dhe të njëjta për të gjithë, nëpërmjet njerëzve që kanë marrë nga komuniteti fuqi e autoritet për të vënë në jetë këto rregulla. Mbi këtë strukturë pushteti zgjidhen të gjitha mosmarrveshjet, që mund të lindin midis anëtarëve të shoqërisë në lidhje me çdo çështje të së drejtës, dhe ndëshkohen me dënime të parashikuara prej ligjit, ato krime që një antar ka kryer ndaj saj (Locke, 2005: 132).

E gjitha kjo, thotë Locke, ndodh kur një numër njerëzish në gjendje natyrore hyjnë në një shoqëri politike për të formuan një popull të vetëm, një trup politik të vetëm në një qeveri supreme (Laskar, 2013: 4). Kjo do të thotë se çdo individ i përfshirë në këtë organizim, apo që i bashkohet më tej, autorizon shoqërinë ose çfarë është e njëjta gjë në kuptimin e Locke, qeverinë e saj që të bëj ligje për të, siç e kërkon e mira publike e shoqërisë (Bobbio, 1963).

Për të kuptuar sesi një shoqëri politike e njerëzve të barabartë funksionon dhe merr vendime të drejta që respektohen nga të gjithë, Locke prezanton konceptin “vendim i shumicës” dhe shpjegon se “nënshtrimi ndaj vendimit të shumicës” i çdo antari të trupit politik është i

domosdoshëm që një popull i vetëm të lëvizë në një drejtim të vetëm (Bobbio, 1963). Me prezantimin e mënyrës së krijimit të shtetit, Locke kujdeset të na prezantojë me dy pushtetet që përbëjnë shtetin liberal: pushtetin legjislativ dhe pushtetin ekzekutiv, dhe marrdhëniet mes tyre (Locke, 2005: 133-139, 177-183), ku pushteti legjislativ dominon dhe “duhet doemos të jetë suprem” (Locke, 2005: 177).

Për filozofinë liberalo-klasike një shtet “Nuk duhet të realizohet për asnjë qëllim tjetër përveç paqes, sigurisë dhe të mirës publike të popullit”, cili është i detyruar të qeverisë: (i) sipas ligjeve të qëndrueshëm dhe në fuqi, të shpallura e të njohura nga populli, dhe jo nëpërmjet vendimesh të improvizuara; (ii) të bëjë drejtësi me gjykatës të paanshëm dhe të drejtë, të cilët duhet të zgjidhin grindjet nëpërmjet këtyre ligjeve; (iii) të përdorë forcën e komunitetit vetëm për ekzekutimin e ligjeve të tilla brenda vendit; (iv) dhe për të parandaluar ose për të zhdëmtuar dëmin e shkaktuar nga të huajt dhe për të mbrojtur komunitetin nga pushtimi dhe sulmet nga jashtë (Locke, 2005: 162).

Ky ishte përkufizimi i rolit dhe madhësisë së shtetit në një shoqëri që organizohet dhe funksionon mbi filozofinë politike të liberalizmit klasik, sepse “njeriu nuk i dorëzoi të gjitha të drejtat e tij, por vetëm të drejtën për të ruajtur/mbajtur rregull dhe për të zbatuar ligjin e natyrës” (Laskar, 2013: 4).

Për Locke, një qeverisje liberale nuk mund të jetë as paternaliste, sepse pushteti paternal, që ai insistonte ta cilësonte si “pushtet prindëror” nuk është i njëjtë me pushtetin politik (Locke, 2005: 111-126; Bobbio, 1963).

Pushteti prindëror ka lidhje me detyrën e prindit, sipas të drejtës natyrore, për ti mbrojtur, për ti ushqyer dhe për ti edukuar fëmijët që lindnin, derisa këta të arrijnë në një moshë për të merituar të drejtën e barabartë për lirinë e vet natyrore (Locke, 2005: 113, 190).

Kurse pushteti politik është një pushtet që çdo njeri e kishte në gjendjen natyrore dhe e kaloi në duart e shoqërisë. Shoqëria ua dha pastaj qeveritarëve, që i ka vënë mbi veten me besim të shprehur apo të heshtur “për ta përdorur këtë pushtet në të mirën e antarëve të saj dhe për të mbrojtjen e pronës së tyre” (Locke, 2005: 191). Ai rrjedh nga përzgjedhja me vullnet të lirë të qytetarëve, ku vet “populli do t’i zgjedhë përfaqësuesit e vet në bazë të rregullave të drejta dhe, natyrisht, të barabarta” (Locke, 2005: 183), dhe funksionon mbështetur në ligje të miratuara me “pëlqimin e shoqërisë” (Locke, 2005: 165-169; Bobbio, 1963).

3.1.2. Evolucionin në dy liberalizma mbi parime të ndryshme (libertarianizëm vs. liberalizëm egalitar).

Konceptet bazike të filozofisë liberalo-klasike do të merrnin kuptim praktik në vendeve që i pranuan këto ideale (Bobbio, 1963). Për Britaninë do ta prezantonte Spencer, nëpërmjet kontraditës ideologjike mes dy partive kryesore të Anglisë së shekullit të 19-të, Vigët dhe Torët, në lidhje me autoritetin e Mbretit të Britanisë. Sipas tij, “Vigët e shikonin monarkinë si institucion civil” të ndërtuar nga kombi për të mirën e të gjithë pjestarëve të tij; për Torët, “monarku ishte i caktuari prej qiellit”. Këto doktrina përplaseshin përkatësisht, në rastin e parë, idenë se nënshtrimi i qytetarit ndaj sundimitarit është i kushtëzuar, ndërsa në rastin e dytë është i pakushtëzuar (Spencer, 2005: 16-17).

Pricipet e Vigëve materializoheshin: nga Akti Habemas Corpus, i cili synonte pavarësinë e gjyqtarëve nga Mbreti (Locke, 2005: 22); nga Deklarata për Provën e Moskundështimit, e cila detyronte ligjvënësit dhe funksionarët e lartë të betoheshin se në asnjë rast nuk do ti kundëviheshin Mbretit me armë; apo nga Deklarata e të Drejtave, e cila ju jepte garanci nënshtetasve kundrejt dhunimeve monarkike (Spencer, 2005). Të gjitha këto akte, kishin në thelb dobësimin e “bashkëpunimit të detyrueshëm” (Spencer, 2005:17). Pra, fuqizimin e qytetarit në aktivitetet e ndryshme shoqërore, sikurse do ta nënvizonte Spencer “Me anë të Deklaratës së Reformës dhe të Pushtetit Vendor, u ngushtuan zonat e skllavërisë politike të atyre që nuk përfaqësoheshin” (Spencer, 2005:18). Sipas tij, si në rafshin e përgjithshëm, edhe në rafshin vendor, sundimi i pakicës ndaj shumicës u zbut, dhe kjo dëshmon rëndësinë që kishte për liberalët klasik të shekullit të 19-të, qeverisja në dy nivele.

Po kështu Friedman, ndërsa prezantonte tezën e tij mbi marrdhënien e pandahshme midis lirive ekonomike dhe lirive politike të shtetasve, identifikoi nevojën e prezantimit të parimeve liberale. Një temë e rëndësishme e kontributit të tij ishte roli që duhet të luajë qeveria në një shoqëri të dedikuar ndaj lirisë dhe tregut të lirë për organizimin e veprimtarisë ekonomike (Friedman, 2005: 4).

Cilësimi më i drejtë i tezave të tij ishte liberalizmi, por ai thekson se e ka fjalën për liberalizmin e shekullit të 19-të në ShBA, kohë kur lëvizja intelektuale liberale theksonte lirinë si qëllimin më të lartë dhe individin si subjektin më të rëndësishëm (Friedman, 2005). Kjo lëvizje mbështeste teorinë e ‘laissez-faire’ brenda vendit, si një mjet për të zvogëluar rolin e shtetit dhe rritur rolin e individit në ekonomi. Kurse në aspektet politike “mbështeste zhvillimin e qeverive

përfaqësuese dhe institucioneve parlamentare, kufizimin e pushtetit arbitral të shtetit dhe mbrojtjen e lirive civile të individëve” (Friedman, 2005: 5).

Friedman, sikurse Spencer, rendiste si parime kryesore të liberalëve: zvogëlimin e fushëveprimtarisë së qeverisjeve; ndarje të fushëveprimtarisë së qeverisjes në qeverisje qendrore dhe qeverisje lokale; dhe fuqizimin e qytetarit, nëpërmjet “bashkëpunimit vullnetar” (Friedman, 2005). Ata kujdesen të theksojnë se po flasin për parimet fillestare të liberalëve, të cilat janë të ndryshme nga ato të liberalëve të mëvonshëm (Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Spencer do të prezantonte një evoluim të qartë të liberalizmit, kur theksonte “duket e nevojshme që ti kujtoj gjithësecilit, çfarë ka qënë liberalizmi në të kaluarën, në mënyrë që të shihet pangjashmëria e tij me të ashtuquajturin liberalizëm të tanishëm”, dhe se “liberalizmi ka përvetësuar gjithmon e më tepër politikën e imponimit ndaj veprimeve të qytetarëve dhe, si rrjedhojë, atë të ngushtimit të hapsirës, në të cilën veprimet e tyre mbeten të lira” (Spencer, 2005: 19).

Në këtë kontekst Friedman do të nënvizonte se “Duke nisur nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe veçanërisht pas viteve 1930 në Shtetet e Bashkuara, termi liberalizëm filloi ti vishej një kuptim krejtësisht i ndryshëm veçanërisht në lidhje me politikën ekonomike” (Friedman, 2005: 5). Liberalizmi i shekullit të 20-të filloi të mbështetej më shumë te shteti sesa te marrveshja private dhe vullnetare, dhe deviza e tij ishte mirëqënie dhe barazi në vend të lirisë. Sikurse do ta nënvizonte Friedman “filloi të mbështesë një ringjallje të politikave të ndërhyrjes shtetërore dhe paternalizmit kundër të cilave ka luftuar përherë liberalizmi klasik” (Friedman, 2005: 6).

Një ndryshim tjetër që vërehet nga Friedman, ishte se “liberali i shekullit të 19-të, favorizon decentralizimin politik”, kurse “liberali i shekullit të 20-të favorizon qeverisjen e centralizuar” (Friedman, 2005: 6).

Dy autorë të tjerë bashkëkohor amerikan janë Forbes dhe Ames, të cilët në vitin 2015, në librin e tyre *‘Ringjallja e Amerikës’* do të ngrinin të njëjtin shqetësim mbi spostimin majtas të liberalizmit. Ndër të tjera do të ngrinin dy probleme të mëdha në filozofinë e qeverisjes liberale të USA. Së pari trajtimin e ekonomisë sikur të ishte një makinë; dhe së dyti nivelin e lartë të taksimit, si dy elementë bazikë të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi (Forbes dhe Ames, 2015). Për ta, janë gabimet katastrofike të “qeverisë së madhe” që e helmuan mjedisin e biznesit në USA gjatë depresionit të madh në vitet ’30-të, në krizën e viteve ’70-të dhe së fundi në atë të 2008-2009 (Forbes dhe Ames, 2015).

Këta bëjnë apel për nevojën e konservatorizmit në qeverisjet e ardhshme të USA, të frymëzuar nga parimet e baballarëve të amerikës. Por sipas Friedman për të përkufizuar konservatorizëm liberalizmin klasik “nuk është një alternativë e kënaqshme” (Friedman, 2002: 6). Kjo kundërshti e Friedman është e kuptueshme, përderisa vet liberalizmi lindi si një kundërshti e konservatorizmit (Locke, 2005; Spencer, 2005).

Arthur Brooks, President i Institutit Amerikan të Sipërmarrjes, në librin e tij *‘Kush me të vërtetë kujdeset: E vërteta befasuese rreth konservatorizmit të dhembshur’*, në vitin 2007, prezanton ndër të tjera spostimin majtas të liberalëve amerikan. Ai e argumenton këtë edhe nëpërmjet shembullit të programit ‘Luftë kundër varfërisë’ që Presidenti Lindon Xhonsn shpalli në programin e tij në 1966, dhe financohet në shifra të larta sa herë demokratët drejtojnë vendin (Brooks, 2007).

Po kështu, Peter Wallison, ish këshilltar i Presidentit Regan dhe një antarët e Komisionit të Invetigimit të Krizës Financiare, i cili u ngrit nga Kongresi në 2009 për të studiuar çfarë e shkaktoi krizën e vitit 2008. Ai në librin e tij *‘Fshehur në shikim të parë; Çfarë e shkaktoi realisht krizën financiare dhe pse ajo mund të ndodhi përsëri’*, do të prezantonte se ishin programet me qasje etatiste të strehimit social të ndjekura në Amerikë përgjatë një dekade, që e sollën krizën e vitit 2008. Edhe për Wallison, liberalizmi amerikan ka shfaqur tendencën të shkoj gjithmon e më shumë majtas, dhe kjo krizë e vërteton këtë (Wallison, 2016).

Një dallim të qartë parimor midis liberalizmit modern dhe liberalizmit klasik na prezantohet nëpërmjet kontributit filozofik të Xhon Rolls. Tezat e tij origjinalizojnë nga debati në lidhje me marrdhënien midis “barazisë politike” dhe “drejtësisë shoqërore” (Rawls, 1975, 1985, 1995, 1997, 2007; Fuga, 2003). Sipas Fugës, për Rolls “Nuk mund të ketë barazi politike nëse shoqëria nuk kujdeset për të ekuilibruar disi pabarazitë shoqërore” (Fuga, 2003: 139).

Rolls mendonte se “Kontrata Sociale” duhet ti përshtatet përvojës dy shekujve që kanë kaluar. Nëse në fillim, qytetari hoqi dorë nga disa të drejta duke ja deleguar këto të drejta një institucioni të paanshëm sikurse është shteti, tashmë ka ardhur koha të shkojmë më tej (Rawls, 2007), sepse tashmë “marrdhëniet e qytetarëve me shtetin nuk i nënshtrohen njëres nga kërkesat bazë të demokracisë: barazisë së qytetarëve përpara ligjit” (Fuga, 2003: 143).

Për Rolls “Në një regjim demokratik me stabilitet, kooperimi bazohet në faktin se më të shumtët e qytetarëve e pranojnë si legjitim rendin politik, apo gjithësesi nuk e konsiderojnë si tepër ilegjitim, dhe rrjedhimisht janë të gatshëm ta respektojnë” (Rawls, 2007: 213). Porse Rolls

këmbëngul vazhdimisht se problemi kryesor i Liberalizmit është mungesa e stabilitetit (Nussbaum, 2011: 2).

Rolls beson se një shoqëri nuk do të mbetet e qëndrueshme me kalimin e kohës, ose të paktën jo “për arsyet e duhura”, nëse trajton individë ose grupe me mungesë respekti (Nussbaum, 2011: 2). Për këtë Rolls propozonte “(a) marrëveshja fillestare duhet të jetë unanime, dhe (b) palët, me konceptimet e tyre për të mirën, duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë” (Rawls, 1975: 536).

Pabarazia funksionon në të gjitha aspektet e tjera të jetës, sipas Rolls, duke qenë se një grup njerëzisht kanë trashëguar nga familjet të ardhura dhe asete, kanë mundësi të realizojnë një sukses më të lehtë se pjesa tjetër e popullsisë, duke i privilegjuar ata (Rawls, 1997: 765; Fuga, 2003:148).

Për të korrigjuar këto padrejtësi, Rolls prezanton konceptin e “drejtësisë sipas hakut” e cila përbëhet nga dy lloj drejtësisë: “drejtësinë liberale” ku të gjithë janë njësoj të barabartë përpara ligjit; dhe “drejtësinë korrigjuese” e cila do të korrigjoj padrejtësitë e krijuara nga ekonomia e tregut të lirë dhe konkurrenca e lirë (Rawls, 2007; Fuga 2003).

Në këtë kontekst, Rolls do të sillte konceptin e tij për “shoqërinë e rregulluar mirë”, në të cilën: (i) të gjithë pranojnë, dhe e dinë që të tjerët pranojnë, të njëjtat parime të drejtësisë; (ii) institucionet themelore shoqërore strukturohen në një skemë që pëlqehet dhe besohet nga të gjithë, se ato institucione funksionojnë për të përmbushur këto parime të drejtësisë (Rawls, 1975: 547).

Rolls i largohet dy koncepteve liberalo-klasike të “bashkëpunimit vulëtar” të individëve të lirë dhe “bashkëpunimit të detyruar”, ku ky i dyti synohet të kufizohet në kufijtë e mbrojtjes së të drejtave natyrore (Laskar, 2013: 4; Locke, 2005). Sipas Nussbaum në vitin 2011 “Në zemër të argumentit të Rawls janë dy ide të lidhura ngushtë: ideja e respektit (ose respekti i barabartë) dhe ideja e ‘kushteve të drejta të bashkëpunimit’” (Nussbaum, 2011: 1).

Rolls sikurse Habermas pretendon se ndryshimet që ai mendon se duhet bërë organizimit liberal të shoqërive moderne origjinalizojnë nga klasikët. Sepse këto dy ide të tij, respekti i barabartë dhe kushtet e drejta të bashkëpunimit, shoqërohen nga nocini i dinjitetit njerëzor, sikurse do të nënvizonte Nussbaum “Për Rawls si për Kantin, dinjiteti është sinonim i respektit: Arsyeja pse respekti është aq themelor është se njerëzit kanë dinjitet” (Nussbaum, 2011: 2).

Edhe sipas Fugës teoria e Rolls “është zhvillim i teorive demokratike bazë të përpunuara në shekujt 17-të dhe 18-të nga themeluesit e frymëzimeve dhe ideve demokratike, Zhan Zhak Ruso, Xhon Lok, Emanuel Kanti etj.” (Fuga, 2003: 139-140).

Po kështu për Habermas, i cili nënvizoi se “Pa mbështetur supozimet fillestare filozofike transcendentale të Kant, Rawls e rinovoi qasjen e tij teorike duke iu referuar veçanërisht çështjes së organizimit të një shoqërie të drejtë.” (Habermas, 1995: 109)

Por sipas Nussbaum nuk gjendet një lidhje ekskluzive e ideve rollsiane me idetë kantiane, sepse “ato [kantiane] janë ide që ndahen gjerësisht dhe thellësisht në të gjithë traditat etike dhe fetare.” (Nussbaum, 2011: 2).

Në këtë kontekst, Rolls do të prezantonte dy parimet e teorisë së tij të dretësisë. Sipas parimit të parë çdo person ka njëjtën të drejtë ndaj një skeme plotësisht adekuate të të drejtave dhe lirive themelore. Kurse sipas parimit të dytë, pabarazitë sociale dhe ekonomike duhet të trajtohen në dy rrugë: së pari, nëpërmjet institucioneve të shtetit, në kushtet e mundësive të barabarta; dhe së dyti, ato duhet të jenë në përfitimin më të madh të anëtarëve më pak të avantazhuar të shoqërisë (Rawls, 1985). Rolls do të nënvizonte se “Të dy parimet së bashku, kur të parit i jepet përparësi ndaj së dytit, rregullojnë institucionet themelore që realizojnë këto vlera” (Rawls, 1985: 227).

Në librin e tij *‘Drejtësia si paanshmëri’* do ta riformulonte qëndrimin e tij kur nënvizon se “Çdo person ka të drejtën e patjetërsueshme për një sistem plotësisht adekuat lirish themelore të barabarta, i cili është i papajtueshëm me të njëjtin sistem lirish për të gjithë” (Rawls, 2007: 88). Ajo që Rolls argumenton në *‘Teorinë e Drejtësisë’* dhe *‘Drejtësia si Paanshmëri’*, është se një shoqëri e drejtë duhet t’u japë njerëzve një spektër të gjerë lirish, për sa i përket barazisë, dhe do të rregullojë çështjet ekonomike në mënyrë që pabarazitë të lejohen vetëm kur ato përmirësojnë nivelin e personave më të varfër (Nussbaum, 2011: 3).

Të njëjtë ide do të nënvizonte edhe Habermas, sipas të cilit Rolls shpjegon pse palët do të bien dakord për dy parime: së pari, mbi parimin liberal, sipas të cilit të gjithë kanë të drejtë për një sistem të barabartë të lirive themelore, dhe, së dyti, mbi një parim dytësor që krijon qasje të barabartë në zyrat publike dhe kujdest që pabarazitë shoqërore të jenë të pranueshme vetëm kur ato janë në avantazh të më pak të privilegjuarve (Habermas, 1995: 110).

Në punimin e tij *‘Drejtësia si paanësi: Politike jo Metafizike’* Rolls do të theksonte se teoria e tij që kërkonte korrigjim të konceptit drejtësi duke favorizuar më të pafavorizuarit, ishte mbi të gjitha politike (Rawls, 1985). Ai do të nënvizonte se “Një gjë që nuk arrita të them në Teorinë

e Drejtësisë, ose nuk arrita të theksoj sa duhet, është se drejtësia si paanësi synon të përmbush konceptin e drejtësisë politike” dhe do të vijonte më tej se “Në veçanti, drejtësia si paanësi është e vendosur të zbatohet për atë që unë e kam quajtur “struktura themelore” e një demokracie kushtetuese moderne” (Rawls, 1985: 224).

Por pozicioni pro “bashkëpunimit të detyrueshëm” i qasjes së Rolls do të shpalosej në konceptin e tij të “arsyes publike” të cilën ai i lidhte me konceptin tjetër të tij të “shoqërisë së rregulluar mirë”. Referuar Rolls “Forma dhe përmbajtja e kësaj arsyeje [publike] - mënyra se si kuptohet nga qytetarët dhe si i interpreton marrëdhëniet e tyre politike- është pjesë e vetë idesë së demokracisë” (Rawls, 1997: 765). Për të, ideja e arsyes publike specifikon në nivelin më të thellë vlerat themelore morale dhe politike që shërbejnë për të përcaktuar marrëdhëniet e një qeverie demokratike kushtetuese me qytetarët e saj dhe lidhjen e qytetarëve mes njëri-tjetrit (Rawls, 1997: 766)

Përveç Nussbaum në vitin 2011, një autor tjetër që e dallon dhe e prezanton qasjen etatiste të Rolls është edhe Brennan në vitin 2007. Ai do të nënvizonte se teoria e drejtësisë së Rolls është paradoksale, sepse kërkon që një shoqëri të synojë në mënyrë të drejtpërdrejt të maksimizoj mirëqënien e më pak të avantazhuarit, megjithëse synimi i drejtpërdrejtë është vetë-shkatërrues (Brennan, 2007). Sipas tij, Rolls është një antikapitalist, dhe sikurse do ta nënvizonte “Arsyet e Rawls për refuzimin e sistemeve kapitaliste e angazhojnë atë të mendojë se një shoqëri nuk duhet thjesht të maksimizojë të mirat që marrin më pak të favorizuarit, por duhet ta bëjë këtë përmes institucioneve specifike [qeverisëse]” (Brennan, 2007: 287).

Edhe për Brennan, teoria rollsiane kërkon zgjerimin e fushëveprimtarisë së qeverisë, nëpërmjet legjislacionit, institucioneve publike dhe buxheteve publike, për ti materializuar në praktikë kostot publike të “drejtësisë korrigjuese”, e cila synon që të sjelli “drejtësinë sipas hakut”. Thelbi i teorisë së Rolls për drejtësinë, drejtësia si paanshmëri, qëndron te parimi i pabarazive. Porse Rolls gabon, sikurse do të nënvizonte Brennan, sepse në planin afatgjatë synimi i drejtpërdrejtë për të përmbushur parimin e pabarazive dëmton interesat e të varfërve, megjithëse ka për qëllim t'i ndihmojë ata. Kjo sepse “rekomandimet institucionale të Rawls minojnë më shumë sesa mbështesin dëshirën e tij për rishpërndarje” (Brennan, 2007: 288).

3.1.3. Shteti social si një kthesë drejt etatizmit (Rawls, Habermas dhe Mouffe).

Në dinamikat e liberalizmit përgjatë shekullit të 20-të, dallohet edhe filozofia e socializmit demokratik apo “demokracisë së masave” (Fuga, 2003; Habermas, 2006). Kjo rrymë e

filozofisë politike, e prezantuar në këtë punim nëpërmjet veprës së filozofit gjerman Jurgen Habermas, ka në thelb tezën se dizajni institucional i demokracive moderne bashkon tre elementë: së pari, autonominë private të qytetarëve, çdonjëri prej të cilëve ndjek një jetë të tijën ose të sajën; së dyti, qytetarinë demokratike, domethënë përfshirjen e qytetarëve të lirë dhe të barabartë në bashkësinë politike; dhe së treti, pavarësinë e një sfere publike që funksionon si një sistem ndërmjetës midis shtetit dhe shoqërisë (Habermas, 2006: 412).

Katarzynan në vitin 2019, duke ju referuar teorisë së ‘veprimit komunikativ’ të Habermas do të nënvizonte se ideja e demokracisë diskutuese është ndoshta homologu më i fuqishëm i demokracisë liberale (Katarzyna, 2019). Ajo argumenton se “Jurgen Habermas është një nga përfaqësuesit dhe burimet kryesore të frymëzimit për qasjen diskutuese të demokracisë” (Katarzyna, 2019: 2).

Po kështu Fuga në vitin 2003, duke e prezantuar atë si një përfaqësues primar të kësaj rryme filozofike politike, do të nënvizonte se “Habermas ka përpunuar një teori të tërë, me influenca të fuqishme sot në mendimin filozofik dhe politik perëndimor” (Fuga, 2003: 42).

Sipas vet Habermas, midis liberalizmit dhe ‘veprimit komunikativ’ ka një diferencë, sepse “Tradita liberale prezanton preferencën për liritë e qytetarit, ndërsa traditat republikane dhe ato komunikative theksojnë pjesëmarrjen politike të qytetarëve aktivë dhe formimin e opinioneve publike” (Habermas, 2006: 412).

Ne e kemi sjellë teorinë e ‘veprimit komunikativ’ në këtë pjesë të punimit për dy arsye. Së pari sepse një nga elementët më të rëndësishëm të filozofisë habermasiane është përfshirja e qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset politike (Habermas, 2006: 412, 2006: 147) dhe përfshirja e një qasje të majtë në një debat mbi fuqizimin e qytetarit në qeverisje është bazike për të bërë dallimin midis të dyja qasjet liberale (klasike dhe moderne). Së dyti, sepse vet Habermas e gjen veten disi më majtas sesa Rolls kur thekson se “Kam frikë se Rawls bën lëshime ndaj pozicioneve të kundërta filozofike [klasike] të cilat dëmtojnë korrektësinë e projektit të tij.” (Habermas, 1995: 110).

Që në prezantimin e saj, filozofia habermasiane kërkon ti japi tregut të lirë një dimension social, çfarë e shton atë në të majtë në aksin ‘djathtas-majtas’. Sipas Fugës, në kohët moderne demokracia habermasiane e masave, nuk mund të ketë si plotësim të saj veçse me ekonominë sociale të tregut (Fuga, 2003: 41). Për Habermas, sipas Fugës, pasojat shoqërore të dhimbshme të konfliktit klasor nuk mund të mbahen të veçuara nga hapsira publike e politikës, prandaj

“Nëpërmjet kësaj rruge, shteti social nis të bëhet përmbajtja politike e demokracisë së masave” (Fuga, 2003: 42).

Habermas pranon se shoqëritë e sotme demokratike kanë siguruar një nivel mirëqënie masive dhe të pakrahasueshëm me nivelin ekonomik të para kësaj periudhe apo të vendeve jashtë zonës së demokracive liberale dhe një nivel nga më të përparuarit dhe demokratikët të zbatimit në praktikë të të drejtave dhe lirive qytetare (Habermas, 2010; Fuga, 2003). Përtej këtyre avantazheve, Habermas dallon se shoqëria perëndimore gjendet në kontraditë të thellë “midis faktit që ajo është një shoqëri e mbështetur mbi pronën private dhe që, nga ana tjetër, bazohet politikisht në një demokraci të shtetit të të drejtës” (Fuga, 2003: 42).

Teoria filozofike liberale dhe revolucionet që u frymëzuan prej saj, u zhvilluan duke u mbështetur në dy parudha themelore veprimi politik “Parudha e parë ka të bëjë me shpalljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ndërsa parudha e dytë me garantimin e të drejtave të qytetarit” (Fuga, 2003: 43-44), që shpesh ngatërohen me njëra tjetrën porse sipas Fugës, janë shumë të ndryshme. Prandaj filozofia habermasiane ngrihet mbi premisën se “Për shkak të karakterit të tyre abstrakt, të drejtat themelore duhet të përcaktohen në terma konkretë në secilin rast të veçantë” (Habermas, 2010: 467).

Parudha e sigurimit të lirive të njeriut ka kuptimin e ndarjes së shoqërisë civile nga shteti por kjo kërkesë vinte nga borgjezia, e cila kishte krijuar pasuri, dhe që kërkonte ta shkëpuste atë nga kontrolli i pushtetit autoritar të monarkive absolute të kohës. Sipas Habermas koha e “të drejtave negative” ishte koha “kur parlamentarizmi dhe shtypi masiv u krijuan nën flatrat mbrojtëse të liberalizmit të herët [klasik]” (Habermas, 2006: 147).

Habermas i lidh “drejtat e qytetarit” me “dinjitetin njerëzor”, dhe beson se dinjiteti njerëzor është “burim” moral nga i cili rrjedhin të gjitha të drejtat themelore të njeriut dhe kuptimi i tyre (Habermas, 2010). Sipas tij “Ideja e dinjitetit njerëzor është mentesha konceptuale që lidh moralin e respektit të barabartë për të gjithë me ligjin pozitiv dhe ligjbërjen demokratike në një mënyrë të tillë që bashkëveprimi i tyre të mund të shkaktojë një rend politik të bazuar në të drejtat e njeriut” (Habermas, 2010: 469).

Konceptin themelor të “dinjitetit njerëzor”, Habermas na e prezanton të pranuar në shumë dokumenta politike dhe juridike më të rëndësishëm në rang global. Një ndër të cilët Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane, gjashtëdhjetë vite më parë, në nenin 1 do të nënvizonte se “Dinjiteti njerëzor është i paprekshëm” (Habermas, 2010: 466). Ai do ta dallonte këtë që në fillimet e shekullit të 20-të, ku “Kushtetuta e Republikës së Weimar më 1919, e cila

ishite pioniere e prezantimit të të drejtave sociale, ofron një shembull të kësaj. Në nenin 151 teksti flet për ‘arritjen e një jete dinjitoze për të gjithë’” (Habermas, 2010: 468). Referuar Habermas edhe “Neni 22 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut tashmë kërkon garanci të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në mënyrë që çdo individ të jetojë në kushte që janë ‘të domosdoshme për dinjitetin e tij dhe zhvillimin e lirë të personalitetit të tij’” (Habermas, 2010: 468).

Demokracia e masave do të sillte një këndvështrim të ri në mënyrën e të parit të çështjes së marrdhënies së shtetit me ekonominë. Habermas shprehet se në kohët e sotme është e vështirë të konceptohet një demokraci e zhvilluar pa iniciativën e lirë ekonomike, apo një shtet që e gllabëron ekonominë brenda vetes duke u bërë pronar dhe administrator i plotë dhe absolut i saj sepse “diktatura dhe totalitarizmi e kanë rrugën të hapur” (Fuga, 2003: 43). Nga ana tjetër “Shoqëria e tregut të lirë është një shoqëri që prodhon pabarazi të mëdha shoqërore dhe ekonomike” (Fuga, 2003: 43). Dhe këtu lind kontradita e demokracive liberale, sipas Habermas, nga njëra anë kemi një shoqëri që në planin ekonomik dhe shoqëror prodhon pabarazi, kurse nga ana tjetër demokracia e shtetit të së drejtës prodhon barazi politike të të gjithë qytetarëve në të drejta dhe detyra (Habermas, 1976, 1995).

Në analizën që i bën revolucioneve liberalo-klasike, Habermas, prezanton pretendimin se në atë kohë “Ende nuk njiheshin mirë mekanizmat dhe pasojat e tregut të lirë kapitalist” (Fuga, 2003: 45). Këto ishin arsytet pse filozofia e liberalizmit klasik dhe revolucionet e frymëzuara prej saj shfaqën vetëm këtë kërkesë të parë, atë për të drejtat e njeriut. Kjo është vetëm në dukje, sipas Habermas, sepse vëzhguar më thellë do të dallojmë se kërkesat prezantoheshin në dy nivele: të drejta negative dhe të drejta pozitive (Fuga, 2003: 45-58; Habermas, 1976, 1995).

Sipas Habermas “Që nga fillimi, ka ekzistuar një tension dialektik midis të drejtave të njeriut dhe të drejtave civile që mund të shkaktojnë një dinamikë që i përforcon reciprokisht në kushte të favorshme historike” (Habermas, 2010: 476).

Kërkesa e parë e lëvizjeve politike të frymëzuara nga liberalizmi klasik kërkonte që shteti të kufizohej brenda sferës së politikës dhe marrdhënies publike, duke vendosur një vijë kufizuese midis tij dhe shoqërisë (Habermas, 1976, 2006). Habermas, do të nënvizonte se “Të drejtat liberale, të cilat fokusoheshin rreth paprekshmërisë dhe sigurisë së personit, rreth tregtisë së lirë dhe rreth ushtrimit të papenguar të fesë, janë krijuar për të parandaluar ndërhyrjen e shtetit në sferën private.” (Habermas, 2010: 468).

Mbi “të drejtat negative”, Habermas do të dallonte edhe disa të drejta të tjera të cilat do ti gjente te veprat e klasikëve të filozofisë dhe të mendimit demokratik si Locke, Spinozës, Kantit, Volterit, Rusoit, dhe të tjerë (Fuga, 2003). Referuar Fugës, sipas klasikëve, mjaftonte që të vendosej logjika e një kontrate të individit me shtetin, mjaftonte të likujdohej pushteti politik jodemokratik i mbështetur mbi arbitraritetin, mjaftonte të kufizohej negativisht sfera publike, mjaftonte të pohohej pavarësia e shoqërisë civile dhe të gjitha këto procese do të garantonin “sigurimin e barazisë shoqërore, lulëzimin e interesave ekonomike të gjithësecilit, zbatimin e drejtësisë shoqërore dhe solidaritetit shoqëror” (Fuga, 2003: 46).

Habermas vet, do të nënvizonte se “Edhe te Kant, [Doktrina e të Drejtave] të drejtat e njeriut marrin përmbajtjen e tyre morale, që materializohen në gjuhën e ligjeve pozitive, nga një konceptim universalist dhe individualist i dinjitetit njerëzor.” (Habermas, 2010: 473).

Në interpretimin habermasian të klasikëve, ideja dhe kërkesat për të “drejta pozitive” për masat, në fazën fillestare, ishte zëvendësuar nga kërkesa e borgjezisë për liri dhe “të drejta negative”. Sikurse do ta nënvizonte Fuga “në fillim kërkesat demokratike kishin më specifikisht një karakter elitar, borgjez, të djathtë, sesa një natyrë popullore dhe të majtë” (Fuga, 2003: 46-47). Koncepti i “të drejtave pozitive” habermasiane ka të bëjë me “të drejtat qytetare” dhe quhen kështu sepse të drejtat e qytetarit nënkuptojnë pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të qytetarëve në administrimin e çështjeve publike. Këto të drejta quhen pozitive sepse nuk kanë natyrë privuese, mohuese apo kufizuese, por karakterizohen nga një tipar pohues, dhënës (Fuga, 2003: 47-48).

Për Habermas “Këto elemente formojnë themelin normativ të demokracive liberale (pavarësisht nga larmia e ndryshimeve në tekstet kushtetuese dhe rendet ligjore, praktikat dhe institucionet politike)” (Habermas, 2006: 412). Ai propozon se “Sa më thellë të përhapura në sistemin juridik në tërësi të jenë të drejtat civile, aq më shumë ndikimi i tyre shtrihet përtej marrëdhënies vertikale midis qytetarëve individualë dhe shtetit dhe përshkon marrëdhëniet horizontale midis individëve dhe grupeve” (Habermas, 2010: 469).

Gjatë shekullit të 19-të dhe gjysmës së parë të shekullit të 20-të u vu re se shoqëria civile megjithëse e kishte fituar pavarësinë prej jetës politike, nuk arrinte dot të siguronte të drejtat politike të qytetarit në atë masë që ishte e kërkuar (Habermas, 2010; Fuga, 2003). Por “Pas dyqind viteve të historisë moderne kushtetuese, ne kemi një kuptim më të mirë të asaj që e dalloi këtë zhvillim që nga fillimi: dinjiteti njerëzor formon ‘portalin’ përmes të cilit substanca barazimtare dhe universaliste e moralit importohet në ligj.” (Habermas, 2010: 469).

Habermas do të shkruante se mekanizmat që karakterizojnë së brendshmi funksionimin e shoqërisë, pasi kanë marrë një pavarësi prej shtetit në sajë të kufizimit negativ të veprimtarisë së tij, nuk janë më në gjendje të marrin përsipër përgjegjësinë që u takon në drejtim të disa fushave shoqërore (Habermas, 2006). Ai do të theksonte se politika të tilla si ato që kanë mbizotëruar në dekadat e fundit jo vetëm në SHBA dhe Britaninë e Madhe por edhe në Evropën Kontinentale, dhe në të gjithë botën, priren të shkatërrojnë ekuilibrin midis kategorive të ndryshme të të drejtave themelore (Habermas, 2010: 469).

I ashtuquajtur i vetrregullim i brendshëm i tregut nuk do të mundte t'i bënte ballë as rishpërndarjes sadopak të drejtë të të ardhurave shoqërore, as nevojës së një pjesëmarrjeje të individit në institucionet publike (Fuga, 2003: 49). Referuar Habermas “Si një koncept modern ligjor, dinjiteti njerëzor shoqërohet me statusin që qytetarët marrin në rendin politik të vetë-krijuar.” (Habermas, 2010: 473).

Kjo ishte koha, sipas Habermas kur “të drejtat e njeriut” dhe “të drejtat e qytetarit” nisin e shpëputen nga njëra-tjetra, “të drejtat e njeriut” nuk janë më një kusht i mjaftueshëm, ndonëse i domosdoshëm, për realizimin e të drejtave të qytetarit. Ekonomia liberale e tregut në vetvete nuk mund të funksiononte automatikisht duke krijuar spontanisht të gjitha kushtet për një barazi politike (Habermas, 2006). Sipas Habermas “Përvojat e përjashtimit, vuajtjes dhe diskriminimit na mësojnë që të drejtat civile klasike fitojnë “vlerë të barabartë” (Rawls) për të gjithë qytetarët vetëm kur ato plotësohen nga të drejtat shoqërore dhe kulturore” (Habermas, 2010: 468).

Me parimet e tij të “të drejtave të qytetarit” që i mbivendosen “të drejtave të njeriut”, Habermas do të prezantonte qasjen e tij mbi strukturën institucionale të qeverisjeve moderne. Sipas tij demokracia moderne ndjeu nevojën e bashkimit të të drejtave të njeriut, të cilat janë një projekt i djathtë dhe borgjez, me të drejtat e qytetarit, që është një projekt i majtë dhe popullor. Të majtët nisen “të zbatojnë praktikën e ndërhyrjes së shtetit në rregullimin e ekuilibrit shoqërorë, shpesh të shprishur prej funksionimit natyror të konkurrencës në kushtet e ekonomisë së tregut” (Fuga, 2003: 50).

Kështu u formësua “shteti social” i cili funksionon jo më mbi të drejtën normative kontraktuale e racionale, por i mbështetur në drejtësinë rishpërndarëse, ku “Sfera publike dhe sfera civile, të ndara me qëllim që të shpërshojnë sistemi politik i privilegjeve aristokrate, nisin të pleksen përsëri. Sfera politike publike ndërhyr në një masë të caktuar mbi shoqërinë civile” (Fuga, 2003: 50). Për këtë arsye, të drejtat e qytetarit janë në rrezik të vazhdueshëm dhe mbrojtja dhe zgjerimi i tyre është një dinamike në zhvillim të pandërprerë. Si rrjedhim “Lufta për zbatimin e të

drejtave të njeriut vazhdon edhe sot në vendet tona, si dhe, për shembull, në Iran dhe në Kinë, në pjesë të Afrikës ose Rusisë ose në Kosovë” (Habermas, 2010: 476).

Për Habermas, dizajni institucional (qeverisja) duhet të garantojë: (i) mbrojtjen e barabartë për individët anëtarë të shoqërisë civile nëpërmjet sundimi i ligjit përmes një sistemi të lirive themelore që është në përputhje me të njëjtat liri për të gjithë; mbrojtje të barabartë nga gjykatat e pavarura; dhe një ndarje të pushteteve; (ii) pjesëmarrjen politike të sa më shumë qytetarëve të interesuar përmes komunikimit të barabartë dhe të drejtave të pjesëmarrjes; zgjedhje periodike (dhe referendume) mbi bazën e një votimi gjithëpërfshirës; konkurrencën midis palëve, platformave dhe programeve të ndryshme; dhe parimi i shumicës për vendimet politike në organet përfaqësues; dhe (iii) kontributin e sferës publike politike në formimin e opinionëve publike përmes një ndarje të shtetit (të bazuar te tatimi) nga shoqëria (të bazuar në treg), të drejtat e komunikimit dhe shoqërimit dhe rregullimi i strukturës së pushtetit në sferën publike duke siguruar diversitetin e mediave të pavarura masive dhe një qasje të përgjithshme të audiencave masive gjithëpërfshirëse në sferën publike (Habermas, 2006: 412).

Për filozofinë habermasiane të “shtetit social” detyrat e qeverisë përfshijnë përveç rregullave dhe ligjeve, ai duhet të sigurojë të mira dhe shërbime publike për shoqërinë civile, si dhe subvencione dhe infrastrukturë për sisteme të ndryshme funksionale, të tilla “si tregtia ose tregu i punës, shëndetësia, sigurimet shoqërore, trafiku, energjia, kërkimi dhe zhvillimi, arsimi, dhe kështu me radhë” (Habermas, 2006: 416).

Referuar Fugës, “shteti social” është “një etapë më e lartë në procesin e evoluimit të shtetit liberal konstitucional” dhe “Ky transformim është bërë nëpërmjet një lloj vazhdimësie dhe aspak, siç mund të mendohet, në sajë të një ndarje me traditën liberale” (Fuga, 2003: 50-51). Mirëpo, është e qartë se këto pohime nuk qëndrojnë. Sikurse do të na e prezantonin baballarët e liberalizmit apo dishepuj të tyre në kohët e sotme, liberalizmi është filozofia politike e lirisë së individit dhe një kontenstim i palëkundur i autoritarizmit dhe etatizmit. Ai lindi pikërisht me këtë synim final, zvogëlimin e rolit dhe masës së qeverisë dhe zgjerimin e lirive të individit (Smith, 2005; Spencer, 2005; Locke, 2005; Mill, 2005; Friedman, 2005).

Çdo filozofi që përpiqet të zmadhojë hapsirat e shtetit, apo të sferës publike, nuk bën gjë tjetër veçse zvogëlon hapsirat e individit, apo të sferës private. Këto filozofi, “shteti social” dhe “demokracia e masave” apo edhe “teoria e drejtësisë” dhe “drejtësia si paanshmëri”, pa hyrë në vlerësime mbi kontributin e tyre në praktikën shoqërore që do ishte një dalje jashtë fushës së punimit, mbeten një kundërshtarë e lirisë dhe një mbështetëse e ndërhyrjes së shtetit. Këtë do të

na e prezantonte edhe Brenan kur theksonte se liberalët modern egalitar shpesh identifikojnë saktë provën e lulëzimit të shoqërisë: fundin apo minimizimin e dominimit, varfërisë dhe mungesës mjekësore dhe shtrirjen e arsimit, mundësive, paqes dhe autonomisë së plotë politike, në shoqëritë e tregut të lirë. Por nënvizon ai “Sidoqoftë, ata shpejt kalojnë nga identifikimi i kriterëve të lulëzimit të një shoqërie në përfundimin se një shoqëri e drejtë do ti përfshijë këto kriterë si qëllime të menjëhershme, të drejtpërdrejta me të cilat ajo ndërton politikën e saj” (Brennan, 2007: 288).

Një qasje akoma më majtas na vjen nga filozofja e njohur Chantal Mouffe, e cila i përket asaj qasje filozofike, që Gjura do ta quante “këndvështrimi i konfliktit”. Ky këndvështrim e vëzhgon shoqërinë si një koleksion pjesësh që ndërlidhen sëbashku nëpërmjet pushtetit shoqëror, i cili ka të bëjë me aftësinë për të kontrolluar sjelljen e të tjerëve kundër vullnetit të tyre (Gjura, 2003: 49). Karl Marks ishte një nga përfaqësuesit më të zëshëm të kësaj qasje dhe idetë e tij rreth sundimit të borgjezisë dhe shfrytëzimit të ploreariatit janë shembulli më i qartë se si pushteti përdoret për përfitim të disa njerëzve në kurriz të disa të tjerëve (Gjura, 2003: 50). Edhe sipas Haliaj në vitin 2017 “Teoria e konfliktit supozon një konflikt bazik midis “të pasurve” dhe “të varfërve”, ose midis elitave ekonomike dhe politike dhe të varfërve dhe njerëzve me ngjyrë” (Halilaj, 2017: 20).

Mouffe do të shprehej shumë qartë se ishte anti-liberale dhe se shikonte filozofinë e Rols si një mjet të papërshtatshëm për të përballuar sfidat e larmishme shoqërore dhe politike të kohës, sepse ai nuk kuptonte dimensionin antagonist të politikës (Mouffe, 2009).

Mouffe beson se ndërkohë që thelbi i shoqërive është konflikti, “Në zemër të liberalizmit është problemi i vendosjes së bashkëjetesës paqësore midis njerëzve me konceptime të ndryshme për të mirën” (Mouffe, 2009: 2). Sipas saj “Duke qenë se [liberalizmi modern] është neutral në respekt ndaj pikëpamjeve të diskutueshme të jetës së mirë, liberalët politikë besojnë se liberalizmi i tyre mund të sigurojë parimet politike që duhet të pranohen nga të gjithë, pavarësisht nga dallimet e tyre.” (Mouffe, 2009: 2-3).

Pikëpamjet e saj, sikurse edhe të Filmer dhe Hobbes, dalin jashtë kontureve të liberalizmit, që sikurse e kemi prezantuar në fillim të këtij punimi, janë kufinjtë e filozofisë politike dhe ideologjike brenda të cilave vendoset vëzhgimi ynë. Prezantimi i qasjes së saj në këtë punim na shërben ti vendosim një kufi të dytë, pas të parit nëpërmjet Hobbes dhe Filmer, kornizës filozofike të kuadrit teorik.

3.2. Llojet e qeverisjeve liberale dhe ndarja ideologjike në boshtin ‘majtas-djathtas’.

Në këtë seksion do të prezantojmë rëndësinë e ideologjisë politike dhe diferencën kryesore midis ‘të majtës’ dhe të ‘djathtës’. Më tej do të prezantojmë dy lloje të ndryshme të qeverisjeve në vendet e demokracive liberale, që frymëzohen nga filozofi të ndryshme politike. Për të dyja këto çështje do të fokusohemi në rolin që ka shteti në modelin e zhvillimit ekonomik dhe social të një shoqërie.

3.2.1. Kapitalizmi i aplikur sipas filozofive libertariane dhe liberale moderne.

Një nga çështjet më të debatuar në mjediset politike, ekonomike e akademike aktualisht dhe historikisht është roli i shtetit në zhvillimin ekonomik e social të çdo vendi (Civici, 2013). Ishin ekonomitë socialiste me një planifikim të centralizuar të aplikuara në ish-Bashkimin Sovjetik, në gjithë bllokun lindor të vendeve të Evropës qendrore e lindore (Krasniqi, 2009; Biberl, 2000) apo Kinë, Vietnam, Kore, të cilat përjetuan ndërhyrjen më të madhe të Shtetit në ekonomi në gjithë historinë ekonomike e politike të botës (Civici 2009, 2013).

Thatcher dhe Reagan, dy nga figurat e frymëzuara nga liberalizmi klasik i qëndronin mendimit se shteti nuk është zgjidhja por problemi (Forbes dhe Ames, 2015; Brooks, 2007).

Në pozicion të kundërt qëndron një nga reformatorët e mëdhenj kinezë, Teng Siao Ping, sipas të cilit tregu është një zog shumë i çmuar por që të shijosh cicërimat e tij, ai duhet mbajtur me kujdes në kafaz se mund të fluturojë dhe të të ikë (Civici, 2013).

Ricardo, nëpërmjet teorisë së tij “të avantazhit krahasues” theksonte se detyra e çdo shteti ishte t’i zbulonte ato dhe ta orientonte zhvillimin e vendit në ato degë e sektorë ekonomikë që ishin në përputhje me këto avantazhe (Duma, 2014: 3-6).

Edhe politikat me inspirim Keynes-ian të zbatuara në shumë nga vendet e Evropës perëndimore mbas Luftës së Dytë Botërore ishin një version i ndërhyrjes së Shtetit në jetën ekonomike (Fuga, 2003: 59).

Dy koncepte do të na sillnin Civici në vitin 2013 dhe Aliaj në vitin 2008, në lidhje me ato lloj kapitalizmash që zhvillohen mbështetur në filozofi politike të ndryshme nga ajo e liberalizmit klasik. Aliaj do të sillte konceptin e “kapitalizmit të administruar” që sipas tij po bëhet një fenomen global që pas fillimeve kaotike të tij në Britani dhe Europë (Aliaj, 2008). Referuar atij “Aktualisht, shoqëri të ndryshme në botë i kanë dhënë atij [kapitalizmit të administruar]

forma të ndryshme organizimi dhe institucionale edhe pse modeli neoliberal është mbizotërues në aspektin intelektual dhe ideologjik” (Aliaj, 2008: 41). Aliaj dallon të paktën tri sisteme të ndryshme të “kapitalizmit të administruar”: kapitalizmin suedez, kapitalizmin amerikan dhe kapitalizmin japonez (Aliaj, 2008: 42-44).

Kurse koncepti tjetër na vjen nga Civici në vitin 2013, i cili na prezanton me “shtetin kapitalist zhvillues” (Civici, 2013). Sipas Civicit, në gjysmën e dytë të shek XX-të, Japonia dhe vende të tjera të Azisë jug-lindore futën në jetën ekonomike dhe politike një element të ri të panjohur apo aplikuar më parë, e cila prodhoi një rritje ekonomike të përsheptuar “nën kujdestarinë e shtetit” (Civici, 2013).

Kapitalizmi suedez mbështetet te një traditë historike të lëvizjes punëtore dhe ajo e ndërhyrjes minimale të shtetit në procesin e industrializimit të vendit (Aliaj, 2008). Mbi këto dy themele të forta “Suedia ka qenë mjaft e suksesshme në zhvillimin e një kapitalizmi të administruar” (Aliaj, 2008: 42). Për të shmangur krizën edhe Suedia, kohët e funksit, ka qenë e detyruar të ndjekë tendecat ndërkombëtare neoliberale, të cilat i kanë mundësuar të rigjallërojnë kapitalizmin pa eliminuar karakterin e saj “kolektivist”, i cili “vazhdon të mbetet përsoshmërisht i pajtueshëm me rritjen ekonomike të vendit” (Aliaj, 2008: 43).

Kapitalizmi u administrua në Japoni që në hapat e parë të procesit të industrializimit, kohë kur shoqëria japoneze ishte shumë e komercializuar dhe sipërmarrëse, por akoma nuk ishte industriale (Aliaj, 2008: 43-44). Ndryshimi midis kapitalizmit të drejtuar japonez dhe atij suedez qëndron në faktin se mungesa e shtetit të mirëqënies që ishte bazament për rastin suedez, ka qenë thelbësore për suksesin e kapitalizmit japonez (Aliaj, 2008: 44).

Qasje të ngjashme mbi kapitalizmin japonez parashtroi edhe Civici në vitin 2013, porse ai e pa në një spektër më të gjerë, duke përfshirë edhe Tajvanin, Korenë e Jugut, Singaporin, dhe Hong Kongu-n, të cilët i grupoi duke i quajtur “dragonjtë e Azisë”. Sipas Civicit, shteti në këto vende ishte prezent në çdo etapë të industrializimit në mbrojtje dhe në ndihmë të biznesit vendas për të kapërcyer pengesat dhe zhvilluar, sidomos për t’u krijuar një mbrojtje aktive këtyre industrive të reja për t’i përgatitur sa më mirë ato për të përballuar konkurrencën ndërkombëtare (Civici, 2013).

Nëse i referohemi Civicit, por edhe Aliajt, forca kryesore e “kapitalizmit të administruar” apo “zhvillimit shtetëror të kapitalizmit” qëndron në bashkëpunimin ndërmjet burokracisë shtetërore dhe biznesit, sepse shteti nuk jep urdhra, por bashkëpunon dhe influencon nëpërmjet

një sistemi të “orientimit administrativ”, sistem që kërkon kontakte të ngushta e transparente ndërmjet administratës dhe biznesit (Civici, 2013; Aliaj, 2008: 42-44).

Në kontekstin kur “dragonjtë e Azisë” dështuan në strategjinë e tyre të “shtetit zhvillues”, debate mbi “rolin e Shtetit” u kthyen përsëri në fokus. Kriza e borxheve e shfaqur në dekadën e viteve 1970-1980 e gjeti zgjidhjen vetëm te propozimi i FMN-së dhe Bankës Botërore në formën e “Planeve të axhustimit strukturor” fjala çelës e të cilit ishte liberalizimi dhe reduktimi i rolit të shtetit (Civici, 2013). Po kështu, rënia e murit të Berlinit në vitin 1989 u shoqërua gjithashtu me një valë reformash liberale të tipit “terapi e Chock-ut” në shumicën e vendeve të bllokut ish-komunist lindor përfshirë Shqipërinë (Biberaj, 2000; Lami, 2013; Fuga, 2001, 2003).

Ishte ky kontekst i gjerë politik dhe ekonomik kur doli në skenë termi “thecherizëm” që portretizon politikën ekonomike të ish-Kryeministres britanike të viteve 1979-1991, Margaret Thatcher. Së bashku me binjakun e saj “reganizëm”, që identifikon politikën e ndjekur nga Presidenti i SHBA-së, Ronald Regan, ajo përbën esencën e një qëndrimi dhe veprimesh të cilësuar si “revolucioni konservator” që bota njohu në fund të shekullit të 20-të (Civici, 2013: Forbes dhe Ames, 2015).

Aliaj në vitin 2008 i vlerësonte të ndryshme dy sistemet kapitaliste anglosaksone. Sidoqoftë, edhe Aliaj, sikurse edhe Civici në *‘Tregu apo Shteti’*, i pranon karakteristikat individualiste të kapitalizmit amerikan dhe dallon faktin se modeli i tij krahasuar me kapitalizmin suedez qëndron në “ekstremin tjetër të spektrit ideologjik dhe institucional të kapitalizmit” (Aliaj, 2013: 43).

Aliaj na prezanton edhe arsyen e kësaj difference të thellë midis këtyre dy modeleve, e cila ishte se industrializimi në Amerikë ndodhi në një shoqëri të decentralizuar ku kishte një besim të plotë te sipërmarrja dhe inisiativa e lirë. Sipas Aliaj, në kapitalizmin amerikan “Organizimi kolektiv është më i kufizuar, mirëqënia e shtetit më pak universale, ndërsa legjislacioni antitrust është tepër i zhvilluar” (Aliaj, 2008: 43). Ai do ta prezantonte këtë fakt, edhe në lidhje me “reganizmin”, të cilën e konsideron “rimarketimi i shoqërisë amerikane pas viteve ’70-të”. Sipas Aliajt “Ky proces [rikthimi në tradita e liberalizmit klasik] hasi më pak rezistencë dhe pësoi më pak dëme se në vendet e tjera, madje prodhoi rritje ekonomike” (Aliaj, 2008: 43).

Sipas Civicit konteksti i kthimit të filozofisë së liberalizmit klasik në dy vendet anglosaksone u mbështet në dy dukuri të rëndësishme, sikurse ishin kriza e naftës dhe pamundësia e politikave “keinesianiste” që të jepnin një zgjidhje adekuate për situatën e krijuar. Kjo u vu re në të gjithë botën, por në mënyrë të veçantë në Britaninë e Madhe dhe SHBA-në (Civici, 2013).

Ai do të nënvizonte se sipas teorisë së John Keynes, papunësia dhe inflacioni nuk mund të bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, pasi nëse papunësia është e lidhur me mungesën e kërkesës, atëherë çmimet kanë tendencë të ulen. Pra, papunësia është e lidhur direkt me deflacionin, dhe nëse ka inflacion atëherë ka edhe tepërisë kërkesë, e cila stimulon ofertën dhe për pasojë zvogëlon papunësinë (Civici, 2013).

Nga ana e tyre, Forbes dhe Ames në vitin 2015, do të theksonin se ulja e taksave që bëri Presidenti Amerikan Roland Regan në vitin 1981 solli shumë përfitime për ekonominë amerikane. Përveç tyre, kjo ulje taksash ju dha një përgjigje edhe akuzuesve të tij se po punonte në shërbim të të pasurve duke dëmtuar buxhetin publik (Forbes dhe Ames, 2015).

Ideologët dhe ekspertët që kundërshtonin politikat e tij, sillnin si argumente kundër tyre faktin e supozuar se këto politika do të favorizonin “1% top të pasurve të Amerikës” ndërsa pjesa tjetër do të paguante më shumë, dhe në të njëjtën kohë do të privoheshin nga shërbimet dhe mbështetja publike. Në të kundërt, Forbes dhe Ames, në vitin 2015, sollën statistika që çonin në përfundimin e kundërt. Sipas tyre nëse në vitin 1981, kohë kur Regan erdhi në pushtet, 1% e amerikanëve më të pasur paguanin 18% të totalit të taksave, kurse 99% e amerikanëve 82% të tyre; ky raport ndryshoi me 10% në të dyja kahet në vitin 1988, pra 1% e më të pasurve tashmë paguanin 28% të totalit kurse 99% e popullsisë vetëm 72% të tij (Forbes dhe Ames, 2015).

Veçimin e drejtimit të USA nën filozofimë klasike të liberalizmit, nga Roland Regan, e bënë edhe Brooks në vitin 2007. Ai e sheh në raport me programet e ndihmës sociale në mbështetjen e familjeve në nevojë (Brooks, 2007). Por gjithashtu edhe Wallison, një nga kështilltërit e Regan gjatë presidencës së tij, e prek filozofinë ‘laissez faire’ të reganizmit kur shpjegon se ishin programet e strehimit social të ndjekura që nga qeverisja e Presidentit Klinton që e prodhuan krizën ekonomike të vitit 2008 (Wallison, 2016).

3.2.2. Rëndësia e ideologjive politike dhe dualizimi ‘e majtë/ ‘e djathtë’.

Filozofitë politike zhvillohen mbi disa parime bazike, të cilat të grupuara së bashku formësojnë atë që quhet ideologjia politike dhe drejtojnë veprimin politik e përcaktojnë parametrat e vlerësimit të këtij veprimi (Lami, 2010). Sipas tij termi ideologji është krijuar nga mendimtari francez Claude Destutt de Tracy në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Sipas Trecy ideologjia është shkenca e ideve dhe e origjinës së tyre. Lami do të prezantonte se “Ai [Trecy] besonte se

është e mundur të zbulohet objektivisht prejardhja e ideve dhe se kjo shkencë e ideve ka propabilitet të gëzojë të njëjtën saktësi dhe status si shkencat natyrore” (Lami, 2010: 488).

Tracy besonte se funksioni i ideologjive lidhet me dy dimensione: përcaktimin e qëllimeve me synim projektimin e funksionimit të shoqërisë në të ardhmen; dhe, përzgjedhja e metodave efikase për të arritur këto qëllime. Fushat praktike ku ideologjitë fokusohen janë ekonomia, edukimi, kujdesi shëndetsor, sistemi i drejtësisë, siguria sociale, emigracioni, mbrojtja e mjedisit, besimi fetar dhe të tjera (Lami, 2010: 488).

Një pjesë e rëndësishme e politologëve mendojnë se ideologjitë dhe dikotomia midis koncepteve politike; e majtë dhe e djathtë, është historike, logjike dhe natyrore dhe prania e tyre është e përhershme në jetën politike të një vendi (Lami, 2013: 15).

Nga ana tjetër “shumë autorë të tjerë kanë parashikuar ose përshkruar fundin e ideologjive” (Lami, 2010: 489). Ai do të na paraqiste një sërë autorësh që ndanin këtë mendim, nisur nga eseisti dhe ronacieri francez Albert Kamy që solli për herë të parë termin ‘*Fundi i Ideologjisë*’, për të vijuar me profesorin e Harvardit Stuard Hughes i cili e rimori këtë koncept në esenë e tij ‘*Fundi i Ideologjisë politike*’, për ta mbyllur me Daniel Bell i cili në librin e tij ‘*Fundi i Ideologjisë*’ do të postulonte se “...pasionet e vjetra janë shuar” dhe së “Koha e ideologjive ka mbaruar” (Lami, 2010). Francis Fukuyama, do të ishte një nga skeptikët sipas Lami, që do të riformulonte në mënyrë më të zbukuruar propozimin e fundit të ideologjive, kur shprehej se “...triumfi i perëndimit dhe ideve perëndimore është dukshëm në eliminimin total të alternativave të mundshme ndaj Liberalizmit Perëndimor” (Lami, 2010: 489).

Lami në vitin 2010, do të prezantonte mendimin e tij, i cili duket se është edhe mendimi jonë, se “fundi i ideologjisë do të ishte fundi i politikës” dhe në këtë kuptim, nuk mund të ekzistojë, aq më tepër kur debatet mbi lirinë, barazinë, solidaritetin social, detyrimet politike, drejtësinë dhe moralitetin politik vazhdojnë të jenë të hapura. Për Lami “konvergenca ideologjike ngatërohet me fundin e ideologjive” (Lami, 2010: 489).

Në këtë kontekst, Lami prezantoi teorinë e studiuesit të doktrinave politike, Jean Blondel, e cila e trajton çështjen e madhe të ideologjive politike të ndara në gjashtë grupe të renditura nga e majta në të djathtë (Lami, 2013: 16). Duke ju referuar shumë autorëve, si Laner (1965), Beer (1978), Robertson (1984) dhe Scrw (1983), ai do të prezantonte qasjen e tyre se “në një univers politik kompleks ku palët janë të shumta dhe kanë me njëri-tjerin konvergenca dhe divergjenca të tilla që mundësojnë kombinime nga më të larmishmet, nuk ka mundësi që problemi të shtrohet në formën “ose e djathtë, ose e majtë”” (Lami, 2013: 16).

Do të ishte Boobio në librin e tij *'E djathta e majta'* që do të sillte arsyetimin më të vlefshëm për këtë pjesë të punimit tonë, sipas të cilit dallimi midis një të majte dhe një të djathte nuk e përjashton aspak ekzistencën e një vije të pandërprer mes tyre ku janë të vendosuar ideologji të tjera, të cilat ai i quan “të qëndrës” (Lami, 2013: 16).

Sigurisht që tema e punimit tonë nuk kërkon detajime të thelluara mbi spektrin e gjerë të ideologjive dhe identifikimin e tyre në një bosht, kështu që ne do të fokusohemi më tej te dallimet midis dy poleve kryesore të saj, brenda liberalizmit. Thelbi i ndryshimit midis të majtës që kërkon socializmin demokratik dhe predikon fuqizimin e rolit të shtetit dhe të djathtës që promovon kapitalizmin e demokracisë liberale dhe të tregut të lirë, qëndron te vlera që secila prej tyre i jep individit (Friedman, 2005).

Për të djathtët njeriu është origjina dhe synimi i gjithçkaje (Locke, 2005), kurse për të majtët thelbi i gjithçkaje është shoqëria (Nisbet 1953: 27). Kjo së pari ka lidhje me raportin midis të drejtave shoqërore me të drejtat e njeriut, që sikurse do ta përkufizonte Spencer “Gjykimi për këtë pikë qëndron në themel të forcimit të bindjeve që kanë të bëjnë me vet sferën e qeverisjes [madhësinë dhe rolin e qeverisë]” (Spencer, 2005: 79).

Ne e prezantuar më parë “teorinë e drejtësisë” dhe ‘drejtësinë si paanësi’ të Rolls (Rawls, 1975, 1985, 1995, 1997). Po kështu, konceptin e “të drejtave natyrore” të Locke, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër konceptet e Habermas “të drejtat negative” dhe “të drejtat pozitive”. Nëse “të drejtat natyrore” dhe “të drejtat negative” nënkuptojnë “të drejtat e njeriut”, “të drejtat pozitive” nënkuptojnë “të drejtat e qytetarit”, si antar i një shoqërie (Habermas, 1976, 2010). Kur themi të drejta qytetare apo shoqërore duket të nënkuptojmë krijimin e “legjislacionit” dhe “institucioneve shtetërore” në shërbim dhe zbatim të këtyre të drejtave, apo zmadhim fizik, të fushëveprimit dhe rolit të qeverisë (Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Nga këtu origjinalizon edhe diferenca midis të majtës dhe të djathtës, që kanë për së pari në lidhje me madhësinë dhe rolin e qeverisë (Lami, 2010: 488-489). Sipas Lami “...liberalët klasik dhe neoliberalët fokusohen kryesisht në rolin qëndror të lirisë dhe në kufizimin e qeverisë dhe të forcës shtrënguese të shtetit. Ndërsa socializmi [demokratik] vendos si përparësi barazinë sociale dhe lë në plan të dytë lirinë” (Lami, 2010: 489).

Sipas Lami pjesa më e madhe e studiuesve bien dakort në ndarjen e ideologjisë në politika të majta dhe të djathta. Ai, referuar Lijphart do të prezantonte ndryshimet midis tyre, disa prej të cilave janë: ndërsa e majta përpiqet të çrrënjos pabarazitë sociale, e djathta i sheh ato si rezultat i pabarazive natyrore dhe të paçrrënjoshme; ndërsa e majta rrit shpenzimet publike, e djathta

i shkurton ato; ndërsa e majta e mbështet korporatat për rolin e spikatur të tyre, e djathta me interes të kufizuar ndaj tyre (Lami, 2010: 489).

Në kufinj të këtij punimi ne u munduam të prezantojmë spektrin e filozofive politike në teori, kur ne prekëm liberalizmin klasik dhe liberalizmin modern, apo egalitar. Është e kuptueshme se këto filozofi janë vetëm stacionet më të rëndësishme, sepse spektri liberal përfshin shumë nuanca të liberalizmit.

Po kështu në lidhje me disa modele të kapitalizmit botëror, të strukuruara në dy grupe të mëdha, për të kuptuar parimet bazike të filozofive politike që i frymëzuan këto qeverisje, veçanërisht në lidhje me rolin e shtetit. Kur flasim për llojin e ‘kapitalizmit’ të një vendi specifik, ne nuk e njësojmë atë për të gjitha periudhat historike, sepse do të gabonim. Ai nuk mund të jetë i njëjtë, përderisa qeverisja në periudha të ndryshme i përkiste partive të ndryshme që mbështeten në filozofi të ndryshme politike. Për ta bërë evidente këtë fakt, ne jo pa qëllim e prezantuam kapitalizmin amerikan në dy kohë të ndryshme.

Porse, në shërbim të synimit tonë modest për të bërë disa vlerësime për qeverisjet shqiptare të tranzicionit, ne jemi të interesuar vetëm për një kuadër të gjerë të prezantimit të filozofive politike dhe qeverisjeve praktike të frymëzuara prej tyre.

Ne prezantuam në teori, gjithashtu, dualizimin ideologjik “majtas-djathtas”, i cili i përket të gjithë spektrin politik të ideologjive. Porse, në këtë punim ne jemi të interesuar për të bërë një dallim të qartë brenda kontekstit liberal mbi dikotominë midis dy koncepteve bazë të politikës teorike dhe të aplikuar: “e majta” dhe “e djathta”.

KAPITULLI IV: EFEKTET E QEVERISJEVE TERRITORIALE PËRGJATË TRANZICIONIT.

Në këtë kapitull ne do të shpjegojmë dëmet hapsinore, territoriale dhe urbane që prodhuan qeverisjet territoriale të 30 viteve të fundit. Ai nis me argumentimin se realiteti hapsinor, territorial dhe urban i një vendi është produkt i qeverisjet territoriale të atij vendi dhe vijon me prezantimin e modelit demografiko-territorial krahasuar me modelin perëndimor. Kapitulli mbyllet me prezantimin e gjendjes hapsinore, territoriale dhe urbane që qeveritë e tranzicionit me veprimin apo mosveprimin e tyre prodhuan. Ky kapitull na shërben për të kuptuar nga nisin shqetësimet tona për ta kryer këtë punim dhe pse është i domosdoshëm studimi i modelit politik të qeverisjeve territoriale dhe të nevojshme reformat e propozuara prej tij.

4.1. Gjendja hapsinore, territoriale dhe urbane e vendit si produkt i qeverisjet territoriale.

Teoria na thotë se ekziston një lidhje e fortë midis mënyrës sesi është zhvilluar territori, veçanërisht qytetet e një vendi, dhe mënyrës sesi shfaqet politika e aplikuar e atij vendi (Thompson, 2007; Imami et al, 2008). Qasja e Thomsonit konsistonte në vlerën që ka qyteti në dimensionin politik të shoqërisë moderne, për të cilën ai do të theksonte se jeta urbane u bë gonxhia e modernitetit: lëvizje politike, ideologjish dhe shoqërish të cilat do të shënonin se bota moderne e kishte origjinën e vet në jetën dhe eksperiencën urbane (Thompson, 2007). Sipas Imamit është shoqëria politike ajo që modelon qytetin/polisin (Imami et al, 2008: 64).

Këtë lidhje simbiotike teorike do ta prezantonte edhe Fuga në vitin 2012 kur do të theksonte se “Pushteti dhe territori, thuhet qartazi në tekset klasike dhe moderne të urbanistikës, të sociologjisë, të filozofisë dhe të shkencave politike, janë dy anë të një ekuacioni të vështirë, por mbeten gjithmon të pandashme nga njëra-tjetra” (Fuga, 2012: 63).

Imami në vitin 2008 do të nënvizonte se koncepti qytetërim vjen nga fjala qytet dhe nuk mund të kuptohet mënyra jonë e të jetuarit dhe të ekzistencës tonë, në tërësinë e tyre, jashtë qytetit dhe pa të (Imami et al, 2008). Duke ju referuar historianit francez Vernant, Imami do të na e prezantonte këtë lidhje të ngushtë midis zhvillimit të qytetit dhe të bërit politikë që me shfaqjen e qytetit në ishujt grekë. Sipas Imamit, ky qyteti i ri, i cili nuk kishte ekzistuar më parë “nuk ishte thjeshtë hartimi i një plani të ri urbanistik, nuk ishte thjeshtë një çështje a një zgjidhje teknike” (Imami et al, 2008: 15).

Ajo që kishte ndodhur sipas Imamit, ishte se vendin e pallatit mbretëror në qendër të qytetit lindor e kishte zenë një element shumë i rëndësishëm urban në qytetin perëndimor. Ndryshimi fizik i qytetit, largimi i pallatit mbretëror dhe zëvendësimi i tij do të vinte si rezultat i pashmangshëm i demokratizimit, dhe si një rrjellojë e ndryshimit të mënyrave të qeverisjes. Ajo që dallohet, në këtë rast, është rënia e fuqisë së mbretërve dhe fuqizimi i qytetarit. Këtë dinamikë Imami do ta prezantonte “Ndodh që papritur shfaqet agora, d.m.th., shfaqet një hapsirë publike e cila nuk është më e zotëruar e sunduar nga autoriteti, nga sundimtari politik, por është e sunduar, e mbizotëruar nga dinamika politike dhe sociale, nga dialogu i brendshëm i qytetit” (Imami et al, 2008:15).

Edhe Veber [Webber] do të na fliste në veprën e tij ‘*Qyteti*’ për këtë element thelbësor të qytetit që ai do ta quante “perëndimor”, agorën, duke e diferencuar nga qyteti fillestar “lindor” (Veber, 2007). Veber ndërsa fliste për qytetarin në një bashkësi politike do të nënvizonte se “Si dukuri masive bashkësitë qytetare u shfaqën vetëm në perëndim dhe vetëm pjesërisht në vendet e Azisë së afërme” (Veber, 2007: 19). Do të ishin këto bashkësi qytetare që duke ndërvepruar brenda vetes politikisht do ti jepnin dhe kuptim formës fizike të qytetit të tyre. Edhe në këtë rast, Veber na tregon se modeli i qeverisjes është shumë i rëndësishëm në mënyrën sesi zhvillohet qyteti.

Për tu kthyer te qasja e Thomson në vitin 2007, mund të prezantojmë se ai theksonte se rëndësia e politikës, është determinues për formësimin e qendrave të banuara. Në këtë kontekst ai do të nënvizonte se politika duhet të shihet si një zotërim i asaj që mund të quhet ngulitja hapsinore (Thompson, 2007). Me ngulitje hapsinore, Thomson ka parasysh proceset e shpërndarjes së demografisë në territor. Sjellë në termat e punimit tonë, kjo do të thotë se mënyra sesi elita politike e ushtron pushtetin e saj përgjatë qeverisjes, prodhon shpërndarjen hapsinore të qendrave të banuara dhe të popullsisë nëpër territorin kombëtar, si dhe realitetet urbane dhe territoriale në të cilat zhvillohet jeta individuale dhe shoqërore.

Nga ana tjetër edhe modeli territorial i një vendi dhe gjendja urbane e qendrave të banuara ndikon në strukturën politike të atij vendi, gjë që do ta nënvizonte edhe Thomson në vitin 2007 “Dhe nga implikimet urbane dhe suburbane gjithashtu mund të modelohen ide të reja politike, vlera dhe sjellje votimi” (Thompson, 2007). Thomson shkoi aq larg në këtë koncept, sa shpjegoi mbështetur në analizat e të dhënave numerike të dy politologëve amerikanë, mënyrën e votimit të votuesve amerikanë në zgjedhjet presidenciale të 2000 dhe 2004. Pra, hapsirat e zhvilluara dhe qendrat urbane dhe qeverisja kanë një madhënie simbiotike, por ne jemi të

interesuar të shohim ndikimin që ka qeverisja në mënyrën sesi është zhvilluar modeli territorial, qëndrat e banuara dhe hapsirat e zhvilluara të një vendi.

Urbanistikë do të thotë kompromis i të gjithë grupeve të interesit të përfshira apo të prekura nga planifikimi në një territor të caktuar, dhe në këtë kuptim, roli prej organizuesi dhe moderatori në proceset e kuvendimit të këtyre grupeve dhe interesave, i institucioneve të qeverisë është i domosdoshëm (De Soto, 1989: 232; Aliaj, 2003, 2008; EC, 1994). Për çështjet territoriale dhe urbane, roli i institucioneve qeverisëse është i pashmangshëm (Spencer, 2005: 78; Bess 2006: 31; UN, 1976).

Këtë domosdoshmëri do ta pranonte edhe Friedman, i cili megjithëse shpesh konsiderohet si kundërshtues i idesë së ndërhyrjes së shtetit, përkundrazi e njeh nevojën e tij dhe thekson se “qeverisja është thelbësore, në të njëjtën kohë si forum për përcaktimin e rregullave të lojës dhe si arbitër, për të interpretuar dhe imponuar zbatimin e rregullave të vendosura më parë” (Friedman, 2005: 17). Friedman i jepte një rëndësi të veçantë ndarjes së fushëveprimit qeverisës në dy nivele (qendrore dhe vendore), por të para sëbashku, edhe për Friedman qeveria duke imponuar rregulla e standarte mund të përmirësojë kushtet e rrugëve apo higjenën urbane, nivelin e realizimit në shumë zona vendore (Friedman, 2005: 4).

Përtej qasjes së përgjithshme të Friedman, Spencer do të ishte më specifik mbi çështjen për të cilin po flasim. Nëse i referohemi atij në librin *‘Njeriu Kundër Shtetit’*, ndërsa i përgjigjet pyetjes se për çfarë qëllimesh do të pranonin të bashkëpunonin të gjithë njerëzit, ai do të theksonte, ndër të tjera, se “Një lloj tjetër bashkëpunimi, për të cilin të gjithë njerëzit janë të interesuar, është përdorimi i territorit ku banojnë” (Spencer, 2005: 78).

Ky bashkëpunim është shumë i rëndësishëm, për së pari, për ti dhënë një kuptim të përbashkët përdorimeve të tokës, por edhe për të siguruar kontributet e të gjithë pronarëve në hapsirat dhe infrastrukturën e përbashkëta shoqërore, ose e thënë nga fjalët e Spencer “me të drejtë, vendimet e shumicës do të mbizotëronin në lidhje me kushtet, në të cilat një pjesë e tokës do të përdorej përkatësisht, për të siguruar ushqimin, për të ndërtuar komunikacionin, ose për qëllime të tjera” (Spencer, 2005: 78).

Përkthyer në gjuhën e zhvillimit urban dhe territorial, kjo thënie e Spencer do të thotë zonim funksional, apo përcaktimin e zonave të përdorimeve të tokës dhe ndërtesave në të. Kurse për çështjet e kontrollit të territorit, si lejedhënia ndërtimore, kontrolli i territorit për ndërtime informale dhe vendimarrja për rastet kur territori është prekur nga ndërtimet paleje, roli i

institucioneve të shtetit është i domosdoshëm (Steiner et al, 2010: 7-38; IHS Alumni et al, 1998; Aliaj 2003, 2008; Faja, 2008).

IHS Alumni et al, do ta prezantonin idenë e rolit të pazëvendësueshëm të qeverisë në çështjet territoriale dhe urbane dhe lidhjen shkak-pasojë të modelit të qeverisjes dhe gjendjes territoriale dhe urbane të vendit, kur kërkuan të definojnë rolin e ri të shtetit në një qeverisje demokratike pas hyrjes në tranzicion. Megjithëse ata prezantojnë se roli i qeverisë në sistemin e ri nuk është më i njëjtë me atë që kishte në regjimin komunist, ata nuk harrojnë të nënvizojnë se qeverisja ka një rol të pazëvendësueshëm në çështjet territoriale dhe urbane. Sipas Dharmo “Roli i shtetit është të kujdeset që rezultati i të gjitha këtyre inisiativave private të jetë një qytet me ambient të këndshëm, plot jetë dhe punë” (IHS Alumni et al, 1998: 3).

Ndërsa e shohin çështjen e rolit të shtetit në një panoramë më të gjerë, sikurse janë vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, IHS Alumni et al, do ta theksonin gjithashtu rolin e pazëvendësueshëm të shtetit. Në këtë kuptim Nientend do të nënvizonte se “ roli i tij [shtetit] është dhe do të vazhdojë të mbetet i rëndësishëm” (IHS Alumni et al, 1998: 9).

Aliaj në vitin 2003 ndërsa prezantonte dinamikat metodologjike të planifikimit territorial dhe urban në historinë botërore do ta vinte themelin e mendimit të tij në raportin midis rolit të sektorit privat dhe sektorit shtetëror. Dy ishin shtyllat e teorisë së tij: së pari, gjendja urbane e qyteteve ka qënë produkt i mënyrave të qeverisjeve territoriale, pavarësisht raportit të rolit midis sy sektorëve; dhe së dyti raporti midis roleve të dy sektorëve ka ndryshur në lidhje me ideologjitë politike që frymëzonin qeverisjet territoriale në kohë të ndryshme përgjatë tre shekujve të fundit (Aliaj, 2003: 3-16). Ai do ta theksonte rolin vendimtar të qeverisë në formësimin territorial dhe urban të vendit duke prezantuar problematikat në zhvillimin specifik të Tiranës urbane në raport me funksione të rëndësishme të qeverisjes si: pronësia e tokës urbane, lejedhënia ndërtimore dhe hartimi i planeve urbane (Aliaj, 2003: 92-98).

Faja në vitin 2008 do ta shihte shumë qartë rolin e qeverisë në bërjen dhe ribërjen e qyteteve dhe territoreve të tjera, kur prezantoi shfaqjen e fenomeneve negative në lidhje me urbanistikën e periudhës së tranzicionit. Ai do ta fajësonte qeverisjen për moskryejën e detyrave themelore të saj, sikurse do të nënvizonte “mungesën e një kodi dhe legjislacioni të qartë” (Faja, 2008: 19).

Po kështu, Aliaj në vitin 2008 do ta prezantonte gjerësisht dhe në shumë dimensionë rolin determinues që ka qeverisja territoriale në gjendjen fizike dhe sociale në të cilën shfaqen qytet e vendit. Ai do ta niste me rolin që ka qeverisja përsa i përket strehimit dhe në mënyrë të

vençantë strehimit social (Aliaj, 2008:155-158), për të kaluar te lejedhënia ndërtimore si një model për zhvillimin e tokës dhe hartimin dhe miratimi i instrumentave të planifikimit (Aliaj, 2008: 180-187).

Derraj në vitin 2008 do të identifikonte tre drejtime: ndarja e tokës, planifikimi i zhvillimit dhe kontrolli i zhvillimit; ku qeveria ka detyrimin për të ushtruar aktivitet qeverisës në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe territorial. Ai nënvizon se mënyra sesi i ushtro qeverisja këto detyra në vitet e tranzicionit reflektohet në gjendjen e qyteteve shqiptare (Imami et al, 2008: 52-56).

HIS Alumni et al, (1998), Misja dhe Misja (2004), Aliaj (2003, 2008), BB (2007, 2012, 2018), Faja (2008), Imami et al, (2008), Fuga (2004, 2012, 2019), Çili (2013) do të nënvizionin mënyrën sesi e kreu qeverisja territoriale funksionin qeverisës të kontrollit të territorit për zhvillime të palejuara si shkaktarin kryesor të fenomenit të ndërtimtarisë informale. Ndërtimet informale në Shqipërinë e tranzicionit erdhën përshkak të shumë arsyeve ku më e rëndësishmja ishte paaftësia e institucioneve të shtetit të kuptonin dhe të paraprinin trendet e reja të zhvillimit (BB, 2007: 63; IHS Alumni et al, 1998). Mbi këtë rol të qeverisjes territoriale do të fliste në mënyrë specifike De Soto (2001, 2007).

Në vijim të këtij punimi, ndërsa do vëzhgojmë mbi çfarë qasje politike dhe ideologjike kanë ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë qeverisjet territoriale, do të sjellim edhe argumenta të tjera që mbështesin tezën se gjendja hapsinore, territoriale dhe urbane e vendit është produkt i mënyrës së ushtrimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi ligjore të qeverisjeve territoriale. Sikurse do ta shohim në vijim, gjithashtu, edhe të gjithë deklaratat politike dhe teknike ndërkombëtare të cilat janë sjellë në këtë punim, theksojnë rolin e pazëvendësueshëm të qeverisjes në çështjet e zhvillimeve territoriale dhe urbane, dhe se mënyra sesi ato i ushtrojnë këto detyra, funksione dhe përgjegjësi reflekton në realitetet urbane dhe territoriale të vendeve të tyre.

4.2. Modeli demografiko-territorial i tranzicionit në raport me modelet socio-urbane perëndimore.

Shqipëria e dimensionit territorial përgjatë tranzicionit 30 vjeçar ka pësuar ndryshime të jashtëzakonshme (Faja, 2008; Fuga, 2004, 2012; Aliaj, 2008). Modeli demografiko-territorial u formësua si produkt i dy dinamikave të forta demografike që prekën vendin: niveli i popullimit të vendit dhe rishpërndarja e brendshme të popullsisë. Fenomeni i migracionit dhe

urbanizimi që ai prodhoi, kanë korigjuar strukturën hapësinore të zhvilluar nën planifikimin qëndror socialist (Kotmilo dhe Kotmilo, 2017; Faja, 2008; BB, 2007). Ky zhvillim masiv erdhi edhe si pasojë e reformave të forta liberale të ndjekura në vitet e para të tranzicionit (Meksi, 2015; Çili, 2013; Biberaj, 2000; Lami, 2013).

Popullsia e Shqipërisë, në vitet e tranzicionit, ka pësuar rënie të ndjeshme nga 3.182.417 banorë në vitin 1989 (INSTAT, 2014) në 2.845.955 banorë në vitin 2019 (INSTAT, 2020). Kjo rënie e popullsisë ka ardhur nga dy faktor kryesorë: së pari, nga ulja e nivelit të lindshmërisë; dhe së dyti, si pasojë e migracionit të jashtëm ndërkombëtar (King dhe Vullnetari, 2003; King, 2010; Vullnetari, 2007, 2010, 2012; Bërxfholi, 2000; INSTAT, 2004; 2014; 2016-2020).

Niveli i lindshmërisë do të fillonte të ulej që në vitet '60-të të shekullit të kaluar, por në dekadën e dytë të tranzicionit Shqipëria të zbriste në vendin e fundit në Europë përse i përket rritjes së nivelit të rritjes (Eurostat, 2019). Rënia e popullsisë vjen edhe për arsyet e migracionit të jashtëm, cili ka qënë i vazhdueshëm dhe në ritme të ndjeshme, në kërkim të mundësive më të mira të jetesës. Përgjatë tranzicionit, 1990-2019, një shifër rreth 1.2 - 1.5 milion shqiptarë, ose rreth 40% e popullsisë të përgjithshme apo 50% e popullsisë banuese në Shqipëri, janë larguar nga vendi (INSTAT, 2014, 2015-2020; King dhe Vullnetari, 2003, Vullnetari, 2007, 2012; WB, 2007, 2018; BSH, 2018).

Kontribuesi kryesor dhe më i rëndësishëm i modelit territorial të tranzicionit është migracioni i brendshëm, i cili në këto tre dekada është prezantuar në përmasën e një eksodi (Fuga, 2012). Gjatë dekadës së parë, si pasojë e këtij migracioni niveli i urbanizimit të vendit u rrit nga 35% në vitin 1989 në 42% në vitin 2001 (Faja, 2008; Misja dhe Misja, 2004; INSTAT, 2004). Përgjatë periudhës 1992-2000, migracioni i brendshëm ka përfshirë 1,357,750 migrantë të brendshëm në 9 vite, ose pothuajse 40% e popullsisë së vitit 2000, në një mesatare vjetore rreth 150.750 njerëz (Vullnetari, 2007).

Edhe dy dekadat e tjera të tranzicionit do të prekeshin nga të njëjtat fluske masive migracioni të brendshëm dhe kjo do të sillte që në vitin 2011 për herë të parë popullsia urbane të ishte më e lartë se ajo rurale duke përfshirë rreth 54-58,2% të numrit të përgjithshëm të popullsisë (INSTAT, 2011, 2014). Të njëjtat trende vërehen edhe në dekadën e tretë të tranzicionit, kur rreth 200 mijë individë ndryshuan vendbanimin (INSTAT, 2015-2020). Si përfundim i këtyre dinamikave, në vitin 2019 Tirana zë rreth 31,8% të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë qarku më të populluara të vendit, dhe tre herë sa qarqet e Durrësit dhe Fierit që e ndjekin për nga madhësia, të cilat përfshijnë nga 10,2% të popullsisë gjithsej secili (INSTAT, 2020).

Modeli demografiko-territorial përbëhet nga tre komponentë kryesorë, të cilët janë situata urbane ekzistuese historike dhe kanë evoluar me shpejtësi përgjatë viteve të tranzicionit. Komponenti i parë është bashkimi fizik territorial dhe urban midis dy qarqeve qendrore, Tiranë dhe Durrës. Rajoni i Madh shtrihet në një sipërfaqe territoriale prej rreth 2.4 mijë km², ose 9% të shtrirjes territoriale shtetërore, dhe përfshin një popullsi takuese prej 42% të popullsisë së përgjithshme të sotme kombëtare (INSTAT, 2020).

Komponenti i dytë i modelit territorial të tranzicionit është rajoni territorial që përfshin qarqet e Fierit dhe Vlorës. Ai shtrihet në një sipërfaqe territoriale prej 4.6 km², ose 16% të sipërfaqes totale të vendit dhe përfshin një popullsi takuese prej 17% të popullsisë së përgjithshme të sotme kombëtare, të ndara midis Fierit 10.2% dhe Vlorës 6.6% (INSTAT, 2020). Rajoni Tiranë-Durrës ka një sipërfaqe rreth 1.8 herë më të vogël dhe një popullsi rreth 2.5 herë më të lartë, ose një densitet të popullsisë rreth 4.5 herë më të lartë se Rajoni Fier-Vlorë.

Dhe në fund, komponenti i tretë që në këtë punim e kemi quajtur Rajoni i Braktisur, që përbëhet nga tetë qarqet veriore, dhe jugore të vendit që kanë pësuar shpopullim. Ai ka një shtrirje të përgjithshme prej rreth 21.8 mijë km², ose 75% të sipërfaqes territoriale kombëtare, dhe një popullsi takuese prej 40% të popullsisë së përgjithshme kombëtare. Ky rajon megjithëse ka një shtrirje rreth 8 herë sa shtrirja e Rajonit Tiranë-Durrës ka një popullsi më të vogël se ai rajon dhe densitetit 8 herë më të ulët (INSTAT, 2020).

Ky model do të ishte i ngjashëm me modelet e dikotomisë rurale-urbane, por në shkallë kombëtare, që shumë sociologë do ta fokusonin në punën e tyre. Të parët që do ta studionin ishin sociologët urban që studiuan krijimin e vendbanimeve të para humane dhe u munduan të shpjegojnë arsyet e krijimit të tyre (Bairoch, 1988; Jacobs, 1961, 1970).

Për Marksinqyteti ishte vend i shkëlqyer i ‘qytetërimit’, në të cilin përqëndrohet popullsia me nevojat e saj, mjetet e prodhimit dhe kapitalet, ndërsa zonat rurale karakterizohen nga izolimi i subjekteve sociale (Muçaj, 2013: 206; Halilaj, 2017). Kjo ishte mënyra sesi Marks e prezantonte dikotominë urban-rural. Ai kërkonte, ndër të tjera “përmirësimet e tokës në përputhje me një plan të përbashkët” dhe “heqjen graduale të dallimit në mes të qytetit dhe pjesës tjetër të vendit, dhe një shpërndarje më të njëtrajtshme të popullsisë mbi vendin” (Marks dhe Engels, 1983: 56). Qasje të ngjashme prezantoi edhe Engels në esetë ‘*Çështjet e strehimit*’ (Engels, 1872).

Sipas Veber kjo dikotomi vendosi përballë shoqërinë e ‘ndjenjave’ sikurse ai quante shoqëritë tradicionale të fshatit; dhe shoqërinë e ‘racionalitetit’, sikurse quante shoqëritë e metropoleve

në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të (Halilaj, 2017). Dikotomia ruralo-urbane qëndron në diferencën midis shoqërisë tradicionalo-rurale dhe shoqërive urbano-industriale. Ndërsa në shoqëritë tradicionale individët ndërveprojnë të drejtuar nga ndjenjat, në shoqëritë urbano-industriale individët ndërveprojnë në bazë të llogaritjeve racionale (Muçaj, 2013: 196-197).

Ndërsa Durkheim u përqëndrua më tepër te uniteti i shoqërisë dhe “prezantoi dy lloje të solidaritetit social: solidariteti mekanik dhe solidariteti organik” (Gjura, 2003: 42). Durkheim, tregoi një “akord perfekt midis pjesëve të shoqërisë e karakterizuar nga autonomia e subjekteve të saj” (Muçaj, 2013: 200; Aldous, Durkheim and Tonnies, 1972).

Tonnies e përkufizoi dikotominë rurale-urbane me termat ‘gemeinschaft dhe gesellschaft’ dhe analizën mbi modelin urban industrial e bazoi në konceptin e komunitetit dhe shoqërisë. Gesellschaft nënkupton një shoqëri në të cilën spikat sjellja e motivuar nga interesi vetjak, ku më evidente është një prani e institucionalizuar se sa një rend spontan (Gjura, 2003: 62; Halilaj, 2017: 19). Ndërsa fshati, tradita, përkatësia fisnore, gjuha e nënës janë kollonat ku bazohet identiteti tipik i Gemeinschaft (Tonnies, 2001: 22-51). Dikotominë komunitet përkundrejt shoqëri, Tonnies, e përktheu sipas vullnetit njerëzor në: vullneti natyror, i cili përfshin dëshirën, zakonet apo kujtesën, dhe përbën bazën për grupin e komunitetit; dhe vullneti racional, i cili përmbledh shqyrtimin e kujdesshëm dhe vlerësimin e kuptimeve më të mira për të arritur disa përfundime specifike, dhe formon bazat për marrdhëniet në shoqëri (Tonnies, 2001: 22-51, 1941: 272-273; Aldous, Durkheim and Tonnies, 1972: 1191-1200).

Ishte tradita Amerikane që solli modelin e kundërt nëpërmjet konceptin e ‘continuumit rural-urban’ që shpreh një vazhdimësi të shtrirjes territoriale të banuar nga fshati rural në qytetin modern dhe ku treguesit kulturor ‘urban’ dhe ‘rural’ gjenden të përziera në doza të ndryshme përgjatë gjithë shtrirjes territoriale (Muçaj, 2013). Një autor që kontribuoji në këtë tezë është Louis Wirth, i cili e gjente faktorin e kozmopolitizimit dhe sintezës kulturore urbane, si aspekte bazike të modelit të kontinuitetit rural-urbane: te roli i masës së popullsisë, densitetit dhe heterogjenitetit të popullsisë që banon atë qendër të banuar (Wirth, 1938).

Ndërsa në shkallën urbane do të ishte Ernest Burgess, i cili prezantonte modelin e ‘zonave koncentrike’ të ngjashëm me modelin koncentruar demografiko-territorial të tranzicionit shqiptar. Burgess studjoi rritjen e qyteteve, si një dukuri gjerësisht e shtrirë në shoqëritë industriale, dhe gjeti se ajo prezantohet në dy forma, së pari në formën e koncentrimit të

popullsisë në qendër ekzistuese urbane, dhe së dyti si një shtrirje e zhvillimit ndërtimor dhe popullsisë në terriore të reja (Parker, Burgess dhe McKenzie, 1984).

Ndërsa modeli i Burgess nënvizonte një shpërndarje të përdorimit të tokës në formën e një seti rrathësh koncentrik në përputhje me shtresëzimin e shoqërisë, Homer Hoyt nuk ishte shumë dakort me të. Ai e gjeti të papërshtatshme modelin Burgess për të prezantuar evolucionin e strukturës së qytetit dhe propozoi modelin e sektorëve. Hoyt argumentonte se rritja e rentës së tokës nuk mund të bëhet në mënyrë të uniforme në formë rrathësh koncentrikë duke u larguar nga qendra, por shpesh shkon paralelisht me akset e transportit. Hoyt besonte se industria është më shumë e interesuar të ndjekë rrugët hekurudhore në të dy zgjatimet e saj, sesa të mbetet afër dhe të rrethoj ‘distriktin qendror të biznesit’ (Hoyt, 1962: 70, 1962: 184).

Një propozim të përputhur me konceptin ‘continuumit rural-urban’, në shkallën urbane, do të sillnin Harris dhe Ullman. Qasja e tyre do të prezantonte për herë të parë konceptin e aplikuar të policentrizmit. Sipas Harris dhe Ullman, modelet e përdorimit të tokës së qytetit të shekullit të 20-të të Amerikës Veriore janë të zhvilluara rreth disa qendrave të shpërndara nëpër territorin urban (Harris and Ullman, 1945: 8-10, 1945: 13).

Koncepti i koncentrizmit në shkallë të ndryshme territoriale dhe urbane pësoi rrënie dhe rriti ndjeshëm idenë se hirearkia nuk mund të shpjegonte modelet e gjetura në praktikë (Davoudi, 2003), dhe prej fillimeve të viteve 1990 e në vazhdim, kërkimet paralajmërojnë zhvillimin e një modeli të ri të organizimit territorial, i cili është përgjithësisht referuar si ‘modeli i rrjetit’ (Meijers, 2006, 2007). Sipas Meijer në vitin 2007, model i rrjetit apo policentrik është esencialisht i kundërt me modelin e koncentruar të ‘qyteteve qendrore’, apo me fjalë të tjera dimensionit hirearkik të sisteme urbane (Meijers, 2007; Gottmann, 1961).

Urbanisti Gaston Bardet do të na sillte kuptimin e parë mbi modelin policentrik të zhvillimit urban. Ai e kuptonte realizimin e tij në tre komponentë planifikimi: si një mënyrë për rigjenerimin shpirtëror të shoqërisë; si një qasje për planifikimin rajonal, duke kontrolluar rritjen e qytetit gjigand për të promovuar qytetet më të vogla dhe në vend të kësaj një ndjenjë të komunitetit; angazhim për cilësitë hapësinore të dizajnit urban (Bardet, 1951; Bullock, 2010).

Policentrizmi është një koncept shumë i rëndësishëm dhe gjerësisht i përhapur në Bashkimin Europian (Kloosterman and Musterd, 2001; Davoudi, 2003, 2008; Vasanen, 2013). Davodi në vitin 2003 do të nënvizonte se “Komisionerët e BE dhe bashkëpunëtorët e tyre të vendeve antare e promovojnë konceptin [policentrizmit] si një synim të politikave socio-ekonomike”

(Davoudi, 2003: 879). Sipas tij, edhe literatura dhe dokumentat e politikave për zhvillimin territorial të BE janë të mbushura me referenca të policetrizmit (shikoni përshembull, ESDP, 1999; CEMAT, 2000; Norvision, 2000)” (Davoudi, 2003: 979).

Qëllimi kryesor i BE-së për të rritur konkurrencën e saj ekonomike në tregun botëror mbështetet te ky koncept zhvillimi hapsinor duke pranuar promovimin që ESDP i bën për një zhvillim policentrik hapsinor në tërë Evropën (Davoudi, 2008: 51–60). Termi ‘zhvillim policentrik’ dhe ‘policentrizmi’ janë shumë të përdorura në teoritë e zhvillimit evropian dhe aplikohen në shkallë të ndryshme territoriale dhe urbane, duke nisur në shkallë lokale të qyteteve, që nënkupton policentrizëm urban, ku brenda një qyteti dallohen disa pole zhvillimi; për të mbëritur në shkallë Europiane, ku rajone të ndryshme zhvillohen në marrdhënie ekonomike dhe sociale mes njëra tjetrës për të formuar një Rajon të madh zhvillimi (Meijers, 2006: 246; Kloosterman dhe Musterd, 2001: 623, 627; Vasanen, 2013).

Niveli i ndërveprimit të qendrave të banuara të Rajonit Policentrik Urban dhe specializimi i tyre është më i lartë se në rajonet e tjera që nuk mund të konsiderohen si policentrike (Parr, 2004: 233-240; Bertaud dhe Malpezzi, 2001).

Problematika territoriale e hirearkisë së qyteteve në strukturën urbane të Shqipërisë (modeli i ‘qyteteve qendrore’), ka qënë një bashkë shoqëruese e modelit territorial të vendit që në shekullin e 19-të ku dalloheshin për nga dominimi qyteti i Shkodrës, Korçës dhe i Gjirokastrës ndërsa mungonin qendrat e tjera të banuara në formatin qytet (Konica, 1993: 63-65; Imami et al., 2008: 17; Pandelejmoni, 2019). Në vitet e socializmit, megjithëse u bënë përpjekje të mëdha për një balancim të qyteteve dhe popullsisë nëpër territorin kombëtar, gjithësesi kjo nuk u arrit (Misja dhe Misja, 2004; Kotmilo dhe Kotmilo, 2017). Kurse në vitet e tranzicionit, sikurse e prezantuar, modeli demografiko-territorial u koncentrua plotësisht në rajonin Tiranë-Durrës.

4.3. Impakti i produkteve të qeverisjeve territoriale në strukturën territoriale të vendit.

Modeli i koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia, që u zhvillua si produkt direkt i politikave territoriale të qeverisjeve përgjatë viteve të tranzicionit, është shumë i ndryshëm nga modelet e vendeve perëndimore. Kjo na dëmtton, në aspektin e rëndësisë së veçantë që kanë demografia dhe territorialiteti për një shoqëri (Fuga, 2012: 9), por edhe në aspiratën themelore të shoqërisë shqiptare për tu integruar në BE (Krasniqi, 2009: 235; Duma, 2014; Çili, 2013).

Aliaj në vitin 2008, do ta shikonte në një këndvështrim më afatgjatë dhe strategjik rëndësinë e modelit policentrik rajonal për të ardhmen territoriale të Shqipërisë “Ky është një hap kyç në integrimin e vendit në BE, pasi dihet që në të ardhmen financimet e BE-së do të jepen mbi baza konkurruese, duke synuar drejtëpërdrejtë rajonet dhe jo qeverinë qendrore” (Aliaj, 2008, 132-133).

Modeli evropian i Rajoneve Policentrike Urbane, me thelb policentrizmin në të gjitha shkallët urbane dhe territoriale, krijon sinergji mes zhvillimit të poleve të ndryshëm të të njëjtit qytet, qyteteve të ndryshme të të njëjtit rajon dhe rajoneve të ndryshëm të të njëjtit vend (Meijers, 2005; Vasanen, 2013). Kjo do të thotë se qendrat e rrjetit urban e territorial komplementojnë mes tyre duke prodhuar një zhvillim të pëgjithshëm shumë më të lartë se shuma e të gjithë qendrave urbane, kur ato zhvillohen sipas modelit hirearkik të ‘qyteteve qendrore’ të koncentruara (Meijers, 2006).

Qeverisja territoriale, nëpërmjet modelit komcentrim-brakstisje, prodhoi një set kontraditash thelbësore në strukturën hapsinore, territoriale dhe urbane të vendit. Kontradita e parë i referohet “tkurrjes” së territorit kombëtar (Fuga, 2012). Nga njëra anë ne kemi koncentruar popullsinë në Rajonin Tiranë-Durrës dhe nga ana tjetër, kemi lëshuar pjesën tjetër të territorit kombëtar. Kjo prodhon dëme të gjera për shoqërinë, sepse hapsira është vitale për një komb dhe lëshimi apo humbja e saj është një gabim fatal për një shoqëri, veçanërisht për një vend me territor të kufizuar dhe një gjeografi shumë të thyer si Shqipëria (Fuga, 2012). Sikurse do të na e prezantonte Biberaj “Pjesa më e madhe e territorit të saj [Shqipërisë], 76.6% përbëhet nga male dhe kodra më shumë se 200 metra mbi nivelin e detit; pjesa tjetër, 23.4%, përbëhet nga fusha dhe lugina” (Biberaj, 2000: 30).

Kontradita e dytë prezantohet nëpërmjet raportit të disbalancuar midis nivelit të urbanizimit të vendit nga njëra anë, dhe numrit të qyteteve shqiptare nga ana tjetër. Vetëm gjatë dekadës së parë niveli i urbanizimit të vendit u rrit nga 35% që ishte në vitin 1989 në 42% në vitin 2001 (Faja, 2008; Misja dhe Misja, 2004; INSTAT, 2001, 2004), ndërsa në dekadën e dytë popullsia urbane përfshiu rreth 54-58,2% të numrit të përgjithshëm të popullsisë (INSTAT, 2014). Megjithëse nuk kemi tregues zyrtarë të nivelit të urbanizimit në dekadën e tretë, pasi nuk kemi një census të kryer nga INSTAT, referuar dinamikave demografike mund të kuptojmë se niveli i rritjes së urbanizimit ka qënë i lartë edhe në këto vite (INSTAT, 2014, 2015-2020).

Rritja e nivelit të urbanizimit teorikisht rrit edhe numrin e qendrave të banuara urbane, por nuk ka ndodhur kështu. Referuar studimit ‘*Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare*’ të

INSTAT, i cili përdori metodologjinë e re të BE për klasifikimin urban-rural, vetëm qarku Tiranë mund të konsiderohet ‘mbizotërim urban’, qarqet e Durrësit dhe Vlorës ‘të ndërmjetme’, kurse nëntë qarqet e tjera vlerësohen si ‘mbizotërim rural’ (INSTAT, 2014: 33).

Vetëm dhjetë qendra të banuara në Shqipëri mund të konsiderohen si qytete, dhe ato janë “Dajti, Durrësi, Elbasani, Farka, Kamza, Kashari, Paskuqani, Shkodra, Tirana dhe Vlora” (INSTAT, 2014: 37).

Tetë nga këto dhjetë qytete hipotetike që ka Shqipëria i përkasin Rajonit Tiranë-Durrës dhe Rajonit Fier-Vlorë. Vetëm Rajoni Tiranë-Durrës përfshin shtatë nga qytetet shqiptare, ndërsa vetëm qarku i Tiranës, si elementi më i urbanizuar i këtij rajoni, përfshin gjashtë qytete nga dhjetë që ka Shqipëria. Me pak fjalë, nëse nga njëra anë, niveli i urbanizimit është rritur me shpejtësi, numri i ‘qyteteve’ është zvogëluar (INSTAT, 2014: 37).

Këtë fenomen do ta parashikonte edhe INSTAT në ‘*Migracioni në Shqipëri*’ kur do të nënvizonte se “gjashtë komunat [që rrethojnë Tiranën] ngjajnë me vendbanimet tipike urbane” (INSTAT, 2014: 45).

Një nga çështjet e rëndësishme së veçantë hapsinore, në dimensionin global, është ngrohja globale dhe modeli territorial i tranzicionit ka implikimin e vet edhe në vulnerabilitetin e Shqipërisë ndaj saj. Ndryshimet klimaterike kanë një ndikim të lartë në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe BE i jep një vend të veçantë në politikën e saj (EU, 2009). Projekti ESPON i BE-s ka studiuar këtë fenomen dhe ka prodhuar një sërë hartash, të cilat tregojnë ndikimet e ndryshimeve klimatike, në tre aspekte kryesore: impaktet potenciale nga klima; kapaciteti adaptues dhe potenciali i vulnerabilitetit (EU, 2012).

Për Shqipërinë nuk ekzistojnë studime të ngjashme, por nëse përdorim gjetjet e EPSON do të dallonim se modeli demografiko-territorial i tranzicionit rrit vulnerabilitetin e Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimaterike në disa drejtime. Së pari është plakja e popullsisë së Shqipërisë si pasojë e emigracionit të jashtëm dhe uljes së normës së fertilitetit (King dhe Vullnetari, 2007; King, 2010; Vullnetari, 2007, 2010, 2012; Hoxha, 2017; INSTAT, 2004, 2014), dhe referuar EPSON “një rajon me popullatë më të vjetër është më shumë vulnerabël ndaj nxehtësisë dhe ka mundësi më të ulta për tu adaptuar ndryshimeve klimaterike” (EU, 2012).

Një aspekt tjetër urban që na rrit nivelin e impakteve potenciale dhe vulnerabilitetit nga ndryshimet klimatike është gjendja e stokut të banesave. Banesat shqiptare janë përgjithësisht të vjetra (Misja dhe Misja, 2004; HIS Alumni et al, 1998; BB, 2007), dhe kanë varësi të lartë nga energjia elektrike për klimatizimin e ambjenteve të tyre, sepse rreth 47% të konsumit të

enengjisë në vend e konsumon sektori i banesave (Co-Plan dhe PU, 2010; IFC, 2010). Nëse i referohemi raportit të EPSON, ky është një problem i shtuar për qendrat e banuara dhe rajonet në lidhje me impaktet potenciale dhe nivelin e vulnerabilitetit nga ndryshimet klimatike (EU, 2012).

Vulnerabiliteti potencial ndaj ngrohjes globale i Shqipërisë rritet edhe përshak të migracionit të brendshëm që e ka formësuar modelin territorial të tranzicionit. Migracioni i brendshëm i popullsisë nga zonat veriore, verilindore dhe juglindore drejt zonës perëndimore të vendit (INSTAT, 2004, 2014; WB, 2018; King dhe Vullnetari, 2003; Vullnetari, 2007, 2012), ka ekspozuar këtë popullsi migrante ndaj impakteve negative të ngrohjes globale. EPSON, ndërsa prezantonte rajonet më vulnerabël, do të rendiste në vend të parë “rajonet bregdetare dhe me densitet të lartë popullsie” (EU, 2012), sikurse janë rajonet pritëse të migrantëve të brendshëm. Ndërkohë që në zonat e origjinës këto impakte do të ishin më të limituara sepse zonat veriore dhe malore kanë nivel më të ulët vulnerabiliteti (EU, 2012).

Një nga karakteristikat e Shqipërisë së tranzicionit është rritja e sektorit të turizmit, i cili “është një tjetër pjesë e rëndësishme (rreth 30 përqind) e sektorit të shërbimeve dhe tregon shenja potenciale rritjeje” (BB, 2007: 40). Nëse i referohemi raportit të EPSON, në lidhje me aspektin e impakteve potenciale, ai pozon si rajone me rrezikshmëri të lartë, rajonet në “varësi të lartë nga turizmi veror” (EU, 2012).

Modeli demografiko-territorial i tranzicionit ka ndikuar edhe në degradimin e tokës në Shqipëri. Migracioni i brendshëm masiv është shoqëruar me nivel të lartë të ndërtimtarisë në qytetet e mëdha të prekura më së shumti prej urbanizimit të shpejtë dhe të paplanifikuar më parë (UNDP, 2019). Tre janë shkaqet e dëmeve që ka pësuar toka: migracioni i brendshëm i popullsisë rurale drejt zonës qendrore dhe zonës bregdetare, apo dy rajoneve dhe zonës së Ultësirës Perëndimore; ineficensa e qeverisjes përgjatë viteve të tranzicionit; dhe zhvillimi ndërtimor i pa paraprirë nga planifikimet territoriale të mëparshme (UNDP, 2019: 58). Në lidhje me degradimin e tokës, të dyja llojet e qyteteve (të koncentruara dhe të braktisura), paraqesin njësoj fenomenin e degradimit të tokës (UNDP, 2019: 61).

Degradimi i tokës është një nga fenomenet më të dëmshme që mund ti ndodhi një shoqërie, së bashku me humbjen e popullsisë përshkak të migracionit të jashtëm, ato drejtojnë në deformimin dhe humbjen e një shteti. Fuga në vitin 2012 demografinë dhe territorin do ti konsideronte si dy thesaret më të mëdhaja të një shoqërie, prej të cilave formohen gjithë të tjerat (Fuga, 2012: 9).

4.4. Impakti i produkteve të qeverisjeve territoriale në dimensionin urban të vendit dhe cilësinë urbane të jetesës.

Mënyra sesi janë prezantuar qeverisjet e territoriale kanë prodhuar një kontraditë në lidhje me tipologjinë e qyteteve. Struktura urbane e vendit formësohet nga dy tipologji diametrikisht të kundërta. Të dyja grupet tipologjike të qyteteve, si ato që kanë pësuar rritje edhe ato që kanë humbur popullsi, kanë kosto shumë të lartë të menaxhimit dhe administrimit të territorit urban të tyre (IHS et al, 1998; Aliaj, 2008).

Në të njëjtin përfundim arrin edhe BB në raportin *‘Vlerësim i Sektorit Urban në Shqipëri’*, e cila shprehet se rënia e thellë apo rritja e papritur e popullsisë “mund të çoj në kolaps financimin e infrastrukturës lokale dhe ofrimin e shërbimeve vendore. Nga ana tjetër, sfidat në qytetet me rritje të shpejtë të popullsisë krijojnë defiçite në strehim dhe plotësimin e nevojave infrastrukturore” (BB, 2007: 42).

Mënyra e zhvillimit territorial të lejuar nga qeverisjet territoriale të tranzicionit kanë implikime edhe në infrastrukturën sociale të qyteteve të vendit. Qytetet që kanë pësuar rritje të popullsisë, dhe veçanërisht Tirana ndjejnë mungesë të theksuar kapacitetesh së infrastrukturave sociale (Aliaj, 2008; Imami et al, 2008). Të njëjtën problematikë shfaqin edhe qytetet që kanë pësuar rënie të popullsisë, të cilat kanë dështuar edhe në ofrimin e aktiviteteve social-kulturore (Fuga, 2003, 2004). Fuga në vitin 2004 do të shprehej se “Hapsira urbane e vendit dhe veçanërisht ajo rurale është boshatisur nga rrjeti i institucioneve kulturore që ka funksionuar më parë. Veçanërisht rrethet e ndryshme të vendit kanë humbur rëndë sallat e kinemasë, muzetë, bibliotekat, teatrot e tyre” (Fuga, 2004: 249).

Fokusuar te arsimi, referuar politikës së Ministrisë së Arsimit, kjo problematikë do të adresohet në dy drejtime: së pari duke iu mundësuar bashkive ndërtimin e shkollave të reja në zonat urbane ku mësimi bëhet me dy turne dhe e dyta të reduktojmë numrin e nxënësve që vijnë në mësim në klasa kolektive, duke i transferuar në shkollën më të afërt, që është më e madhe dhe ku mund të mësohet me bashkëmoshatarë (RM, 2018). Përveç kostove të tjera sociale dhe politike, kostot ekonomike të kësaj qasje për qytetin e Tiranës shkojnë në 60 milion euro (BT, 2019: 73-74).

Këtë impakt ekonomik të mënyrës sesi është administruar territori në tranzicion e kemi vetëm për bashkinë Tiranë dhe vetëm për sistemin e arsimit, sepse nëse konsiderohen edhe qytetet e

tjera që janë sulmuar nga migracioni i brendshëm ritës, dhe infrastrukturat e tjera sociale, kostot janë të shumëfishta.

Urbanizimi në Shqipërinë e tranzicionit ka rezultuar një zhvillim i pa mbështetur në instrumenta planifikimi territorial dhe urban (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008; Imami et al, 2008; BB, 2007). Kjo do të thotë se mënyra e zhvillimit të të gjitha qyteteve Shqiptare ka prodhuar një sërë problematikash dhe disbalancash në aspektin urban (Imami et al, 2008; IHS Alumni et al, 1998; Faja, 2008; Aliaj, 2008).

Për të përmendur vetëm disa nga to, mund ta nisim me raportin e zhdrejtë midis zonave të zëna nga ndërtimet dhe hapsirave të hapura, që përfshijnë hapsirat e parqeve, shesheve, të aktiviteteve të rekreacionit dhe sportive, nga ana tjetër. Kjo disbalancë prezantohet në disfavor të hapsirave të hapura dhe kjo ndikon në cilësinë e dobët të jetesës qytetare (IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008; Fuga, 2003, 2012).

Së dyti, raport të zhdrejtë midis funksioneve të ndryshme të përdorimit të ndërtesave. Që do të thotë, raport të zhdrejtë midis ndërtimeve me funksion banimin dhe ndërtesat e funksioneve të tjera, që përfshijnë ndërtesat e aktiviteteve ekonomike e të punësimit dhe infrastrukturës sociale e kulturore, si çerdhe, kopshte, shkolla, spitale (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008; Imami et al, 2008). Kjo disbalancë shprehet në disfavor të ndërtesave me karakter ekonomik dhe social kulturor, gjë që dëmton shumë cilësinë ekonomike dhe social-kulturore të qytetarëve (Fuga, 2004: 249, 2003, 2012).

Së treti, mungesë apo pamjaftueshmëri të infrastrukturave inxhinierike, si përshembull, por jo vetëm, rrugë sipas hirearkisë dhe llojeve të transportit, kanalizime të ujësjellës kanalizimeve, telefoni (Aliaj, 2008; BB, 2007). Nëse i referohemi INSTAT “Furnizimi i përshtatshëm i furnizimit me ujë, kanalizimet, dhe hapësira e përshtatshme e banimit janë tregues jo monetarë të një standardi të caktuar jetese.” (INSTAT, 2014: 15)

Këto problematika dhe disbalanca kanë impaktet e tyre negative në cilësinë e jetës urbane të qytetarëve. Impakti i parë ka të bëjë me raportin e banorit me qytetin dhe element të tij, si ajri, peisazhi, drita dhe ndriçimi natyror, qetësia, etj. Zhvillimet masive ndërtimore prodhuan një shumësi ndërtesash të reja të cilat i prishën ekuilibrat ambjental, higjenik dhe estetik të mëparshëm, duke impaktuar cilësinë e jetës së qytetarit (Imami et al, 2008, Fuga, 2004, 2012). Në *‘Indeksi i cilësisë së jetës në qytete, 2020’* të Numbeo del se Tirana jo vetëm është qytet i ndotur, porse po vijon ta thelloj këtë problematikë të saj. Numbeo vlerëson se për gjashtë

mujorin e parë të vitit 2016 Tirana ishte kryeqyteti më i ndotur i Europës dhe i treti qytet më i ndotur i Europës (Numbeo, 2019).

Shumë autorë shqiptarë do ta preknin temën e ndotjes së ajrit në Tiranë, një ndër ta, Aliaj në vitin 2008 do ta vlerësonte si problematikë që vjen nga trafiku i rënduar, i cili është rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës rrugore në qytet (Aliaj, 2008). Sipas Aliaj “Ajri është nga më të ndoturit në Europë, teksa qytetarët janë të ekspozuar të gëlltisnin mesatarisht 70 kg pluhur nga ndërtimet dhe bloza nga karburanti i makinave që përbën shtratin e sëmundjeve të mushkërive dhe kancerit. Këto sëmundje kanë një periudhë inkubimi të fshehtë 15 vjeçar, gjë që do të thotë se në pjesën e dytë të kësaj dekade që po kalojmë, parashikohet një rritje prej 33-35% të këtyre sëmundjeve” (Aliaj, 2008: 96). Këtu duhet theksuar edhe ndikimi në shëndetin public nga mungesa e infrastrukturave të kanalizim-ujësjellës, që sipas Aliaj “ujërat nëntokësore janë të ndotura, dhe kjo situatë rrezikon të konvertohet shumë shpejt në kosto të larta sociale përtej niveleve normale” (Aliaj, 2008: 96).

Këtë fenomen do ta dallonte edhe INSTAT në ‘*Kushtet e banimit dhe jetesës*’, ku do të theksonte se “Njerëzit po bëhen të ndjeshëm ndaj aspekteve negative të grumbullimeve në qendrat urbane si stresi, ndotja, qytetet e mbipopulluara, dhe kanë filluar të pëlqejnë natyrën.” (INSTAT, 2014: 13).

Përkeqësimi i indeksit të ndotjes së ajrit dhe të ujrave nëntokësore sjell edhe uljen e cilësisë së jetesës për ata që jetojnë dhe ata që po mendojnë të shpëngulen në Tiranë. Cilësia e jetesës në qytetet e mëdha të krijuara nga ky model territorial, veçanërisht në Tiranë, prezantohet e ulët edhe nga ‘*Rankimi i qyteteve sipas cilësisë së jetës urbane*’ i kompanisë këshilluese Mercer. Mercer, vlerëson se Tirana renditet në vendin e 175 nga 231 qytete të botës të marra në studim, për cilësinë e jetesës në vitin 2018 (Mercer, 2019).

Zhvillimi ndërtimor, veçanërisht në sektorin e krijimit të banesave të reja, ishte mbresëlënëse që në vitet e tranzicionit (BB, 2007: 14; Misja dhe Misja, 2004; INSTAT, 2014). Në vitet e para, ritmet e rritjes së stokut të banesave do të kishin impakt pozitiv në cilësinë e jetës së qytetarëve. Kjo lidhet për së pari me gjendjen cilësore dhe sasiore të mjeruar të stokut të banesave në regjimin komunist, që u trashëguua në vitet e tranzicionit (BB, 2007: 43; HIS Alumni et al, 1998: 56; Fuga, 2004: 113; Aliaj, 2008: 93).

Si rezultat i “bumit të ndërtimeve” në vitet e tranzicionit paskomunist “konsumi mesatar i hapësirës së banimit për person është rritur nga minimumi prej 5 m² për person në kohën e tranzicionit [1989], në rreth 19.62 m²” (BB, 2007: 46). Por në vitet në vijim ai do të sillte një

paradoks në gjendjen e stokut të banesave në Shqipërinë e sotme, ku nga njëra anë stoku rritet në numër dhe cilësi (INSTAT, 2014: 10, 11; Misja dhe Misja, 2004; BB, 2007), dhe nga ana tjetër popullsia po zvogëlohet me shpejtësi (INSTAT, 2014, 2016-2020; Vullnetari, 2007, 2012). Ky parados shoqërohet me braktisjen e banesave në qytetet e origjinës dhe kthimin e tyre në të pabanueshme (INSTAT, 2004, 2014).

Këtë fenomen do ta dallonte edhe INSTAT kur do të nënvizonte se në 2001 rreth 11,3% të stokut të përgjithshëm të banesave do të mbeteshin të pabanuara, ndërsa një dekadë më vonë, në vitin 2011 ky tregues do të rritej në masën 21,7% (INSTAT, 2014: 12). Ky fenomen negativ përforcohet edhe nga një numër i konsiderueshëm qytezash të reja të krijuara nga urbanizimi i fortë dhe i shpejtë përgjatë regdetit shqiptar (BB, 2007; INSTAT, 2014; Fuga 2012), të cilat janë zhvilluar me ndërtesa shumëfamiljare banimi, megjithëse konsiderohen si zona turistike. Sipas INSTAT “Tetë përqind e ndërtesave dhe banesave janë për qëllime dytësore dhe për përdorim sezonal, që do të thotë se numri i banesave të pabanuara është rritur më shpejt se sa kërkesa e njerëzve apo mundësia e tyre për t’i blerë ato.” (INSTAT, 2014: 13).

Kjo rritje e sipërfaqeve të banesave të ndërtuara në një kohë kur një pjesë e stokut nuk është i banuar vjen për dy faktorë kryesorë. Së pari janë taksat që përfitojnë bashkitë e mëdha nga këto zhvillime ndërtimore, të cilat përfaqësojnë 85.8% të totalit të taksave vendore (Toska, 2020; INSTAT, 2018, 2019, 2020), dhe së dyti është korrupsioni galopant në sektorin e ndërtimit të banesave (BB, 2007; Aliaj, 2008). Si pasojë e qeverisjes territoriale ne jemi në kontraditën që ndërsa kemi një stok të madh ekzistues të banesave të pabanuara ne vijojmë të ndërtojmë ndërtesa banimi të reja në qytetet që po mbipopullohen.

KAPITULLI V: VLERËSIMI I QEVERISJEVE TERRITORIALE TË TRANZICIONIT SIPAS PARIMEVE LIBERTARIANE.

Në këtë kapitull, ne do të bëjmë një vlerësim modelit të qeverisjeve territoriale të tranzicionit. Ai nis me një vlerësim të përgjithshëm të qeverisjeve të tranzicionit sipas qasjeve ideologjike të dy partive kryesore qeverisëse. Më tej vlerësimi fokusohet vetëm për qeverisjet territoriale në lidhje me tre parimet kryesore libertarian: parimi i kufizimit të fushëveprimtarisë së qeverisjes; parimi i qeverisjes me fushëveprimtari të deçentralizuar; dhe parimi i fuqizimit të qytetarit në qeverisje. Këto parime libertariane përputhen me rekomandimet dhe kushtëzimet që vendosin institucionet politike dhe teknike të BE-së dhe të botës perëndimore në dokumentet e tyre politike. Kjo është shumë e rëndësishme për Shqipërinë, e cila prej 30 vitesh kërkon të bëhet “si e gjithë Europa”.

5.1. Vlerësimi qeverisjeve të tranzicionit sipas qasjes ideologjike të partive kryesore qeverisëse.

Rënia e sistemit monist shënoi fundin e modelit të diktaturës totalitare dhe futjen e Shqipërisë në rrugën e ndërtimit të një modeli të demokracive shumë partiake dhe liberale (Krasniqi, 2009: 235; Biberaj, 2000; Gjura, 2015). Biberaj do të nënvizonte se “Demonstratat e studentëve të dhjetorit 1990-të e shtynë Shqipërinë në një epokë të re që premtonte demokraci dhe lulëzim” (Biberaj, 2000: 135).

Në këtë kontekst, në 12 dhjetor 1991, u krijua Partia Demokratike e Shqipërisë (PDSh), e cila u prezantua me një filozofi demokratike të bazuar në modele perëndimore, me angazhimin për të ndërtuar një sistem politik modern, mbështetur në ndarjen e pushteteve, zhvillimin e pluralizmit dhe të demokracisë si dhe për ekonomi të tregut të lirë, integrimin europian të vendit dhe kujdes të veçantë për shqiptarët në trojet e tyre etnike (Krasniqi, 2009: 246).

PPSh ishte pasardhësja e Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSh) të krijuar në vitin 1941 (Krasniqi, 2009: 226; Fuga, 2003: 86). E krijuar prej saj, PPSH ishte një vijuese e ideologjisë marksiste-leniniste të PKSh-së deri në vitin 1991, kur ndryshoi përsëri emrin në Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH) (Fuga, 2003; Biberaj, 2000; Krasniqi, 2008, 2009).

Në kuadrin e hyrjes në tranzicion të vendit, përpara PPSH-së shtrohej domosdoshmëria e përtëritjes së saj për t’ju përshtatur realitetit të ri (Lami, 2013: 30). Sipas Lami, ajo kishte tre mundësi për një ripërtëritje. Nga ana e tij, Fuga në vitin 2003 do të dallonte të paktën katër

faza në procesin e ndryshimit ideologjik të PS-së si forca kryesore e të majtës shqiptare (Fuga, 2003: 99).

Përballë PP-së qëndronte PD e cila prezantohej më shumë si një parti gjithëpërfshirëse (Lami, 2013: 33) dhe kishte prezencën e një fronti antikomunist më shumë sesa të një partie të strukturuar nga ana ideologjike, politike dhe organizative (Krasniqi, 2009). Thelbi ideologjik i PD-së mbështetej në parrudhën “E duam Shqipërinë si gjithë Europa” (Biberaj, 2000).

Në fillimet e saj PD-ë e shfaqte veten si trupëzimi i horizontit të ri mbi konceptet e “demokracisë”, “Europës” dhe “perëndimit”, brenda të cilit shoqëria shqiptare po kërkonte të ripërkufizonte veteveten. Si e tillë PD-ja po e prezantonte veteveten si një parti që përfaqëson të gjithë shoqërinë (Lami, 2013). Sikurse do të na prezantonte Lami, në gjirin e saj aderonin disidentë antikomunistë, nacionalistë, ish-komunistë, liberalë, studentë, përfaqësues të punëtorëve, republikanë, monarkistë, dhe kushdo tjetër që ishte kundër Partisë së Punës së Shqipërisë (Lami, 2013: 33).

Kjo paqartësi nga pikëpamja e përfaqësimit të grupeve shoqërore do të reflektonte edhe në nivel elitash politike të PD-së. Mungonin njohuritë dhe ideologët për të prodhuar një strategji integrale për të kaluar nga sistemi socialist në ekonominë e tregut të lirë (Lami, 2013: 34; Biberaj, 2000; Krasniqi, 2008).

PP-ja e shtrënguar nga realiteti i mjeruar ku e kishte çuar vendin dhe presioni ndërkombëtar bëri përpjekje të shkëputet nga e kaluara e vet totalitare (Fuga, 2004). Ajo tenton një spostim ideologjik nga socializmi stalinist drejt socializmit demokratik por pa u shkëputur plotësisht nga trashëgimia e saj (Fuga, 2003: 108). Ai do të nënvizonte se “Elita politike sunduese e kohës [PPSh] nuk e kishte mendjen thjeshtë te problemi i modelimit të ri të shoqërisë shqiptare, por më tepër kishte shqetësimin e mbajtjes së pushtetit” (Fuga, 2004: 366).

Ndërsa PD-ja, si një parti e krijuar rishtash dhe si një kundështi ndaj PP-së dhe rolit të saj monopolist në politikë, ekonomi dhe shumë aspektet të jetës shoqërore dhe individuale, ishte për së pari një front anti vlerave komuniste që paraqiste PPSh-ë (Biberaj, 2000: 159-160). Kjo është arsyeja pse PD nuk kishte një ideologji të qartë dhe plotësisht të djathtë, por një parti ideologjikisht e të gjithë popullit (Lami, 2013).

Gjatë kohës kur PD ushtronte qeverisjen, 1992-1997, PS do të pranonte tashmë nevojën e krijimit të një ekonomie të përzier, ku duhet të bashkëjetonin prona publike dhe ajo private, por duke theksuar se kjo lloj ekonomie do të sillte me vete pasoja të papëlqyeshme në planin social (Fuga, 2003; Biberaj, 2000). Kurse në lidhje me tokën dhe pronësinë e saj, PS i

përmbahej idesë se “Toka- [duhet të jetë] pasuri mbarëkombëtare, fshatarët përball saj -të barabartë dhe pa asnjë damkë klasore” (Fuga, 2003: 102).

Si konkluzion i Fugës në vitin 2003 “Në vitin 1991 dhe 1992 ajo [PS] kaloi ideologjikisht nga stalinizmi, drejt socializmit demokratik, ndërsa duke filluar nga viti 1997, ajo shkon drejt një liberalizmi ekonomik dhe shoqëror të spikatur” (Fuga, 2003: 108). Për të njëjtin tred flet edhe Biberaj, sipas të cilit ndonëse më parë kishin kritikuar ashpër strategjinë e privatizimit tërësor të PD-së, tani socialistët mbështetën privatizimin e sektorëve strategjikë, duke përfshirë naftën, energjinë elektrike, minierat, burimet ujore dhe turizmin (Biberaj, 2000: 518).

Midis ligjërimit politik dhe veprimit të saj politik në qeverisje shpesh ka diferencë të madhe, sepse ndodh fenomeni që filozofi Zhan Pol Sarte do ta quante “la mauvaise fois” dhe që ka të bëjë me një lloj hipokrizie të pashmangshme që ndan fjalën nga realiteti (Fuga, 2003). Kjo dallohet më qartë në qeverisjen 1992-1996 të Partisë Demokratike, e cila ndërsa u prezantua si një Parti që do të kryente reforma të thella të djathta, nuk hezitoi të ndërmernte edhe politika sociale për të zbutur efektin e këtyre reformave. Kjo do të dëshmonte për një sjellje tipike libertariane dhe socialdemokrate, në të njëjtën kohë, në qeverisjen e saj të kësaj periudhe (Lami, 2013: 35-36).

Sipas Biberaj “Partia Demokratike hiqej si një parti e qëndrës së djathtë por për disa çështje, sidomos ato shoqërore dhe ekonomike, ajo mbante vazhdimisht një qëndrim të majtë” (Biberaj, 2000: 418). Kjo vërehet sidomos në fazën e dytë të qeverisjes së saj, sepse në fazën e parë reformat e konceptit “terapi e shokut” do ti jepnin asaj një prezantim ideologjik të djathtë (Lami, 2013: 36). Sipas Lami në vitin 2013, i cili i referohej burimeve zyrtare, në vitin 1995 rreth 70% e pasurisë së vendit ishte privatizuar (Lami, 2013: 37).

Përball këtij liberalizimi dhe privatizimi në shkallë të gjerë, qëndronte qasja majtiste për të amortizuar ngritjen e çmimeve dhe për të mbështetur konsumatorët që nuk i përballonin dot këto çmime të larta (Lami, 2013). Këto masa shprehnin strategjinë e Berishës që përpiqej të balanconte dëshirën për të vazhduar reformat rrënjësore ekonomike me domosdoshmërinë e sigurimit të bashkëpunimit të masës së gjerë të popullit që ishin prekur nga këto reforma (Lami, 2013: 37).

Qasja e majtë e Pd-së ndaj pronës private, veçanërisht në lidhje me tokën, jo vetëm do ta vendoste atë në një pozicion të majtë ideologjik për një nga çështjet më të rëndësishme që ndajnë hendekun midis të majtës dhe të djathtës ideologjike (Lami, 2013), por do të ishte dhe

një nga pengesat kryesore për zhvillimin e kapitalizmit në tërësi dhe investime të huaja në veçanti (Biberaj, 2000: 294).

Partitë që drejtojnë polet politike në vend, fillojnë e tërhiqen duke humbur plotësisht pozicionet diametrikisht të kundërta ideologjike. PD-ë në qeverisje i largohet ideologjisë diskursive libertariane dhe ndërmerret politika të majta të mbrojtjes së shtresave vulnerabël (Lami, 2013; Meksi, 2007, 2015) dhe në të njëjtën kohë bën një reformë pothuajse komuniste përta i përket pronësisë së tokës bujqësore dhe urbane (Biberaj, 2000; Lami, 2013). Pa mohur reformat e tjerë liberalizuese dhe privatizuese në sektorë të tjerë të ekonomisë (Lami, 2013; Biberaj, 2000; Fuga, 2003), qasje e PD-s në qeverisje anan gjithmon e më shumë qëndrës së majtë.

Nga ana tjetër, ndërsa është në opozitë PS-ë prezantohet si një parti ideologjikisht e majtë, që Fuga do ta konsideronte një parti që do të ndërtonte një socializëm demokratik “utopik”, sapo vjen në pushtet vijon me reformat liberale të PD-s (Fuga, 2003; Biberaj, 2000, Lami 2013).

Arsyet e humbjes së pozicioneve të natyrshme ideologjike të dy partive kryesore shqiptare janë të shumta. Kryesorja, dhe për të dyja partitë, ishte integrimi në Bashkimin Evropian, i cili u kthye në prioritet i padiskutueshëm për çdo qeveri shqiptare (Gjuraj, 2015) dhe prioritetet e përcaktuara në raportet e BE-së përbëjnë pak a shumë edhe programin qeverisës të forcës politike në pushtet (Lami, 2013; Gjuraj, 2015).

Lami do të nënvizonte se “Nuk është rastësi që prioritet e përcaktuara në raportet e Stabilizim Asocimit, si korrupsioni, lufta ndaj trafikut të qenieve njerëzore apo forcimi i kufijve, përbëjnë bazat e programit të qeverisë socialiste [1997-2005] dhe më vonë të asaj demokrate [2005-2013]” duke ju larguar aksit ideologjik majtas - djathtas (Lami, 2013: 46). Për të “Kjo ndryshe quhej edhe si paradigma e kushtëzimit (conditionality paradigm)” (Lami, 2013: 46).

Artikuli i politikave qeverisëse prodhonte një diskurs politik që theksonte aspektin teknik të reformave për instalimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut sesa atë ideologjik (Lami, 2013). Këtu duhet të përmendim edhe një lloj servilizmi të qeverive shqiptare ndaj faktorit ndërkombëtar, i cili lidhej deri diku edhe me faktin e ndikimit që ata kishin në vend nga pikëpamja e sigurimit të kredencialeve politike. Në kushtet kur legjitimiteti i institucioneve shqiptare vazhdonte të ishte problematik në sytë e publikut, politika shpesh e kërkonte legjitimitetin tek institucionet ndërkombëtare (Lami, 2013: 43).

Arsyet e largimit të PD-s nga ideologjia e djathtë dhe një sjellje anti pronë (Biberaj, 2000: 294), ishin të një spektri të gjerë. Së pari, ndikoi e kaluara komuniste e vendit që zgjati për një kohë të gjatë dhe kishte ndikuar në kuptimet antikapitaliste të shoqërisë. Në këtë kuptim

“Ndryshimi i sistemit nuk solli ndryshimin e mendësisë” (Krasniqi, 2008: 229). Por në mënyrë të veçantë të elitës drejtuese të PD-së, shumica e të cilëve vinin nga qarqet akademike, nuk kishin përvojë politike dhe rezatonin deferencë të madhe mes ideve të tyre teorike dhe shanseve për realizëm praktik (Krasniqi, 2008: 230).

Arsyeja e dytë ka lidhje me faktin se PD-ë në fillimet e saj më shumë se një parti ishte një fron antikomunist (Krasniqi, 2009: 246; Biberaj 2000), dhe prezantohej më shumë si një parti gjithëpërfshirëse sesa parti ideologjike (Lami, 2013: 33; Biberaj, 2000: 420).

Arsyeja e tretë ishte elektorale, dhe kishte të bënte me raportin e saj që është e drejtë në kuptimi ideologjik dhe asaj që kërkon nevoja për të krijuar apo mbajtur shumicën e elektoratit. PD-ë gëzonte mbështetje dërmuese në shumicën e zonave qytetare, ndërkohë që e kishte të vështirë të siguronte përkrahjen e fshatarësisë (Biberaj, 2000). Partia Demokratike ishte thujse e detyruar të merrte të njëjtin qëndrim politik sikurse edhe komunistët kur bëhej fjala për tokën, sepse fshatarësia ishte ndikuesja më e madhe në rezultatet e zgjedhjeve (Fuga, 2004: 76).

Për ta vijuar me PS-në, referuar Fuga në vitin 2003 arsyet e largimit të saj nga ideologjia janë katër. Së pari, kur PS erdhi në pushtet, reformat ekonomike të ndjekura nga PD-ja kishin ecur shumë përpara dhe kthimi mbrapsht ishte i pamundur (Fuga, 2003: 109).

Arsyeja e dytë është fakti se socialistët kërkuan dhe nxituan të hiqnin qafe peshën e të kaluarës së tyre totalitare, centralizuese dhe izolacioniste dhe të paraqiteshin para institucioneve financiare ndërkombëtare më një fytyrë të re, me vullnet të plotë për ta futur Shqipërinë në rrugën e globalizimit (Fuga, 2003; Krasniqi, 2008). Por edhe se “socialistët e dinin mirë se pa ndihmën e instancave ndërkombëtare, pa kreditë dhe financimet e Brukselit, shteti dhe shoqëria shqiptare nuk do të mund të funksiononin” (Fuga, 2003: 113).

Si një arsye të tretë do të shërbente faktin se një shtresë shoqërore, e lidhur më partitë e spektrit të majtë politik kishte mundur të pasurohej përgjatë kësaj kohe dhe kishte grumbulluar kapital financiar të mjaftueshëm për të hyrë në ankande ku shiteshin ndërmarrje shtetërore (Fuga, 2003:113). Biberaj do të thellohej më tej në këtë pikë, sipas tij ndërmarrjet dhe dyqanet më fitimprurëse i blenë ish-funksionarët komunistë, duke krijuar përshtypjen e gjerë se, ndërsa mund të kishet humbur pushtetin politik në nivel mbarëkombëtar, e ashtuquajtura mafia e kuqe vazhdonte prapë të kishte në dorë ekonominë (Biberaj, 2000: 292).

Arsyeja e katërt ishte strategjike, sepse ndërmarrja e politikave liberale nga ana e PS-së paralizon diskursin dhe aksionin politik të mbështetur në teza ideologjike të kundësthtarit të saj PD-ë (Fuga, 2003: 113-114). PS-ë “filloi të ndërtojë diferencimin e shoqërisë duke i faturuar

rrezikun partisë kundërshtare. Diskursi “antiberishizëm” dominonte ligjërimin ndaj kundërshtarit në këtë periudhë” (Lami, 2013: 44). Sipas këtij skenari, që në fakt u realizua nga PS-ë, PD-së nuk i mbetet gjë tjetër veçse të konstatojë se programi i saj po zbatohet, dhe kështu humbet alternativa politike.

E gjendur në pamundësi për të bërë opozitë ideologjike, Partia Demokratike i përmbahej vetëm diskursit “antikomunist” (Lami, 2013). Më tej, si PD-ë edhe PS-ë do ti shtonin diskursit të tyre edhe akuzat e ndësjellta dhe reciproke për korrupsion, dhe “programeve të tyre politike edhe premtime antikorrupsion”. Në këtë pikë vlen për tu përmendur fushata e PD-së në viti 2005 “me duar të pastra” që nënkuptonte se PD-ja nuk do të qeveriste në mënyrë korruptive, sikurse e kishte bërë PS-ë gjatë qeverisjes së saj 1997-2005. Dhe në të njëjtën logjikë premtimi i socialistëve në 2013 se “nuk do vidhnin sa demokratët” në qeverisjen e tyre 2005-2013 (Lami, 2013).

Kjo strategji thellonte tensionin politik dhe konfliktualitetin pozitë-opozitë, ndërkohë që përplasjet mes tyre nuk ndërtoheshin mbi bazën e diferencave programore apo ideore por mbështeteshin tek etiketimet dhe sulmet personale. Kështu, të dy partitë kryesore u shkëputën përfundimisht nga strukturimi i diskursit dhe veprimit politik mbështetur në ideologji (Biberaj, 2000; Fuga, 2003; Lami, 2013). Ato tashmë ofrojnë si zgjidhje pak a shumë të njëjtën gjë, duke zbehur dukshëm diferencat doktrinare ndërmjet tyre. Të gjitha partitë shpreheshin gati njëlloj, për integrimin në BE, për ekonominë e tregut, për drejtësinë sociale dhe demokracinë politike pluraliste, partneritetin ndërkombëtar (Lami, 2013; Krasniqi, 2009).

Ndërsa i bën një skaner partive shqiptare, përgjatë viteve të tranzicionit, Krasniqi do ta dalloj “mungesën e identitetit politik” të partive si problemin më të madh të sistemit shumë partiak (Krasniqi, 2009). Këtë dinamikë do ta prezantonte edhe Fuga në vitin 2004 i cili do të nënvizonte se “Të ishe apo të mos ishe në pushtet, kjo s’përbënte më thjeshtë një çështje zbatimi strategjishë të mirëfillta politike të gjetura si të përshtatshme për rindërtimin dhe ripërcaktimin e demokracisë dhe të shoqërisë shqiptare” (Fuga, 2004: 110).

Për Fugën kundërshtitë midis partive që synonin pushtetin nuk ishin mbi nevojën e zbatimit të reformave mbi ideologjinë dalluese të secilës parti, por se kush nga partitë do të kryenin proceset e privatizimeve (Fuga, 2004). Referuar Krasniqit “Kundërshtitë janë më shumë teknike dhe morale, sesa parimore dhe të mbështetura në vlera e synime afatgjata. Kjo ka ardhur si rezultat i ecjes së partive drejt qendrës politike, duke humbur vazhdimisht identitet politik” (Krasniqi, 2009: 300).

Kështu, të dy partitë i ikën “politikës ideologjike” për të zhvilluar një “politikë pa politikë”, të shkëputur nga idetë politike dhe të vendosur vetëm në dikotomitë “komunist-antikomunist”, “korrupsion-antikorrupsion”, dhe të zhvendosur nga idetë apo zgjidhjet drejt vlerave “morale” të individëve. Ndërsa në praktikën qeverisëse përgjatë viteve të tranzicionit ndiqeshin reforma, politika dhe programe të qëndrës së majtë. Apo sikurse e kemi prezantuar në këtë punim: në kuptimin ideologjik të frymëzuara nga “shteti social” rollsian dhe habermasian; dhe në kuptim praktik qeverisës, si “shteti zhvillues” dhe “kapitalizmi i administruar”.

5.2. Vlerësimi i qeverisjeve të tranzicionit sipas parimit të kufizimit të veprimtarisë qeverisëse.

Në këtë seksion do të vlerësojmë qeverisjet territoriale në raport me parimin libertarian të “kufizimit të fushëveprimit të qeverisë”. Do të analizojmë nëse sjellja e tyre ka qenë në përputhje me frymën e “qeverive të vogla” libertariane apo e “qeverive të mëdha” majtiste, në dy kolonat e fushëveprimtarisë qeverisëse në lidhje me zhvillimin e territorit: planifikimi dhe kontrolli i zhvillimit të territorit. Duke qenë se Shqipëria në tranzicion ka kaluar edhe një dinamikë më specifike, që ka lidhje me pronësinë e tokës, ne do ta shtrijmë këtë vlerësim edhe në këtë aspekt.

5.2.1. Parimi libertarian i kufizimit të fushëveprimtarisë qeverisëse.

Pas tre revolucioneve anti-autoritariste të frymëzuara nga vepra e Lock, liberalizmi klasik mbetet apoteoza e lirisë individuale dhe kontenstim i paekuivok i autoritarizmit (Locke, 2005: 20). Prej 250 vjetësh e djathta ka kontribuar për të drejtat e individit dhe një sistem politik të mbështetur te: legjitimiteti, kufizmi, ndarja dhe llogaridhënia e pushtetit (Locke, 2005: 77-218).

Në historinë e filozofive politike është tentuar të vlerësohen edhe filozofi të tjera si të djathta, por referuar kornizës tone teorike, në këtë punim do të pranojmë si të djathtë Liberalizmin Klasik. Çdo filozofi politike apo aplikim i saj në qeverisje të ndryshme kanë modifikuar parimet e tij dhe kanë shkuar më majtas në dualizmin ‘majtas-djathtas’. Kjo ka ndodhur nisur nga liberalizmi i fundshekullit të 19-të dhe shekulli i 20-të (Spencer, 2005; Friedman, 2005; Fuga, 2003).

Dallimi thelbësor në dualizimin “të majtë dhe të djathtë”, qëndron në faktin se ndërsa të majtët janë për një qeveri të madhe, të djathtët janë për një qeveri të vogël (Spencer, 2005; Friedman, 2005; Fuga, 2003; Gjura, 2015; Civici, 2013; Lami, 2010, 2013). Ky thelb formulon ndarjet në të gjitha aspektet e tjera dytësore. Koncepti i “qeverisë së madhe” që mbrohet nga e majta si qeveria e masës së duhur, ka nevojë për: një fushëveprimtari të gjerë qeverisëse, e cila zvogëlon rolin e individit në shoqëri; koncentrim të funksioneve qeverisëse në duart e nivelit më të lartë qeverisë; rrjet të gjerë institucionesh shtetërore të cilat kanë nevojë për hiperlegjislacion për të ushtruar këto funksione qeverisëse; dhe shpenzime të larta shtetërore për mbajtjen e institucioneve, dhe ushtrimin e këtyre funksioneve (Friedman, 2005; Spencer, 2005; Civici, 2013).

Disa nga kuptimet e përgjithshme, të së majtës për “qeverinë e madhe” si qeveri e masës së duhur, na vijnë nga qasje e liberalëve të fundshekullit të 19-të dhe fillimshekullit të 20-të, që kërkonin zgjerim të aktiviteteve qeverisëse dhe centralizim të funksioneve dhe fushëveprimtarisë qeverisëse (Spencer, 2005; Friedman, 2005). Sikurse edhe nga filozofia habermasiane që prezantoi konceptin “të drejtat e qytetarit” apo “të drejtat pozitive” (Habermas, 1976, 1995, 2006, 2010). Këto të drejta që vijnë si shtesë mbi “të drejtat natyrore”, detyrojnë zmadhimin e qeverisë me synimin për ti mbrojtur ato, por gjithashtu zvogëlimin e rolit të individit.

Me të njëtat kërkesa vjen koncepti rollsian i “të drejtës korrigjese” e cila i mbivendosej “të drejtës liberale” për të arritur në një të “drejtë sipas hakut” në filozofinë rollsiane të “drejtësisë si paanshmëri” (Rawls, 1955; Nussbaum, 2011; Brennan, 2007).

Për prezantimin e konceptit “qeveri e vogël” do të donim të sillnim disa përcaktime mbi rolin e shtetit sipas klasikëve të liberalizmit. Për Locke, një shtet është i detyruar të qeverisë: sipas ligjeve të qëndrueshëm e në fuqi, të shpallur e të njohur nga populli dhe jo nëpërmjet vendimesh të improvizuara; të bëjë drejtësi me gjykatës të paanshëm dhe të drejtë, të cilët duhet të zgjidhin grindjet nëpërmjet këtyre ligjeve; dhe të përdorë forcën e komunitetit brenda vendit vetëm për ekzekutimin e ligjeve të tilla dhe jashtë vendit për të mbrojtur komunitetin nga sulmet e huaja dhe pushtimi (Locke, 2005). Sipas tij “Pushteti i shoqërisë ose i legjislativit që krijon ajo nuk mund të hamendësohet kurrë që të shtrihet më tej sesa është e nevojshme për të mirën e përbashkët” (Locke, 2005: 162).

Ndërsa për Spencer, “të drejtat fillimisht ekzistojnë si një tërësi e pandarë të popullit sovran; dhe se kjo tërësi e pandarë i jepet në mirëbesim, një pushteti qeverisë që caktohet nga vet

populli, me qëllim që të bëhet shpërndarja e tyre” (Spencer, 2005: 82). Në këtë kontekst ai do të nënvizonte se qeveritë e duhura (liberale) kërkojnë: “zvogëlimin e bashkëpunimit të detyruar dhe zgjerimin e bashkëpunimit të vullnetshëm...ngushtimin e autoritetit shtetëror dhe zgjerimin e hapsirës, ku çdo qytetar mund të veprojë i pakontrolluar...mbrojtja e lirisë individuale dhe kundrejt shtrëngimit nga ana e shtetit” (Spencer, 2005: 19).

Për Mises qeveria krijohet “Për ndërtimin dhe ruajtjen e qytetërimit dhe bashkëpunimit shoqëror i nevojiten masa për të penguar individët asocial të kryejnë akte të cilat do të shkatëronin gjithçka ka realizuar njeriu përgjatë zhvillimit të tij prej nivelit të Neandertalit” (Mises, 2005: 199-200).

Shoqërisë i nevojitet një institucion që shtyp gjithë elementët antisocialë me synim që të ruhet balanca ku individ është i mbrojtur nga tirania e njerëzve të tjerë me inteligjencë dhe forcë superiore. Kështu, paqja, që Mises nga një qasje hobsiane do ta quante “mungesa e betejës së përhershme së të gjithëve kundër të gjithëve”, mund të arrihet vetëm nëpërmjet një aparati detyrimi dhe shtrëngimi që monopolizon pushtetin për të përdorur verimin e dhunshëm (Mises, 2005). Sipas Mises ushtrimi i këtij pushteti duhet të kufizohet nga “ligjet e bëra nga njeriu, përkundrejt ligjeve të natyrës dhe atyre të prakseologjisë njëherësh” (Mises, 2005: 200).

Kështu e konturon Mises rolin dhe masën e qeverisë, apo sikurse e quan “aparati shoqëror i detyrimit dhe shtypjes”. Fushëveprimtaria qeverisëse, sipas Mises, duhet të kufizohet në pikën ku dhuna qeveritare të mos ndrydhë lirinë e zgjedhjes së individit brenda cakut të vendosur nga ligji prakseologjik. Sepse, përse kohë qeveria e kufizon ushtrimin dhe kërcënimin me dhunë nëpërmjet ndryshjes dhe parandalimit të veprimit antisocial, mbizotëron liria e individit në shoqëri. Nga ana tjetër, kur veprimet e qeverisë shkojnë përtej mbrojtjes së njerëzve nga veprimi i dhunshëm apo mashtrues të individëve antisocial, ajo redukton hapsirën e lirisë së veprimit të individit (Mises, 2005: 200-201).

Nëse do të referoheshim qasjes më shumë mbi ekonominë të Friedman “rolet bazë të qeverisë në një shoqëri të lirë [janë]: sigurimi i një mjeti nëpërmjet të cilit ne mund të modifikojmë rregullat, të ndërmjetësojmë dallimet mes nesh në kuptimin e rregullave dhe të sigurojmë zbatimin e detyruar të rregullave nga ana e atyre pak personave të cilët, ndryshe, nuk do ta luanin lojën” (Friedman, 2005: 29).

Friedman besonte se “Funkcioni kryesor i saj duhet të jetë mbrojtja e lirisë tonë, si nga armiq të jashtë kufinjve ashtu edhe nga bashkëqytetarët tanë: të ruajë ligjin dhe rendin, të garantojë zbatimin e kontratave private, të nxisë tregjet konkurruese” (Friedman, 2005: 2).

Për të kaluar në një qasje tjetër ekonomike do të prezantojmë kuptimin e Smith mbi rolin dhe funksionet e shtetit. Ndërsa na prezanton “Shpenzimet e Sovranit ose të Shtetit”, ai do të na jepte indirekt edhe qasjen e tij mbi funksionet e qeverisë në një vend liberal. Smith do të na i prezantojë të gjitha shpenzimet e Shtetit të ndara në katër pjesë, dhe në këtë kuptim fushëveprimtarinë e tij, të cilat janë: për mbrojtjen e shoqërisë, për drejtësinë, për veprat dhe institucionet publike dhe për ruajtjen e dinjitetit të sovranit (Smith, 2005: 233-248).

Smith thekson se kontributet e publikut të gjerë duhet të përdoren për të përballuar pjesërisht ose tërësisht shpenzime të tilla si ato të mbrojtjes së vendit, të ruajtjes së dinjitetit të kryemagjistratit [drejtësia], mirëmbajtjes së rrugëve dhe mjeteve të tjera të komunikacionit, si edhe institucioneve që shërbejnë për shkollimin dhe edukimin fetar të popullsisë (Smith, 2005: 248). Sipas tij “Të gjitha këto janë në të mirë të të gjithë shoqërisë” (Smith, 2005: 248).

Këto përkufizime mbi rëndësinë themelore që ka liria e individit dhe rolin e shtetit, prezantojnë edhe detyrën e parë të një libertariani, e cila është ruajtja e lirisë. Sipas Friedman “[liria] është një pemë e radhë dhe delikate” dhe për të ruajtur atë duhet kufizuar roli dhe madhësia e qeverisë, në të kundërt mund të kthehet në një Frankeshtain që shkatërron lirinë e individit dhe të shoqërisë në mbrojtje të të cilave është krijuar (Friedman, 2005: 2). Nëse qeveria rritet ajo ‘gëlltit’ liritë tona, sepse sipas Friedman “Qeveria është e nevojshme për të mbrojtur lirinë tonë, është një mjet nëpërmjet të cilit mund të ushtrojmë liritë tona; megjithatë përshkak të përqëndrimit të pushtetit në duar politike, ajo është, gjithashtu, një kërcënim për lirinë” (Friedman, 2005: 2).

Këtë fenomen e dallon edhe Spencer na prezanton më tej nevojën e kufizimit të rolit dhe masës së qeverisë dhe dëmet e pushtetit të pakufizuar. Mbi këtë kontekst, Spencer shprehej se “Pushteti pa cak ndaj shtetasve, i cili, në mënyrë krejt të arsyeshme, i mvishej një individ sundimtar ngaqë besohej se ky përfaqësonte Zotin, tani i mvishet një grupi sundimtar për të cilin askush nuk thotë se përfaqëson Zotin” (Spencer, 2005: 99).

Të njëjtin qëndrim mban edhe John Stuard Mill, në librin e tij *‘Mbi Lirinë’*, ndërsa fliste me superlativa për popujt europiano kontinental që vendosin “kufinj për mundësinë e veprimeve të një qeverie” dhe do të shprehte dëshirën e tij se “një frymë e ngjashme mund të mbizotëronte edhe në vendin tonë [Britani]” (Mill, 2005: 8). Ky koncept i Mill, edhe për qeverinë “e zgjedhur nga populli dhe e përgjegjshme”, sikurse do të konceptohej në atë kohë “vetqeverisje” apo “pushteti i popullit mbi vetë popullin”, është bazik në mendimin e tij shkencor. Për Mill qeveritë duhet mbajtur në kontroll sepse “Si të gjithë tiranitë, edhe titania e shumicës

konsiderohej dhe akoma konsiderohet, e frikshme, kryesisht meqë vepron nëpërmjet akteve të autoriteteve publike” (Mill, 2005: 9), sepse “Vet pushteti është i palogjikshëm” (Mill, 2005: 23).

Tre janë mjetet e “qeverive të mëdha” nëpërjet të cilave ato bëhen gjithmon e më të mëdha dhe zvogëlojnë liritë e individit. Së pari, për të përdorur një concept të Spencer, është “hiper-legjislacioni” (Spencer, 2005: 104-157).

Ndërsa fliste për padobishmërinë rregullimeve dhe ligjeve të tepërta, Spencer do të argumentonte se sikurse nuk imponohen më shtrëngime, për të mirën shpirtërore të njerëzve, nuk duhet të imponohen as për të mirën materiale të tyre. Sipas tij “njëra është po aq e kotë dhe po aq e palejueshme se tjetra. Dështimet e panumërta ende nuk kanë mjaftuar që ta nxjerrim këtë mësim” (Spencer, 2005: 106). Megjithëse çdo ditë shoqëritë përballen me dështime të panumërta, të njëjtat shoqëri besojnë se mjafton një akt i politikës dhe çfarëdo qëllimi i vendosur do të arrijet. Nuk bën asnjë kuptim logjik që nga njëra anë pranojmë se shteti performon keq, përderisa kemi nevojë për ndryshime të legjislacionit, dhe nga ana tjetër ne i japim më shumë fuqi nëpërmjet ligjeve të reja dhe administratës së shtuar (Spencer, 2005; 106-157).

Në të kundërt, dy janë kolonat e funksionimit të një shoqërie të lirë sipas argumentimit të Friedman, të cilat duhen kuptuar si të ndara “[1] veprimtaritë e përditshme të njerëzve dhe [2] struktura e përgjithshme e zakonshme brenda të cilës ato zhvillohen” (Friedman, 2005: 28). Veprimtaritë e përditshme të njerëzve janë si veprimet e pjesmarrësve në ndonjë lojë apo garë, dhe sikurse çdo lojë e mirë apo garë e ndershme, kërkon që pjestarët në të duhet ti njohin dhe pranojnë paraprakisht rregullat e lojës, dhe gjithashtu kërkon edhe një arbitër të interpretoj dhe vëri në zbatim rregullat e lojës. Në të njëjtën mënyrë edhe një shoqëri e mirë kërkon që antarët e saj të njohin paraprakisht dhe bien dakort me të gjitha kushtet e përgjithshme me të cilat qeveria do të qeverisi marrdhëniet mes tyre (Friedman, 2005: 28-29).

Struktura në të cilën zhvillohen aktivitetet dhe veprimtaritë e përditshme njerëzore, është legjislacioni. Për një shoqëri të lirë është bazike që individët të njohin paraprakisht dhe të dakortësojnë me ligjet nëpërmjet të cilave, qeveria si një arbitër do të arbitrojë aktivitetin e tyre të përditshëm (Friedman, 2005: 28). Megjithëse qeveria, në rolin e një arbitri në lojën e individëve mund të bëj ndryshime në legjislacion, ato duhet të jenë të vogla dhe jo të përsëritura. Sipas Friedman “E shumta ne [libertarianët] konsiderojmë vetëm kryerjen e modifikimeve minimale në to, megjithëse efekti grumbullues i një sërë modifikimesh minimale

mund të cojnë në një ndryshim dramatik të karakterit të lojës në shoqëri.” (Friedman, 2005: 28).

Edhe sipas Mises ka dy lloj të bashkëpunimit shoqëror, që janë “bashkëpunimi bazuar mbi kontrata e koordinim, dhe bashkëpunimi mbështetur në urdhëra e nënshtrim, apo hegjemoni” (Mises, 2005: 198). Mises besonte se, kur bashkëpunimi ndodh mbi baza kontraktuale, marrdhënia logjike ndërmjet individëve që bashkëpunojnë është simetrike; kurse, kur bashkëpunimi bazohet te urdhëri dhe vartësia, marrdhënia logjike mes individëve që bashkëpunojnë është asimetrike. Rendi kontraktual i shoqërisë është një rend i së drejtës dhe ligjit dhe shoqërohet nga një qeverisje e shtetit ligjor, që dallon nga shteti social apo shteti paternal (Mises, 2005: 189).

Legjislacioni është tërësia e rregullave që përcaktojnë hapsirën në të cilën individët janë të lirë të veprojnë, dhe sa më të shumta të jenë këto rregulla aq më e kufizuar është liria e individit. Në shoqëritë e bashkëpunimit hegjemonik ka vetëm direktiva dhe rregulla të cilat pushtetmbajtësi mund t’i ndryshojë kur të dojë dhe t’i zbatojë në mënyrë arbitrare duke pasur dorë të lirë për diferencime. Në këtë rend shoqëror “e vetmja e drejtë që kanë vartësit është: të binden pa pyetur” (Mises, 2005: 199).

Përtej hiper-legjislacionit, një instrument tjetër i “qeverisë së madhe” është hiper-administrata, e cila gjithashtu, është e dëmshme dhe ka kosto për shoqërinë dhe taksapaguesit (Friedman, 2005; Spencer, 2005). Spencer, e trajtoi hiper-administratën si pjesë përbërëse të konceptit të tij “hiper-legjislacion”. Që “qëllimi i vendosur të arrijet”, duhet edhe një institucion apo agjensi që ta zbatojë atë ligj (Spencer, 2005: 106). Për Spencer, kalimi i pushtetit politik nga sovranitë te punonjësi i ngarkuar me këtë çështje, është një operacion shumë i gjatë, i cili duke operuar nëpërmjet shumë levave dhe ingranazheve të njëpasnjëshme, konsumon një pjesë të forcës lëvizëse nëpërmjet fërkimit dhe inertësisë. Ky proces është aq i keq në vetvete (përshkak të kompleksitetit vet), sa është i mirë (përshkak të thjeshtësisë së tij) ai sistem ku shoqëria punëson në mënyrë të drejtpërdrejtë individë, kompani apo institucione private (Spencer, 2005: 121).

Në këtë argumentim, Spencer do të rreshtonte disa mangësi të administratës shtetërore, të cilat e pengojnë atë të kryej të njëjtat funksione, të cilat sektori privat do ti kryente më shpejt. Sipas Spencer “Burokracia është e ngadaltë... mendjetrashë...” (Spencer, 2005: 121-122). Ai do të nënvizonte se “Idioti i familjes, gjithmonë do ta gjej një post kishtar, nëse familja ka lidhje të forta” (Spencer, 2005: 122). Për Spencer, një tjetër e metë e burokracisë është paaftësia e saj për tu përshtatur. Ndryshe nga ndërmarrja private, e cila, për t’iu përgjigjur nevojave të

ngutshme, i ndryshon me shpejtësi veprimtaritë e veta: ndryshe nga dyqanxhiu, i cili për një kërkesë që del papritur, menjëherë gjen mënyrën si ta plotësojë” (Spencer, 2005: 123-124).

Në të njëjti kontekst “Një karakteristikë tjetër e burokracisë është se ajo konsiston në shpenzime të tepruara” (Spencer, 2005: 122), sepse “Këto agjensi publike nuk i nënshtrohen kurrëfarë ndikimi si ai që e detyron ndërmarrjen private të jetë ekonomike, afaristët dhe entet tregtare janë të suksesshme, duke i shërbyer shoqërisë me shpenzime të pakta” (Spencer, 2005: 123).

Pesha e dëmshme në ekonominë e vendit, apo “hiper- buxheti” është instrumenti i tretë nëpërmjet të cilit shfaqen “qeveritë e mëdha”. Këtë karakteristikë dhe dëmet e saj do të na e prezantonte Adam Smith në librin e tij ‘*Pasuria e Kombeve*’ (Smith, 2005).

Sipas Smith, pasuria e kombeve varet nga dy rrethana të ndryshme: së pari, nga aftësia, mjeshtëria e zgjuarsia me të cilat realizohet zakonisht puna e tij; dhe, së dyti nga përpjestimi ndërmjet numrit të atyre që zihen me punë të dobishme e numrit të atyre që nuk zihen me një të tillë. E para nënkupton produktivitetin e atij kombi, kurse e dyta nënkupton raportin midis punëtorëve prodhues dhe atyre joprodhues, ku Smith fuste administratën shtetërore. Sipas Smith “Meqë vetë [zyrtarët] nuk prodhojnë asgjë, të gjithë këta mbahen me produktin e punës së të tjerëve” (Smith, 2005:116). Kur zyrtarët shumohen më tepër se ç’duhet, sipas Smith, “mund të konsumojnë në një vit të veçantë një pjesë kaq të madhe të këtij produkti [produkti vjetor kombëtar], saqë sasia e mbetur nuk mjafton për të mbajur punëtorët prodhues” (Smith, 2005: 116-117).

Mbështetur në tre komponentët e një qeverisjeje jo liberalo-klasike: hiper-legjislacion, hiper-administratë dhe hiper-buxhet, ne do të vlerësojmë në vijim të këtij punimi kush ishte modeli i qeverisjeve territoriale të tranzicionit.

5.2.2. Pronësia private mbi tokën urbane dhe roli i qeverisë.

Dëmet në shkallë të gjerë që pësoi struktura hapsinore dhe dimensionimi territorial dhe urban i vendit ishin pasojë e mënyrës së veprimit të shtetit në çështjet territoriale dhe urbane (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2003, 2008; Faja, 2008). Për Aliaj “Arsyet e kësaj situatë shihen tek procesi jo i saktë/plotë i kthimit të pronave nga ku pronarët e tokave kanë marrë sërish pronat e tyre të shpronësuar më parë” (Aliaj, 2003: 95).

Kurse BB do të shprehej se “legjislacioni civil i vendit ende shpreh një qëndrim konservator, klasik ndaj të drejtave të tokës dhe pronës, që është tepër i favorshëm për një qëndrim “laissez

faire” (lejo të ndodhë) deri më sot përsa i përket zhvillimit urban.” (BB, 2007: 81). Për BB-e fajn që u zhvillua një qasje e tillë “laissez faire” e kishte, jo vetëm legjislacioni fillestar civil ndaj të drejtave të tokës dhe pronës, por edhe legjislacioni i mëvonshëm si “Kushtetuta e vitit 1998 dhe legjislacioni civil i vendit.” (BB, 2007: 81).

Sipas kësaj prespektive, kthimi i pronësisë private të tokës urbane ishte faktori dominues për problematikat dhe disbalancat urbane në qytete. Në kontekstin e lirisë së fituar pronarët e pronave të kthyer ndërtuan pa marrë parasysh nevojën për shërbime dhe elementë të tjerë plotësues të zonës së banimit (Aliaj, 2003: 95).

Referuar këtij kuptimi, nëse toka urbane nuk do t’i ishte kthyer ish-pronarëve nuk do të mund të ndërtonin në pronat e kthyer. Si rezultat njësisë urbane nuk do ti shtoheshin ndërtesa të reja dhe qyteti do ishte shumë më mirë i jetueshëm për qytetarin (IHS Alumni et al, 1998; BB, 2007). Sipas Aliaj “Vërehet një tendencë që aty ku pronarëve të mëparshëm u janë kthyer prona/objekte të vjetra të një cilësie të dobët ose të rrënuara, këto po zëvendësohen me ndërtesa të tjera të larta që nuk mund të përballohen me ato shërbime dhe infrastruktura që ekzistojnë” (Aliaj, 2003: 96).

Ka një kuptim gjithë përfshirës se ishin pikërisht këto ndërtesa të reja të zhvilluara në njësitë strukturore ekzistuese urbane të qyteteve që sollën degradimin urban të territoreve ekzistuese urbane (IHS Alumni et al, 1998; Faja, 2008; Fuga, 2003, 2012; Aliaj, 2003, 2008; Imami et al, 2008). Çështja që duhet të kuptojmë është nëse ky zhvillim erdhi si rezultat i veprimtarisë së “shtetit të vogël” liberal që privatizon dhe priorizon zhvillimin e pronës private, apo i “shtetit të madh” majtist që kontrollon shumëçka në proceset e zhvillimit ekonomik dhe marrdhënien mes individëve. Për të kuptuar këtë duhet të vëzhgojmë mënyrat e qeverisjes territoriale të tranzicionit.

Fillimet e tranzicionit u shoqëruan nga urbanizimi i shpejtë dhe fenomeni i migracionit, të cilat korrigjuan strukturën hapësinore që u zhvillua nën planifikimin qëndror të periudhës socialiste (BB, 2007: 22), dhe ju përshtat tregut në rritje që erdhi si pasojë e reformave të forta liberale (Lami, 2013; Biberaj, 2000; Fuga, 2003). Në kontekst të këtyre reformave, në prill të vitit 1991 Kuvendi i parë pluralist i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 7491/1991 ‘*Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese*’ (FZ, nr. 2, 1991). Për tu përmendur janë, gjithashtu, ligji nr. 7512/1991 ‘*Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit*’ (FZ, nr. 6, 1991) dhe ligji nr. 7652/1992 ‘*Për privatizimin e banesave shtetërore*’ (FZ, nr. 10, 1992).

Ky realitet i ri në pronësinë e banesave u ngrit mbi konteksin socialist të pronësisë mbi tokën dhe banesën në të, e cili referuar nenit 18 të Kushtetutës së vitit 1976, toka urbane dhe çdo lloj tjetër i tokës ishin “pronë vetëm e shtetit” (PL, 1979). Shteti kishte edhe dominancën mbi pronësinë e banesës, sepse referuar nenit 23 të tij, shtetasi kishte të drejtë të kishte pronë vetjake banesën e ndërtuar para regjimit socialist, ndërkohë që banesat që shtetëzonte dhe ndërtonte shteti ishin në pronësi të plotë të tij (PL, 1979).

Shtetasit gëzonin teorikisht të drejtën edhe për të ndërtuar një banesë vetjake, lejuar nga neni 9 i Dekretit nr. 5747/1978, *‘Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave’*, që ishte ligji që rregullonte çështjet se ndërtimtarisë, sipas të cilit “Në qytete lejohet ndërtimi i banesave të reja vetjake me të ardhurat e vet shtetasit, në raste të ralla dhe të domosdoshme” (FZ, nr. 3, 1978). Në këtë kontekst të përgjithshëm, ndërsa toka urbane ishte plotësisht në pronësi të shtetit, pronësia e ndërtesave ishte në dy grupe: private ose shtetërore (Misja dhe Misja, 2004; Meksi, 1997, 2015).

Ligji *‘Për privatizimin e banesave shtetërore’* trajtonte stokun e banesave të zhvilluar përgjatë viteve të socializmit dhe ishin në pronësi të shtetit (FZ, 1992). Kjo reformë ndikoi shumë në krijimin e tregut të parë të pronave të paluatshme sepse privatizoi në përfitim të familjeve apartamentet dhe banesat në të cilat ato banonin si qiramarrës të shtetit (Misja dhe Misja, 2004; BB, 2007; Meksi, 1997, 2015).

Sipas nenit 10 të ligjit “Trualli që zë ndërtesa e banimit vlerësohet si zë i veçantë dhe kalon në bashkëpronësi të pronarëve të banesës” (FZ, nr. 10, 1992). Si rrjedhojë logjike, pronarët legjitim nuk e morën pronën e tyre të trashëguar nga të parët (Biberaj, 2000: 294; Lami, 2013; Fuga, 2004), megjithëse referuar frymës së ligjit nr. 7491/1991 *‘Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese’* prona e shtetëzuar nga regjimi komunist duhet të kthehej te pronari legjitim (Biberaj, 2000; FZ, nr. 3, 1991).

Në këtë kontekst, megjithëse ishte një reformë liberale, ajo mbeti në kuadrin e qasjeve majtiste, sepse Shteti si “pronar i epërm” (Spencer, 2005: 78), ja mohoi pronarëve të ligjshëm të drejtën e pronësisë mbi tokën, për t’ia privatizuar atë disa shtetasve të tjerë. Pronarëve legjitim të tokës urbane ju premtoi se do i kompensonte me para’ nga buxheti i shtetit dhe nuk po e realizon dot prej 30 vjetësh (Aliaj, 2008). Aliaj do të prezantonte se “Raporti i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, flet për një sërë çështjes të lidhura me këtë problem [trajtimin e pronësisë së tokës], sidomos me mobilizimin e burimeve të nevojshme për kompensimin e pronarëve” (Aliaj, 2008: 211).

Derraj, gjithashtu, në vitin 2008 do ta prezantonte këtë fenomen padrejtësie shoqërore, kur theksonte se “Pronësia mbi tokën vijon të mbeter problem i pazgjidhur, me gjithë zhurmën e madhe, apo retorikën e përditshme të mediave apo të folësve të qeverive të ndryshme gjatë 17 viteve të fundit” (Imami et al, 2008: 53).

Sipas Biberajt, që në origjinë qeveria nuk e kishte shumë seriozisht me kompensimin e pronarëve, çfarë duket nga fakti se “qeveria u angaxhua të zhdëmtonte ish-pronarët për aq sa e lejonin mundësitë e vendit” (Biberaj, 2000: 294).

Kjo do të përcaktonte kalvarin e zgjidhjes së kësaj çështje shumë të rëndë në disa drejtime, por për së pari në lidhje me borxhin që shoqëria i kishte ish-pronarëve që sipas Aliajt “grupet përfaqësuese të interesit të pronarëve të shpronësuar flasin për një faturë 30 miliard euro” (Aliaj, 2008: 209).

Situatën e vështirë të pronave dhe ish-pronarëve do ta dallonte edhe Fuga në vitin 2012 kur do të nënvizonte se “shohin nga larg se si e gëzojnë të tjerët tokën e tyre apo dëgjojnë gjatë fushatave elektorale sesi liderët bëhen “xhymertë” duke falur, dhuruar, blatur, jashtë dhe përtej ligjit, për nevoja elektorale pronat që i takojnë tjetërkujt” (Fuga, 2012: 158).

Pra, ishte “shteti i madh” me metalitet majtist, që së pari, zgjeroi kufinj të fushëveprimit dhe rolit të vet duke zvogëluar të drejtat e individit, dhe së dyti, krijoi parakushtin për dëmtimin e qytetit, dhe jo pronësia private mbi tokën. Toka urbane, vërtetë nuk ju kthye në tërësinë e vet, porse një pjesë e parcelave në hapsirat e hapura midis pallateve që formojnë njësinë e banimit u kthyen te pronarët legjitim (Biberaj, 2000).

Referuar Biberaj në vitin 2000, *‘Ligji mbi Kthimin dhe Zhdëmtimin’* që PD-ë miratoi në prill të 1993, ndër të tjera u jepte ish-pronarëve të drejtën të kërkonin trojet që nuk ishin zënë me ndërtime (Biberaj, 2000: 294-295). Një pjesë e atyre pronarëve që arritën ta marrin, përfituan një leje ndërtimi të cilat dëmtuan rëndë njësitë urbane dhe dimensionin urban, mjedisor dhe estetik të qytetit si një i tërë (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008).

Vëzhguar në këtë kontekst, duket sikur ishte pronësia private mbi tokën urbane që shërbeu si një shkaktar i dëmeve urbane në territoret në zhvillim të qyteteve. Në të kundërt edhe këtë dëm e solli “qeveria e madhe” që i njohu vetes të drejtën të japi leje ndërtimi në kundërshtim të plotë me shkencën e urbanistikës, për të cilën njësitë e konsoliduara urbane janë të mbyllura për zhvillim të mëtejshëm ndërtimor (Steiner, Butler dhe Sendich, 2010; Faja, 2008; Aliaj, 2003, 2008).

Pavarësisht se këto pronësi pas kthimit të i zoti ishin pronësi private; një qeverisje që i respekton kufinj të vet të vendimarrjes brenda ligjit, nuk do i kishte lejuar këto ndërtime të gabuara. Zhvillimi urban nuk varet nga pronësia private apo publike e tokës, por me shkencën e aplikuar të urbanistikës, e cila mund të vlerësojë nëse një kërkesë për zhvillim duhet lejuar apo jo (Steiner, Butler dhe Sendich, 2010; IHS Alumni et al, 1998; Faja, 2008).

Për këto arsye qeveritë territoriale të tranzicionit, në lidhje me pronësinë e tokës urbane, nuk janë sjellë si “qeveri e vogël” me filozofi libertariane. Për libertarianizmin “Roli i qeverisë është thjeshtë të bëjë diçka që tregu nuk mund ta bëjë për vetveten, domethënë të përcaktojë, të arbitrojë dhe të imponoj rregullat e lojës” (Friedman, 2005: 31).

Pra, në këtë rast, ajo duhet të kryente vetëm dy detyra bazike, të privantizonte stokun shtetëror të banesës sipas rregullave të përcaktuara prej saj dhe të njohura e të pranuar nga qytetarë, që janë parime bazike për një shoqëri të lirë (Friedman, 2005: 28), dhe do kthente titujt e pronësive private të pronari legjitim i cili ishte shpronësuar në sistemin e kaluar, duke lejuar që tregu i lirë të vepronte me “dorën e padukshme” dhe të rregullonte marrëdhëniet e pronësisë midis truallit dhe ndërtesës (Smith, 2005).

Klasiku i liberalizmit ekonomik, Adam Smith, në veprën e tij ‘*Pasuria e Kombeve*’ do ta prezantonte paradigmen e tregut të lirë si një sistem rregullues, apo “një dorë e padukshme”, që sjell mirëqënien publike nëpërmjet zhvillimit të interesit vetjak (Smith, 2005). Ky mekanizëm do të siguronte që secila nga palët, të gjenin interesin e vet në një transaksion privat “me kusht që transaksioni të jetë vullnetar dhe të dyja palët të jenë të informuara” (Friedman, 2005: 14).

Për më tepër, arsyetimi se qytetet u dëmtuan përshkak të kthimit të tokës urbane ka kuptim vetëm për shtrirjet urbane të qyteteve të para viteve 1990-të. Urbanistika socialiste e zhvilluar nëpërmjet kontrollit të plotë mbi territorin kishte përfshirë në teorinë dhe praktikën e saj instrumentin e “vijës kufitare të ndërtimit” (Faja dhe Alimehmeti, 1983; Faja, 2008; Kotmilo dhe Kotmilo, 2017). Mbështetur në nenin 6 dhe 7 të Dekretit nr. 5747, dt. 29. 06. 1978 ‘*Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave*’ (FZ, nr. 3, 1978), ky instrument kufizonte mundësinë e ndërtimit dhe shtrirjes urbane të qytetit dhe përtej saj nuk lejohej ndërtimi (Faja dhe Alimehmeti, 1983; Faja, 2008; BB, 2007).

BB në 2007 do të nënvizonte “Zhvillimi i qyteteve të vogla [1950-1990] u kthye në prioritet dhe qytetet e mëdha u detyruan të zhvilloheshin brenda “vijave të verdha” – kufijt e qyteteve të vendosura sipas Master Planeve” (BB, 2007: 5).

I gjithë arsytimi i mësipërm ka relevancë vetëm për zhvillimin ndërtimor në shtrirjen brenda vijës së ndërtimit të qyteteve socialiste, kurse qytetet e sotme kanë shtrirje shumë më të madhe se ajo (Vullnetari 2010; Fuga, 2004, 2012).

Urbanizimi i shpejtë përshkak të migracionit të brendshëm preku për së pari territoret që shtrihen në zona me përdorime të tjera të tokës, si fshatrat rreth Durrësit dhe Tiranës apo gjatë bregdetit të Ultësirës Perëndimore (INSTAT, 2004, 2014; King dhe Vullnetari, 2003; Vullnetari, 2007, 2012). Periferitë e qyteteve kryesore u zhvilluan me shpejtësi dhe zonat informale “gjenden në të gjithë qytetet e tjera të mëdha, si Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe në një shkallë më të vogël, Vlorë” (BB, 2007: 66).

Po kështu, “Zinxhiri Bregdetar” nga Velipoja në Ksamil, ka një pësuar një zhvillim masiv ndërtimor, megjithëse këto territore ishin jashtë vijave të verdha të qyteteve socialiste. Këto teshtirje të reja, tashmë urbane, shfaqin probleme edhe më të rënda se njësitë e vjetra që kanë pësuar ndërhyrje (IHS Alumni et al, 1998; Fuga, 2012; Aliaj, 2008).

Këto ndërtime, përgjithësisht, ishin zhvillime informale të tokës me përdorim të mëparshëm bujqësor, që më vonë do të përfshiheshin në një proces të gjatë legalizimi (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008). Edhe ky proces do të paraqesi shumë qartë karakteristikat etatiste të qeverive territoriale të katër fazave, por për arsye të shtrirjes në kohë ne do ta trajtojmë gjerësisht në vijim të këtij punimi, ku do të bëjmë edhe propozimet tona për reformim të tij.

5.2.3. Instrumentat e planifikimit territorial dhe roli i qeverisë.

Qytetet shqiptare të sotme paraqesin një sërë problemesh dhe disbalancash urbane të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës së qytetarëve (BB, 2007; WB, 2018; Fuga, 2004, 2012; Aliaj, 2003, 2008; Imami et al, 2008). Më parë ne arsyetuar se këto dëme urbane i solli “qeveria e madhe” por jo nëpërmjet pronësisë private mbi tokën urbane.

Dy janë instrumentet që përdorë një qeveri për të ushtruar kontroll mbi zhvillimin urban dhe territorial, dhe ato janë: instrumentat e planifikimit, apo llojet e ndryshme të planeve urbane dhe territoriale; dhe instrumentat e kontrollit të zhvillimit (Faja dhe Alimehmeti, 1983; IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008; Faja, 2008; Aliaj, 2003, 2008; Steiner, Butler dhe Sendich, 2010). Mbi këto dy shtylla zhvillohet gjithë procesi i administrimit të zhvillimit urban dhe territorial, dhe këto janë kontrollet shtetërore, megjithëse me emërtime të ndryshme në

kohë të ndryshme, që kanë vendosur ligjet shqiptare që nga ai i vitit 1978 (FZ, nr. 3, 1978) deri te ai i vitit 2014 (FZ, nr. 137, 2014).

Urbanizimi që përfshiu vendit ishte i pa-paraprirë nga planifikimi dhe ishte kjo një nga shkaqet që prodhoi këtë dëmtim masiv të qyteteve shqiptare përgjatë periudhës së tranzicionit (Misja dhe Misja, 2004; BB, 2007; Aliaj, 2003, 2008; Imami et al, 2008; IHS Alumni et al, 1998). Ndërsa shprehej në këtë kontekst, Nientied do të nënvizonte se “Planifikimi dhe koordinimi i pamjaftueshëm, në një këndvështrim afatmesëm apo afatgjatë, do të rezultojë me kosto më të lartë të zhvillimit urban” (IHS Alumni et al, 1998: 13).

Qeverisjet, si ato qëndrore edhe ato vendore, nuk arritën të hartojnë instrumente planifikimi, sipas nivelit të tyre qeverisë dhe në përputhje me funksioneve të veta qeverisëse (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2003, 2008; Imami et al, 2008; BB, 2007). Banka Botërore do të nënvizonte se “Ato pak Master plane [instrumenta planifikimi] që ekzistojnë, datojnë që në kohën e komunizmit dhe nuk përputhen me kërkesat e kohës për përdorim toke si dhe i janë keqpërshtatur ekonomisë së tregut.” (BB, 2007: 53).

Do të ishte mungesa e planeve që do të prodhonin realitetin e papranueshëm urban të qyteteve të tranzicionit (BB, 2007). Sipas saj, kur nuk ekziston një plan rregullues, një aplikanti për leje ndërtimi shpesh i kërkohet të përgatisë një plan për një lagje specifike, bllok apo shesh ku ai/ajo dëshiron të ndërtojë. Përveç kostove dhe vonesave me të cilat përballlet aplikanti, kjo praktikë mund të krijojë pa dyshim konflikte interesi (BB, 2007: 83)

Për këtë situatë do të fliste edhe Derraj në vitin 2008 kur do të nënvizonte se “në Shqipëri në këtë moment është vështirë të flitet për një administrim të efektshëm të territorit [nëpërmjet planeve të miratuara më parë] nga ana e autoriteteve si në nivel qëndror, ashtu edhe në atë lokal” (Imami et al, 2008: 52).

Sipas Derrajt proceset e zhvillimit urban dhe territorial “bazohen [vetëm] në norma teknike të cilat evidentojnë distancat midis objekteve që duhet të ndërtohen, dendësinë e lejuar, si dhe cilat janë hapat administrativë që duhet të ndjekë ndërtimi” (Imami et al, 2008; fq. 52). Me pak fjalë, Derraj thekson se zhvillimi është lejuar mbështetur në disa kushtëzime të projektimit urban dhe në mungesë të planifikimit urban apo territorial. Ndërkohë që thekson se “zhvillimi territorial i një vendi duhet të bazohet në plane, të cilat janë të lidhura organikisht midis tyre” (Imami et al, 2008: 53).

Aliaj në vitin 2003 do ti vinte një theks të veçantë mungesës së planeve rregullues urban për qytetet shqiptare, veçanërisht kryeqytetit (Aliaj, 2003: 92-115).

E thënë thjeshtë, Shqipërisë së zhvillimit të shpejtë ekonomik, politik, social, kulturor, demografik, dhe në këtë kuptim edhe ndërtimor, i munguan përgjatë gjithë viteve të tranzicionit instrumentat e planifikimit territorial. Mungesën e tyre do ta prezantonte edhe Fuga në vitin 2012, kur thekson se ka ardhur koha “për ti bërë këto politika [urbane dhe demografike] me plan kombëtar dhe vendor” (Fuga, 2012: 154).

Në mbështetje të këtij argumenti, mjafton të thuhet se i fundit Plan i Përgjithshëm Territorial, që në atë kohë quhej Plan Rregullues i Përgjithshëm i Kryeqytetit është miratuar nga qeveria komuniste (IHS Alumni et al, 1998; Faja, 2008; Aliaj, 2003, 2008). Ai u hatuar nga Instituti i Projektmeve Urbanistike në vitin 1989-të dhe u miratua në 1 Shkurt 1990 nga Qeveria e drejtuar nga Kryeministri Adil Carcani (Aliaj, 2003: 100; Kotmilo dhe Kotmilo, 2017).

As sot, Tirana nuk ka një Plan Territorial, i cili do na ndihmojë për të ndërtuar një Tiranë tjetër nga kjo që kemi (Aliaj, 2003: 101). Aliaj do të prezantonte se “Tirana i referohet deri sot një plani urbanistik, i cili jo vetëm është hartuar përpara 20 vjetësh, por është konceptuar në kohën e një sistemi tjetër” (Aliaj, 2008: 106).

Edhe Dhamo, do të theksonte se “Plani Rregullues ekzistues [i Tiranës] duke mos qenë i orientuar nga objektiva realë, nuk mundi ta zotëronte dot zhvillimin e kësaj situate” (IHS Alumni et al, 1998: 28).

Kurse Faja do të prezantonte se të gjitha qytetet shqiptare po zhvilloheshin në vitet e tranzicionit në mungesë planifikimi, sepse planet e fundit të tyre ishin hartuar në vitet e komunizmit (Faja, 2008: 19).

Kjo situatë, e zhvillimit të paplanifikuar më parë, identifikohet për të gjitha qytetet kryesore shqiptare dhe është e tillë, në mungesë instrumentash planifikimi, për të dyja nivelet e qeverisjes (Imami et al, 2008: 52-55).

Qeveria qendrore ka dështuar të hartojë instrumenta të planifikimit territorial në lidhje me sektorët e zhvillimit që i përkasin si fushë veprimtarie, si për infrastrukturat kombëtare apo shpërndarjen e popullsisë nëpër territor. Në vitin 2008, Derraj do të nënvizonte se “Në Shqipëri vazhdojmë të mos kemi një Plan Hapsinor në nivel kombëtar” (Imami et al, 2008: 53).

Gjithashtu, edhe qeveritë lokale, kanë dështuar të hartojnë e miratojnë instrumenta të përgjithshëm dhe pjesorë për territoret në juridiksionin e tyre (Aliaj, 2008; Imami et al, 2008). Në këtë kontekst Derraj do të pohonte se “Shumica e qyteteve shqiptare (bashkive) operojnë me Plane Rregulluese të miratuara para viteve '90-të” (Imami et al, 2008: 53).

Thënë në formën e një sentence, në Shqipërinë e tranzicionit ka munguar Planifikimi i Zhvillimit (IHS Alumni et al, 1998: 28-29; Aliaj, 2003: 92-115, 2008: 106; BB, 2007: 53-54, 83).

Ndërsa është e qartë mungesa e instrumentave të planifikimit ka prodhuar shumë dëme në dimensionin urban dhe territorial të vendit, pyetja është kush ishin shkaqet e mungesës së tyre. Për të kuptuar këtë do ti kthehemi, klasikëve të liberalizmit, dhe veçanërisht Spencer, i cili kur shpjegon konceptin e tij të “Hiper-legjislacionit” si dukuri e “shtetit të madh”, prezanton hiper-legjislacionin, hiper-administratën dhe hiper-buxhetet si karakteristika të tij (Spencer, 2005: 104-158).

Vëzhguar në këtë kontekst, që të fajësojmë “shtetin e vogël” libertarian për mungesën e planeve urbane dhe territoriale, na duhet të gjejmë: mungesa financimesh publike; institucionesh; dhe, legjislacioni për hartimin dhe miratimin e tyre. Në të kundërt, shumë para’ të taksapaguesve shqiptar, europian apo amerikan janë shpenzuar: në mbajtje institucionesh e agjensish shtetërore me detyra dhe funksione specifike në planifikimin territorial; në tendera e konkurse kombëtare e ndërkombëtare me synim hartimin e këtyre planeve. Për hartimin dhe miratimin e instrumentave të planifikimit nuk kanë munguar as financimet, një pjesë e të cilave kanë qenë edhe financime në formë grantesh apo kredish të huaja (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008).

Dhamo në vitin 1998, ndërsa fliste për nevojën e adresimit të situatës së zhvillimit të paplanifikuar do të prezantonte se “Si përgjigje e kësaj shtate planifikimi, USAID ka mbështetur një Program për Menaxhimin e Tokës, të fokusuar në çështje konkrete, duke përfshirë në të stafin ekzistues dhe komunitetin si të dhëna bazë”, apo më tej “Gjithashtu Qeveria Austriake u aktivizua në përgatitjen e një Plani për Tiranën” (IHS Alumni et al, 1998: 29).

Këtë fakt do ta prezantonte më qartë Aliaj, kur nënvizoi se “Që nga viti 1989 [1990], kur u miratua plani rregullues i fundit, donatorë të ndryshëm kanë financuar të paktën 7-8 inisiativa planifikuese duke ndihmuar hartimin e planeve rregulluese, strategjike dhe specifike për rajonin dhe qytetin e Tiranës” (Aliaj, 2008: 106-107).

Aliaj e prezanton këtë fakt që në vitin 2003, kur theksonte se “USAID ka financuar në 1998 për rishikimin dhe hartimin e propozimit për një Rregullore Zonimi Funkcional” dhe “... planit strategjik të realizuar nga PADCO, si pjesë e Projektit të Menaxhimit të Tokës Urbane financuar nga Banka Botërore” (Aliaj, 2003: 101).

Ndërsa shkruante për temën e kostove publike për planifikimin territorial Aliaj do të nënvizonte faktin absurd që qeveria shqiptare i ka paguar këto konsulenca nga financime si donacion apo kredi. Sipas tij këto para’ duhen paguar përmes taksave, ndërsa “çuditërisht ajo nuk i ka pranuar de jure produktet finale të kësaj asistence, edhe pse ka rimbursuar për firmat e huaja të konsulencës paratë e shërbimit?!” (Aliaj, 2008: 107).

Këto qasje janë gjerësisht të shtrira, sepse vetëm për Tiranën janë financuar tre instrumente të planifikimit të përgjithshëm territorial: Plani i administratës së Kryebashkiakut Rama i cili nuk arriti të miratohej në nivelin përfundimtar në KKRrTRSh; Plani i administratës së Kryebashkiakut Basha, i cili u hartua nga administrata lokale në proçese gjithëpërfshirëse, dhe u miratua me vendimit të KKT në 15 Shkurt 2013-të; dhe Plani i administratës së Kryebashkiakut Veliaj, i cili u hartua nën drejtimin e arkitektit italian Boeri, u miratua në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Tiranë në 29 Dhjetor 2016, dhe më tej u miratua me vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit në 20 Prill 2017-të (AKPT, 1993-2017).

Të pakta janë qytetet për të cilat është financuar vetëm një herë proçesi i hartimit të Planit. Më të shumta, janë qytetet për të cilat plani është financuar më shumë se dy herë. Për Hapsirën Tiranë-Durrës janë dhënë dy financime për Studime Hapsinore dhe Rajonale, (AKPT, 1993-2017, 2015).

Zonave turistike bregdetare, nga Velipoja e Shkodrës te Ksamili i Sarandës ju është buxhetuar të paktën një herë Masterplani, pa folur për Shkëmbin e Kavajës, Golemin, Karpenin që jua është bërë nga tre here pagesa për planifikim turistik. Bregdetit të jugut nga gjiri Vlorës në Kepin e Stillos, i janë financuar tre Masterplane për ‘*Zhvillim e Turizmit dhe Mbrojtjen e Bregdetit*’, një pjesë e të cilave janë miratuar nga KKRrTRSH apo KKT (Brammah et al, 2010; MIE, 2020; AKPT, 1993-2017; Imami et al, 2008).

Përveç financimit të inisiativave, për të hartuar instrumenta planifikimi territorial nuk kanë munguar institucionet publike për të kryer këto detyra. Në varësinë e Ministrisë së linjës së sektorit të Zhvillimit Territorial dhe Urban ka funksionuar ‘*Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Urbane*’ (ISPU), i cili është organizuar dhe ka funksionuar me detyrë hartimin e instrumentave të planifikimit Kombëtar dhe Vendor. Së pari, në nenin 8 të ligjit 7693/1993 ‘*Për Urbanistikën*’ (FZ, 1993), por më tej edhe në nenin 13 të ligjit 8405/1998, ‘*Për urbanistikën*’ (FZ, 1998), përcaktohej se “ISPU është organi shtetëror në nivel kombëtar që harton studime dhe projekte urbane të përcaktuara në rregulloren e urbanistikës” (FZ, nr.23, 1998), kurse në kreun V të rregullores së Urbanistikës të miratuar me VKM Nr. 722/1998,

përcaktohen roli dhe detyrat e ISPU, ndër të tjera “ISPU është organ i specializuar shtetëror në nivel kombëtar në fushën e planifikimit të territorit dhe studimeve e projekteve urbanistike në nivel kombëtar rajonal e lokal” (FZ, 1998).

Me miratimin e ligjit 10119/2009 ‘*Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial*’, u krijuar Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (QBZ, 2010) e cila kryen detyra të ngjashme.

Të tre ligjet i detyrojnë Njësitë e Qeverisjes Vendore, të përfshijnë në administratën e tyre njësi me detyra dhe përgjegjësi në sektorin e planifikimeve urbane (FZ, 1993, 1998, nr.23; QBZ, 2010).

Për të marrë shembull bashkinë e Tiranës, ajo përfshinë në strukturën organizative të administratës së saj një Drejtor të Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, që përfshin katër drejtori me 10 sektorë, dhe dhjetëra zyrtarë që paguhën nga taksat për të kryer detyra në planifikimin dhe kontroll të territorit (BT, 2020).

Në këtë kuptim, mungesa e instrumentave të planifikimit territorial nuk ka ardhur si pasojë e “qeverisë së vogël” libertariene, por nga “qeveria e madhe” majtiste, që i lejon vetes të mbajë institucione inekzistente dhe të shpërdorojë paratë publike të shqiptarëve dhe bujarinë e ndërkombëtarëve, pa dhënë asnjë produkt (Aliaj, 2008). Ishte “shteti i madh” majtist me karakteristikat e tij që kanë penguar hartimin e instrumentave të planifikimit territorial dhe urban, gjë që ka lejuar zhvillimin e paplanifikuar. Kjo është në përputhje me atë që do të theksonte Aliaj ndërsa shkruante për arsyet e ndërtimitarisë së paplanifikuar “për shkak të paaftësisë së qeverive paskomuniste për të siguruar alternativa të ligjshme ndaj qytetarëve që tashmë kanë të drejtën legjitime të lëvizjes së lirë” (Aliaj, 2008: 96).

5.2.4. Kontrolli i zhvillimit ndërtimor dhe roli i qeverisë.

Qytetet kryesore të vendit kanë pësuar një densifikim të popullsisë dhe një intensifikimin të ndërtesave veçanërisht në zonat qendrore të tyre (IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008; Fuga, 2004, 2012; BB, 2007).

Fuga, ndërsa do ti bënte një skaner gjendjes urbane të qyteteve do të theksonte se “në mikromjediset tona urbane [njësitë strukturore të qytetit] sidomos në zonat kryesore të vendit, kemi një sipërfaqe më të ngushtë dhe më të populluar dendur sesa më parë” (Fuga, 2012: 13).

Këto realitete të reja urbane dhe territoriale u formësuan si rezultat i migracionit të brendshëm nga rajonet veriore dhe jugore drejt rajonin qendror dhe veçanërisht qyteteve të mëdha (INSTAT, 2004, 2014; BB, 2007; King dhe vullnetari, 2003; Vullnetari, 2007, 2012). Të gjitha këto zhvendosje demografike i realizuan nevojat e tyre për strehim, ose nëpërmjet tregut informal, ose nëpërmjet tregut formal të ndërtimit të banesave (IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008; BB, 2007).

Për tregun informal do të flasim më tej në këtë punim, kurse për tregun formal do të ndalemi tani. Janë ndërtesat e krijuara nga tregu formal i ndërtimit të banesave, që ka lidhje me lejdhënien ndërtimore, që sollën problematikën për të cilën po flasim. Referuar Aliaj në vitin 2003 “...përkeqësimi i zhvillimit të brendshëm të qytetit ka ardhur si pasojë e tejkalimit të dhënies së lejeve të ndërtimit...” (Aliaj, 2003: 95).

Sipas kësaj perspektive, intensifikimi i ndërtesave në qytetet shqiptare kanë dëmtuar njësitë strukturore të qytetit dhe për këtë pasojë është faji i qeverisjes në sektorët përkatës (IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008; Fuga, 2004, 2012; Aliaj, 2008). Sipas Aliajt në vitin 2003 “Tashmë sa vjen e rritet rreziku i mbipopullimit të zonave të banimit në pjesën e brendshme/qëndrore të qytetit” (Aliaj, 2003: 96)

Ka një lidhje shumë të qartë dhe simbiotike midis dimensionit urban të qyteteve dhe cilësisë së jetës urbane të qytetarëve me mënyrën sesi është qeverisur territori (Fuga, 2012; Imami et al, 2008; Thompson, 2007). Çështja është nëse dëmtim të dimensionit urban e shkaktoi “shteti i vogël” që dha leje ndërtimi me lehtësi dhe pa rregulla strikte dhe shtrënguese, apo “shteti i madh” burokrat, i ngadaltë dhe i korruptuar (Spencer, 2005; Friedman, 2005). Sikurse do ta prezantojmë në vijim, procesi i pajisjes së individëve apo sipërmarrësve me një leje ndërtimi, ka qënë shumë i vështirë e me kosto shumë të larta, dhe kalonte në proçese shumë të gjata e të kushtueshme në kohë e para’.

Së pari, ka një lidhje të fortë midis lejeve të ndërtimit dhe ekonomisë në përgjithësi dhe me lehtësinë e të bërit biznes në veçanti, i cili është katalizatori parësor i ritmeve të zhvillimit ekonomik (WB, 2015, 2018, 2019). Lejet e ndërtimit lejojnë ndërtimin që është një biznes shumë i rëndësishëm në tërë botën, veçanërisht në vendet në zhvillim si Shqipëria, ku industria e ndërtimit zë 17% të Produktit të Përgjithshëm Bruto (PPB) (INSTAT, 2019).

Sipas Misja, ky kontribut i industrisë së ndërtimit nisi që vitet e pata të tranzicionit, ku vetëm në pesë vitet e para “Ndërtimi nga 6.6 e GDP [PPB], është rritur në 11.6 të GDP në 1996” (IHS Alumni et al, 1998: 55).

Për Shqipërinë që po tranziton drejt BE, këta tregues ekonomik prezantohen pozitiv, sepse edhe në vendet e zhvilluara perëndimore ndërtimtaria është kontribues i fuqishëm i PPB (10% në BE) dhe gjithashtu është një përshpejtues i fuqishëm i punësimit, ku në BE në vitin 2018 arrin të punësoj rreth 5 milion njerëz (Schmid, 2018).

Kjo ka ndodhur edhe në Shqipëri, sepse sipas BB “Me bumin e ndërtimeve në zonat kryesore urbane (kryesisht apartamente dhe ndërtesa banimi), industria e ndërtimit është kthyer në një nga sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare, duke punësuar 17,000 punëtorë” (BB, 2007: 14). BB do të prezantonet se “Shërbimet dhe ndërtimi janë dy sektorët më të mëdhenj private të punësimit” (BB, 2007: 15).

Në këtë kontekst, Fuga do të nënvizonte se në këto vite që kaluan, një sërë rrethanash konjunkturiale bën që sektori i ndërtimit për banim të jetë një nga sektorët më të zhvilluar të ekonomisë shqiptare, dhe ndoshta ai edhe kështu vazhdon ende të mbetet. Sipas tij “Ky sektor, mirë apo keq, ka dhënë një pjesë shumë të konsiderueshme të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto të vendit duke garantuar një rritje ekonomike të kënaqshme në treguesit e vet sasior ama” (Fuga, 2012: 195).

Në vitin 2018 tre sektorët më të mëdhenj të ekonomisë shqiptare janë bujqësia me 20% të PBB-së, ndërtimi me 14% dhe tregtia me 13,5%, (Reiter, Schëarzappel dhe Stehrer, 2020: 12).

Për më tepër industria e ndërtimit është një lokomotivë edhe për shumë sektorë të tjerë ekonomikë. Pra, nga njëra anë, industria e ndërtimit është një kontributor i rëndësishëm i ekonomisë kombëtare, por nga ana tjetër ky bum zhvillimi është shkaktari direkt i gjendjes së papranueshme urbane të qyteteve shqiptare. Kjo nuk do të thotë se ne duhet të pranojmë “ndërtimin si synim ekonomik në vetvete”, sepse dëmet që ai prodhon në dimensionin urban dhe territorial të vendit, shpesh janë me kosto më të larta sesa përfitimet prej tij (Fuga, 2012; Aliaj, 2003, 2008; Imami et al, 2008).

Për t’ju kthyer çështjes nëse ishte “qeveria e vogël” apo “qeveria e madhe” që e shkaktoj këtë problematikë me funksionin qeverisës së lejdhënies ndërtimore, ne do të drejtohem i pari Bankës Botërore. Ajo harton dhe boton raportin e përvitshëm ‘*Doing Business*’, i cili vlerëson 10 aspekte të të bërit biznes në 189/190 vend të botës, vlerësimi i të cilit është shumë i rëndësishëm për ekonomitë e vendeve në zhvillim që kanë domosdoshmëri investime të huaja, sikurse është Shqipëria (AIDA, 2019).

Ky raport, përveç se shërben vendeve të analizuar të kuptojnë çfarë duhet të ndryshojnë për të përmirësuar klimën e biznesit në vend në mënyrë të tërthortë na jep të kuptojmë se kush është

niveli i legjislacionit dhe burokracisë. Nëse konsultohemi me të, Shqipëria gjendet përherë në vendet e fundit, dhe përgjithësisht për shkak të vështirësive dhe kostove të larta që i duhet një individ apo një sipërmarrësi për tu pajisur nga autoritet me një leje ndërtimi (WB, 2015, 2018, 2019).

Referuar treguesit të lejeve të ndërtimit, Shqipëria në vlerësimin e vitit 2015 zbriti 35 vende nga një vit më parë, duke u renditur në vend të 97-të nga i 62-ti (WB, 2015).

Kjo situatë vijon edhe në vitet në vijim, dhe në vitin 2018 Shqipëria u rendit në vendin e 63 nga 190 shtete për lehtësirat e të bërit biznes (WB, 2018). Me një zbritje prej 54 vendesh nga viti 2016, treguesi ku Shqipëria shfaqet më keq janë marrja e një leje ndërtimi, në të cilin ajo renditet në vend të 151 (WB, 2018).

Për vitin 2020, Shqipëria e shoqëruar nga Bosnja, dhe Malta u renditën të fundit në Europë për klimën e të bërit biznes, duke përkeqësuar 9 nga 19 indikatorët që mat ky raport. Shqipëria u rendit në vend të 82 në rang global, me një rënie 19 vende krahasuar me vitin 2019 (WB, 2019). Përveç këtyre rekodeve negative, Shqipëria renditet edhe në vendet me përkeqësim më të lartë nga një vit më parë. Kjo vihet re veçanërisht në indikatorin ‘lejet e ndërtimit’, i cili ka zbritur nga vendi 151 një vit më parë (WB, 2018) në vendin e 166 këtë vit (WB, 2019).

Këto vlerësime tregojnë se nuk është “qeveria e vogël” libertariane dhe mungesa e rregullave apo lehtësia e pajisjes me një leje ndërtimi që e shoqërojnë atë, që solli bumin shkatërimtarë ndërtimor. Në të kundërt, ishte burokracia sfiluese, kostot e mëdha financiare, dhe vendimarrjen korruptive si karakteristika të “qeverisë së madhe” dhe të centralizuar socialiste. Në këtë kontekst, nuk munguan vetëm instrumentat e planifikimit (planeve urbane dhe territoriale), por edhe instrumentat e kontrollit të zhvillimit (Imami et al, 2008).

Sigurisht që këto leje ndërtimi, si ato në brendësi të qendrave urbane ekzistuese edhe ato në shtrirje të reja urbane, u dhanë për preferim të disa individëve mbi të tjerët, për trafik influencash, bile edhe për mitmarrje (Aliaj, 2008; BB, 2007).

Sikurse edhe ndërtimet paleje të shtrira në gjithë territorin kombëtar, por në mënyrë të veçantë në Rajonin Tiranë-Durrës dhe Fier-Vlorë, u toleruan përshkak të korrupsionit qeveritar (BB, 2007). Në këtë kontekst BB do të nënvizonte se “Korrupsioni shfaqet si problem veçanërisht i qyteteve të mëdha, dhe sidomos në sektorin e ndërtimit” (BB, 2007: 27).

Sepse “qeveritë e mëdha” që majtistët i konsiderojnë si “qeveritë e dhura” kanë edhe një karakteristikë tjetër; sa më të mëdha të jetë ato, aq më i madh është niveli i korrupsionit në to

(Spencer, 2005). Teoria na thotë se nëse e zvogëlojmë qeverisjen, në kufinjtë e pranuar nga liberalët klasik, të nevojës së përbashkët të gjithë komunitetit, atëherë edhe niveli i korrupsionit do të jetë shumë më i ulët (Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Ishte vështirësimi që i bëri procesit të pajisjes me një leje ndërtimi “qeveria e madhe” majtiste, nëpërmjet karakteristikave të saj burokratike dhe korruptive, që së pari prodhoi rreth 350-400 mijë ndërtesa paleje në këto vite tranzicion dhe më tej dëmtoi në me lejet preferenciale që lejoi (BB, 2012; Aliaj, 2008).

Sikurse do të shprehej Aliaj për vendimarrjet preferenciale të zyrtarëve të qeverisë “nëse arkitekti/urbanisti projektues [arkitektët e administratës shtetërore], ose vetë vendimarrësit dëshirojnë që të favorizojnë një pronë të caktuar, mjafton që ata ta përcaktojnë atë parcelë si zonë ndërtimore; të rrisin maksimalisht koeficientin e shfrytëzueshmërisë; të rrisin numrin e kateve” (Aliaj, 2008: 181), dhe më tej “Në rast të kundërt, për ta zhvlerësuar një pronë/tokë të caktuar mjafton të përcaktohet ajo si lulishte, shkollë apo dicka tjetër me funksion public/social” (Aliaj, 2008: 185).

Po kështu, BB do të shprehej se çdo propozim i ri për përdorimin e tokës kalon një miratim specifik sipas vendit për të përcaktuar të drejtën e përdorimit dhe parametrat e zhvillimit. Ky sistem krijon pasiguri për çdo përdorues të mundshëm të tokës dhe përfshin dhe mundësi për korrupsion dhe kërkim pagese nën dorë në proceset e planifikimit dhe miratimit (BB, 2007: 83-84).

5.3. Vlerësimi i qeverisjeve të tranzicionit sipas parimit të decentralizimit të funksioneve qeverisëse.

Në këtë seksion do të vlerësojmë frymën e qeverisjeve të tranzicionit në lidhje me parimin libertarian të decentralizimit të funksioneve qeverisëse. Përshkak të rëndësisë që ka për Shqipërinë e tranzicionit, ne do të prezantojmë qasjen politike të institucioneve politike dhe teknike të BE-së mbi këtë çështje.

5.3.1. Parim libertarian i decentralizimit të funksioneve qeverisëse.

Ka një dallim të qartë midis liberalëve të fund shekullit të 19-të dhe fillim shekullit të 20-të dhe liberalëve klasik edhe në lidhje me shpërndarjen e funksioneve qeverisëse në dy nivelet e qeverisjes (Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Koncepti klasik i decentralizimit vjen nga filozofi dhe ekonomisti i shquar John Stuart Mill, sipas të cilit:

“Qëllimi i të pasurit një përfaqësim lokal nënkupton që ata që kanë interesa të përbashkëta, të cilat nuk i ndajnë me bashkatdhetarët e tjerë në tërësi, mund t'i menaxhojnë vetë interesat e tyre. Çdo qytet ka interesa specifike, qoftë i vogël apo i madh, por që janë të përbashkëta për komunitetin e si rrjedhim çdo qytet, pa dallim shtrirjeje gjeografike apo popullsie, duhet të ketë këshillin e vet” (KLSH, 2018: 9).

Në kuptimin ideologjik, si një ndarje të qartë midis liberalëve modern dhe libertarianëve, çështja e ndarjes së fushëveprimtarisë qeverisëse midis dy niveleve qeverisëse trajtohet edhe nga Friedman. Një ndryshim që vërehet nga Friedman, mes liberalëve të dy shekujve të ndryshëm, është se “liberali i shekullit të 19-të, favorizon decentralizimin politik”, kurse “liberali i shekullit të 20-të favorizon qeverisjen e centralizuar” (Friedman, 2005: 6). Ky nënvizim i Friedman do ti jepte kuptim të plotë diferencave ideologjike, midis dy llojeve të liberalëve në lidhje me marrdhënien e niveleve të qeverisjes dhe fushëveprimin e secilës prej tyre.

Locke, gjithashtu, prezanton domosdoshmërinë e shpërndarjes së pushtetit në një shoqëri të lirë. Ai do të nënvizonte se meqë tundimi mund të jetë tëpër i madh përshkak të dobësisë njerëzore, që priret të kapet pas pushtetit, të njëjtët pesona që kanë pushtet të bëjnë ligje, mund të duan të kenë në duart e tyre edhe pushtetin për ti ekzekutuar ato (Locke, 2005: 173).

Pra, pushteti duhet ndarë mes dy institucioneve që të mos krijohen kushtet që një grup i vogël njerëzisht të kenë në duar e tyre edhe pushtetin për të bërë ligje, edhe pushtetin për ti zbatuara ato. Me prezantimin e domosdoshmërisë së ndarjes së pushtetit në “shumë duar”, Locke kujdeset të na prezantojë me dy pushtetet që përbëjnë shtetin liberal: pushtetin legjislativ dhe pushtetin ekzekutiv, dhe marrdhëniet mes tyre (Locke, 2005: 133-139, 177-183), ku pushteti legjislativ “duhet doemos të jetë suprem” (Locke, 2005: 177), por sidoqoftë “jo gjithnjë i mbledhur” (Locke, 2005: 173).

Libertarianët kanë një parim të dytë shumë të rëndësishëm në mënyrën e tyre të të kuptuarit të rendit shoqërore dhe të marrdhënies midis shtetit dhe shtetasve, i cili është ndarja e pushtetit qeverisës në nivele. Sikurse do ta prezantonte Friedman “Parimi i dytë është që pushteti duhet

të shpërndahet. Nëse qeverisë i takon të ushtrojë pushtet, më mirë ta ushtrojë në nivelin e komunës sesa të shtetit, më mirë në nivelin e shteteve sesa në Uashington” (Friedman, 2005: 3).

Nëse funksionet qeverisëse janë të decentralizuara, dhe një njeri nuk pëlqen mënyrat sesi operon një bashkësi e caktuar, në lidhje me: menaxhimin e rrjeteve inxhinierike të kanalizim-ujësjele, sistemin rrugor, transport publik; apo infrastrukturën sociale, si çerdhe, kopshte, shkolla, abulanca, spitale; apo sesi qyteti ka të shpërndarë zonat e banimit, punësimit, arsimit; ky njeri mund të largohet nga ky qytet dhe mund të shkojë në një qytet tjetër, që i bën më mirë këto punë dhe i ofron më mirë këto shërbime publike. Kurse në rastin kur këto funksione qeverisëse janë të centralizuara, dhe këto sektorë i trajton në mënyrë të njëjtë qeverisja vendore, atëherë gjendja do të jetë e njëjtë në të gjitha bashkitë, dhe qytetarit i mbetet të largohet nga vendi (Friedman, 2005).

Ruajtja e lirisë është arsyeja kryesore për të zvogëluar fushëveprimin qeverisës dhe për të decentralizuar pushtetin qeverisës nga qeveria qendrore drejt qeverisë lokale, por ka edhe një arsye konstruktive dhe po kaq të vlefshme. Kjo arsye na thotë se centralizmi pengon zhvillimin, sikurse do të nënvizonte Friedman, sepse “Përparimet e mëdha të njerëzimit, si në arkitekturë apo në pikurë, në shkencë apo në letërsi, në industria apo në bujqësi, nuk kanë ardhur kurrë nga qeverisjet e centralizuara” (Friedman, 2005: 2).

Sipas Friedman, Kolombi nuk vendosi të kërkojë të gjej një rrugë të re për të arritur në Kinë në përgjigje të ndonjë direktive të ndonjë shumice parlamentare, megjithëse ai u financua pjesërisht nga një monark absolut. Newton-i dhe Leibnitz-i, Einstein-i dhe Bohri, Shekspiri, Miltoni, Pasternaku, Witney, McCormik-u, dhe një spektër i gjerë autoritetesh në dijet e tyre, që Friedman do të rreshtonte për të theksuar se “asnjë prej tyre nuk hapi horizonte të reja për dijen dhe kulturën njerëzore, në përgjigje të direktivave qeveritare” (Friedman, 2005: 4).

Për Friedman të gjitha arritjet më të mëdha të njerëzimit erdhën nga gjenialiteti individual, nga qasjet dhe pikëpamjet e mbrojtura nga grupet e pakicave, dhe në një kohë e një klimë shoqërore, e cila lejonte shumëllojshmërinë dhe diversitetin që proklamonte dhe implementonte decentralizimin. Mbi këtë kuptim, Friedman do të theksonte se “Qeveria nuk mund të riprodhojë kurrë shumëllojshmërinë dhe diversitetin e veprimit individual” (Friedman, 2005: 4).

Asnjë qeveri qendrore nuk mund të trajtojë çështjet e rëndësishme lokale, që paraqiten në një shumëllojshmëri specifikash dhe karakteristikash njerëzore, sociale, kulturore dhe gjeografike.

Një qeveri mund të rregulloj dhe përmirësoj shumë nivelin e jetës së qytetarëve në shumë zona vendore apo qytete të vendit, dhe ndoshta edhe të të gjithë vendit si një mesatare, nëse imponon kushte standarte për banimin, ushqimin apo veshjen, apo duke imponuar norma standarte për shkollimin, ndërtimin e rrugëve, apo higjenën dhe mjedisin, por “gjatë këtij procesi qeveria zëvendëson përparimin me mbetjen në vend, ofron mediokritet uniform në vend të shumëllojshmërisë aq thelbësore kjo për atë eksperimentimin që mund të bëjë që të fundmit e nesërm të jenë mbi mesataren e të sotmes” (Friedman, 2005: 4).

Tokëvill, ndërsa prezantonte nivelin e lartë të decentralizimit të funksioneve qeverisëse në Amerikën e shekullit të 19-të do të nënvizonte se “pavarësia municipale [bashkiake] në Shtetet e Bashkuara është rrjedhojë e natyrshme e vet parimit të sovranitetit të popullit” (Tokëvil, 2002: 36-37).

Sipas tij, qytetet i nënshtroheshin shtetit vetëm për ato interesa që Tokëvill i quante “sociale”, meqënëse ato janë të përbashkëta për të gjithë qytetet. Qytetet amerikane janë të pavarura në gjithçka që ka të bëjë vetëm me to dhe shteti nuk ka të drejtë të ndërhyj. Por ajo që do të nënvizonte Tokëvill mbi marrdhënien e dy niveleve të ndryshme qeverisëse, është se ka disa detyrime shoqërore të cilat taunshipet janë të detyruara t’i përmbushin, si përsëmbull “Në qoftëse shteti ka nevojë për para, qyteti nuk mund të mos ja japë ato; në qoftëse shteti projekton një rrugë, taunshipi nuk mund të mos pranojë që ajo të kalojë nëpër territorin e tij” (Tokëvil, 2002: 37).

Sipas Tokëvill, kjo frymë e taunshipit vjen si rezultat i dy përparësive motivuese: pavarësia dhe autoriteti i qytetit, dhe se pa to “një qytet mund të ketë nënshtetas të mirë, por nuk mund të ketë shtetas aktivë” (Tokëvil, 2002: 38).

Edhe për Tokëvill ka dy metoda për të zbutur forcën e autoritetit në një shtet, së pari është zvogëlimi i fushëveprimtarisë së qeverisë qendrore, kurse e dyta është “në shpërndarjen e ushtrimit të pushteteve të saj [qeverisjeve] në duar të ndryshme” (Tokëvill, 2002). Ai do të deklaronte se parapëlqente shumë përparësitë politike që u jep amerikanëve sistemi i tyre i decentralizuar se sistemet e kundërta.

5.3.2. Decentralizimi i fushëveprimtarisë së qeverisë si një parim Europian.

Pas ndryshimeve të mëdha politike të vitit 1990-1992 shumë reforma liberalizues u ndërmorën me synimin për të arritur ngjashmëri politike dhe ekonomike me vendet perëndimore (Fuga,

2003, 2004; Krasniqi, 2008; Lami, 2010, 2013). Kështu u hap rruga drejt synimit kryesor të shqiptarëve të shprehur në protestat kundër komunizmit një partiak “e duam Shqipërinë si gjithë Europa” (Biberaj, 2000; Lami, 2013; Çili, 2013).

Që atherë vendi është përfshirë në një proces integrimi në BE, që prezantohet në një sërë sektorësh të ndryshëm të jetës së vendit dhe të shoqërisë (Gjura, 2015; Civici, 2013). Një nga aspektet thelbësore ku vendi kërkon dhe ka domosdoshmëri për të synuar ngjashmëri me vendet antare të BE është rëndësia që këto vende i japin rolit të qeverisjes lokale. Duket se kjo, sikurse në shumë synime të tjera politike, nuk është lehtësisht e aritshme sepse përballet me një sërë pengesash.

E kaluara komuniste e Shqipërisë së viteve 1944-1991, është një nga barrierat që pengojnë këtë synim të shoqërisë shqiptare (Gjura, 2015), veçanërisht në sektorin e qeverisjes territoriale (IHS Alumni et al, 1998). Nientied, ndërsa analizonte çështjet e kulturës së qeverisjes lokale të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL) e vlerësonte shumë të rëndësishme ndikimin e trashëgimisë së të kaluarës socialiste (HIS Alumni et al, 1998: 9-11).

Në këtë kontekst ai do të shprehej se “Për shumë dekada sektori i qeverisjes lokale ka qënë marrë më shumë me dizenjimin dhe kontrollin e rregullave urbane me të gjitha format sesa me stimulimin e iniciativave të sektorit privat”, dhe për këtë arsye “Është e vështirë për sektorin e pushtetit lokal që të jetë i orientuar drejt klientëve dhe ti përgjigjet kërkesave të kompanive që duan të ngrenë aktivitete ekonomike” (HIS Alumni et al, 1998: 10).

Aliaj i fokusuar në rastin shqiptar, do të theksonte se megjithëse janë kryer një sërë reformash në sektorin e planifikimit urban dhe të zhvillimit të territorit, mentaliteti koncentruar e ka shoqëruar mendimin politik dhe të ekspertizës sektoriale (Aliaj, 2003, 2008). Aliaj do të arsyetonte se ajo që nuk ka lejuar të përforcohet dimensionin lokal i qeverisjes territoriale dhe demokracisë lokale është “mëndësia pothuajse konservatore e profesionalistëve, të cilët ende edhe sot nuk arrijnë të dalin mbi kufizimet e mentalitetit dhe arsimimit të periudhës së ekonomisë së centralizuar” (Aliaj, 2008: 96).

BE ku shqiptarët në një masë dëmtuese duan të integrohen, i jep një rëndësi të veçantë qytetit si një entitet politik, autonomisë vendore dhe demokracisë lokale. Këtë ne do mundohemi ta trajtojmë në tre shtylla kryesore politike: (i) dimensionin i qeverisjeve lokale të vendeve të BE-s; (ii) dimensionin i qeverisjeve kombëtare të vendeve antare të BE-s; dhe, (iii) dimensionin i profesionistëve, teknikëve dhe kërkuesve shkencor të sektorit të zhvillimit territorial dhe urban nga e gjithë bota, duke e nisur nga këta të fundit.

Një nga dokumentet më të rëndësishme profesionale të shkallës globale është ‘*Deklarata e Vankuverit*’ e miratuar në Kongresin Botëror të Planifikuesve mbajtur në Vankuver të Kanadasë në vitin 2006, dhe nënshkruar nga 29 drejtuesit e institutive dhe agjensive qeverisëse të vendeve më të mëdha të botës. Thelbi i saj ishte vendosja e disa parimeve bazike të planifikimit urban dhe territorial në rang global, ku parimi i planifikimit sipas nivelit qeverisës ishte më thelbësori (WPC, 2006).

Sipas kësaj deklarate llojet e instrumenteve planifikuese duhet të përputheshin me nivelin qeverisës që i hartonte dhe miratonte këto instrumente, dhe se bota politike dhe teknike duhet të pranonin se sikurse ka planifikime strategjike që kërkojnë autoritetin e qeverive kombëtare, ka edhe planifikime lokale, të cilat duhet të kryhen dhe miratohen nga qeverisja lokale, përshkak të specifikave dhe diversiteteve kulturore dhe territoriale që paraqesin qytete të ndryshme. Në deklaratë do të theksohej se “Planifikimi është strategjik dhe lokal, integruar, pjesëmarrës, krijues, përfaqësues i diversiteteve kulturore dhe mbështet çështjet e barazisë” (WPC, 2006: 1).

Theksi i planifikimit sipas nivelit qeverisës është vendosur në të gjitha dokumentet me qasje politike të planifikuesve botëror dhe europian. Për tu përmendur janë Kongresi për Urbanizmin e Ri në dokumentin e tij ‘*Karta e Urbanizmit të Ri*’ (CNU, 1996), dhe Këshilli Europian i Planifikuesve të Qyteteve, në ‘*Kartën e Re të Athinës 2003; Vizioni për Qytetet e shekullit të 21-të*’, të miratuar në Lisbon në vitin 2003 (ECTP, 2003).

Por, gjithashtu mund të përmendim Konferencën Europiane ‘*E Ardhmja Urbane*’ në Saarbrücken të Gjermanisë, e cila bashkoi lojtarë të rëndësishëm të Inisiativës Komunitare URBANE në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe Europian, për të reflektuar rezultatet dhe eksperiencat nga URBAN në baza shkencore dhe praktikuese. Me përfaqësues 300 pjesëmarrës nga 22 vende antare, në këtë konferencë u trajtua vlera e shtuar e dokumentit ‘*Acquis URBAN*’, dhe u prezantuan e diskutuan parimet dhe elementët kyç e tij (EC, 2005).

Në deklaratë u bë shumë e qartë rëndësia e qyteteve dhe planifikimeve vendore në proceset europiane, përfshirë financimet nga projektet e BE, sikurse do të theksohej “Përgjatë rolit të rëndësishëm dhe potencialeve të qyteteve për zhvillimin rajonal dhe kohesionin e territorit të BE-s nga njëra anë, dhe, problemet mbizotëruese të zonave urbane nga ana tjetër, për periudhën e ardhshme shumë qytete kanë për të përfituar nga financime të BE-s dhe me një shtrirje më të gjatë” (EC, 2005: 2).

Rëndësia e qyteteve, planifikimit territorial në dimensionin vendor dhe demokracia lokale, për BE demonstron edhe nga rëndësia që i jep ai deklaratave dhe qëndrimeve politike të autoriteteve të qyteteve të vendeve antare. Komisionit Evropian mbështeti iniciativën e 80 autoriteteve lokale europiane dhe të 253 përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, qeverive antare, institucioneve shkencore dhe konsulente, për të zhvilluar Konferencën Europiane për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Kjo Konferencë u zhvillua në Aalborg të Danimarkës, në vitin 1994 dhe hartoi dhe dakortësoi *'Kartën e Aalborgut'* (EC, 1994).

Thelbi i kësaj deklarate ishte rëndësia e qyteteve si entitete të qarta politike, sikurse thekson:

“Ne, qytetet europiane, nënshkruarit e kësaj karte, deklarojmë se gjatë historisë, qytetet tona kanë ekzistuar dhe sfiduar perandoritë, shtetet kombëtare, dhe regjimet dhe kanë mbijetuar si qendra të jetës shoqërore, bartëse të ekonomive, dhe roje të kulturës, trashëgimive dhe të traditave. Së bashku me familjet dhe fqinjët, qytetet kanë qenë elementet themelor të shteteve dhe shoqërive tona. Qytetet kanë qenë qendrat e industrisë, artizanatit, tregëtisë, ekonomisë dhe qeverisjes” (EC, 1994: 1).

Projekt-Karta u diskutua nga më shumë se 600 pjesëmarrës në 36 seminare dhe synoi të theksonte aftësitë e qyteteve për vet-qeverisje, sikurse do të nënvizonte “Ne, qytetet, jemi të vetëdijshëm se disponojmë aftësitë, njohuritë dhe potencialin krijues për të cuar më tej mënyrat e qëndrueshme të të jetuarit dhe të projektojmë dhe administrojmë qytetet tona drejt qëndrueshmërisë” (EC, 1994: 3).

Një nga thekset e veçanta të kartës së Aalborgut ishte dimensionin përfaqësues i sovranit të autoriteteve lokale, sikurse prezantoi se “Si përfaqësues të zgjedhur në mënyrë demokratike nga komunitetet tona, ne jemi në gjendje të marrim përgjegjësitë për riorganizimin të qyteteve tona drejt qëndrueshmërisë” (EC, 1994: 4). Prandaj, ajo që kërkuan në këtë konferencë pjesëmarrësit masiv të saj dhe të tjerë aktorë lokalë që ju bashkëngjitën në vite u bë shumë e qartë nga pohimi:

“Shkalla në të cilën qytetet tona janë në gjendje që t’i përgjigjen kësaj sfide varet nga dhënia e të drejtave për vetëqeverisje lokale, në përputhje me parimin e varësisë. Është esenciale që pushtetit lokal t’i lihen kompetenca të mjaftueshme dhe t’i sigurohet një bazë financiare e qëndrueshme” (EC, 1994: 4).

Konferenca e Aalborgut shtroi kërkesën për zgjerim të vazhdueshëm të funksioneve lokale qeverisëse dhe vet-qeverisje lokale, kërkesë e cila përsëritet në dinamikën e deventralizimit të funksioneve qeverisëse deri në ditët e sotme. Që prej vitit 1994, kur u zhvillua për herë të parë,

kjo konferencë është kthyer në periodike, çdo tre vjet, për të mbështetur të njëjtën qasje decentralizuese dhe në mbështetje të demokracisë lokale.

BE e mbështet decentralizimin dhe forcimin e rolit të qyteteve në qeverisje edhe nëpërmjet nismave të saj. Në këtë aspekt së pari do të sjellim takimin Ministerial për kohesion territorial, të mbajtur në Rotterdam të Holandës në Nëntor të vitit 2004. Në këtë takim mes ministrave të vendeve antare të BE-s që kanë kompetencë çështjet e zhvillimit territorial, ndanë mes tyre eksperiencat e vendeve të ndryshme Europiane në politikat urbane në dekadat e fundit dhe identifikuan dhe gjeneruan një set parimesh të përbashkëta të cilat kornizojnë ato që konsideruan si politika të suksesshme (EU, 2004).

Ministrat e vendeve antare të BE-së miratuan ‘*Urban Acquis*’, i cili siguron themelet e zhvillimit të një qasje më koherente të politikave urbane për të ardhmen. Dokumenti, ndër të tjera, theksoi rëndësinë e planifikimeve sipas nivelit qeverisës duke vendosur si prioritet se “Qytetet duhet të jenë të jetueshme, vende të alternativave dhe të identitetit kulturor” (EU, 2004: 1), nëpërmjet të cilit njohu nevojën e identifikimit dhe utilizimit të specifikës dhe karakteristikave të çdo qyteti. Dokumenti, duke pranuar rolin e veçantë të qyteteve në politikat territoriale, përcaktoi mekanizmat për politika urbane të suksesshme, ndër të cilat nënvizoi “Politikat sektoriale, rajonale dhe lokale duhet të integrohen më mirë” (EU, 2004: 2).

Në këtë kuptim, mund të përmendet edhe Ministerialin e Leipçigut, i cili prodhoi ‘*Kartën e Leipçigut, për qytetet e qëndrueshme europiane*’, i zhvilluar në 24-25 Maj 2007, në qytetin e Gjermanisë nga ku mori emrin. Kjo kartë nënvizonte, si thelb të saj “Në njohje të shanseve dhe oportuniteteve sikurse edhe të kaluarës së ndryshme historike, ekonomike, sociale dhe mjedisore të qyteteve Europiane, Ministrat e Vendeve Antare, përgjegjës për Zhvillimin Urban dakortësuan për principe përbashkëta dhe strategji të politikave të zhvillimit urban” (EU, 2007: 1).

Në këtë kuptim reflektuan rëndësinë e specifikave të ndryshme të qyteteve të ndryshme të vendeve antare të BE-s, duke pranuar si të përbashkëta vetëm parimet dhe strategjitë e politikave, duke ruajtur nevojën e hartimit dhe miratimit të instrumentave lokalë të zhvillimit territorial dhe urban. Një vend të veçantë, karta i jepte dimensionit të policentrik të zhvillimit, kur ministrat e vendeve antare të BE-s u angazhuan për të promovuar zhvillimin e balancuar territorial duke u bazuar “në strukturën policentrike urbane të Europës” (EU, 2007). Duke theksuar më fortë rëndësinë e qyteteve, autonomisë lokale dhe demokracisë vendore, më tej në dokument theksohej se ministrat përgjegjës për zhvillimin urban në vendet antare të Bashkimit

European “konsiderojmë qytetet Europiane të të gjitha masave të cilat kanë evoluar në histori si asete të vlerëshme dhe të pazëvendësueshme ekonomike, sociale dhe kulturore” (EU, 2007).

Prej vitit 2008 e në vijim janë dakortësuar në nivele të ndryshme politike, shumë dokumente që nënvizojnë rëndësinë e qytetit, autonomisë lokale dhe demokracisë vendore, për të përmendur vetëm dy më të rëndësishmet si ‘*Planifikimi hapsinor; Një instrument kyç për zhvillimin dhe qeverisjen efektive me referencë ndaj vendeve në tranzicion*’ të Komisioni Ekonomik për Europën të UN (UNECE, 2008)

Një shembull tjetër është edhe ‘*Axhenda Territoriale 2020, drejt një Europe gjithëpërfshirëse, të zgjuar dhe të qëndrueshme të rajoneve të ndryshme*’, dakortësuar në Ministerialin Informal të Ministrave përgjegjës për Planifikimin Hapsinor dhe Zhvillimin Territorial në 19-të Maj 2011 Godollo, Hungari (EU, 2011).

Këto dokumeneta dhe të tjerat që prekëm më parë ishin fillesat e një procesi të gjatë dhe që do të vijoj edhe në të ardhmen, veçanërisht në vendet në zhvillim si Shqipëria që paraqet domosdoshmëri në marrjen e hapave në këtë drejtim shumë të rëndësishëm të demokracisë dhe zhvillimit.

5.3.3. Dinamikat e decentralizimit të funksioneve qeverisëse në Shqipërinë e tranzicionit.

Centralizimi i thellë i funksioneve qeverisëse ishte një nga karakteristikat e regjimit socialist, me të cilat duhej të përballeshin qeverisjet territoriale të tranzicionit. Tradita 46 vjeçare nuk mundësonte një reformë të thellë, që në të njëjtën kohë të prodhonte rezultate të pranueshme në terren (IHS Alumni, 1998; Imami et al, 2008; Aliaj, 2008; BB, 2004).

Shqipëria përballej me një praktik më të koncentruar pushteti (Aliaj, 2008), sesa vendet e tjera të Europës Qëndrore dhe Lindore që kishin një nivel relativ decentralizimi (IHS Alumni et al, 1998: 9-10).

Në këtë kontekst të përgjithshëm, që në vitet e para të tranzicionit u vu re nevoja e marrjes së veprimeve për fuqizimin e njësive vendore të qeverisjes në kuadrin e një reforme administrative të përgjithshme. Banka Botërore në vitin 2004, në raportin ‘*Shqipëria: Decentralizimi në tranzicion*’, do të vlerësonte se “Pas gati një gjysmë shekulli qeverisjeje tejet të centralizuar, Shqipëria hyri në rrugën e decentralizimit politik dhe në vitin 1992 zhvilloi zgjedhjet e para demokratike në vend” (BB, 2004: 6).

Këto nevoja, të përcaktuara që në programin qeverisës 1992-1996, konsistonin në dy pika kryesore. Së pari, ishte domosdoshmëria e tranzitimit të qeverisjes vendore nga një qeverisje me drejtues të emëruar nga Partia-Shtet në një qeverisje të zgjedhur nga populli nëpërmjet kryerjes së zgjedhjeve pluraliste edhe për nivelin lokal të qeverisjes (Meksi, 1992; 2015).

Në nivelin qëndror zgjedhjet e përgjithshme politike të vitit 1992 kishin sjellë në pushtet partitë e opozitës demokratike të krijuara vetëm dy vjet më parë (Lami, 2013; Fuga, 2003; Biberaj, 2000). Ky rotacion epokal ktheu në domosdoshmëri zgjedhjet pluraliste edhe në nivelin vendor të qeverisjes (Meksi, 1992, 1997, 2019). Meksi, në programin e qeverisë 1992-1996, që drejtonte do të theksonte se “Reformat administrative dhe përmirësimet cilësore duhet, gjithashtu, të kryhen edhe në nivelin lokal, në mënyrë që politika ekonomike e Qeverisë qendrore të zbatohet në tërë vendin. Ne do të marrim masa që të zhvillohen zgjedhjet lokale brenda pak muajsh” (Meksi, 2019: 13).

Qeveria Meksi 1992-1996, përgatiti dhe miratoi ligjin nr. 7573/1992 *‘Për Zgjedhjet e Organeve të Pushtetit Vendor’* (FZ, nr. 3, 1992), i cili i hapi rrugën e demokracisë lokale. Në përputhje me nenin 1 të këtij ligji, “Organet e Pushtetit Vendor zgjidhen me votim të përgjithshëm, të drejtëpërdrejtë, të fshehtë dhe të lirë” (FZ, nr. 3, 1992), çfarë hapi rrugën për një demokratizim të plotë të jetës politike të vendit, përfshirë pushtetin lokal.

Nëpërmjet këtij ligji, u hap rruga edhe për krijimin e parlamenteve të para lokale, në përputhje me nënin 1 të tij “Zgjedhja e Këshillave Lokalë bëhet me sistem proporcional në zona me listë shumë emërore”, por gjithashtu i dha edhe një dimension të thellë përfaqësues kryebashkiakut dhe kryekomunarit të qendrës së banuar, bashkisë apo komunës. Në përputhje me nenin 1 të këtij ligji “Kryetarët e komunave dhe bashkive zgjidhen me sistem maxhoritar në zona me lista një emërore” (FZ, nr. 3, 1992).

Konteksti i këtij ligji, krijoi bazat e para drejt asaj që Fuga në 2012 do ta quante demokraci diskursive dhe do ta përkufizonte “Demokracia diskursive përkufizohet në nivelin kur publiku i interesuar flet dhe dëgjon për problemet e komunitetit dhe mbi këtë bazë krijohet edhe një lloj opinioni i përbashkët për politikatat që duhen ndjekur dhe për ekipet e pushtetit lokal që mund ti realizojnë më mirë ato” (Fuga, 2012: 74).

Kurse çështja e dytë, që trajtonte programi qeverisës i qeverisë 1992-1996, në lidhje me pushtetin lokal, kishte synim fuqizimin e njësisë vendore qeverisëse nëpërmjet një reformimi të plotë të rolit dhe përgjegjësisë të tyre (Meksi, 1992, 1997).

Në përputhje me këtë Meksi do të shprehej se “Njëherazi do t’i propozojmë parlamentit të marrë në konsideratë kërkesën për të ripërcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e organeve lokale, duke përfshirë edhe çështjet fiskale, si dhe marrëdhëniet administrative e juridike të tyre me qeverinë qendrore” (Meksi, 1992). Ky ishte hapi i dytë që qeveria Meksi ndërmori në krijimin dhe fuqizimin e demokracisë vendore, i cili kërkonte një ndarje të qartë midis dy niveleve të qeverisjes dhe roleve të tyre në çështjet shoqërore.

Çili në vitin 2013 do të nënvizonte se “Qeveria Meksi bëri reforma të mëdha dhe të guximshme në fazën e parë” për të nënvizuar edhe në lidhje me luftën që bëri qeveria Meksi kundër centralizimit të thellë të regjimit komunist “hoqi shumë prej institucioneve ekonomike dhe praktikave që kishin lënë shteti i centralizuar” (Çili, 2013: 42).

Në këtë kontekst edhe Meksi do të theksonte objektivin e qeverisë së tij se “Pa kryer reformën administrative dhe demokratike në nivel lokal, revolucionin ynë politik dhe ekonomik nuk do të jetë i plotë” (Meksi, 1992).

Sidoqoftë, decentralizimi nuk eci me shpejtësinë e kërkuar, për dy arsye kryesore. Së pari ishte fakti se “demokratët u vonuan me mbajtjen e zgjedhjeve vendore, duke humbur kështu një pjesë të mirë të mbështetjes që kishin siguruar në zgjedhjet parlamentare të marsit” (Biberaj, 2000: 239).

Së dyti ishte fakti i bllokimit të shpeshtë që i bënte këtij procesit Partia Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë, që ishte pasardhësja e Partisë së Punës që kishte qeverisur për 46 vjet vendin nën frymëzimin centralist të ideologjisë Parti-Shtet (Lami, 2010, 2013). Këtë fenomen do ta prezantonte edhe Aliaj kur nënvizuan se “megjithëse autoritetet qendrore kanë nisur një proces decentralizimi në drejtim të pushtetit lokal, praktikisht ky proces është i ngrirë për arsye politike” (IHS Alumni et al, 1998: 103).

Proçesi i decentralizimit mori një shtysë të dytë nga fundi i viteve ’90-të. Gjatë viteve 1998-2000, vendi ratifikoi zyrtarisht *‘Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Vendore’*, i mishëroi parimet e saj kryesore në Kushtetutën e re, dhe miratoi reforma ligjore për vetëqeverisjen vendore (BB, 2004). Banka Botërore do të theksonte se “Qysh nga viti 2000, janë bërë rregullime të rëndësishme institucionale, janë miratuar rregullore dhe në disa fronte janë zbatuar reformat e para për politikën” (BB, 2004: 6).

Për tu fokusuar në politikat në lidhje me territorin dhe administrimin e tij, në këtë periudhë ishte reforma territoriale që u konkretizua me ligjin nr. 8652/2000 *‘Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore’*, shpallur me dekretin nr. 2729/2000 të Presidentit të

Republikës së Shqipërisë (FZ, 2000). Ky ligj nuk preku ndarjen gjeografike dhe shtrirjes territoriale të njësive të Qeverisjes Vendore, të cilat referuar pikës 4, të nenit 5, të Kreut II-të, i konceptoi në tre lloje: qark (niveli i dytë) dhe bashki dhe komunë (njësitë bazë) (FZ, 2000).

Së bashku me ligjin nr. 8653/2000 *‘Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të Qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë’* shënuan fundin e Këshillave të Rretheve, duke zvogëluar kështu ndikimin e drejtpërdrejtë politik të qeverisë mbi veprimtaritë e pushtetit vendor (FZ, 2000). Kjo krijoi një kuadër të qëndrueshëm ligjor që do të mundësonte funksionimin e strukturave administrative dhe fiskale të decentralizuara, që do të përfshinin qarqet vetëqeverisëse, bashkitë dhe komunat (BB, 2004).

Kontributi thelbësor i këtij legjislacioni ishte në procesin e decentralizimit, sikurse do të shprehej Banka Botërore:

“Ndonëse Shqipëria është larg plotësimit të tablosë së decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal që do të mund të përmirësonte në mënyrë të kënaqshme shpërndarjen e shërbimeve, qeverisjen dhe llogaridhënien, duhet pranuar se është bërë përparim i konsiderueshëm për ngritjen e institucioneve dhe të kuadrit ligjor bazë, si dhe për zbatimin e politikave drejt decentralizimit” (BB, 2004: 6).

Njësive të Qeverisjes Vendore, të të dyja niveleve, ju përcaktuan disa funksione qeverisëse të cilat ishin të grupuara: (i) funksione të deleguara, (ii) funksione të përbashkëta dhe (iii) funksione të veta, referuar nenit 2, të Kreut I-rë (FZ, 2000).

Nëpërmjet këtij ligji, referuar pikës 5c, të nenit 72, të Kreut XI-të, bashkive dhe komunave ju kalua edhe kompetenca e planifikimit urban, menaxhimit të tokës dhe strehimit social, përfshirë miratimin e shesheve të ndërtimit dhe dhënien e lejeve të ndërtimit, që nga data 1 Janar 2001 (FZ, 2000).

Mirëpo, sikurse do të prezantojmë më tej, funksioni i planifikimit urban, u vu nën kontrollin e qeverisjes qëndrore, e cila, nëpërmjet KKRrT dhe më pas KKT, duhet të bënte miratimin përfundimtar të këtyre instrumentave të planifikimit vendor (QBZ, 2010).

Megjithëse nëpërmjet kësaj reforme, qeverisjes vendore ju dhanë disa funksione në çështjet e planifikimit të territorit dhe kontrollit të territorit nga ndërtimet paleje, lejedhënien ndërtimore dhe të strehimit social, ato nuk përputheshin me pritshmëritë edhe nevojat reale të vendit për decentralizim (Aliaj, 2008). Sikurse do të theksonte Aliaj “dekadën e fundit është folur shumë për decentralizimin. Pas një fillimi të suksesshëm në hartimin e reformës, kjo e fundit ka ecur

me një shpejtësi tepër të ngadaltë, kryesisht si pasojë e mungesës së vullnetit politik, megjithë disa përpjekje të bëra nga ministra e linjës që mbulon problematikën e planifikimit të territorit, mjedisit dhe turizmit” (Aliaj, 2008: 128).

Faza e katër e qeverisjes territoriale, 2013-2020, ndërmoi një reformë të thellë në çështjet administrative dhe territoriale, nëpërmjet ligjit nr. 115/2014 ‘*Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*’ dhe ligjit nr. 139/2015 ‘*Për vetqeverisjen vendore*’ (QBZ, 2019).

Kjo reformë, sikurse do ta shohim më tej në këtë punim, dëmtoi demokracinë lokale në dy mënyra, së pari duke larguar politikanin e votuar nga qytetarët dhe në vend të tij solli administratorin e emëruar nga politika, dhe së dyti duke zvogëluar funksionet e veta të Njësive të Qeverisjes Vendore (Fuga, 2019).

Fuga për këtë reformë do të shprehej “E çuditshme është që ky proces centralizimi dhe përqëndrimi e homogjizimi administrativ i pushtetit dhe i territorit vendor pas vitit 2014 erdhi me një propogandë për decentralizimin” dhe më tej në të njëjtën faqe do të deklaronte “Demokracia lokale në Shqipërinë pas kësaj [Reforme] nuk ekziston më!” (Fuga, 2019: 224).

5.3.4. Proçesi decentralizues dhe planifikimi e zhvillimi territorial përgjatë tranzicionit.

Një nga aspektet ku demokracia lokale mund të shprehet më mirë, më qartë dhe më produktivisht në rritjen e cilësisë së jetesës së komuniteteve, familjeve dhe individëve, është sektori planifikimit dhe i zhvillimit territorial e urban (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2003, 2008; Fuga, 2012).

Për çështjet territoriale dhe urbane, ajo që duhet të kuptojmë dhe të dakortësojmë që në fillim është fakti se, roli i institucioneve qeverisëse është i rëndësishëm (UN, 1976; EU, 1994, 1999, 2003, 2007, 2011).

Urbanistikë do të thotë kompromis i të gjithë grupeve të interesit të përfshira apo të prekura nga planifikimi në një territor të caktuar, dhe në këtë kuptim, roli prej organizuesi dhe moderatori në proçeset e kuvendimit të këtyre grupeve dhe interesave, i institucioneve të qeverisë është i nevojshëm (De Soto, 1989: 232; UNECE, 2008; EC, 1994).

Çështja reale që shtrohet në diskutim është kush nga qeverisjet, qeverisja qendrore apo vendore, do të ketë si funksion të vetin qeverisës të hartojë instrumentat lokalë të planifikimit dhe zhvillimit territorial dhe do të marri vendimet për lejdhënien ndërtimore (Aliaj, 2003, 2008). Ndërsa prezantonte qasjen e tij, mbi një ligj të ri të planifikimit të territorit, Aliaj do të shtonte se “Ligji duhet të nxjerrë në pah hallkat dhe kërkesat ndërinstitucionale në pushtetin qendror dhe atë lokal për funksionimin e punës për kontrollin e planifikimit” (Aliaj, 2003: 103).

Praktikat e vendeve antare të BE janë të shumta dhe na dëshmojnë, jo vetëm në dimensionin teorik apo të dakortësive politike, por edhe në praktikat jetësore se decentralizimi i funksioneve qeverisëse ndikon ndjeshëm në funksionimin e qytetit dhe ka implikime pozitive në cilësinë e jetës së qytetarëve (Aliaj, 2008: 117; IHS Alumni et al, 1998).

Vlerësime të BB për sektorin e zhvillimit territorial dhe të procesit të decentralizimit dhe ekspertiza teknike vendase insistojnë që ky proces specifik duhet ndërmarrë sa më shpejt dhe është shumë i vonuar (BB, 2004, 2007; HIS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008). Sikurse BB do të nënvizonte “Në fakt planifikim urban dhe sistemi i menaxhimit në fuqi është ende i formës piramidale dhe shumë i centralizuar” (BB, 2007: 84).

Në këtë kuptim Aliaj në vitin 2008 do të ngrinte pyetjen “Cili do të jetë fati dhe rruga më e shkurtër për dhënie fund të zvarritjeve të procesit të decentralizimit në mënyrë që ti pritët rruga përgjithmonë abuzimeve centralizuese dhe monopoleve individuale në sferën e planifikimit dhe të administrimit të territorit” (Aliaj, 2008: 100).

Përgjatë viteve të tranzicionit, çështja e autonomisë lokale dhe e procesit të decentralizimit të funksioneve qeverisëse që kanë lidhje me zhvillimin dhe planifikimin territorial dhe urban kanë qënë një nga çështjet më të diskutuara në debatet politike dhe teknike. Ajo është shtruar që në vitet e para të tranzicionit por duket se nuk është adresuar si duhet si nga autoritet politike edhe ato administrative të vendit (HIS Alumni et al, 1998). Dharmo do të nënvizonte se “Shkalla e pavarësisë lokale ka qënë objekt diskutimi në Shqipëri pas ndryshimeve politike (1991), por pa arritur në rezultate konkrete” (HIS Alumni et al, 1998: 31).

Thelbi i kësaj autonomie ka lidhje me raportin midis dy niveleve të qeverisjes dhe transferimin e funksioneve qeverisëse nga qeveria qendrore drejt qeverisë vendore (BB, 2004, 2007; Aliaj, 2008; HIS Alumni et al, 1998). Dharmo do të nënvizonte se “Ideja për të vendosur raporte të reja midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale bazohet në decentralizimin e kompetencave” porse “aktualisht roli i pushtetit lokal është shumë i reduktuar ndërsa është shumë e madhe ndërhyrja e pushtetit qendror” (HIS Alumni et al, 1998: 31).

Në këtë kontekst, Aliaj do të nënvizonte se nëse do të studiojmë historinë e qeverisjes në Shqipëri, do të vemë re një handikap që është krijuar gjatë viteve të ekonomisë së centralizuar dhe që sot mbetet në heshtje. Sipas tij “Kjo pengesë ka të bëjë me koncentrimin, një nga format më të sofistikuara të centralizimit të pushtetit në Shqipëri gjatë viteve të diktaturës komuniste” (Aliaj, 2008: 130).

Kjo ishte arsyeja që proceset decentralizuese nuk ishin aq të lehta për tu ndërmarr në Shqipëri. Për më tepër, një reformë decentralizuese nuk do të kishte ndonjë rezultat të prekshëm nëse ajo nuk do të mbështetej nga aktorë të tjerë që do ta implementonin atë në terren (IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008). Referuar Nientied, për të përballuar një decentralizim funksionesh qeverisëse “stafi përgjegjës për zhvillimin e qytetit në pushtetin lokal nuk e ka formimin e duhur” (IHS Alumni et al, 1998: 10).

Në këtë kuptim, procesi i decentralizimit në vitet e para të tranzicionit nuk ishte një proces i lehtë për tu kryer, përshkak të trashëgimisë socialiste, mendësisë koncentruese dhe centralizuese të politikës dhe në mënyrë të veçantë të ekspertëve dhe zyrtarëve që do të përfshiheshin në implementimin në terren të kësaj reforme potenciale. Edhe Aliaj në vitin 2003 mendonte se burimet njerëzore dhe niveli i tyre në dispozicion të planifikimit dhe zhvillimit urban ishin shumë të kufizuar (Aliaj, 2003: 98).

Edhe me kalimin e viteve do të dukej se nuk do të ndryshojë asgjë në lidhje me këtë proces dhe biles kjo arsye do të përdorej për ta kthyer mbrapsht. Duket se, edhe një dekadë më vonë këto stafe lokale nuk kishin afësitë e duhura (Imami et al, 2008). Derraj në vitin 2008 do të prezantonte se duke u nisur nga eksperiencia personale në punën me bashkitë dhe komunat në shumë zona të vendit “kam frikë se do të duhet akoma shumë kohë dhe shumë punë derisa të kemi realisht administrata të afta që të vënë nën kontroll territorin e tyre” (Imami et al, 2008: 58).

Banka Botërore në vitin 2007 do të dallonte një koncentrim të skajshëm të vendimarrjes në fushën e planifikimit territorial. Sipas saj: “Në fakt duket që në qoftë se ligji zbatohet ka shumë pak raste që KKRRTSH-ja duhet të mos marrë pjesë në aprovimin e tyre. Kjo duket të lërë një rol shumë të vogël për KKRRT-te rajonale ose për KKRRT-te bashkiake”, ndërsa do të nënvizonte se “KKRRT-ja e Tiranës [vendore] është aktualisht e formuar kryesisht nga përfaqësues të agjensive të qeverisë kombëtare.” (BB, 2007: 84).

Në këtë kontekst ajo propozonte që për këtë synim të shfrytëzohej “Një rishikim i rëndësishëm i ligjit mbi planifikim urban është në proces e sipër, pjesërisht me qëllimin për të bashkërenduar të gjithë procesin e decentralizimit.” (BB, 2007: 84).

Realiteti faktik ka dëshmuar se produktet konkrete kanë munguar, dhe arsyeja e parë ka qënë qasja etatiste dhe veçanërisht centralizuese ka mbizotëruar (Aliaj, 2003, 2008). Por edhe kur ekspertë të ndryshëm kanë shprehur aspirata për decentrealizim ato kanë dështuar të konsiderohen nga autoritetet ligj hartuese (HIS Alumni et al, 1998).

Përgjithësisht, legjislacioni sektorial në fushën e planifikimit dhe zhvillimit territorial është prezantuar me karakteristika të forta centralizuese (Aliaj, 2008; HIS Alumni et al, 1998). Sikurse do të vërente Dharmo “legjislacioni urban, përball alternativës për të hapur rrugë zhvillimit të kapaciteteve të nivelit lokal, ka zgjedhur atë të centralizimit të kompetencave në fushën e planifikimit” (HIS Alumni et al, 1998: 32).

Qeveritë shqiptare të tranzicionin kanë prezantuar një qasje etatiste dhe koncentruese në lidhje me planifikimin territorial. Kjo mund të dallohet me lehtësi nëse vëzhgojmë legjislacionin që ato kanë hartuar dhe më tej është miratuar në këto vite. Për zhvillimin territorial dhe urban në Kuvendin e Shqipërisë janë miratuar katër ligje, në periudhën 1993-2014: ligji 7693/1993 ‘Për Urbanistikën’ (FZ, nr. 25, 1993); ligji 8405/1998 ‘Për Planifikimin Urban’ (FZ, nr. 23, 1998; QBZ, 2010); ligji 10119/2009 ‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial’ (FZ, nr. 56, 2009; QBZ, 2010); Ligj nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’ (QBZ, 2019).

Këto ligje pësuan ndryshime të vazhdueshme dhe të shpeshta, ku vlen për tu përmendur se ligji nr. 7693/1993 ‘Për Urbanistikën’ ndryshoi dy herë; ligji 8405/1998 ‘Për Planifikimin Urban’ u ndryshua dhjetë herë; dhe ligji 10119/2009 ‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial’ pësoi ndryshime që pak muaj pas miratimit të tij, para hyrjes me fuqi të plotë në fuqi, nëpërmjet ligjit nr. 10258/2010 (QBZ, 2010).

Karakteristika e parë e politikave qeverisëse të tranzicionit në fushën e zhvillimeve territoriale ka qënë ‘Hiper-legjislacioni’. Për këtë karakteristikë të “qeverisë së madhe” majtiste dhe dëmet e saj ne kemi folur më parë në këtë punim duke ju referuar Spencer, i cili e konsideronte si një kufizim të fortë të lirisë së individit dhe një dëmtuese të madhe të interesave të shoqërisë për shumë arsye (Spencer, 2005: 104-157).

Klasikët e liberalizmit do ti vinin një theks të veçantë legjislacionit të mirëpërcaktuar, konçiz dhe gjerësisht e gjithë njohura nga shoqëria (Locke, 2005; Friedman, 2005). Sipas Locke

individët bashkohen në shoqëri politike me synim për të mbrojtur pronat e tyre nëpërmjet “rregullave të qëndrueshme” (Locke, 2005: 168).

Ky ishte thelbi i filozofisë libertariane të Locke në lidhje me ligjet, dhe ai mbështetej në ligje të shpallura dhe të pranuara nga shoqëria që do ti zbatoj, dhe të qëndrueshme apo të pandryshueshme. Në këtë kuptim, sikurse Locke do ta nënvizonte “cilado qoftë forma e shtetit, pushteti në fuqi duhet të qeverisë nëpërmjet ligjeve të shpalluara e të pranuara” (Locke, 2005: 169).

Të njëjtën qasje prezanton edhe Friedman kur shprehej se “një shoqëri e mirë kërkon që antarët e saj të bien dakort me kushtet e përgjithshme që do të qeverisin marrdhënien mes tyre” (Friedman, 2005: 28).

Por shqetësimi më i madh i Friedman, sikurse i Locke por edhe i Spencer ka lidhje me ndryshimet e ligjeve. Friedman do të nënvizonte se “E shumta, ne konsiderojmë vetëm kryerjen e modifikimeve minimale në to, megjithëse efekti i grumbullues i një sërë modifikimesh minimale [ndryshimesh të shpeshta të ligjit] mund të çojë në një ndryshim drastic të lojës në shoqëri” (Friedman, 2005: 28).

Problematika më e madhe e legjislacionit sektorial i referohet faktit se këto ndryshime kanë synuar kthimin mbrapsht të procesit të decentralizimit duke prodhuar një centralizim të funksioneve qeverisë. Sipas ligjit fillestar nr.10119/2009 *‘Për Planifikimin e Territorit’*, specifikisht nenit 13 pika 2a, funksionin e miratimit të instrumentave vendor të planifikimit territorial për territorin nën juridiksionin e tyre, e kishin njësitë e qeverisjes vendore, kurse KKT-ë kishte kompetencë vetëm miratimin formal të përputhshmërisë së instrumentit vendor me instrumentet kombëtare të planifikimit territorial (QBZ, 2010).

Ndryshimet nëpërmjet ligjit nr.10 258/2010, që ju bënë ligjit nr.10119/2009, fuqizuan rolin e qeverisë qendrore. Sikurse vërehet në nenin 2 dhe 3 të tij, KKT-së, që është një autoritet kombëtar i kryesuar nga Kryeministri dhe i përbërë nga disa ministra, ju akordua e drejta për miratimin përfundimtar të instrumentave vendorë të planifikimit (QBZ, 2010). Ligji nr. 10 258/2010 rikthehu konceptin hirearkik të bashkive, sikurse vërehet në pikën 3 të nenit 3 të tij, duke konsideruar disa bashki si të “Kategorisë së Parë” (QBZ, 2010). Kjo me synimin që KKT-ë të ushtronte në disa njësi të qeverisjes vendore që nuk konsideroheshin si të kategorisë së parë, një kontroll akoma më të thellë politik.

Përveç kësaj tentative të vitit 2009 të kthyer mbrapsht pas pak muajsh, të gjitha ligjet e tjera të mëparshme nuk ja kanë deleguar Pushtetit Vendor funksionin e hartimit dhe miratimit të

instrumenteve lokale të planifikimit territorial në kufinjtë e juridiksionit të tyre. Të njëjtën dinamikë ka pësuar ligji nr. 107/2014 *‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’* të qeverisjes 2013-2020 (QBZ, 2019). Ne do ta trajtojmë atë gjerësisht më tej në këtë punim, kur të prezantojmë reformën për të cilën ka nëvojë sistemi legjislativ për sektorin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Një politikë tjetër shumë e rëndësishme për tu vlerësuar në raport me parimin libertarian dhe praktikën europiane të ndarjes së fushëveprimit qeverisës ndërmjet dy nivele të saj, është programi i planifikimeve vendore. Qeverisja territoriale 2013-2020 e ndërmori këtë program vijon prej vitesh për 61 bashkitë e Republikës (AKPT, 2015-2020).

Megjithëse i nisur ndoshta nga dëshira pozitive e qeverisë qendrore, është një qasje “paternaliste” (Friedman, 2005) që dëmton autonominë lokale të qeverisjes vendore. Mbi “pushtetin paternal” dhe “pushtetin politik”, ndryshimin midis tyre dhe dëmet që prodhon projektimi i një qeverisje në karakteristika dhe vlera paternaliste, do të fliste edhe Locke (Locke, 2005: 111-126, 159- 189, 190-193). Mbi këto premisa dëmtuese vepron edhe ky program i qeverisë qendrore për të pajisur me instrumenta planifikimi të gjitha bashkitë e vendit.

Nevoja për hartim të instrumentave të planifikimit territorial, veçanërisht në dimensionin lokal, është një domosdoshmëri por ndërhyrja e qeverisë qendrore në një funksion dhe detyrë bazike që i përket qeverisë qendrore është një veprim i gabuar qeverisës, për shumë arsye (HIS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008; Imami et al, 2008).

Së pari, dëmton demokracinë dhe parimin e proporcionalitetit, sipas të cilit problemet dhe disbalancat urbane duhen trajtuar në atë nivel që ato shfaqen, në akordancë me UNECE kur do të theksonte se “Parimi [i proporcionalitetit] është ky, nuk është e nevojshme ‘të përdorësh një varre për të thyer një kikirik, nëse këtë mund ta bëj një kikirikthyes’. Me fjalë të tjera, mënyrat duhet të jenë në propocion më përfundimet.” (UNECE, 2008: 12).

Një dëm të madh ky projekt i qeverisë qendrore i solli procesit të modernizimit të qeverisjes, si një nga metodat bazike për të rritur autonominë lokale dhe për të forcuar institucionet lokale. Nëpërmjet koncentrimit të projektin në AKPT, që është një institucion nën varësinë e Kryeministrit, qeveria qendrore e largoi këtë projekt nga administratat lokale. Prandaj Shqipëria ka domosdoshmëri një qasje të re në çështjet kompetencave dhe fushëveprimit qeverisës në fushën e planifikimit dhe zhvillimit territorial (HIS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2003, 2008).

Sipas Aliajt në 2003, ndërsa i referohej rekomandimeve të Planit Strategjik hartuar nga PADCO do të nënvizonte se “Një Ligj Urbanistike i reformuar duhet të ndaj pushtetin dhe funksionet ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisë dhe agjensive të saj për sa i përket kërkesave të urbanistikës” (Aliaj, 2003: 102). Aliaj mendon se duhet decentralizim në funksionin e hartimit dhe miratimit të instrumenteve të planifikimit, por veçanërisht në funksionin e lejedhënies ndërtimore “Ligji duhet të nxjerrë në pah hallkat dhe kërkesat ndër-institucionale në pushtetin qendror dhe atë lokal për funksionimin e punës për kontrollin e planifikimit” (Aliaj, 2003: 103).

Domosdoshmërinë për një decentralizim të thellë dhe pakthim në këtë sektor, Aliaj do të kërkonte edhe në vitin 2008 kur nënvizonte se:

“Tashmë realizimi i plotë i kësaj reforme është një domosdoshmëri urgjente për të korrigjuar mënyrën e mbrapshtë se si ushtrohet kontrolli mbi burimet financiare dhe materiale të vendit, dhe mbi të gjitha për të korrigjuar shpërndarjen e padrejtë dhe klienteliste të këtyre burimeve, bazuar në situatën dhe kushtet e krijuara sidomos për shkak të lëvizjes së popullsisë dhe të procesit dinamik të urbanizimit” (Aliaj, 2008: 128).

5.4. Vlerësimi i qeverisjeve të tranzicionit sipas parimit të fuqizimit të rolit të qytetarit në qeverisje.

Në këtë seksion ne do të bëjmë një vlerësim të reformave dhe politikave territoriale të qeverisjeve të tranzicionit në lidhje me parimin libertarian të fuqizimit të qytetarit në qeverisje. Përshkak të rëndësisë që ka për Shqipërinë e tranzicionit, ne do të prezantojmë qasjen politike të institucioneve politike dhe teknike të BE-së mbi këtë çështje.

5.4.1. Parimi libertarian i fuqizimit të qytetarit nëpërmjet përfshirjes në qeverisje.

Më parë në këtë punim ne kemi prezantuar filozofinë politike habermasiane të “shteti social” e cila mbështetej në mbivendosjen e konceptit lokian “të drejta natyrore” në dy lloje të drejtash: “të drejtat e njeriut” dhe “të drejtat e qytetarit” (Fuga, 2003: 46-49; Habermas, 1976, 1995, 2006, 2010).

Sipas Habermas “shteti social” i “demokracisë së masave” nëpërmjet “të drejtave të qytetarit” synonte të ashtuquajturën “barazi e shanceve në përvetësimin e pronës” duke zgjeruar fushëveprimin e qeverisë, e cila tashmë është e ngarkuar ti krijojë dhe ti mbrojë këto të drejta të reja (Habermas, 2006, 2010). Habermas mendonte se ky zgjerim i fushëveprimtarisë së qeverisë duhet të shoqërohej me dy element të rëndësishëm, së pari “pavarësia e jetës private” dhe së dyti “pjesmarrja e qytetarëve në politikë” (Habermas, 2006: 412, 418; Fuga, 2003: 45).

Sipas Habermas, “pjesmarrja e qytetarëve në politikë” bëhet nëpërmjet “pjesmarrjes së tyre në debatin e madh publik që formon në fakt opinionin publik të shoqërisë” (Habermas, 2006: 413).

Për Habermas kjo pjesmarrje nuk arrihet thjeshtë në mënyrë “negative” duke e detyruar shtetin që të mos përziehet me lirinë e shtypit dhe të mediave, sepse liria e shtypit nuk është vetëm një liri e individit, por një liri publike (Habermas, 2006). Sikurse do të shprehej Habermas për kohën kur lindën të drejtat negative “kur parlamentarizmi dhe shtypi masiv u krijua nën flatrat mbrojtëse të liberalizmit të herët [klasik]” (Habermas, 2006: 147).

Prandaj duhet një politikë e tërë shtetërore nëpërmjet detyrimit ligjor që e ndihmon praktikisht dhe ligjërisht shoqërinë civile të shprehi opinionin e saj në hapsirën mediatike (Fuga, 2003: 52; Habermas, 2006). Për Habermas paradigma komunikative ofron si pikë kryesore të saj një proces demokratik në tre komponentë “(a) publicitet dhe transparencë për procesin diskutues, (b) përfshirje dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje, dhe (c) supozimin e justifikuar për rezultate të arsyeshme (kryesisht në funksion të ndikimit të argumenteve në ndryshimet racionale të preferencës)” (Habermas, 2006: 413).

Habermas prezanton disa shembuj empirik të fuqizimit të qytetarëve në çështjet politike, të referuara nga Neblo (në shtyp), ku qytetarët u pyetën mbi çështje “të tilla si veprimi pohues, homoseksualët në ushtri ose drejtësia shpërndarëse e skemave të taksave të sheshta” (Habermas, 2006: 413).

Ai sjell edhe shembuj të tjerë nga eksperimentet e famshme të James Fishkin në vitin 1995 dhe Fishkin & Luskin në vitin 2005. Sipas Habermas “Të gjitha këto studime ofrojnë prova empirike për potencialin njohës të diskutimit politik” (Habermas, 2006: 414). Por gjithashtu, Habermas pranon se këto shembuj empirik vijnë nga eksperimente me grupe të vogla qytetarësh të përfshirë dhe jo nga të gjithë individët e shoqërisë. Ai pranon gjithashtu se “Mangësi të dukshme në këtë drejtim janë (a) mungesa e ndërveprimit ballë për ballë midis pjesëmarrësve të pranishëm në një praktikë të përbashkët të vendimmarrjes kolektive dhe (b)

mungesa e reciprocitetit midis roleve të folësve dhe adresuesve në një shkëmbim barazitar pretendimesh dhe mendimesh.” (Habermas, 2006: 414-415).

Për këtë shkak Habermas na propozon “Imagjinoni sferën publike si një sistem ndërmjetës të komunikimit midis diskutimeve të organizuara zyrtarisht dhe informale ballë për ballë në arena si në krye dhe në fund të sistemit politik” (Habermas, 2006: 415).

Për Habermas duhet të jetë sfera publike (një grup i zgjedhur i shoqërisë civile) në një sistem që vepron si një i tërë, që filtron elementet e rëndësishëm të çështjeve në një proces legjitimimi të strukturuar në mënyrë diskursive. Si një element thelbësor i procesit demokratik, diskutimi pritet të përmbushë tre funksione:

“të mobilizojë dhe bashkrendojë çështjet përkatëse dhe informacionin e kërkuar, dhe të specifikojë interpretimet; të prezantojë dhe ofrojë kontribute në mënyrë diskursive me anë të argumenteve të duhura pro dhe kundër; dhe të gjenerojë qëndrime të motivuara në mënyrë racionale me po ose jo, që pritet të përcaktojnë vendimet e marra në procedura të sakta” (Habermas, 2006: 416).

Sipas Habermas, roli lehtësues i sferës publike politike është kryesisht të përmbushë vetëm të parin e këtyre funksioneve dhe kështu të përgatisë agjendat për institucionet politike, dhe “Për ta thënë me pak fjalë, modeli diskutues pret që sfera publike politike të sigurojë formimin e një spektri të gjerë opinionesh publike” (Habermas, 2006: 416).

Filozofia habermasiane i jep në diskurs një vend të veçantë parimit të përfshirjes së qytetarëve në qeverisje nëpërmjet një mediatori (sferës publike politike). Mirëpo edhe Habermas e pranon se “Momenti i vetparaqitjes së aktorëve [të përzgjedhur] e shndëron paevitueshmërisht publikun gjykues, që ulur para ekranit dhe merr pjesë në sherrin mbi tema me interes të përgjithshëm, edhe në një publik spektator” (Habermas, 2006: 149).

Si spektator, publiku thjesht dëgjon opinionin e aktorëve në debatin televiziv, por nuk e jep dot mendimin e tij mbi çështjen në diskutim. Një problematikë tjetër të tezës së tij, sjell vet nga Habermas, është moraliteti i intelektualëve që marrin pjesë në debatet mbi çështjet e rëndësishme publike. Sipas tij “Komunikimi politik i ndërmjetësuar kryhet nga një elitë.” (Habermas, 2006: 416) dhe “disa [intelektualë] e kanë lënë veten të korruptohen para ftesës së medias për vetparaqitje duke dëmtuar emrin e tyre” (Habermas, 2006: 149).

Habermas, gjithashtu vëren se “Për më tepër, dinamika e komunikimit masiv janë të drejtuara nga fuqia e mediave për të përzgjedhur dhe ti dhënë formë prezantimit të mesazheve, dhe nga

përdorimi strategjik i pushtetit politik dhe social për të influencuar axhendat, si dhe duke shkaktuar inkuadruar çështjet publike” (Habermas, 2006: 415).

Habermas nuk e shikon këtë problematikë vetëm nga media, por nga intelektualit që ka ndërtuar një reputacion të përvetësuar në një fushë brenda profesionit të tij. Prandaj, kur një intelektual përfshihet në një debat të rëndësishëm publik me argumente, duhet ti drejtohet një publiku që nuk është i përbërë thjeshtë nga shikues, “por nga folës dhe të adresuar të mundshëm, që mund ti japin llogari njëri-tjetrit” (Habermas, 2006: 149). Sipas Habermas, kjo është arsyeja pse politikanët dhe gazetarët nuk lënë asnjë boshllëk në debatet publike të moderatorëve të rëndësishëm të medias televizive “që ta mbyll këtë [boshllëk] paskëta një intelektual” (Habermas, 2006: 150).

Në fakt, vet Habermas do të prezantonte se ekzistojnë dy lloje aktorësh të përhershëm në debatin publik, “profesionistë të sistemit mediatic - veçanërisht gazetarë që redaktojnë lajme, raporte dhe komente - dhe politikanë që zënë qendrën e sistemit politik dhe janë të dy bashkëautorë dhe adresuesit e opinionëve publike” (Habermas, 2006: 416).

Arsyeja pse po e trajtojmë fuqizimin e qytetarit në qeverisje si një parim libertarian, duke e kufizuar spektrin e filozofive politike ideologjike, është se nuk bën asnjë kuptim që nga një anë e risim fushëveprimin e qeverisë duke zvogëluar zvogëluar defakto fushëveprimin e individit; dhe nga ana tjetër, të shpresojmë se kjo do të sjell fuqizimin e qytetarit. Sikurse i kemi prezantuar sa më shumë zmadhohet fushëveprimi qeverisës, aq më shumë zvogëlohet fuqia e individit apo e shoqërisë (Smith, 2005; Locke, 2005; Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Locke, do ta prezantonte gjerësisht rrezikun e tundimit përshkak të dobësisë njerëzore, të njerëzve me pushtet për ta përdorur atë për interesa personale dhe të ndryshme nga ato të publikut (Locke, 2005: 173).

Po kështu Spencer me konceptin e vet të “hiper-legjislacionit” dhe Friedman me tezën e tij se “fusha e veprimtarisë së qeverisë duhet të jetë e kufizuar” sepse “mendja na thotë dhe historia konfirmon, që kërcënimi më i madh i lirisë është përqëndrimi i pushtetit” (Friedman, 2005: 3).

Përtej argumentave teorike të klasikëve të liberalizmit, ne kemi edhe praktika shumë të qarta nga jeta jonë në socializmin stalinist që ka një diferencë të madhe midis diskursit dhe realitetit, veçanërisht në raportin liri e individit dhe e shoqërisë dhe autoritet qeverisës (Imami et al, 2008). Lelaj, në vitin 2008 do ta analizonte tezën habermasiane të “sferës publike, ku shtetasit-qytetarë bashkohen lirisht dhe formojnë një opinion publik që ka për funksion shtrëngimin e

pushtetit public të shtetit mbi sferën private”, dhe do ti rezultonte jo reale (Imami et al, 2008: 84).

Edhe ai do të mbronte mendimin se në të njëjtën mënyrë e interpretonte “rolin e shtetit, të partisë dhe të shoqërisë civile” edhe Kushtetuta e vitin 1978 dhe ideologë socialist shqiptar të periudhës së socializmit stalinist (Imami et al, 2008: 84-85), porse liritë individuale dhe shoqërore ishin të shtypura në çdo qelizë (Fuga, 2001, 2003; Krasniqi, 2008; Biberaj, 2000; Lami, 2013; Aliaj, 2008; Imami et al, 2008).

Lelaj do ta argumentonte duke ju referuar neneve specifike të Kushtetutës Socialiste, të cilat në lidhje me rëndësinë e shoqërisë civile në qeverisje, kundështojnë njëra-tjetrën. Ai dalloi se nga njëra anë flitet për një rol të rëndësishëm që duhet të kryenin organizatat e masave në realizimin e symineve më të larta shoqërore, dhe nga ana tjetër përcaktohej se në krye të këtyre organizatave të masave qëndron partia marksiste leniniste e punëtorëve, çfarë ja suprimonte këtë rol duke i vendosur nën kontrollin politik të partisë (Imami et al, 2008: 84).

Për të sjellë një argument që i përket më shumë sektorit të planifikimit dhe zhvillimit territorial, neni 6-të i Dekretit nr. 5747/1978 *‘Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave’*, detyronte që të gjitha instrumentat e planifikimit urban dhe territorial përpara se të miratoheshin duhet ti “nënshtrohen gjykimit të masës për një periudhë kohe deri në një muaj” (FZ, nr. 3, 1978).

Katarzyna në vitin 2019, gjithashtu, do të argumentonte se teoria e demokracisë diskutuese të Habermas përmban në vetvete dy komponentë që kundështojnë njëra-tjetrën, sikurse janë: diskutimi dhe konsensusi (Katarzyna, 2019). Sipas saj ndërsa diskutimi synon ta mbaj procesin e hapur, konsensusi kërkon që ai të mbyllet më një marrveshje në unanimitet të plotë dhe “Për Habermas-in, diskutimi është i lidhur në thelb me konsensusin (si një presupozim pragmatik dhe një ideal rregullator)” (Katarzyna, 2019: 1).

Katarzyna do të nënvizonte se “Ajo që e dallon konsensusin e Habermas nga format e tjera të marrëveshjes është lloji i fortë i pëlqimit që kërkohet nga pjesëmarrësit në diskutim. Jo vetëm që të gjithë duhet të përputhen me rezultatin, por edhe duhet të përputhen për të njëjtën arsye” (Katarzyna, 2019: 6).

Kjo e bën, sipas Katarzyna, teorinë e Habermas të pa zbatueshme në praktikë, sepse “Realizimi i tij [arritja e konsensusit] në politikën e jetës reale bëhet shumë i pamundur” (Katarzyna, 2019: 6).

Në këtë kuptim ne do të flasim për parimin e fuqizimit të qytetarit në qeverisje, jo sipas qasjes së “shtetit të madh” dhe një grupi specifik të shoqërisë civile (sfera politike publike), por sipas qasjes libertariene e qytetarit individual në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Këtë rol të rëndësishëm individit në një shoqëri të lirë e ka arritur si një rrugë në dy nivele: nga njëra anë duke luftuar për zgjerimin e lirisë së tij përkundrejt pushtetit qeverisës; dhe nga ana tjetër për të vepruar në zonën e lirisë së tij, nëpërmjet të drejtës së mendimit e opinionit dhe të shprehjes së tyre pa asnjë kufizim (Mill, 2005: 32-35).

Marrdhënia dikotomike midis lirive të individit dhe pushtetit të qeverisë është një nga karakteristikat më dalluese të evoluimit shoqëror që në periudhat më të hershme të historisë njerëzore, veçanërisht në ato të Greqisë, Romës dhe Anglisë (Mill, 2005). Sikurse do ta përkufizonte Mill “[në antikitet] me liri kuptohej mbrojtja kundër tiranisë së sunduesve politikë. Sunduesit konceptoheshin (me përjashtim të disa prej qeverive popullore [demokratike] të Greqisë) si një pozicion antagonist të domosdoshëm me njerëzit që ata sundonin” (Mill, 2005: 5-6).

Për të ngelur te qasja e Mill, i cili nënvizonte se garantimi i kësaj gjëndje kërkonte një garanci nga sunduesi për sa kohë që njerëzit ishin të kënaqur të luftonin një armik me një tjetër dhe të sundoheshin nga një padron, me kushtin e të qenit pak a shumë të garantuar ndaj tiranisë së tij, ata nuk i çonin aspiratat e tyre përtej kësaj pike (Mill, 2005: 7).

Më tej erdhi një kohë kur njerëzit nuk e pranonin më faktin që qeveritarët e tyre të ishin një pushtet i pavarur, dhe shpesh herë i kundërt me interesat e tyre (Mill, 2005). Këtu nisi dinamika e kalimit të qeverisjes nga sundimi i një mbreti të përhershëm në “qeverisje të përkohshme” (Mill, 2005: 7).

Me kohën republikat demokratike filluan të instaloheshin në shumë vende të botës perëndimore dhe në këtë kuptim qeverisja e zgjedhur nga populli u kthye në subjektin e ri për tu vëzhguar dhe kritikuar nga njerëzit që ishin të dashuruar me lirinë e individit. Sipas Mill:

“tashmë mendohej se lokucione të tilla si ‘vetqeverisje’ dhe ‘pushteti i popullit mbi vetë popullin’ nuk shprehnin gjendjen reale të çështjes. ‘Njerëzit’ që ushtrojnë pushtetin nuk janë gjithmonë të njëjtë me ata mbi të cilët ai ushtrohet. ‘Vetqeverisja’ për të cilën flitet nuk është qeverisje e secilit nga vetvetja, por e secilit nga e gjithë pjesa tjetër.” (Mill, 2005: 7).

Kështu lindën dy risi, së pari, frika nga tirania e shumicës, e cila konsiderohej dhe konsiderohet akoma e frikshme sepse vepron nëpërmjet akteve të autoriteteve publike (Spencer, 2005), dhe

liberalizmi i cili do të kishte thelb mbrojtjen e lirisë së individit dhe fuqizimin e vullnetit të tij politik në qeverisje.

Njëtrajtshmërisht, Friedman do të prezantonte se “Si liberalë [klasik], ne e konsiderojmë lirinë e individit, ose të familjes, si qëllimin tonë final në gjykimin e rregullimeve shoqërore” (Friedman, 2005: 13), apo sikurse do ta nënvizonte Spencer “liberalët [klasik] zakonisht mbronin lirinë individuale kundrejt shtrëngimit nga ana e shtetit” (Spencer, 2005: 19).

Mënyra e dytë nëpërmjet të cilës individët përfshihen në qeverisje përfshin tre aspekte: së pari, lirinë absolute të mendimit dhe opinionit në të gjitha fushat, të cilat janë të pandashme nga liria e shprehjes pa asnjë kufizim të këtyre mendimeve dhe opinioneve; së dyti, lirinë e thurjes së planit të jetës së tij në përputhje me karakterin dhe ashtu si i pëlqen me kufizimin e vetëm që ky plan nuk dëmton një individ tjetër; dhe së treti, liria e individit për tu shoqëruar dhe bashkërenduar veprimtarinë me individë të tjerë (Mill, 2005: 18-19).

Sipas liberalëve klasik, ka vetëm dy mënyra të bashkërendimit të veprimtarisë njerëzore, e para është drejtimi qëndror nga autoriteti qeverisës me anë të shtrëngimit, kurse e dyta është bashkëpunimi vullnetar i individëve. Të parat janë teknika të shtetit policor, ushtarak, autokrat dhe totalitar, dhe mbështeten në tezën se “qëllimi justifikon mjetin” (Friedman, 2005: 25), kurse mënyrat e dytat janë teknika të demokracisë liberale dhe të tregut të lirë (Friedman, 2005). Sipas tij “Për liberalin [klasik], mjetet e përshtatshme janë diskutimi i lirë dhe bashkëpunimi vullnetar.” (Friedman, 2005: 25).

Mill i bën një analizë të thellë lirisë së individit për të patur opinionin e tij dhe të drejtës për ta shprehur atë; si dhe lirisë së tij për të thurur plane për jetën e tij në bashkërendim me individë të tjerë. Referuar Mill “Gjykimi i është dhënë njerëzve që ta përdorin. Sepse, a mund t’u thuhet njerëzve se nuk duhet ta përdorin fare gjykimin ngaqë mund ta përdorin gabim?” (Mill, 2005: 25).

Mbi këtë sentencë, ngrihet e gjithë godina e fuqizimit të qytetarit nëpërmjet përfshirjes në proceset qeverisëse. Nëse të gjithë qytetarët në një shoqëri të lirë janë të barabartë në lirinë e tyre (Locke, 2005), asnjëri prej tyre nuk gëzon të drejtën të përjashtoj opinionin e dikujt tjetër në një diskutim të lirë për të arritur një bashkëpunim vullnetar në çështjet që ju përkasin të gjithëve (Friedman, 2005). Sipas Mill kjo, jo vetëm nuk do ishte e drejtë për një shoqëri të individëve të lirë, por nuk do ishte as produktive për të mirën e shoqërisë (Mill, 2005: 25-27).

Sipas Mill, edhe në rastin kur opinionin e gabuar, ai duhej shprehur sepse vetëm nëpërmjet diskutimit mbi të mund të kuptonim se ai ishte i gabuar, çfarë do të na drejtonte në një opinion

më të drejtë. Po kështu, nëse nuk do ti testonim mendimet dhe opinionet tona mbi bazën e diskutimit të lirë, ato nuk do të arrinin mbështetjen e gjerë publike për të cilën kanë nevojë, që të implementohen si zgjidhje të problemeve të shtruara (Mill, 2005).

Në shërbim të këtij përfundimi, Mill do të nënvizonte se:

“në qoftë se fusha e debatit mbahet e hapur, mund të shpresojmë se nëse ka një të vërtetë më të mirë [sesa ajo që kemi gjetur deri në këtë moment], ajo do të gjendet kur mendja njerëzore të jetë e aftë për ta perceptuar dhe ndërkohë mund të kemi besim të plotë se po i afrohem të vërtetës, për aq sa është e mundur sot” (Mill, 2005: 29).

Ky është thelbi i libertarianizmit, qytetarët e lirë dhe të përgjegjshëm, mblidhen në mënyrë vullnetare, kuvendojnë problematikat që i shqetësojnë dhe arrijnë në dakortësi sesi këto problematika mund të përmirësohen apo të asnjëansohen.

5.4.2. Fuqizimi i qytetarit në qeverisje si individ që mbart virtytin qytetar.

Metodat bashkëpunuese dhe ato të përfshirjes qytetare në proceset planifikuese janë një çështje e rëndësisë bazike në praktikatat e planifikimit hapsinor sot në botë. Shtete perëndimore dhe të demokracisë liberale, por edhe të tjera që nuk kanë traditë të gjatë në demokraci, kanë evoluuar metoda me këtë synim. Qasjet ndërvepruese dhe bashkëpunuese janë prezantuar gjerësisht në Shtetet e Bashkuara, në Itali, Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë, Vendet Skandinave, bile edhe në vende si Kina dhe Brazili, por ishte Holanda vendi ku këto praktika origjinalizuan (Boonstra dhe Boelens, 2011).

Sikurse do të theksonin ata:

“disa tentative janë bërë që nga vitet 1960-të për të përfshirë qytetarët në procesin e zhvillimit hapsinor, dhe bashkëveprimi është avokuar ndërmjet agjensive qeveritare, sipërmarrësve dhe organizatave civile, ose, ndërmjet palëve të interesuara publike, biznesit dhe civile, si një qasje multi aktorëshe në planifikim” (Boonstra dhe Boelens, 2011: 101).

Dy janë mënyrat bazike nëpërmjet të cilave është synuar përfshirja qytetare në procese planifikuese territoriale, e para është rritja e pjesëmarrjes aktive e qytetarëve, dhe e dyta ndarja e përgjegjësisë për çështjet urbane dhe të territorit ndërmjet institucioneve qeverisëse dhe komuniteteve qytetare (Boonstra dhe Boelens, 2011).

Sipas tyre:

“Pjesmarrja qytetare në vendimarrjen qeverisëse ka një histori të gjatë për të paktën 45 vjet [55 vjet] në planifikimin e Holandës. Për herë të parë është prezantuar nga e ‘Majta e Re’ e Social-Demokratëve të Holandës nga mesi i viteve ‘60-të. Ajo synonte lëvizje emancipuese dhe demokratizuese në të cilat ishin përfshirë është ShBA (si rezultat i demonstratave për Vietnamin), Franca (revolta e studentëve), Gjermania (rudi Dutschkes Marshimi nëpër Institucione) dhe trazirat post-luftë në vendet e tjera perëndimore” (Boonstra dhe Boelens, 2011: 107).

Kështu lindi niveli i parë i planifikimit pjesëmarrës i quajtur ‘Dëgjesa Publike’ i aplikuar në vitet ‘70-të. Ky ishte një hap i rëndësishëm, por edhe sipas Boonstra dhe Boelens shumë larg nevojës reale, sepse “thjesht prezantoi në praktikë vetëm mundësinë reale të qytetarëve për të kritikuar dhe reaguar ndaj propozimeve hapsinore të bëra nga agjensitë qeverisëse.” (Boonstra dhe Boelens, 2011: 110).

Duke qenë se praktika e ‘Dëgjesave Publike’ u konsideruan shumë shpejt si inefektive, lindi niveli i dytë i fuqizimit të qytetarit në qeverisjen territoriale që e quajmë ‘Planifikimi Bashkëpunues’, i cili nënkupton bashkëpunimin në proceset planifikuese të dy sektorëve, publik dhe privat. Këtë formë të re bashkëpunimi Boonstra dhe Boelens do ta prezantonte si mënyrën ku qeverisjet lokale ose rajonale biles edhe kombëtare zgjedhin të bashkëpunojnë me palët e interesuara kryesore në biznes dhe në vazhdim gjithashtu me shoqërinë civile, në mënyrë që të zhvillojnë një plan realist në të cilin çdo palë e interesuar të ketë përgjegjësitë e veta (Boonstra dhe Boelens, 2011: 114).

Niveli i tretë i fuqizimit të rolit të qytetarit në vendimarrjet qeverisëse ka shumë përhapje kohët e fundit në vendet me demokraci të brishtë si vendet e Amerikës Latine dhe Kina. Ajo quhet ‘Buxheti i Inisiativave’ dhe nënkupton financimin nëpërmjet buxheteve publike, ose në bashkëfinancim të buxheteve publike dhe private të projekteve të iniciuara nga komunitetet e qytetarëve (Boonstra dhe Boelens, 2011). Por kjo nuk do të ishte stacioni i fundit i niveleve të përfshirjes së qytetarëve.

Një kontribut shumë të vyer teorik në këtë çështje ka dhënë në vitin 1996 Sherry Arnstein, nëpërmjet punimit të saj ‘*Një shkallare për pjesmarrjen qytetare*’. Shumë shtete e përdorin shkallaren e Arnstein për të përmirësuar nivelin e përfshirjes së qytetarëve në proceset lokale të zhvillimit. Në këtë punim ajo prezantoi dhe argumentoi se ka tetë nivele të pjesmarrjes së qytetarëve në proceset e hartimit të instrumentave të planifikimit territorial. Këto nivele Arnstein

i quajti këmbëshkallë të pjesëmarrjes dhe i prezantoi në formën e një tipologjie shkallare të pjesëmarrjes qytetare, në të cilën secila këmbëshkallë i korespondon një nivel i caktuar i pushtetit të qytetarëve në hartimin e një plani, programi apo projekti qeverisës. Të tetë këmbëshkallët e shkallës së pjesëmarrjes qytetare janë; manipulimi, terapia, informimi, konsultimi, lajkatimi, bashkëpunimi, delegimi i pushtetit dhe kontrolli qytetar (Arnstein, 1969: 217-220).

Shumica e teoricienëve nuk e gjejnë produktive pjesëmarrjen qytetare në proceset planifikuese hapsinore, dhe mendojnë se ajo ka prodhuar rezultate zhgënjyese (Boonstra dhe Boelens, 2011). Ata argumentojnë se pjesëmarrja në planifikimin hapsinor, mbetet e kontrolluar nga qeverisja publike dhe se, këto qeverisje publike duket se nuk janë shumë të adaptueshme ndaj iniciativave që dalin nga vet dinamikat e shoqërisë civile (Boonstra dhe Boelens, 2011).

Të cituar nga Boonstra dhe Boelens, Judith Ines dhe David Booher deklaruan se metodat tradicionale të pjesëmarrjes qytetare nuk arrijnë dot pjesëmarrje të sinqertë në planifikim apo vendimmarrje; ato nuk sigurojnë dot informacion sinjifikat nga zyrtarët publik që të bëjë diferencë në veprimet e tyre; ato nuk kënaqin antarët e publikut që janë dëgjuar; ato nuk përmirësojnë dot vendimmarrjen që bëjnë agjensitë dhe zyrtarët public; dhe ato nuk prezantojnë spektër të gjerë të publikut. Por kështu “Woltjer (2002) pretendoi se planifikimi interaktiv nuk do të jetë asgjë më tepër ‘*making* mbështetëse’ për të legjitimuar vendimmarrjet e marra ndërkohë, nga administratat ekzistuese” (Boonstra dhe Boelens, 2011: 99).

Këto praktika dhe propozime për planifikim pjesëmarrës apo bashkëpunues vijnë “më së paku pjesërisht, të bazuara në teorinë e ‘veprimit komunikativ’ të Jürgen Habermas” (Boonstra dhe Boelens, 2011).

Ne nuk do ti rikthehemi analizës mbi kontraditën e fortë që mbart teoria habermarsiane e shoqërisë civile që mbron sferën private nga autoriteti shtetëror, pasi i ka dhënë më parë shtetit një rol më të madh kontrollues dhe rregullator të medias private. Ajo që do të donim të sillnim këtu është arsyeja pse ndodh kjo, e cila ka të bëjë me atë që Imami në vitin 2008 do ta vlerësonte si “komunikimi me një sens” (Imami et al, 2008: 20).

Për Imamin, propozimi për përfshirjen qytetare në punët e qytetit të tij nëpërmjet medias thjeshtë e kthen qytetarin në një “shikues të habitur që ri përballë televizorit dhe bëhet hambar idesh”, sepse “Ky komunikim padyshim që është me një sens, njëkalimësh, sepse konsumatori [qytetari i informuar nga media] nuk shkëmben, merr por nuk jep [mendim]” (Imami et al, 2008: 20).

Po kështu, edhe njerëzit që përfshihen për të prezantuar opinionet e tyre, në televizionet e shtrëguar ligjërisht nga shteti, do të jenë të përzgjedhur mbi bazën e aftësisë së tyre komunikative. Sepse, jo çdo njeri ka aftësi për tu përfshirë në media, ndërkohë që “Jo vetëm njerëzit që dijnë të shkruajnë dhe lexojnë [komunikojnë] mirë, kanë të drejtë të jenë pjesë e qytetit, por pjesë e qytetit janë duhet të jetë çdo qytetar i tij” (Imami et al, 2008: 21).

Teoria habermasiane për pjesëmarrjen e qytetarëve në debatin e madh publik të zhvilluar në median e detyruar ligjërisht nga shteti (Fuga, 2003: 52), nuk na drejton dot në gjithëpërfshirje të qytetarëve në punët e qytetit (Imami et al, 2008: 21). Po kështu, sikurse do të na shpjegojnë Boonstra dhe Boelens, përfshirja e mendimit qytetar në proceset planifikuese urbane dhe territoriale janë të destinuara të dështojnë sepse këto procese kontrollohen nga qeverisjet (Boonstra dhe Boelens, 2011: 99).

Ata propozojnë një model tjetër të fuqizimit të qytetarit në qeverisjen territoriale duke prezantuar “nacionin e vet-organizimit, referuar inisiativave që dalin nga vet shoqëria civile, nëpërmjet rrjeteve autonome me bazë komunitare të qytetarëve, jashtë kontrollit qeveritar” (Boonstra dhe Boelens, 2011). Sipas këtij modeli, qytetarët në mënyrë individuale apo duke u grupuar sipas interesave, identifikojnë problematikat dhe përfshihen në debate politike mbi mundësitë e zgjidhjes së tyre. Ata do të na sillnin një shembull nga Holanda, ku ky model funksionon që prej viteve 1970, si dhe shumë të tjerë nga SHBA dhe Britania e Madhe që kanë tradita në këtë drejtim (Boonstra dhe Boelens, 2011: 122).

Ky model nuk mund të funksionojë në qytete ku jetojnë banorë të prekur “nga varësia nga shteti” që presin që çdo gjë t’jua rregulloj qeveria, por në ato qytete ku jetojnë qytetarë të lirë dhe të përgjegjshëm (Imami et al, 2008). Sikurse do ta përkufizonte Kulluri “Qytetari Aristotelian, jo si banorë të qytetit, por si kategori filozofike, qenie politike në një system demokratik. Qytetari si njeri i lirë i polisit” (Imami et al, 2008: 64).

Në polisën që nuk ka në qendër pallatin e sunduesit por agorën ku këta njerëz të lirë do të mbledhen për të diskutuar dhe komunikuar. Qytetar është ai që kryen shërbimin ushtarak, por mbi të gjitha ai që gjykon dhe këshillon. Mbi këtë rregull krijohet marrdhënia midis qytetarit dhe qytetit, pa të cilën nuk mund të jetojë as “polisi pa qytetar” dhe as “qytetari pa polis” (Imami et al, 2008: 64). Sipas Kullurit qytetari aristotelian është njëri liberal (Imami et al, 2008), kurse sipas Imamit është shoqëria politike ajo që modelon qytetin/polisin (Imami et al, 2008: 64).

Imami do të nënvizonte se “ne nuk dalim dot jashtë këtij përcaktimi, dhe liria jonë qëndron vetëm në atë se çfarë zgjedhim [që është e mirë për qytetin tonë], sepse edhe moszgjedhja është një varian zgjedhjeje” (Imami et al, 2008: 64).

Në këtë rast, me mos zgjedhje, ne kemi zgjedhur që qyteti ynë të zhvillohet ashtu si duan të tjerët, si duan ata që janë gjithmonë prezent, “sundimtarët” (Sted, 2000). Sipas Sted në vitin 2000, kjo është arsyeja pse njerëzit janë të interesuar të kontribuojnë në të mirën e komunitetit, kurse ajo që i drejton njerëzit e lirë drejt bashkërendimit në mënyrë vullnetare është “virtyti qytetar” (Sted, 2000). Sted do të nënvizonte se “Për themeluesit e Amerikës, virtyti qytetar ishte vlera më e rëndësishme e një qytetari”, por ata besonin se kjo vlerë duhet të mësohet sepse nuk ishte element natyror i qënies njerëzore (Sted, 2000: 19).

Lelaj në vitin 2008, do të prezantonte se dy janë institucionet që formësojnë vlerë të qënies njerëzore, që ai e emërtonte “socializimim i njerëzve në shoqëri”, dhe ato janë familja dhe institucionet vullnetare (Imami et al, 2008). Familja konsiderohet si bërthama më autonome e shoqërisë, është institucioni më i rëndësishëm socializues dhe quhet “institucioni parësor socializues privat” (Imami et al, 2008: 82). Kurse “institucionet parësore socializuese publike” janë shoqatat vullnetare, si grupimet e ndryshme fetare, kopshtet, shkollat, media dhe të tjera institucione që janë të lokalizuara jashtë kufinjve të familjes (Imami et al, 2008: 83).

Sted në vitin 2000 do të na prezantonte me tre mënyrat që duhet të përdorin këto institucione shoqërore për të ngulitur te fëmijët “virtitun qytetar” (Sted, 2000: 20-26), por kjo del jashtë interesit të këtij punimi.

Mbi “virtytin qytetar” të amerikanëve të shekullit të 19-të do të na fliste edhe Tokëvill në librin e tij *‘Demokracia në Amerikë’*. Sipas Tokëvill “Parimi i sovranitetit të popullit drejton të gjithë sistemin politik të anglo-amerikanëve” dhe sipas këtij parimi çdo individ ka të njëjtën pjesë të barabartë të pushtetit dhe merr pjesë barazisht në qeverisjen e vendit (Tokëvill, 2002: 36).

Ky lloj qytetari i barabartë mes të barabartëve, i bindet shtetit jo se është më poshtë se ata që e drejtojnë apo është më pak i zoti se të tjerët për të drejtuar veten, porse ai e njeh dobinë e bashkimit me bashkëqytetarët e vet dhe e si se asnjë bashkim i tillë nuk mund të ekzistojë pa një forcë rregulluese. Në të kundërt, qytetarët që e konsiderojnë veten të huaj nuk u bënë përshtypje fati i vendit ku banojnë, ndërsa ndryshimet e mëdha bëhen pa pjesëmarrjen dhe dijeninë e tyre (Tokëvil, 2002).

Një qytetar i huaj për qytetin e tij, sipas Tokëvill:

“nuk do t’ja dijë për kushtet e fshatit të tij, mirëmbajtjen e rrugës, kishës a pastoratit të tij, sepse të gjitha këto ai i sheh sikur të mos kishin lidhje me të dhe si pronë të ndonjë fuqie të huaj të cilën ai e quan shtet” (Tokëvil, 2002: 47).

Sipas Tokëvill, një qytetar i tillë dridhet nga zyrtari më i vogël, por sapo tërhiqet forca e zyrtarit ai i kundërvihet ligjit, duke u luhatur midis nënshtrimit dhe shthurjes. Tokëvill do të dallonte një diferencë të madhe midis qytetarit europian dhe atij amerikan, në shekullin e 19-të, në shprehjen e pjesmarrjes në qeverisje. Sipas tij, “Për një europian, nëpunësi i shtetit përfaqëson një forcë më të lartë, për një amerikan ai përfaqëson një të drejtë” (Tokëvill, 2002: 48).

Pra, në Amerikë askush nuk i bindet një njeriu tjetër, por drejtësisë dhe ligjit, dhe kjo është arsyeja pse qytetari amerikan është aktiv në qeverisje dhe nuk pret që çdo çështje ta zgjidhi shteti.

5.4.3. Rekomandimet e BE dhe praktikat shqiptare për përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen territoriale.

Përfshirja e qytetarëve dhe palëve të interesuara në proceset e hartimit të instrumentave të planifikimit hapsinor, territorial dhe urban është një nga metodat më produktive për të fuqizuar qytetarin në vendimarrjen qeverisëse (HIS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008).

Pamjaftueshmëria e tre niveleve të aplikimit të deri tanishëm të saj, për ti dhënë zërin që meriton qytetari në çështjet e qeverisjes, duhet të na drejtojë në dy drejtime veprimi (Boonstra dhe Boelens, 2011). Së pari të vijojmë të kërkojmë mënyra dhe modele më të mira, sipas të cilave opinionin e qytetarit të jetë plotësisht i përfshirë dhe gjerësisht i konsideruar (Boonstra dhe Boelens, 2011). Dhe së dyti, të mundohemi të implementojmë ato praktika të mira europiane dhe perëndimore, edhe në vendet që nuk kanë traditë demokratike sikurse Shqipëria (Aliaj, 2008).

Aliaj, duke ju referuar raportit të *‘Zhvillimit Human’* të WB në vitin 2006, do të nënvizonte nevojën që “qytetet të vazhdojnë të demokratizojnë vendimarrjen e qeverive të tyre, në mënyrë që këto të fundit të bëhen më të përgjegjshme dhe më reaguese ndaj qytetarëve” (Aliaj, 2008: 90).

Theksi i planifikimit që përfshin dhe fuqizon qytetarin është vendosur në të gjitha dokumentet me qasje politike të planifikuesve botëror dhe europian. Kongresi për Urbanizmin e Ri në dokumentin e tyre *‘Karta e Urbanizmit të Ri’*, do të deklarohej se “Ne jemi të përkushtuar të

ristabilizojmë marrdhënien ndërmjet artit të ndërtimit dhe bërjen e komuniteteve, nëpërmjet pjesmarrjes së komuniteteve në planifikim dhe projektim” (CNW, 1996: 1).

Në të njëjtin drejtim BE, në dokumentin ‘*Urban Acquis*’, të miratuar në Ministerialin për Kohesionin Territorial, zhvilluar në Rotterdam në vitin 2004, do të theksonte si një mekanizëm për politika urbane të suksesshme duhej të konsiderohej koncepti “Lidershipi nga lart duhet të balancohet nga fuqizimi i komuniteteve nga poshtë”. Ndër të tjera dokumenti ‘*Urban Acquis*’ theksonte se “Pjesmarrja qytetare duhet të bazohet në një dialog me ekspertët për të stimuluar përkatësinë e qytetarëve në mjedisin jetësor urban”, si një mënyrë për të dëshmuar në praktikë rëndësinë e përfshirjes së qytetarit në qeverisje (EU, 2004).

Komisioni Ekonomik për Europën i Kombeve të Bashkura do ti jepte një rëndësi shumë specifike kësaj çështje, veçanërisht për vendet në tranzicion në dokumentin e saj ‘*Planifikimi hapsinor: Instrumentët kyç të zhvillimit dhe qeverisja efektive, me referencë të vecantë për vendet në tranzicion*’. Sikurse theksonte në këtë raport, ajo kërkonte nga vendet në zhvillim “të rrisin pjesmarrjen e gjerë, të përmirësojnë përfshirjen e komunitetit dhe të ndërtojnë mbështetje për politikën dhe programet e planifikimit të qëndrueshëm” (UNECE, 2008: 12).

Fuqizimi i qytetarëve mund të zhvillohet në të dyja nivelet e qeverisjes, sipas instrumenteve të planifikimit që ato hartojnë dhe miratojnë dhe në funksion me fushëveprimtarinë e tyre (UNECE, 2008). Në këtë kuptim të saj, UNECE do të udhëzonte veçanërisht vendet në zhvillim se “Pjesmarrja në procesin e planifikimit përmirësohet shumë atje ku takime bashkëpunimi sjellin sëbashku palë të ndryshme të interesuara dhe në nivele të ndryshme planifikimi (strategjik apo lokal)” (UNECE, 2008: 37).

Këtë qasje do të prezantonte edhe Bongëa kur theksonte se “Pjesmarrja mund të jetë e formave të ndryshme” (IHS alumni et al, 1998: 42). Në nivelin e qeverisjes kombëtare (qëndrore) ai mund të implementohet në formën e pjesmarrjes të grupeve të interesuara (organizatat jo qeveritare apo të sipërmarrjes, në ato sektorë që trajton instrumenti i planifikimit).

UNECE do të udhëzonte ndërsa nënvizonte se “Ajo [pjesmarrja në procesin e planifikimit] gjithashtu mund të jetë e dobishëm në nivelet strategjike, në të cilat përfshihen edhe përfaqësuesit e organizatave” (UNECE, 2008: 37).

Por, ajo ku prezanton më mirë synimin për të fuqizuar qytetarin në qeverisje është përfshirja e tij në proceset planifikuese territoriale vendore (HIS Alumni et al, 1998). Sipas tyre, në këto procese qytetari mund të kuptoj, ti preki dhe të japi opinionin e tij në mënyrë të drejtpërdrejt çështjet që e shqetësojnë atë, apo komunitetin ku ai bën pjesë. UNECE do të ndante të njëjtin

qëndrim, kur theksonte se “Ushtimi i pjesmarrjes punon më mirë në nivelin e komunitetit local ku palët e interesuara janë të qarta rreth kufizimeve dhe hapsirave të hapura për vendimmarje” (UNECE, 2008: 37).

Një rekomandim i UNECE do të ishte:

“Në statet e para të hartimit të një strategjije apo plani hapsinor, përpara se autoritetet e planifikimit të kenë vendosur për një zgjidhje të veçantë, është një avantazh përfshirja dhe angazhimi i një spektri të gjërë palësh të interesuara në diskutimin e çështjeve dhe në formulimin e propozimeve” (UNECE, 2008: 37).

Qeverisjet territoriale të viteve të tranzicionit shqiptar nuk e kanë pasur një synim politik përfshirjen e palëve të interesuara dhe qytetarëve në proceset për hartimit të strategjive kombëtare, në çështjet e nivelit kombëtar (Fuga, 2019).

Sikurse e kemi prezantuar edhe më parë, për sektorët e zhvillimit territorial në vitet e tranzicionit janë miratuar katër ligje, në periudhën 1993-2014: ligji 7693/1993 ‘*Për Urbanistikën*’ (FZ, nr. 23, 1993); ligji 8405/1998 ‘*Për Planifikimin Urban*’ (QBZ, 2010); ligji 10119/2009 ‘*Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial*’ (FZ, nr. 25, 1998); ligj nr. 107/2014 ‘*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*’ (QBZ, 2019).

Pa hyrë në analiza të thella të teksit legjislativ mund të thuhet se përshkak të detyrimeve nga institucionet e BE, konceptet e përfshirjes së palëve të interesuar dhe qytetarëve në proceset planifikuese, janë prezantuar në legjislacionin shqiptar (BB, 2007: 85-86). Ligji 7693/1993 ‘*Për Urbanistikën*’, përcaktonte një kornizë minimale të përfshirjes qytetare në proceset planifikuese. Neni 20 i tij përcaktonte se “Të interesuarit për këto materiale paraqesin vërejtjet e tyre dhe seksioni i urbanistikës bashkë me përfaqësuesit e organizatës projektuese motivon pranimin ose jo të vërejtjeve të paraqitura” (FZ, nr. 23, 1993). Kurse neni 21 i ligjit 8405/1998 ‘*Për Planifikimin Urban*’ detyronte që “Në mbledhjen e KRRT-së marrin pjesë pa të drejtë vote përfaqësuesit e pushtetit lokal të interesuar dhe përfaqësues të njësisë projektuese” (QBZ, 2010). Do të ishte ligji 10119/2009 ‘*Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial*’ që nëpërmjet nenit 37 ‘*Dëgjimi publik*’ do ti jepte qytetarit dhe palëve të interesuara një vend të veçantë (FZ, nr. 25, 1998). Në të njëjtin nivel prezantohet përfshirja qytetare edhe në nenin 24 ‘*Këshillimi dhe takimi publik*’ të ligjit nr. 107/2014 ‘*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*’ (QBZ, 2019).

Kurse praktikat qeverisëse dëshmojnë të kundërtën, sepse proceset e hartimit të planeve vendore nuk kanë qenë asnjëherë të hapura për palët e interesuara apo për qytetarët e prekur nga zhvillimet e planifikuara (HIS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008).

Referuar vlerësimeve të BB “Pjesëmarrja e popullsisë në diskutimet dhe formulimin e planeve urbane nuk ndodh shpesh, sidomos në nivel lokal” (BB, 2007: 85).

Për të kuptuar këtë, mjafton të vëzhgojmë procesin e hartimit të Planit Vendor të Përgjithshëm të Bashkisë Tiranë. Ky instrument i përgjithshëm territorial u hartuara nga studio e një arkitekti Italian në ndihmesë nga një grup specialistësh të Bashkisë, në një proces të mbyllur për palët e interesuara dhe të prekura nga zhvillimet e parashikuara në të (VP, 2016). I vetmi proces real i përfshirjes së palëve të interesuara, që ligji sektorial e njeh me termin ‘Dëgjësë Publike’ ishte një takim i vetëm i antarëve të Këshillit Bashkiak dhe një pjese të ekspertëve vendor të urbanistikës dhe arkitekturës që u përzgjedhën sipas preferencës politike. Kryetari i grupit kuvendor të Partisë Demokratike, Leonard Olli do të shprehej në këtë takim “Për fat të keq nuk kemi transparencë” (VP, 2016).

Po kështu në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për miratimin e këtij instrumenti planifikimi, Olli do të shprehej “janë shkelur dispozitat ligjore përsa i përket konsultës publike [Konsultimit Publik] për bërjen të njohur të këtij plani”, ndërsa më tej do të theksonte se edhe antarët e Këshillit Bashkiak nuk kanë pasur mundësi të njihen dhe të japin mendim për këtë instrument. Sikurse do të shprehej Olli:

“Unë do të doja ti bëja të ditur zotërisë së nderuar [kryebashkiakut] dhe gjithë opinionit publik se puna që ai me shumë përkushtim bën prej më shumë se një viti, ne na është vënë në dispozicion [për njohje] vetëm prej dy ditësh. Dhe të pretendoj nga ne që, atë që një studio ka një vit që e përpunon, në ta njohim vetëm për 48 orë besoj se është kulmi i hipokrizisë” (VP, 2016).

Në pozicion të ngjashëm ishte edhe grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim, një parti në koalicion me Partinë Socialiste që drejton Bashkinë Tiranë dhe që përfaqësohet në këtë nivel qeverisës me nënkryetaren e Bashkisë Tiranë. Kryetari i këtij grupi, Endri Brahimllari do të shprehte të njëjtin shqetësim “Në radhë të parë, përgjeshmëria jonë është me qytetarët e Tiranës, me ata që na dhanë votën, dhe kemi detyrën morale për të qenë më të qartë” (TChA, 2016).

Ndërkohë, të ftuarit e pakët që ju dha fjala për të bërë pyetje apo bërë propozime, përgjithësisht ishin të përzgjedhur më parë nga autoriteti qeverisës. Për më tepër, sikurse do të shprehej Olli, asnjë nga sugjerimet e pakta dhe të kontrolluara nga autoriteti shtetëror, nuk u konsiderua apo reflektua në produktin final të instrumentit të planifikimit (VP, 2016).

KAPITULLI VI: VLERËSIMI I REFORMAVE DHE LEGJISLACIONIT SEKTORIAL QË PRODHUAN QEVERISJET TERRITORIALE.

Në këtë kapitull do të bëjmë një vlerësim të qeverisjeve territoriale në lidhje me dinamikat e reformave dhe legjislacionin të sektorëve që kanë ndikim në zhvillimin hapsinor, territorial dhe urban të vendit. Në seksionin e parë do të vlerësojmë dinamikat e përballjes qeverisëse me fenomenin e ndërtimitarisë informale dhe formalizimin e produkteve të saj. Në seksionin e dytë do të vlerësojmë dinamikat e sistemit ligjor të planifikimit dhe zhvillimit territorial. Kurse në seksionin e tretë do të vlerësojmë dinamikat e reformave territorialo-administrative, fokusuar në nivelin e decentralizimit të funksioneve qeverisëse në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial. Të treja këto vlerësime do të bëhen mbi parimet libertariene dhe europiane dhe secila prej tyre do të mbyllet me një propozim minimalist dhe modest për rikonceprim të tyre.

6.1. Reforma e legalizimeve të ndërtimeve informale e rikoncetuar mbi parimet libertariene.

Në këtë seksion do të vlerësojmë në dinamikë reformën e legalizimeve dhe do të propozojmë disa parime për një reformë të re.

6.1.1. Qeverisja territoriale dhe ndërtimet informale.

Modeli territorial i tranzicionit u zhvillua mbështetur në dy dinamika kryesore, së pari ishte braktisja e territoreve të qarqeve veriore, verilindore, jugore dhe juglindore të Shqipërisë dhe e dyta është koncentrimi demografik i dy qarqeve kryesore të vendit Tiranë dhe Durrës (INSTAT, 2004, 2014, 2015-2020; King dhe Vullnetari, 2003; King, 2010; Vullnetari, 2007, 2010, 2012). Sipas Fugës “Qindra mijë njerëz apo edhe familje zbritën nga zonat me lartësi më të madhe drejt ultësirave” (Fuga, 2012: 9).

Kjo lëvizje masive demografike prodhoi një kërkesë të shtuar për ndërtimtari banesash dhe objekteve me funksione të tjera urbane, e cila u përgjigj në dy mënyra, së pari në mënyrë antiligjore dhe informale, dhe së dyti në mënyrën ligjore dhe formale (HIS Alumni et al, 1998; Faja, 2008; Misja dhe Misja, 2004; Aliaj, 2008, Fuga, 2004, 2012).

Rruga informale ishte mënyra më e përhapur në fillesat e tranzicionit, dhe sikurse do të theksonin Shutina dhe Slootweg “Ndërtimet e parregullta përreth Tiranës janë rezultat i

drejtpërdrejtë i presionit të madh e të vazhdueshëm të të ardhurve në Tiranë dhe i mungesës së banesave në qytet” (IHS Alumni et al, 1998: 125).

Kurse Banka Botërore do të prezantonte se “Kjo kërkesë [për banesa] në një masë të madhe u akomodua nga ndërtimtaria informale, veçanërisht në zonën qendrore të vendit” (BB, 2007: 28).

Urbanizimi i shpejtë dhe intensiv i shoqëruar nga procesi i ndërtimtarisë informale prodhoi dy risi urbane. Së pari, janë qytetet e reja të zhvilluara si pasojë e rritjes së fshatrave rreth qyteteve të mëdha të vendit (BB, 2007: 66; Fuga, 2012). Një shembull perfekt për këtë janë fshatrat rreth Tiranës dhe Durrësit, dhe fshatrat që i lidhin duke i bashkuar ato. Për këtë dukuri, Fuga do të shprehej se “Zona fshatare e dikurshme brenda dy dekadave, sidomos ajo që ndodhet në rrugët kryesore të komunikimit midis dy metropoleve të mëdha, është urbanizuar së tepërmi” (Fuga, 2012: 51).

Mbi këtë fenomen do të fliste edhe Aliaj, sipas të cilit “Kamza dhe Fushëkruja janë dhjetëfishuar, bregdeti shqiptar po përjeton një bum demografik mjaft agresiv” (Aliaj, 2008: 56).

Së dyti janë zonat e zhvillimit përgjatë akseve rrugore të rëndësishme kombëtare, sikurse do të theksonte Fuga “Rruga e madhe është një qytet me një formë të re, jo me qëndër e në formë rrethi, por i zgjatur si drejtëz. Këto rrugë janë qytetet e reja. Nuk lidhin qytetet, por formojnë qytete të reja” (Fuga, 2012: 23).

Ndërtimet informale në Shqipërinë e tranzicionit erdhën përshkak të shumë arsyeve ku më e rëndësishmja ishte paaftësia e institucioneve të shtetit të kuptonin dhe të paraprinin trendet e reja të zhvillimit (BB, 2007: 63; IHS Alumni et al, 1998).

Pas rënies së komunizmit dhe ekonomisë së planifikimit të centralizuar roli i shtetit në çështjet e zhvillimit ndërtimor kërkonte një ndryshim radikal, por burokratët e institucioneve shtetërore nuk mundën të shkëputeshin nga praktikate tyre kontrolluese dhe centralizuese (Aliaj, 2008: 96).

Në një kontekst më të përgjithshëm Dharmo, do të nënvizonte se “ndryshimet që kanë ndodhur në vend që prej 1990-ës kanë qartësuar një fakt: shteti nuk është i vetmi vendimarrës” (IHS Alumni et al, 1998: 3), ndërkohë që institucionet shtetërore vepronin sikur asgjë nuk kishte ndryshuar dhe ato vet ishin kalorësi i vetëm i ruajtjes së gjëndjes urbane të qytetit (Aliaj, 2003). Në të kundërt, ishin ata vet që ndikuan në formësimin dhe përforcimin e këtij fenomeni

shoqëror, sikurse do ta theksonte Aliaj, ndërsa prezantonte dy arsyt sipas tij që ndikuan në ndërtimtarinë informale “përshkak të paaftësisë së qeverisjeve paskomuniste për të siguruar alternativa të ligjshme ndaj qytetarëve që tashmë kanë fituar të drejtën legjitime të lëvizjes së lirë, si dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi që nënkuptojnë të drejtën për një jetë sa më normale” (Aliaj, 2008: 96).

Kjo nuk ishte arsyeja e parë e fenomenit të ndërtimtarisë informale dhe ndikoi më shumë se çdo fenomen tjetër shoqëror dhe jo vetëm në dimensionin territorial dhe urban të Shqipërisë. Arsyeja e parë, për të ndjekur arsyetimin e Aliajt, ishte “kërkesa e madhe për strehim e rënduar gjatë sistemit komunist dhe dëshira për një jetë më të mirë” (Aliaj, 2008: 96).

Sistemi komunist pas viteve 1960, i humbi aftësitë ekonomike dhe ndoqi një politikë të kontrollit të urbanizimit në shkallë të gjerë dhe nomat e ulta të banimit do të prodhonin një nevojë të shtuar në periudhën pasardhëse (Faja, 2008, Misja dhe Misja, 2004; Kotmilo dhe Kotmilo, 2017).

Mungesa e stokut të banesave do të shoqërohej me dobësimin e institucioneve shtetërore në sektorin e strehimit (Aliaj, 2008). Ai do ta përcaktonte se “rezulton se është e rëndësishme të theksohet që ndërtimet paleje për strehim lidhen sa me problemet e planifikimit dhe të menaxhimit të territorit, po aq edhe me mungesën e një politike shtetërore të qartë për strehimin” (Aliaj, 2008: 104).

Një arsye tjetër, që gjithashtu mund të konsiderohet si e trashëguar nga sistemi komunist, ishte varfëria e pjesës dërmuese të migrantëve të brendshëm që pamundësoi adresimin e kërkesës për strehim të kësaj mase të madhe në tregun legal të pasurive të patundshme (IHS Alumni et al, 1998). Sipas Slootweg “Kostua e banesave të ndërtuara nga kompanitë tregtuese të banesave janë shumë të larta për shumicën e banorëve të Tiranës” (IHS Alumni et al, 1998: 149).

Kjo i drejtoi migrantët ta siguronin këtë nevojë jashtë tregut formal të banesave (BB, 2007; Aliaj, 2008). Njerëzit e morën vet në dorë situatën e strehimit të tyre nëpërmjet “pushtimit ose blerjes informale të tokës më çmime sa më të ulta, të vetpunësimit, shmangies së procedurave burokratike (shpesh të korruptuara) të administratës” (Aliaj, 2008: 97).

Ata vijuan investimin në banesën e tyre të pa ngacmuar nga shteti duke investuar në mënyrë graduale dhe progresive, bile shpesh duke sakrifikuar edhe bukën e gojës (Fuga, 2004).

Në përfundim të këtij procesi urbanizimi të paligjshëm, në gjithë territorin e vendit vet-deklaroheshin 270 592 objekte të reja, ndërkohë që gjenden edhe të paktën 80 mijë të tjera që

nuk janë përfshirë në vetdeklaratim (BB, 2012: 11). Sipas Bankës Botërore “ndërtimet jo të ligjshme përbëjnë një të tretën e inventarit strehues gjithsej dhe kanë kushtuar afro 10 miliard euro për t’u ndërtuar” (BB, 2012: 4).

Këto objekte ishin të shpërndara në të dymbëdhjetë qarqet e vendit, ku Tirana me 95.526 objekte, Durrësi me 38.944 objekte, Fieri me 27.124 objekte dhe Elbasani me 21.556 objekte, kishin ndikimin më të madh (BB, 2007: 66-68). Sikurse do të përcaktonte Aliaj “Vlerësohet se këto objekte përfshijnë 350 mijë familje shqiptare ose gati gjysmën e popullsisë së vendit” (Aliaj, 2008: 55).

Banka Botërore që do ta trajtonte në thellësi këtë problematikë urbane do të prezantonte se “[zonat] informale gjenden në të gjithë qytetet e mëdha, si Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe në një shkallë më të vogël, Vlorë” (BB, 2007: 66).

Sipas saj vetëm në Shkodër “Rreth 5,000 familje (ose 25% të popullsisë së përgjithshme në qytet), që zënë një hapësirë prej 7 zonash dhe 150 hektarësh, kanë status informal.”; në Fier “Llogaritet se ndërtimet informale në këtë zonë mbulojnë rreth 250 ha ose 38% të zonës totale të ndërtuar.”; dhe Elbasan “Rreth 5,000 familje (ose 20% të popullsisë totale të qytetit), mbi dy zona me sipërfaqe totale 180 hektarësh” (BB, 2007: 67). Por sikurse do ta shohim në vijim të këtij punimi, këto statistika do të rriteshin me shpejtësi në vitet në vazhdim.

Një nga problemet themelore të ndërtimitarisë informale është zënia apo blerja jashtë tregut formal të tokës nga ndërtuesit informal, çfarë implikon në këtë proces edhe pronarët e trojeve mbi të cilat këto ndërtesa informale janë zhvilluar (BB, 2007; Aliaj, 2008; HIS Alumni et al, 1998). Këtë shqetësim do të ngrinte BB në viti 2012, kur do të theksonte se në Shqipëri migrimi i vrullshëm i brendshëm ka çuar në zënie informale të tokës dhe në ndërtime pa leje në masë, duke i vështirësuar kështu, më tej, probleme të lidhura me kalimin e paplotë të pronave (BB, 2012).

Slootweg, ndërsa fliste për Tiranën, do të prezantonte se “Zënia e tokës brenda dhe jashtë Tiranës është një fakt, i cili nuk duhet denigruar apo refuzuar, por mbi të gjitha, nuk mund të ribëhet. E vetmja mundësi është që ai të pranohet dhe të përpiqemi për ta rregulluar” (IHS Alumni et al, 1998: 150).

Nga ana tjetër, ndërtimtaria paleje ishte një ndihmë e madhe për gjithë shoqërinë shqiptare në disa aspekte, sikurse do ta theksonte Slootweg “Investimet e mëdha të familjeve dhe kompanive në Tiranë, së pari duhet të shihen si një faktor pozitiv. Ato sigurojnë vitalitetin

ekonomik të saj. Shteti nuk mund të siguroj banesa për qindra mijë të ardhur” (IHS Alumni et al, 1998: 149).

Gjithë kjo energji, vërtet e shprehur në një formë jo ligjore, prodhoi banesa për qindra mijë shqiptarë, dhe prodhoi gjithashtu hapsira ekonomike dhe urbane që nuk ekzistonin më parë, prodhuan qytete të reja (Fuga, 2012).

Të zhvilluara pa një planifikim të mëparshëm dhe në mungesë të investimeve infrastrukturore, sot këto qytete të reja paraqesin problematika të rënda urbane (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008; BB, 2007).

Legalizimi i vendbanimeve informale, dhe lidhja me rrjetet urbane, mbetet një nga sfidat më kryesore për Shqipërinë, për modernizimin dhe integrimin e ekonomive të saj urbane. Në raportin *‘Vlerësimi i Sektorit Urban në Shqipëri’* Banka Botërore, do ta nënvizonte se:

“(i) vendbanimet e paligjshme kanë sipërfaqe të konsiderueshme duke përfshirë deri një të katërtën e popullsisë dhe 40 % të sipërfaqes së ndërtuar të qyteteve ku ndodhen; (ii) banoret kanë vështirësi si pasojë e mungesës së shërbimeve sociale dhe infrastrukturës, (iii) janë forma hapësinore të përjashtimit shoqëror, i dëmshëm për shoqërinë dhe brezin e ri; dhe (iv) mungesa e sistemit kanalizimeve dhe kullimit rrezikon mjedisin” (BB, 2007: 65).

Fenomeni i ndërtimtarisë informale nuk ishte një fenomen me produkte që mund të injoroheshin, apo zgjidhja e tyre mund të shtyhej pafundësisht në kohë (IHS Alumni et al, 1989; Fuga, 2004, 2012; Aliaj, 2008).

6.1.2. Përpyjekjet e para për tu përballur me fenomenin e ndërtimeve informale.

Në vitet e para, kur realiteti urban i ndërtimtarisë informale u shfaq në qytetet kryesore të vendit, shoqëria dhe në këtë kuptim edhe specialistët dhe politikanët ndaheshin në dy grupe (BB, 2007, 2012).

Shumica e publikut, që ishte edhe grupi me qëndrimin realist dhe kishte mbështetjen më të gjerë nga ekspertiza kërkonte që këto ndërtesa të legalizoheshin (IHS Alumni et al, 1998). Por jo të gjithë ndanin këtë mendim, sikurse do të shprehej Dhamo, duke ju referuar qytetit të Tiranës, që ishte edhe qyteti më i impaktuar nga ky fenomen në vitet e para të tranzicionit “ende qyteti luhetet në dilemën midis përmirësimit të këtyre zonave [informale] apo të provojë të

zhvendosë numrin e madh të njerëzve të vendosur në zonët periferike [të qytetit]” (IHS Alumni et al, 1998: 29).

Si rezultat i këtij dyshimi u formësua një presion publik i shtuar ndaj autoriteteve ligjzbatuese dhe qeverisë e cila provoi disa herë të ndërhynte me forcë në zonat informale (BB, 2007: 63).

Ishte reagimi i familjeve që banonin dhe i kishin ndërtuar këto ndërtesa informale, që i penguan këto ndërhyrje të institucioneve të shtetit, sikurse do të prezantonin Shutina dhe Slootweg “kur tentativa e shtetit për të përdorur buldozerin që të prishte shtëpitë e okupuesve dështoi si rezultat të banorëve” (IHS Alumni et al, 1998: 126).

Këtë fenomen do ta prezantonte edhe Banka Botërore në vitin 2012 e cila do të nënvizonte se “Me rritjen e komuniteteve të zaptuesve, autoritetet filluan të kenë gjithnjë e më shumë kujdes të mos ndërhyjnë” dhe se “Rezistenca e armatosur në Bathore, një vendbanim informal në Tiranë, kundër përpjekjes së policisë për t’i dëbuar në vitin 1995 bëri shumë bujë, sepse zaptuesit morën peng Zëvendëskryeministrin” (BB, 2012: 6).

Të njëjtën prezantim bëri edhe BB në vitin 2007, sipas të cilës “Në mes të vitit 1997, ky bllokim krijoi tension të madh social në ndërtimet informale në periferi të zonave urbane, veçanërisht në Bathore” (BB, 2007: 65)

Më tej politika do të kuptonte se ky nuk ishte një realitet që duhej anashkaluar apo shmangur, në të kundërt legalizimi ishte edhe rruga më e logjikshme (BB, 2012: 7). Porse, sipas BB në vitin 2007 “nuk ka patur përpjekje serioze nga qeveria për të legalizuar ndërtimet informale deri në vitin 1998.” (BB, 2007: 72).

Pas këtij viti nisën inisiativat e para në formë pilotimi në zona të caktuara, ku dëmet nga ndërtimet paleje ishin më të mëdha dhe më të dukshme, përshkak të afërsisë me Kryeqytetin (BB, 2007, 2012; IHS Alumni et al, 1998). Një nga zonat me prioritet u shpall zona informale e Bathores që, sikurse do të shprehej Shutina dhe Slootweg “në vitin 1998 zona e Bathores prej 200 ha është populluar me rreth 1750 familje” (IHS Alumni et al, 1998: 126).

Që mbas vitit 1995 kjo zonë informale pranë Tiranës u indikua si një zonë e mundshme pilot për përmirësimin e infrastrukturës në kuadrin e Programit të Menaxhimit të Tokës në Tiranë. Ky program ishte shumë i rëndësishëm në ato vite, dhe sikurse do ta prezantonte Shutina dhe Slootweg “është një inisiativë e përbashkët e pushtetit qendror dhe lokal e mbështetur nga Universiteti Harvard” (IHS Alumni et al, 1998: 126).

Këtë projekt e financonte BB dhe Qeveria Qëndrore shqiptare, që kishte kuptuar se ndërhyrja nëpërmjet forcës për largimin e banorëve informal ishte e kotë dhe jo produktive. Shutina dhe Sloomweg do të prezantonin se “Për të përgatitur këtë projekt, për aprovim nga Banka Botërore, u zgjodhën dy zona pilot, një në Breglumas (zona e Laprakës) dhe një në zonën e Bathores. Kjo do të mundësonte testimin e racionalitetit të projektit” (IHS Alumni et al, 1998: 126).

Sipas vet Bankës Botërore në vitin 2007 “Projekti pati një sukses modest” (BB, 2007: 65).

Në fillim të vitit 1998 u kalua një ligj i veçantë për këto dy zona pilot në rrethin e Tiranës, thelbi i të cilit ishte kushti “për të përjashtuar këtë zonë nga rikthimi i tokës të ish-pronarët” (BB, 2007: 65).

Ligji mbi ndërtimet informale në Bathore dhe Laprakë u miratua në shtator 1998, me nr. 8398 (FZ, 1998), dhe do të sillte dënim më të madh mbi këtë proces kaq shumë të rëndësishëm, për shumë aspekte mbi pronësinë e tokës dhe zhvillimet urbane e territoriale. Ai do të vendoste standartin e përfshirjes në procesin e legalizimit edhe të procesit të shtetëzim-privatizimit të tokës mbi të cilën ishte kryer zhvillimi ndërtimor (BB, 2012: 8). Ne do ta prezantojmë më tej këtë gabim të madh që po i kushton shumë buxhetit publik dhe përfundimit të procesit të legalizimit.

Referuar BB ky ligj “jep të drejta të zënies së tokës për banorët e ndërtimeve informale në Bathore e Laprakë dhe parashikon kompensimin monetar për pronarin origjinal të tokës” (BB, 2007: 72). Ndërkohë që pjesa e Ligjit që i jep të drejtë pronarit origjinal të tokës të marrë kompensim monetar nuk u zbatua kurrë për shkak “të mungesës së fondeve në buxhetin e shtetit” (BB, 2007: 72).

Në një analizë të kryer nga BB vetëm për Bathoren, në një sipërfaqe të zhvilluar informalisht rreth 13 hektarë, do të tregonte se kontributet nga familjet nuk do të arrijnë më shumë se 1.3 milionë dollarë, ose 10 dollarë për hektarë, çfarë e bënte procesin të dështuar që në fillim, sepse pronarët legjitim të tokës nuk mund ta pranonin kursesi këtë shifër (BB, 2007: 74).

Pas këtyre përpjekje të politikës për të zgjidhur çështjen më të rëndësishme territoriale të tranzicionit nëpërmjet formave të fragmentarizuara, nisën iniciativat konkrete për ta përballur me fenomenin e informalitetit si një i tërë (BB, 2007, 2012). Sipas BB në vitin 2012 “Përpjekja e parë, nën qeverisjen e Partisë Socialiste në vitin 2004, ngriti një skemë vetëdeklarimi dhe legalizimi por pati sukses të kufizuar për shkak të burimeve dhe njohurive të pamjaftueshme në nivel të pushtetit vendor” (BB, 2012: 7).

Dinamikat e procesit të legalizimeve u konkretizua me miratimin e ligjit nr. 9209/2004, *‘Për legalizimin e shtesave në ndërtim’* i cili do të tentonte të rregullonte situatën ligjore të shtesave paleje në ndërtesat me leje (FZ, nr. 26, 2004). Gjithashtu edhe ligjin nr. 9304/2004 *‘Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale’* (FZ, nr. 90, 2004). Sipas këtij ligji, urbanizimi dhe integrimi i këtyre zonave synonte përmirësimin e jetesës së qytetarëve të këtyre zonave duke ju afruar atyre akses të njëjtë si banorët legal të territoreve të qyteteve, për hapsira të hapura, publike dhe sociale si dhe shërbime (BB, 2007: 65, 2012).

Jetëgjatësia e këtij ligji ishte e shkurtër sepse zgjedhjet e pak muajve më vonë sollën në pushtet Partinë Demokratike. Diferencat politike për mënyrët e formalizimit të ndërtesave informale, midis kahur të majtë në qeverisje dhe kahut të djathtë në opozitë, kishte të bënte vetëm me konceptin se kush proces duhej bërë më parë formalizimi i ndërtesave apo urbanizimi i zonave informale (Aliaj, 2008: 240; BB, 2007).

Për socialistët së pari duhej bërë urbanizimi i zonave dhe më tej legalizimi i ndërtesave, kurse për demokratët duhej një proces legalizimi i ndërtesave në fillim, dhe më tej edhe urbanizimi i tyre dhe integrimi i zonave në territoret urbane ekzistuese dhe formale (BB, 2007: 74). Demokratët, pas analizave të hollësishme financiare dhe juridike, vlerësonin se “dihet qartë shuma e kapitaleve që janë investuar, sa vlejné ato në treg, sa kredi mund të merren, sa taksa mund të paguhen” (Aliaj, 2008: 240), dhe në këtë kuptim besonin se opsioni legalizim pastaj urbanizim “vërtetohet shkencërisht se është më ekonomiku” (Aliaj, 2008: 241).

Proceset e urbanizimit të këtyre zonave informale kanë kosto të larta sepse mungojnë të gjitha infrastrukturën inxhinierike dhe sociale (BB, 2007), dhe ky proces duhet të financohet edhe nga banorët si taksapagues përshkak të pronësive të formalizuara më parë nga procesi i legalizimit (Aliaj, 2008: 241).

Me ardhjen e PD në qeverisje vëmendja u shtua ndaj produkteve të krijuara nga fenomeni i ndërtimitarisë informale. Tashmë, çështja e fenomenit nuk shihet si një ngjarje shoqërore e fragmentarizuar apo e përmasave të vogla, por si një çështje e cila duhet studiuar në themel, për vet përmasat gjigante dhe shumëpërfshirëse shoqërore (Alialj, 2008; BB, 2007, 2012). Në këtë kontekst Aliaj do të shprehej se:

“Rreth 6-7 nga 10 objekte të ndërtuara pas vitit 1990 në Shqipëri janë ndërtuar në mënyrë ilegale/informale. Mbi 350 mijë familje shqiptare, ose të paktën 50% të popullsisë së vendit, zotërojnë në një mënyrë apo një tjetër asete ekstraligjore, dhe

pothuajse 80% e bizneseve kanë tipare qoftë edhe të pjesshme ekstralegaliteti” (Aliaj, 2008: 230).

Ekstralegaliteti nuk është një çështje që duhet parë vetëm në kontekstin e formalizimit të ndërtesave fizike. Për më tepër ky fenomen nuk duhet trajtuar si një ngjarje e keqe, por duhet futur në rendin ligjislativ dhe formal të vendit, si një fenomen që ka sjellë të mira (De Soto, 2001). Në këtë kontekst, Aliaj do të prezantonte se “Statistikat zyrtare flasin për të aktën 270 mijë ndërtime paleje të ndërtuara deri më sot, me një vlerë të paktën 6 miliardë US\$, ekuivalente me dyfishin e kursimeve të shqiptarëve të depozituara nëpër banka” (Aliaj, 2008: 230). Sipas De Sotos dhe Aliajt, vërtet kishte ndodhur një fenomen i dëmshëm shoqëror, si në aspektin mjedisor dhe urban, porse këto ndërtesa informale ishin gjithashtu edhe një shtysë shumë e rëndësishme për ekonominë shqiptare (IHS Alumni et al, 1998; De Soto, 2001).

Sikurse do ta prezantonte De Soto:

“Do të gjallëroj biznesi dhe ekonomia do të rritet, do të eliminohet ekonomia paralele por mbi të gjitha njerëzit e këtyre zonave do të kenë mundësi të shfaqin talentet, entuziazmin dhe aftësitë e tyre të cilat deri në njohjen ligjore të pronave të tyre qëndrojnë të fjetura” (De Soto, 2001: 18).

Formalizimi i tyre, do të prodhonte një kapital të madh financiar për familjet që i zotëronin këto ndërtesa, sikurse do të prezantonet Aliaj:

“Edhe pse shumë vet i konsiderojnë këta “sipërmarrës informal” thjeshtë si “hajdutë” dhe “dhunues të ligjit”, për hir të së vërtetës duhet nënvizuar se ata nuk dëshirojnë të jetojnë jashtë ligjit. Sepse për këta njerëz, siç thotë De Soto, ekonomia e tregut dhe kapitalizmi nuk janë “llafe në erë”, por qëllime dhe objektiva për të cilat ata sfiliten çdo ditë ” (Aliaj, 2008: 231).

Mbi këtë filozofi, qeverisja territoriale e fazës së tretë draftoi dhe miratoi ligjin nr. 9482/2006 ‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’ (QBZ, 2018). Ky ligj, megjithë ndryshimet e shpeshta, do të ishte dhe mbetet shtylla mbi të cilin zhvillohet prej 14 vitesh procesi i legalizimit të ndërtesave informale.

6.1.3. Teoria e De Sotos për formalizimin dhe varianti i saj shqiptar.

Për reformën legalizuese Qeveria Shqiptare ka marrë modelin ‘De Soto’, të cilën e quajmë kështu në respekt të autorit të saj. De Soto është një ekonomist Peruan që trajtoi çështjen e vendbanimeve informale në Peru dhe prodhoi një set idesh për këtë çështje, të cilat u përqaftuan në shumë vende përfshirë edhe Shqipërinë (Gilbert, 2002; Aliaj, 2008). Ai e konsideronte ndërtimtarinë informale në Shqipëri si “ekstralegalitet, një fenomen që gërryen gjithnjë e më shumë respektin për shtetin ligjor në Shqipëri dhe përjashton nga zgjidhja e ligjshme njerëzit, sidomos ata pa përkrahje dhe në nevojë” (Aliaj, 2008: 229).

De Soto argumentonte se, janë mbi 10 trilion \$ në kapitale të vdekura, sepse ato nuk janë të formalizuara, çfarë është një shifër 40 herë më e lartë se ndihmat që ka siguruar bota që prej 1 shekulli (De Soto, 2007). Sipas tij:

“në Egjipt pasuria e grumbulluar nga të varfërit është 45 herë më e lartë se investimet e huaja direkte të të gjitha kohërave.... Në Haiti, në kombin më të varfër të Amerikës Latine, asetet totale të të varfërve janë 150 herë më të larta se të gjitha investimet e huaja qe Haiti ka marrë që nga sigurimi i pavarësisë nga Franca më 1804” (De Soto, 2007: 7).

Nëse këto kapitale legalizoheshin atherë ato mund të njiheshin nga tregu dhe poseduesit e tyre mund të kreditoheshin për biznes duke i përdorur për kolateral (De Soto, 2001, 2007). Këto zona që ishin në gjendje shumë të rëndë ekonomike paradoksisht janë të tilla se nuk janë të kapitalizuara, pra nuk janë të njohura ligjërisht prej shtetit dhe ky fakt ndikon në krijimin e formave nga më të ndryshme të thyerjes së ligjit. Ato janë pasuri që përdoren nga banorët por nuk janë pjesë e sistemit legal dhe askush nuk e di kush ka, çfarë ka dhe ku i ka; kush është përgjegjës për kryerjen e detyrimeve dhe kush është mekanizmi që do ti bëj të paguajnë për të mirat dhe shërbimet (De Soto, 2001: 18).

Teoria e De Sotos “[kishte] filluar në Amerikën Latine, por kishte fituar respekt dhe nderim në nivel global” (Aliaj, 2008: 229). Shumë autorë do ta trajtonin rëndësinë politike globale që mori teoria e De Sotos, por unë do të përmendja Gilbert i cili do të theksonte respektin e lartë që kishte BB, FMN dhe USAID për teorinë e formalizimit të De Sotos (Gilbert, 2002: 2-3). Teoria e De Sotos mori lavdërime nga udhëheqësit e botës, sikurse do të shprehej Gilbert duke cituar atë që George W. Bush do ti thoshte Sekretarit të Strehimit dhe Zhvillimit Urban Melquiades R. Martinez, sipas Gilbert:

“Ai kupton vlerat Amerikane. Ai është edukuar ti vlerësoj ato. Dhe nuk ka vlerë më të lartë Amerikane se të zotërosh diçka, të zotërosh shtëpinë tënde dhe të kesh

oportunitetin ta bësh këtë [të kesh titullin formal të pronësisë së shtëpisë tënde]” (Gilbert, 2002: 3).

Në këtë kontekst politik, teoria e De Sotos u shpërnda në shumë vende të botës, kryesisht në vendet e Amerikës Latine, të Afrikës dhe të Europës Lindore, të cilat ishin vende në zhvillim apo vende në tranzicion nga socializmi monist dhe ekonomia e planifikimit qendror drejt demokracisë liberale të ekonomisë së tregut të lirë. UNDP mbështeti organizatën e de Soto-s *‘Instituto Libertad y Democracia’* të shqyrtonte situatën në Shqipëri në vitin 2006 (BB, 2012: 7; De Soto, 2007).

Alij në vitin 2008 do të nënvizonte se ishte ai që e kishte njohur teorinë e De Sotos që në vitin 1995, dhe se sëbashku me disa kolegë dhe me ndihmën e UNDP-së ngritën një projekt të posaçëm për të ndihmuar autoritetet shqiptare në përballimin me këtë fenomen (Aliaj, 2008). Ai do të ishte një nga njerëzit që ka punuar për të sjellë në Shqipëri Hernando De Soton dhe stafin e tij të *‘Institutit për Liri dhe Demokraci’*, me synimin për të përfshirë idetë e tij në politikat e qeverisë shqiptare për legalizimin e ndërtesave informale. Në këtë kontekst Aliaj do të prezantonte “Së bashku me ta [Hernando De Soton dhe stafin e tij] dhe me ndihmën e UNDP-së arritëm të ngremë një projekt të posaçëm dhe një departament ‘think-tank’ me synimin për të asistuar autoritetet shqiptare” (Aliaj, 2008: 231).

Sipas këtij ‘think-tanku’ ajo që duhej të kuptohej nga çështja e ndërtesave informale është se një pjesë e mirë e shqiptarëve nuk mund të krijonin dot pasuri dhe mirëqënie, pasi asetet e tyre ishin jashtë sistemeve ligjore (Aliaj, 2008: 231; De Soto, 2007). Formalizimi i ndërtesave, apo njohja e tyre ligjore, do ti kthente ato automatikisht në kolateral, nëpërmjet të cilit familjet mund të përfitonin kredi për të financuar sipërmarrje private. Këto sipërmarrje private do sillnin të ardhura për këto familje, dhe në këtë kuptim familjet nuk do ishin aq të varfëra, sepse përveç zotërimit të një titulli pronësie mbi ndërtesën e legalizuar tashmë, do të zotëronin edhe një sipërmarrje (De Soto, 2001, 2007; Aliaj, 2008).

Përgjithësisht këto familje kishin migruar në këto teritore pikërisht përshkak të vështirësive ekonomike dhe sociale në vendbanimet e tyre të origjinës (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2009; Vullnetari, 2007, 2012). Ishin vështirësitë me të cilat u përballën në vitet e para të tranzicionit, veçanërisht mungesa e punësimit përshkak të mbylljes së aktiviteteve ekonomike shtetërore (Meksi, 1997, 2015; Biberaj, 2000; Fuga, 2003) që i detyroi këta njerëz të migronin drejt zonave qendrore të vendit në kërkim të një jete më të mirë (INSTAT, 2004, 2014, Vullnetari, 2007, 2012). Sigurisht, përtej punësimit ishin edhe faktorë të tjerë, që kanë lidhje me shërbimet

publike, si arsimi dhe shëndetësia, të cilat me krijimin e balancave të reja politike humbën shtrirjen e tyre nëpër zonat malore dhe veriore të vendit (BB, 2003, 2007, 2012).

Në njohje të kësaj situatë, De Soto do të nënvizonte se “Nëse këto zona do të legalizohen dhe do të bëhen pjesë e tregut, atëherë banorët e këtyre zonave do të integrohen dhe do të kapërcejnë vështirësitë ekonomike” (De Soto, 2001: 18).

Mbështetur në filozofinë e tij të “formalizimit” De Soto dhe ekspertët lokalë të ‘think-tankut’ të krijuar për këtë projekt, pasi njohën gjendjen faktike të rastin shqiptar të ndërtimtarisë informale, prodhuan një raport për qeverinë shqiptare (Aliaj, 2008; BB, 2012). Fatkeqësisht ne nuk e gjetëm një raport të tillë, që të mund të bënim një vlerësim mbi gjetjet dhe propozimet e tij për rastin shqiptar. Këtë shqetësim do ta prezantonte edhe BB, e cila në vitin 2012 do të nënvizonte se “Projektraporti nuk u publikua asnjëherë, por mund të merret me mend se konstatimet dhe rekomandimet e tij kanë qenë në përputhje me filozofinë bazë të de Soto-s për legalizimin e pronave për t’i integruar ato në ekonominë kryesore” (BB, 2012: 7).

Mbi këtë kontekst edhe ne do të tentojmë të bëjmë disa vlerësime të përcipta mbi teorinë e tij të përgjithshme. Referuar Aliajt në vitin 2008, ndërsa përpjekjet e përbashkëta me De Soton dhe stafin e tij për të projektuar një reformë për Shqipërinë vijonin, nuk munguan edhe opoenca kundështuese mbi thelbin e teorisë së tij (Aliaj, 2008: 232). Këto oponeca shkonin paralel, bile sipas Aliajt edhe të mbështetura në “arkivat e publikimeve të huaja” (Aliaj, 2008: 233) të cilat jo vetëm nuk munguan por ishin gjerësisht të prezantuara dhe të argumentuara (Payne, 2004; Gilbert, 2002).

Sipas Aliajt, i cili e pranon rolin pozitiv të opinionit oponent, këto kundështi “pa asnjë bosht ideologjik ose politik” kishin për qëllim të bllokonin një nga reformat më të rëndësishme të tranzicionit shqiptar. Ai do të theksonte se “Kjo reformë, nuk synon legjitimimin e të ‘paligjshmesh’ që sot është bërë fakt, sesa të rivendosë respektin në esencë për pronën e cënuar në të kaluarën, dhe të rigjenerojë ADN-në e ekonomisë së tregut” (Aliaj, 2008: 232).

Në fakt, ajo që ndodhi pas ndërmarrjes së kësaj reforme ishte një dështim, përderisa edhe pas 14 vitesh ky proces nuk ka përfunduar; kurse kontributi i saj shumë larg synimeve për të rivendosur respektin mbi pronën të cënuar në të kaluarën, apo për të rigjeneruar ADN-së e tregut të lirë. Sikurse do ta shohim, ajo ishte një përpjekje e “rrugës së tretë”, që sikurse do ta pranonte edhe Aliaj në vitin 2008 ishte një qasje e ndryshme edhe nga teoria e “ekonomisë së centralizuar”, edhe nga teoria e “ekonomisë klasike të tregut” (Aliaj, 2008: 233).

Me pak fjalë, dështimi i aplikimit të teorisë së De Sotos në Shqipëri, vjen së pari dhe thelbësisht përshkak të frymëzimit ideologjik etatist të saj, të “rrugës së tretë” (Aliaj, 2008: 233), ku shteti merr një rol më të madh sesa i takon. Shumë autorë të huaj prezantojnë se dështimi e ka shoqëruar implementin e teorisë së “formalizimit” në shumicën e vendeve ku është implementuar (Payne, 2004).

Megjithëse De Soto në vitin 2007 mendonte se “supozimi se kultura [shoqërore] është burimi i suksesit [të vendeve të ndryshme të botës] ... është më tepër se çnjerëzor; dhe jo bindës” (De Soto, 2007: 4), ne mendojmë se ajo është një nga arsyet që prodhuan dështimin në rastin shqiptar. Kultura të ndryshme të shoqërive të ndryshme me kuptime të ndryshme në lidhje me të drejtën e pronësisë nuk reagojnë në mënyrë të njëjtë, sikurse në çdo aspekt të tranzicionit të tyre në ekonomi të tregut të lirë (Gjura, 2015; Civici, 2013).

Për rëndësinë e diferencave të aspektit kulturor të shoqërive të ndryshme është shprehur edhe Aliaj në vitin 2008, kur prezantonte llojet e ndryshme të kapitalizmit nëpër botë (Aliaj, 2008: 41-44) dhe lloje të ndryshme të tranzicioneve drejt kapitalizmit (Aliaj, 2008: 40-41).

Në këtë kuptim, nuk mund të pritej që shoqëria shqiptare të reagoje njësoj si shoqëria Peruane, ku De Soto e kishte formuluar këtë teori (Aliaj, 2008: 229), apo si shoqëritë e vendeve të Afrikës dhe vendeve të Europës lindore, ku Institucione Ndërkombëtare, e pilotuan atë (Payne, 2004; Gilbert, 2002). Akoma më pak nuk mund të pritej, që shoqëria shqiptare e fillim mijëvjeçarit të tretë, të reagoje njësoj si shoqëria Amerikane e shekullit të 17-të, nga ku De Soto e kishte origjinalizuar këtë teori (De Soto, 2001; 2007: 111-162). Për këtë ai do të shprehej se:

“Për të kuptuar arsyen e kësaj gjendje, duhet parë historia e shekullit të XIX, kur Shtetet e Bashkuara patën trashëguar nga Britania jo vetëm lidhin shumë të ndërlikuar të tokës, por edhe një sistem të gjerë bllokues të granteve për tokën” (De Soto, 2000: 16).

Për më tepër, në rastin e ShBA, krijimi i legjislacionit që çuan në formalizim, ishte një proces që zgjati për dekada, dhe nuk ishte vetëm me dimension politik por edhe me dimension juridik, sepse u krijua edhe nga praktikatat dhe vendimet e sistemit të drejtësisë. Sikurse vet De Soto do të theksonte se, “Në fund të shekullit të 19-të, politikanët dhe gjykatësit amerikanë kishin mbëritur, pas një kohe të gjatë, në një zonë me ligje prone-dhe ishin pikërisht zaptuesit ata që i kishin drejtuar deri atje” (De Soto, 2007: 158), kurse në rastin shqiptar ai kërkohej të realizohej nëpërmjet vendimarrjes politike, brenda natës.

Arsyeja tjetër pse teoria e De Sotos nuk mund të funksiononte është e sferës së financave. Aliaj do të theksonte se “Mjafton të shikosh ndërtimet pa leje në periferi të qyteteve tona. Volumi i këtyre aseteve është i jashtëzakonshëm, por shumica e tyre është praktikisht ‘kapital i vdekur’” (Aliaj, 2008: 197-198). Këtë “kapital të vdekur” Aliaj e shikonte si përgjigje të pyetjes, ku mund të gjenden kapitale për të financuar zhvillimin në vendet në zhvillim (Aliaj, 2008). Ai do të theksonte se “Sipas De Sotos, ishte pikërisht procesi i formalizimit që krijoi mundësinë për të krijuar kapital, duke zëvendësuar karakterin statik të pronës së sigurtë të mbrojtur nga ndryshimet e shpejta, me aspektin dinamik të pronësisë në funksion të rritjes ekonomike” (Aliaj, 2008: 201).

Megjithëse kanë kaluar më shumë se 14 vjet ne nuk mund ta masim empirikisht këtë teori të përdorimit të ndërtesës së legalizuar si kolateral për kreditim, por në dimensionin teorik mundemi. Sikurse e ka shpjeguar gjerësisht dhe shterueshëm Friedman, një nga mekanizmat më të rëndësishëm të tregut të lirë, është “mekanizmi i çmimit” që ndryshon në funksion të raportit ofertë-kërkesë (Friedman, 2005).

Adam Smith, gjithashtu do të fliste për këtë mekanizëm, të cilin e konsideronte “dora e padukshme” në tregun e lirë (Smith, 2005). Në këtë kontekst, bankat e nivelit të dytë, pas rritjes së kërkesës për kredi hipotekore, nuk do të kishin të njëjtën sjellje ndaj kreditimit, nëse në treg hynin si kolateral potencial menjëherë edhe 270-400 mijë ndërtesa të reja. Mbi këtë bazë u ngrit filozofia desotojane e ringjalljes së “kapitaleve të vdekura” (De Soto, 2001, 2007; Aliaj, 2008; Gilbert, 2002; Payne, 2004), mbi të cilën u formësua kjo reformë shqiptare.

6.1.4. Qasjet etatiste të qeverisjeve territoriale në lidhje me legalizimin.

Qeverisjet territoriale e kanë trajtuar nga qasje të forta etatiste problemin e legalizimit të ndërtesave dhe zonave informale. Kjo dallohet në ndërhyrjet arbitrare dhe nëpërmjet forcës policore, për prishjen e këtyre ndërtesave informale në fazën e parë të qeverisjes territoriale megjithëse ato e kishin kaluar një masë kritike kur mund të ndërhyej me forcë (IHS Alumni et al, 1998: BB, 2012). Ndërhyrja nëpërmjet forcës policore do të kishte kuptim në filesat e këtij procesi, jo në kohën kur komuniteti i banorëve në zonat informale kishte kaluar në disa mijë banorë (BB, 2007: 65).

Sikurse tentuam të argumentojmë më parë në këtë punim, janë qeveritë etatiste që prezantojnë ndërhyrje të tilla “për të vendosur rregull” nëpërmjet forcës së shtetit, ndërkohë që qeverisjet duhet të paraprijnë zhvillimet ndërtimore me instrumenta planifikimi të dakortësuara dhe të

miratuara më parë nga aktorët privatë të zhvillimit. Ne e argumentuam këtë me qasjen e Spencer mbi bashkëpunimin e njerëzve, ku ndër të tjera, ai prezanton “Një lloj tjetër bashkëpunimi, për të cilin të gjithë njerëzit janë të interesuar, është përdorimi i territorit ku banojnë” (Spencer, 2005: 78).

Mises gjithashtu e prezanton konceptin “aparati shoqëror i detyrimit dhe shtypjes”, në kufinj të ku dhuna qeveritare të mos ndrydh lirinë e zgjedhjes së individit brenda cakut të vendosur nga ligji prakseologjik (Mises, 2005: 200-201).

Qeveria e fazës së parë (1992-1997) dështoi të formësojë instrumenta planifikimi dhe lejoi zhvillimin informal për një kohë të gjatë përpara se të ndërhynte forcërisht (BB, 2007, 2012; IHS Alumni et al, 1998). Pas dështimit me ndërhyrjen e dhunshme, qeverisja territoriale tentoi të ndërhynte nëpërmjet dy karakteristikave të tjera të “shtetit të madh” majtist, sikurse janë hiper-legjislacioni dhe centralizimi (Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Megjithëse kemi të bëjmë me një çështje vendore urbane qeveria qendrore vendos të zgjerojë administratën e vet, si një nga tre elementët e konceptit spencerian të “hiper-legjislacionit” që është hiper-administrata. Shutina dhe Sloodweg, ndërsa prezantonin projektin e *‘Menaxhimit të Tokës Urbane’* në dy zona pilote në vitin 1995, do të na njihte me faktin se “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ka ngritur Njësinë e Kordinimit të Projektit që është përgjegjësi kryesor për zbatimin e projektit dhe komunikimin me Bankën Botërore” (IHS Alumni et al, 1998: 127).

Me një veprim, qeveria e fazës së parë, mban të centralizuar veprimtarinë qeverisëse dhe zgjeron fushëveprimtarinë dhe administratën e saj. Si shoqëruese e hiper-administratës vjen, si gjithmonë, kostot në buxhetin publik për tu zbatuar ky projekt, sepse “Qeveria shqiptare do të marrë borxh nga Banka Botërore një shumë prej 10 milion US \$ nga kosto totale e projektit prej 16 milion US\$” (IHS Alumni et al, 1998: 126). E njëjta qasje etatiste e qeverisjes qendrore, shprehet edhe te njësitë e qeverisjes vendore, të cilat të detyruara nga ky projekt “do të krijojnë Grupin e Menaxhimit të Projektit. Ky grup do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës” (IHS Alumni et al, 1998: 127).

Por dimensionin më i fortë etatist që do të sillte dëm më të madh mbi këtë proces kaq shumë të rëndësishëm, për shumë aspekte mbi pronësinë e tokës dhe zhvillimet urbane e territoriale ishin përcaktimet në ligjin nr. 8398/1998 “për të përjashtuar këtë zonë nga rikthimi i tokës të ish-pronarët” (BB, 2007: 65). Referuar BB ky ligj “jep të drejta të zënies së tokës për banorët e ndërtimeve informale në Bathore e Laprakë dhe parashikon kompensimin monetar për pronarin origjinal të tokës” (BB, 2007: 72).

Mbështetur mbi këtë filozofi etatiste do të vepronin edhe në vijim qeveritë shqiptare të tranzicionit ndërsa tentuan ti japin zgjidhje ligjore kësaj problematike. Inisiativa e parë domethënëse i përket fazës së dytë të qeverisjes territoriale, e cila hartoi dhe miratoi ligjin nr. 9304/2004 (FZ, nr. 26, 2004), kurse iniciativa e dytë i përket fazës së tretë të qeverisjes territoriale, nëpërmjet ligjit nr. 9482/2006 (FZ, nr. 36, 2006).

Ligji i parë (nr. 9304/2004) nuk do të kishte produkte në realitet përshkak të rotacionit në qeverisje, dhe sikurse e kemi prezantuar më parë, qeveria e re kishte dallime të qarta nga ajo që u largua për çështjen e legalizimeve (Aliaj, 2008; BB, 2007, 2012). Këto diferenca u inkorporuan në ligjin e dytë (nr. 9482/2006) dhe kishin në bënin me faktin që duhej kryer njëherë legalizimi dhe pastaj urbanizimim (Aliaj, 2008; BB, 2007), dhe “Çmimi për metër katror [që duhet të paguajë ndërtuesi informal për truallin] është zvogëluar shumë në krahasim me ligjin e mëparshëm.” (BB, 2007: 74).

Diferenca e dytë do të riste kostot në buxhetin e shtetit për procesin e shpronësimit të pronarit legjitim, proces ky që ju bashkëngjiti atij të legalizimit të ndërtesës informale. Kjo do të shtonte masën etatiste të qasjes së qeverisë së fazës së tretë në zgjidhjen e këtij problemi, apo e thënë ndryshe do ta bënte qeverisjen e PD-së akoma më majtiste se qeveria pararendëse e PS-së. Për më tepër, çfarë do ti zvogëlonte shumë mundësitë që në të ardhmen kjo qasje të ndryshonte, referuar BB në vitin 2012 “Ky ligj ngre edhe një mekanizëm për kalimin të kërkuar të pronësisë mbi tokën ku është ndërtuar objekti i legalizuar dhe përfshin një të drejtë kompensimi për ish-pronarin si edhe një formulë për llogaritjen e kompensimit” (BB, 2012: 7-8).

Këtu do të niste vijueshmërisë në pafundësi e kësaj reforme, dhe kalvari i pronarëve legjitim të tokës për tu dëmshpërblyer për tokën e shtetëzuar përshkak “të mungesës së fondeve në buxhetin e shtetit” (BB, 2007: 72). Që do të thotë se, pronarët legjitim mund të mos kompensohen kurrë për pronën që ju është shtetëzuar. Në këtë kontekst, referuar BB e cila perifrazonte një antare e Gjykatës Kushtetuese “Ekziston rreziku që moskompensimi i pronarëve të shpronësuar të bëjë që vendimet e shpronësimeve të shpallen si jo të vlefshme” (BB, 2012: 10).

Këto dy dimensionet etatiste do të përforcoheshin progresivisht përgjatë viteve kur ligji nr. 9482/2006 ju bënë disa ndryshime të cilat synin politikisht të lehtësonin dhe përshpejtonin procesin e legalizimeve. Disa nga të cilat ishin; ligji nr. 9786/2007 (FZ, nr.103, fq. 2981, 2007); ligj nr. 9895/2008 (FZ, nr.102, fq. 4475, 2008); ligj nr.10 099/2009 (FZ, nr.43, fq. 2187, 2009);

ligj nr. 10 169/2009 (FZ, nr.152, fq. 6871, 2009); ligj nr.10 219/2010 (FZ, nr.15, fq. 479, 2010); ligj nr. 141/ 2013; ligj nr. 50/ 2014; ligj nr. 62/ 2015 (QBZ, 2018).

E njëjta qasje qeverisëse për ndryshime të vazhdueshme preku edhe VKM Nr. 289, datë 17.5.2006 *‘Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të zonave/ndërtimeve informale (ALUIZNI)’* (FZ nr.53, fq. 1529, 2006), nëpërmjet VKM nr.678/2006 (FZ nr.113, fq. 4439, 2006); VKM nr.1147/2008 (FZ nr.135, fq. 6021, 2008); VKM nr.1147/2008; VKM nr. 450/2012; VKM nr. 338/2013; VKM nr. 955/2013; VKM nr. 485/2014; VKM nr. 451/2015; VKM nr.130/2016 (QBZ, 2015). Janë këto ndryshime, të cilat u shtrinë në fazën e tretë dhe të katërt të qeverisjes territoriale, që do të ngulisin dimensionin etatist në trajtimin e kësaj çështje bazike.

Qasjen e fortë etatiste do ta pranonte edhe Aliaj, si një nga ideatorët e kësaj reforme të fazës së tretë qeverisëse, i cili e konsideronte si një nga përpjekjet më serioze, “për të ravijëzuar të ashtuquajturën ‘rruga e tretë’ në politikat e zhvillimit dhe progresit ekonomik” (Aliaj, 2008: 233).

Kjo teori ka në bazë dy elemente thelbësore që origjinalizojnë nga frymëzimi etatist i liberalëve modern, dhe janë hiper-legjislacioni i shoqëruar në mënyrë të pashmangshme nga hiper-administrata dhe kosto të larta në buxhetin publik (Spencer, 2005), dhe zvogëlimi i lirive ekonomike të qytetarëve që me vullnet të lirë të negociojnë një marrveshje private mes tyre (Friedman 2005). Mbi këtë implementim në legjislacion dhe praktika e tij shoqëruese, procesi i legalizimeve të ndërtimeve paleje është tejzgjatur përtej çdo limiti logjik, nga nevoja e kastës politike për vota, e cuar çështjen në dimensionin populist (Çili, 2013: 35, 44, 45, 49, 56).

Të dyja palët e përdorën për të përfituar elektoralisht, duke e zvarritur në kohë (Aliaj, 2008). Sikurse do ta parashikonte ai:

“Trysnia në rritje nga poshtë përshkak të premtimeve politike” ishte arsyeja bazike dhe vendimtare, që “i kanë detyruar autoritetet politikbërëse dhe vendimmarrëse, që ti futen një gare të paparë premtimesh për legalizime pa kushte, pa pasur një strategji të qartë, ç’ka mund të degjenerojë në një proces masiv spekulimi” (Aliaj, 2008: 98).

Ndryshimet e shumta ligjore zgjerojnë fushën e veprimit të ligjit: duke e shtrirë zbatimin e tij në kohë, çfarë përfshinte më shumë ndërtesa informale; ulur kostot për familjet përfituese në dëm të publikut dhe taksapaguesve; dhe duke përfshirë edhe tipologji të ndërtimeve paleje që ishin përjashtuar nga ligji pararendës (BB, 2007; 2012). Në këtë kontekst BB do të nënvizonte se “Në Shqipëri, pavarësisht përpjekjeve të shumta nga qeveritë e mëparshme dhe ajo aktuale,

ecuria e procesit të legalizimit dhe integritit të zonave informale ka qënë i ngadaltë.” (BB, 2007: 76).

Këto zvarritje të zbatimit dhe ndryshime të shumta të ligjit sollën që numri i ndërtesave informale të rritet në këto vite në mënyrë të ndjeshme (Aliaj, 2008: 236).

Referuar këtij fenomeni BB do të nënvizonte se “një sërë zyrtarësh treguan një rritje të ndjeshme të ndërtimeve të paligjshme, pasi personat shpresonin për legalizimin e mundshëm të tyre sipas ligjit.” (BB, 2007: 72). Të njëjtën perspektivë, do të jepte edhe në vitin 2012, ku duke ju referuar një interviste të bërë prej saj në shtator të vitit 2009, do të prezantonin se:

“Zoti Shaban Memia, Drejtori i ALUIZNI-t, çmon se numri i ndërtesave të paligjshme është më afër shifrës 400.000 se 350.000, e cila është shifra e nxjerrë nga fotografitë ajrore dhe e cila ndodhet në bazën e të dhënave të ALUIZNI-t.” (BB, 2012: 4).

Shifrat e ndërtesave informale duhet të jenë ritur në të njëjtën dinamikë edhe në dekadën 2010-2020. Ndërkohë shteti ka harxhuar dhjetëra milion euro nga paratë publike për mbajtjen e ALUIZNI-t, për të financuar aktivitetin e kësaj agjensie, si dhe për kostot për shtetëzim dhe riprivatizim të tokës që këto ndërtesa kanë zënë (Çili, 2013; BB, 2007).

Dështimin e kësaj reforme si pasojë e qasjes etatiste dhe përdorjes politike të saj nga partitë qeverisëse do ta pranonte edhe Aliaj, kur nënvizonte se:

“Trysnia në rritje nga poshtë përshak të premtimeve politike dhe përkeqësimit në rritje të kushteve të jetesës, i kanë detyruar autoritetet politikbërëse dhe vendimmarrëse, që ti hyjnë një gare të paparë premtimesh për “legalizim pa kushte” pa pasur një strategji të qartë...” (Aliaj, 2008: 98).

Aliaj do të shpjegonte shumë qartë dinamikat e trajtimit në interesin politik të partive qeverisëse të të dyja polet politike.

6.1.5. Një propozimi nga qasje libertariane për procesin e formalizimit të ndërtimeve informale.

Qasja etatiste e qeverive shqiptare në procesin ligjor dhe praktikat e legalizimeve e kanë ekspozuar atë si një reformë që dëmton barazinë ligjore të shtetasve. Kjo qasje qeverisëse bie në kundërshtim në tre drejtime kryesore me pikën 1 të nenit 18 të Kushtetutës që detyron “Të gjithë qytetarët janë të barabartë përpara ligjit” (FZ, nr. 28, 1998).

Së pari në lidhje me kufizimin e të drejtës së përfitimit nga prona, për pronarët e trojeve në të cilat këto ndërtime informale janë zhvilluar. Mbi 35 % të ndërtesave informale janë zhvilluar në pronësi private të të tretërve, dhe kjo shifër mund të jetë edhe më e lartë po të kemi parasysh se rreth 12% e pronarëve të ndërtesave informale nuk e deklarorin se kujt i përkiste pronësinë mbi tokën (BB, 2012: 4).

Ata jo vetëm që po shpronësohen të detyruar me ligj dhe nuk po kompensohen për pronën e shtetëzuar (BB, 2007, 2012; Aliaj, 2008; Fuga, 2012), por edhe po privohen nga përfitimi i mundshëm në rast të një rrizhvillimi të këtyre pronësive në të ardhmen.

Kjo barrë që i vendoset këtyre shtetasve është një shkelje e qartë e të drejtave Kushtetuese të tyre, sepse bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 41 të Kushtetutës e cila detyron që e drejta e pronës private të jetë e garantuar nga shteti. Por, edhe me pikën 3 të nenit 41 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e pronës private dhe thotë se “Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë” (FZ, nr. 28, 1998).

Në kushtet e kësaj reforme, shpronësimi nuk po kryhet për një interes publik, por për interesa të individëve, siç janë subjektet kërkuese të legalizimit. Pronarët legjitim gjenden në një situatë jo të barabartë me qytetarët që kanë privatizuar nga shteti pronën e tyre. Në këtë kontekst Fuga do të shprehej se:

“Më keq akoma, titujt e pronësisë mbi to [trojet] i zotërojnë shpesh qytetarë të tjerë, të cilëve, pasi jeta ju është imponuar me forcë dhe dhunë, shohin nga larg sesi e gëzojnë të tjerët tokën e tyre apo dëgjojnë gjatë fushatave elektorale se si liderët bëhen xhumertë duke falur, dhuruar, blatur, jashtë dhe përtej ligjit, për nevoja elektorale prona që i takojnë tjetër kujt” (Fuga, 2012: 158).

Një shkelje tjetër ndaj barazisë së shtetasve, dhe në këtë kuptim të pikës 1 të nenit 18 të Kushtetutës, ka lidhje me diferencën midis kostosh reale të legalizimit me koston që përballon familja përfituese. Sikurse e prezantuam më parë nëpërmjet konstatimit të Bankës Botërore në vitin 2007, për projektin e Bathores kontributi i ndërtuesve informal shkonte deri në 10 dollarë për hektarë, çfarë është një përqindje shumë e ulët ndaj vlerës reale të tokës (BB, 2007: 74).

Këtë do ta dallonte edhe Banka Botërore në vitin 2012, e cila do të prezantonte se “Kjo është larg shumës së nevojshme për të kompensuar pronarët e shpronësuar, çka do të thotë se përqindja më e madhe e kompensimit duhet të dalë nga burimet e buxhetit të shtetit” (BB, 2012: 9).

I gjithë ky proces shpronësim-privatizim shtesë, rëndon në xhepat e taksapaguesit shqiptar, sepse ligji sektorial sipas nenit 15/1 pika 3 kërkon që shtetëzimi i tokës private nga shteti të bëhet me vlerë referuar tregut të lirë, dhe kryhet në përputhje me ligjin nr. 10239/2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të ndryshuar.” dhe nenit 32 të ligjit nr. 9482/2006 *‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’*, ndërsa privatizimi i truallit të bëhet me vlerë të reduktuar sipas neni 17 të të njëtit ligj (FZ, nr. 36, 2006). Këtë diferencë duhet ta paguajnë pjesa tjetër e shqiptarëve që nuk kanë lidhje me këtë event shoqëror, taksa paguesit shqiptar. Çdo taksapagues shqiptar është i detyruar të paguajë që një pronë ti shpronësohet një individ privat nga shteti dhe ti privatizohet një individ tjetër privat.

Pabarazia e shtetasve përpara ligjit që detyron ligji sektorial për legalizimet ka lidhje edhe me faktin se futja në tregun e lirë, pas formalizimit të sforcuar dhe të pabarabartë, e këtyre pronësive ndërtimore, qoftë në tregun bankar për kredi edhe në tregun e pasurive të paluajtshme për shitblerje/qira apo të drejta zhvillimi, do dëmtonin pasuritë e tjera të të njëjtit treg por që janë krijuar duke zbatuar rregullat morale dhe ligjore të shoqërisë. Barazia në tregje është një karakteristikë bazike e individëve në shoqëritë e demokracive liberale (Smith, 2005; Friedman, 2005).

Përtej argumentave kritik ndaj reformës së qeverisë territoriale, procesi i formalizimit të ndërtimeve informale është jetik për shumë dimensionë të zhvillimit shoqëror dhe kombëtar (Aliaj, 2008). Në këtë kuptim, formalizimi duhet të vijojë i përshpejtuar deri në përmbylljen e tij, në një kohë sa më të shpejtë. Sipas Aliajt “Në rast të kundërt, legalizimi dhe informaliteti s’do të pushojnë kurrë dhe ky proces rrezikon të kthehet në bumerang politik, social dhe ligjor për promovuesit” (Aliaj, 2008: 236). Për më tepër, ekstralegaliteti është “një fenomen që gërryen gjithmon e më shumë respektin për shtetin ligjor në Shqipëri dhe përjashton nga zgjidhjet e ligjshme njerëzit” (Aliaj, 2008: 229).

Për këtë arsye dhe për ta futur në kornizë Kushtetuese, ku qytetarët janë të lirë dhe të barabartë, ajo duhet rikonceptuar mbështetur në parimet libertariene të: zvogëlimit të rolit të shtetit në procesin e legalizimit; decentralizimit të procedurave administrative për legalizim drejt pushtetit vendor; dhe veçanërisht duhe hapur procesin për fuqizimin e individëve dhe marrvëshjeve vullnetare të tyre jashtë detyrimeve shtrëguese të shtetit (Smith, 2005; Locke, 2005; Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Qeveritë shqiptare të shekullit të 21-të janë sjellë si pronare të “epërme” të tokës, si monarki absolute ku “çdo pronar toke, në bazë të ligjit [monarkik] është qiramërrës ndaj Kurrorës” (Spencer, 2005: 79), apo si shteti i socializmit stalinist shqiptar të viteve 1945-1978 që kishte pronësinë e plotë mbi tokën (PL, 1979; Biberaj, 2000; Lami, 2013; Fuga, 2003, 2004).

Ato janë prezantuar si qeverisje paternaliste, “ku qeveria është padroni dhe qytetari është vartësi” (Friedman, 2005: 1). Ato nuk kanë pranuar konceptin bazik të demokarcisë ku “Çdo njëri [qytetar] ka të njëjtën të drejtë për liri” (Friedman, 2005: 218), dhe nuk morrën rolin e “arbitrit” që vendos rregulla dhe lejon lojtarët të luajnë në tregun e pasurive të paluajshme me vullnet të lirë, duke u siguruar që askush të mos shkel rregullat e vendosura më parë, të njohura dhe të pranura nga të gjithë (Friedman, 2005: 28-29).

Në një shoqëri të lirë, “Roli i qeverisë është thjeshtë të bëjë diçka që tregu nuk mund ta bëjë për vetveten, domethënë të përcaktojë, të arbitrojë dhe të imponojë rregullat e lojës” (Friedman, 2005: 31) duke lënë “dorën e padukshme” të tregut të lirë të bëjë punën e saj (Smith, 2005), dhe të sigurohet që “individët të jenë efektivisht të lirë të hyjnë ose jo në një shkëmbim të veçantë, në mënyrë që çdo transaksion të jetë krejtësisht vullnetar” (Friedman, 2005: 16).

Në të kundërt, sikurse Spencer do të theksonte “Teksa shteti bën ato gjëra që nuk duhet ti bënte, si rrjedhojë e pashmangshme lë pa bërë ato që duhet ti bënte” (Spencer, 1882:143).

Zgjidhja e drejtë dhe e moralshme përfshin në proces vetëm palët e prekura nga ky zhvillim informal, pra familjen zhvilluese informale dhe familjen pronare të tokës së zënë nga zhvillimi ndërtimor, të cilat jo vetëm duhet të përballojnë kostot por edhe të ndajnë përfitimin nga ky zhvillim informal. Nga ky veprim e gjithë shoqëria shqiptare përfiton uljen e kostove publike për këtë proces formalizimi nëpërmjet financimit të buxhetit të shtetit për transaksion mes dy privatëve.

Si një hap i parë, ky veprim do të sillte përjashtimin nga ky proces të publikut të gjerë taksapagues që nuk kanë lidhje me këtë zhvillim dhe nuk ka arsye të mbajnë kosto buxhetore, nëpërmjet taksave.

Si një hap i dytë duhet ndryshuar qasje ndaj marrdhënies midis pronarit të truallit dhe pronarit të ndërtesës, që ligji i vendos në një marrdhënie anti- Kushtetuese pabarazie. Referuar dispozitave ligjore aktuale, pronarët e tokës detyrohen t’ia shesin këtë tokë shtetit, dhe të heqin dorë menjëherë e përfundimisht nga përfitimet që mund të kenë në të ardhmen prej saj. Më tej këtë pronësi e fiton pronari i ndërtesës pas privatizimit nga shteti, duke fituar menjëherë dhe përgjithmon të drejtat e zhvillimit të kësaj pronësie.

Mbi këtë kontekst, mekanizmat ligjorë duhet të sigurojnë që pronari i tokës dhe pronari i ndërtesës të kenë si kosto edhe përfitime nga zhvillimi ndërtimor në të ardhmen, ose të kryejnë transaksione për shit-blerje mes njëri-tjetrit sipas mekanizmave të tregut të lirë.

Smith do ta prezantonte shumë qartë konceptin e tij mbi përparësinë morale dhe praktike të marrveshjes me vullnet të lirë mes palëve në një shkëmbim mbi bazë të “dobisë praktike” të “vet-interesit” dhe jo të “mirëbërësisë” (Smith, 2005). Ai do të nënvizonte se “Ne nuk mund të presim që tryeza jonë të shtrohet në sajë të mirëbërësisë së kasapit, të prodhuesit të birrës apo të bukëpjekësit, por nga kujdesi që ata tregojnë për interesin e tyre personal” (Smith, 2005: 13). Ky është rasti, kur palët janë shumë të interesuara të gjejnë një dakortësi mes “kujdesit për interesin e tyre personal” nga e cila përfitojnë të dyja palët.

Skema e zgjidhjes së propozuar është shumë e thjeshtë dhe e mbështetur në tre parime bazike libertariane: zvogëlim i rolit dhe madhësisë së qeverisë; decentralizimi i funksioneve qeverisëse; dhe rritja e lirisë së individëve për të kryer transaksione private mes njëri-tjetrit.

Ajo mbështetet në tre shtylla kryesore: së pari, legalizim i ndërtesës, njohja formale që ky volum ndërtimor ekziston dhe i njihet si pronë ndërtuesit apo ndërtuesve informal; së dyti, kthimi te pronari legjitim i tokës mbi të cilin është bërë ndërtimi informal, duke e lejuar atë të përfitoj nga shitblerja e saj apo nga rrizhvillimi i saj në një moment të dytë; dhe së treti, lënia e mekanizmave të moralshëm të tregut të lirë të veprojnë duke rregulluar marrdhëniet e pronësisë midis dy pronarëve.

Këto tre shtylla do të përshpejtonin procesin e legalizimeve, do ta bënin atë më të drejtë dhe do të zvogëlonin kostot ndaj taksapaguesit publik si për institucione qeverisëse edhe për financim publik. Decentralizimi drejt pushtetit vendor, i cili është një parim tjetër libertarian, i funksionit qeverisës të legalizimit, integritit dhe urbanizimit të ndërtesave dhe zonave informale, është një mënyrë tjetër për ta përshpejtuar formalizimin e ndërtesave paleje.

6.2. Reforma e sistemit të planifikimit të territorit sipas parimeve libertariane.

Në këtë seksion do të vlerësojmë në dinamikë reformën e sistemit ligjor të planifikimit territorial dhe do të propozojmë disa parime për një reformë të re.

6.2.1. Legjislacioni shqiptar i planifikimit të territorit në tre fazat e para të qeverisjes territoriale, dhe nevoja për një reformim të thellë.

Zhvillimi territorial dhe urban është një nga sektorët më të rëndësishëm të zhvillimit dhe të qeverisjes së një vendi (Fuga, 2012; Thompson, 2007; UNECE, 2008). Pasja e një legjislacioni modern që e rregullon këtë sektor është bazik për një qeverisje të mirë (Aliaj, 2008; BB, 2007). Kjo bëhet akoma më e domosdoshme për vendet në tranzicion (UNECE, 2008) sikurse është Shqipëria.

Një nga politikat e rëndësishme urbane të fazës së parë të qeverisjes territoriale, 1992-1997, ishte miratimi i ligjit nr.7693/1993 ‘*Për urbanistikën*’ (FZ, Nr. 3, 1993). Ky ligj pranonte dhe inkorporonte konceptet e reja të pronësisë private mbi tokën dhe ndërtesën edhe në proceset e zhvillimeve territoriale dhe urbane. Vlera e këtij ligji qëndronte te hapja e tregut edhe për sektorin privat, si në pronësinë mbi tokën edhe në proceset projektuese dhe zhvilluese ndërtimore (IHS Alumni et al, 1998; Misja dhe Misja, 2004).

Ky ligj, duke vetpërfaqësuar një nga karakteristikat më të këqia të qeverisjes (hiper-legjislacionin), u ndryshua me Dekretin nr. 772/1994, ligjin nr. 8015/1995 dhe ligjin nr. 8249/1997 (FZ, 1994, 1995, 1997; IHS Alumni et al, 1998: 24).

Domosdoshmëria për një reformë liberale dhe moderne në sistemin legjislativ të planifikimit dhe zhvillimit territorial ka qënë prezente përgjatë gjithë viteve të tranzicionit, por megjithëse janë bërë disa herë përpjekje, ato nuk kanë suksesuar (BB, 2007; Aliaj, 2008; IHS Alumni et al, 1998). Sipas Aliaj kjo reformë është e detyrueshme edhe sepse “Duke filluar që nga burimet njerëzore, niveli i burimeve në dispozicion të planifikimit urban dhe më tej zbatimit, është i kufizuar” (Aliaj, 2003: 98).

Në vlerësim të procesit për hartimin e ligjit të vitit 1998, Dharmo do të theksonte se “Rishikimi i ligjit të urbanistikës, i cili është në proces e sipër, nuk premtan për ndryshime konceptuale të kërkuara” (IHS Alumni et al, 1998: 30).

Dharmo do të përcaktonte disa nga rekomandimet e tij për një reformë të re në këtë sektor, si: përcaktimin e qartë të instrumentave të planifikimit sipas niveleve qeverisëse, si dhe autoritetin përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e secilit prej tyre; përmirësimin nga ana përmbajtësore të instrumentave të planifikimit; futjen e llojeve të reja të planeve, të cilat duhet të jenë më fleksibël; kombinimin e formave ekzistuese të planifikimit me të reja të orientuara nga zhvillimi; futjen e konceptit të pjesmarrjes publike në proceset e planifikimit; si dhe ndërmarrjen e një procesi decentralizimi (IHS Alumni et al, 1998: 30-31).

Misja do të kundështonte hiper-legjislacionin dhe burokracinë që pengonte zhvillimin, sepse sipas saj:

“Nëse konsiderojmë të gjitha hapat që një investitor duhet të ndjekë që nga blerja e tokës deri në zhvillimin e saj, mund të konkludojmë që ekzistojnë disa pengesa të cilat ndikojnë në eficensën e tregut si mungesa e informacionit mbi pronësinë e tokës, konflikte midis pronarëve, konfuzion në urbanistikë, zgjatje kohe në shënien e lejeve të ndërtimit” (IHS Alumni et al, 1998: 60).

Këtë nevojë do ta prezantonte edhe Banka Botërore, sipas të cilës “Duhet të përgatitet sa më shpejt një kuadër i ri ligjor për të përcaktuar planet rregulluese në Shqipëri, mundësisht me një dekret të ri.” (BB, 2007: 54)

Sistemi ligjor i fazës së dytë të qeverisje territoriale, 1998-2005, përbëhej nga ligji 8405/1998 ‘Për Planifikimin Urban’ dhe VKM nr. 722, dt. 19. 11. 1998 ‘Për miratimin e rregullores së urbanistikës’ (FZ, nr. 23, 1998; QKB, 2010). Ligji 8405/1998 pësoi 10 herë ndryshime të njëpasnjëshme (QBZ, 2010).

Sipas Dhamo, kjo bazë ligjore vijonte nën frymën e ligjit pararendës dhe nuk solli risitë që Shqipëria e asaj periudhe kishte domosdoshmëri (IHS Alumni et al, 1998: 30).

Kurse për Bankën Botërore “Dekreti ekzistues Nr. 722 (1998) mbi Normat e Urbanistikës ka një pozicion jashtë mase normativ dhe nuk lejon variacione në normat rregulluese të përdorimit të truallit në varësi të qyteteve dhe vendndodhjes.” (BB, 2007).

Kjo inisiativë ligjore nuk arriti të dilte mbi kulturën mbizotëruese në çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të bazuar mbi planifikime dhe projekte të miratuara më parë. Në të kundërt, ishte pikërisht kjo bazë ligjore që krijoi parakushtet për një zhvillim të paplanifikuar më parë dhe të atomizuar (Aliaj, 2008).

Nevoja për një reformim të thellë të sistemit të legjislacionit dhe atë normativ, vijoi të mbetet edhe pas miratimit dhe implementimit të këtij ligji, përshkak të pamundësisë së tij për ta drejtuar zhvillimin shqiptar në rrugën e zhvillimit të qëndrueshmë të zgjuar dhe gjithëpërfshirës (Aliaj, 2003, 2008). Sipas Aliaj “Ligji i tanishëm për Urbanistikën (nr. 8405, dt. 1998) ka nevojë të reformohet në mënyrë që të përfshijë kushtet të reja që ndikojnë planifikimin në Shqipëri” (Aliaj, 2003: 102).

Ai në vitin 2008 do të theksonte se “Shqipëria ka nevojë dëshpërimisht për një legjislacion të ri që i jep hapsirë proçeseve të përmirësimit, shndërimit, kualifikimit dhe zhvillimit urban”

(Aliaj, 2008: 190). Aliaj e shikonte këtë çështje, si të vetmen mënyrë esenciale, për të ndryshuar gjëndjen e qyteteve shqiptare dhe për përmirësimin. Nëpërmjet kësaj mënyre duhet të krijohen në qytete zonat për ndërtim, zonat tregate, zonat turistike dhe kulturore, zonat sociale dhe kështu mund të bëhej ripërtëritja e qytetit duke ruajtur indin e tij urban nga pikëpamja historike dhe kulturore (Aliaj, 2008: 190-194).

Kontributi i fazës së tretë të qeverisjes territoriale, 2005-2013, nis nga ‘*Dokumenti i Politikave për Planifikimin hapsinor në Shqipëri*’ (MPPT, 2006). Në Prill të vitit 2009 u miratua ligji nr. 10119/2009 ‘*Për Planifikimin e Territorit*’ duke hapur një vision të ri për planifikimin e territorit të mbështetur në disa parime të rëndësishme të qeverisjes së mirë urbane (QBZ, 2010).

Ky ligj pësoi ndryshime që pak muaj pas miratimit të tij, para hyrjes me fuqi, nëpërmjet ligjit nr.10 258/2010 (QBZ, 2010). Këto ndryshime konsistojnë në fuqizimin e rolit të qeverisë qendrore në miratimin përfundimtar të instrumentave vendorë të planifikimit dhe procesin e lejdhënies ndërtimore, sikurse vërehet në nenin 2 dhe 3 të tij (QBZ, 2010). Ligji nr.10 258/2010 rikthehu konceptin hirearkik të bashkive, sikurse vërehet në pikën 3 të nenit 3 të tij, duke konsideruar disa bashkitë si Bashki të Kategorisë së Parë (QBZ, 2010).

Koncepti i kategorizimit të bashkive në dimension hirearkik është një koncept shumë i vjetëruar (Davoudi, 2003, 2008; Meijers, 2006) që ka shoqëruar Shqipërinë territoriale përgjatë historisë së saj (Konica, 1993; Misja dhe Misja, 2004; Kotmilo dhe Kotmilo, 2017). Ky koncept ka shoqëruar legjislacionin në sektorin e urbanistikës deri në vitin 1998, ku neni nr. 15 i ndante bashkitë me Kategori (FZ, nr. 25, 1998). Në legjislacionin bazë të vitit 2009, ky koncept nuk u përfshi, por u rikthye me ndryshimet e vitit 2010. Ky koncept i vjetëruar i shërben kuptimit etatist të politikës shqiptare për të fuqizuar rolin e qeverisjes qendrore nëpërmjet KKT-s.

Proçesi tranzitor, për draftimin e legjislacionit dytësor dështoi për shkaqe të paaftësisë së profesionistëve, të sektorit publik dhe privat, të përfshirë në procesin e hartimit dhe diskutimit të tyre. Për ekspertizën teknike ishte shumë e vështirë të kuptohej dhe pranohej: niveli i lartë i decentralizimit të proçeseve planifikuese; ndarja midis normativave rregulluese dhe instrumentave planifikuese; shumëllojshmërinë e instrumentave të planifikimit territorial, sipas nivelit qeverisës (qëndror, lokal), sipas klasifikimit të llojeve të instrumentave dhe sipas sektorëve të zhvillimit. Për këtë arsye, proçesi i tranzicionit për hyrjen e ligjit në fuqi të plotë veprimi, u shty dy herë nga Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet ‘*Akteve Normative*’ të Qeverisë Qendrore (QBZ, 2019).

Në këtë kontekst, nevoja për një sistem të ri ligjor në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial mbeti e pa adresuar (Imami et al, 2008; Aliaj, 2008). Ndërsa fliste për fushën e planifikimit, zhvillimit dhe administrimit të territorit, Aliaj do të nënvizonte se “Në fakt kjo është një nga sferat më të pareformuara të qeverisjes në Shqipëri” (Aliaj, 2008: 99).

Për Aliaj “Në këtë situatë është e ngutshme të ndërmerret sa më parë një reformë e menjëhershme dhe e plotë e institucioneve politikbërëse, shkencore dhe akademike që lidhen me fushën e planifikimit, zhvillimit dhe administrimit të territorit” (Aliaj, 2008: 98-99). Për të, kjo është një nga sferat më të pareformuara të qeverisjes territoriale shqiptare (Aliaj, 2008: 99).

Derraj, gjithashtu, ndërsa theksonte domosdoshmërinë e një reformimi të sistemit ligjor, do të nënvizonte vlerësimin e tij se “Ligji i ri Për Planifikimin e Territorit që po përgatitet vlen të përshëndetet me gjithë mangësitë që mund të ketë si çdo gjë e re që vjen dhe na serviret” (Imami et al, 2008: 58).

Aliaj do të prezantonte qasjen e tij teknike mbi thellbin që duhet të realizonte ky legjislacion i ardhshëm në këtë fushë. Sipas tij, kjo qasje e re duhet mbështetur në një zonim funksional, të përcaktohen nevojat për ndërhyrje, të cilat të miratohen nga këshilli bashkiak për terriore me shtrirje 10-20 mijë metra katrorë. Dhe pasi të miratohen nga pushteti vendor nëpërmjet Këshillit Bashkiak, këto plane të dërgohen për miratim në KRRrTRSh-ë, që është ekuivalenti i KKT-së (Aliaj, 2008). Një qasje centraliste dhe me elementë të fortë centralizuese, kjo e Aliaj, të cilën e pranon edhe vet porse e justifikon me argumentin se “Kjo mund të duket disi e centralizuar, por është e nevojshme për të garantuar dhe koordinuar zgjidhjen e gjithë problemeve sidomos të investimeve të shërbimeve publike” (Aliaj, 2008: 191).

Kurse për çështjet e projektimit urban të njësive strukturore të qytetit, të emërtuara ‘Studime Urbanistike Pjesore’ në kohën e diktaturës deri në reformën e viti 2009 që do ta shohim në vijim, ‘Planet e Detajuara Vendore’ të emërtuara në ligjet e viteve 2009 dhe në 2013, apo projektet e ‘zonave të shndërimit’ dhe ‘zonave të zhvillimit’, sikurse i emërtonte Aliaj në 2008, duhet të zbatohen nga “bashkisë përkatëse, institucioneve publike, personave fizikë dhe personave juridikë privatë” (Aliaj, 2008: 192). Një qasje shumë e ngjashme me sistemin legjislativ të fazës së katërt qeverisëse, kjo e Aliajt, e cila solli edhe problematikat më të mprehta në çështjet e bërjes dhe ribërjes së qytetit.

Ndërsa fliste për instrumentet e planifikimit territorial, Aliaj do të theksonte se “Në përgjithësi ka një konsensus se planet janë të nevojshme për të parandaluar zhvillime urbane informale,

për të mundësuar strehimin e të gjithë shtresave të popullsisë, si dhe për të siguruar një zhvillim social-ekonomik dhe ambjentor të qëndrueshëm” (Aliaj, 2008: 108).

Shqetësimi dhe pikëpyetjet që ngrinte Aliaj, nisur nga qasje globale, kishin të bënin me faktin nëse këto plane duhet të jenë urdhëruese, shtrënguese dhe rregulluese, apo konsultuese, nxitëse dhe lehtësuese. Përgjigjja që i jepte Aliaj, ishte një pyetje tjetër:

“Në Shqipëri, ku shoqëria është mjaft dinamike dhe shpejtësia e ndryshimeve është marramendëse, çështja qëndron në atë sesi mund të hartohet një kornizë ligjore, që të përfshijë instrumente “kontrolli dhe pjesëmarrjeje, lehtësuese të cilat nuk frenojnë, por stimulojnë “motorin ekonomik të qytetit” (Aliaj, 2008: 108).

Derraj në vitin 2008 do të këmbëngulte se një sistem i ri ligjor duhet të mos injorojë kapacitetet teknike vendore që do ta zbatojnë atë ligj. Ai do të nënvizonte se “Pa u futur në diskutimet për risitë që do të sjell ky ligj i ri, natyrshëm lind pyetja: a do të jenë të afta administratat e bashkive dhe të komunave në Shqipëri që të vënë në zbatim përcaktimet e tij” (Imami et al, 2008: 58).

Të njëjtin shqetësim do të sillte edhe Aliaj, i cili do të propozonte që “Duke ndjekur përvojën e vendeve të tjera të ngjashme, Shqipëria ka nevojë për një investim kolosal për ngritjen e kapaciteteve lokale në fushën e planifikimit dhe të administrimit të territorit, në se kërkohet ndryshimi i mentalitetit” (Aliaj, 2008: 99).

Aliaj vinte përball, nga njëra anë konceptin veprimet pjesëmarrëse dhe lehtësuese, të cilat ishin të rëndësishme; dhe nga ana tjetër instrumentët frenues të kontrollit, të cilat kontribuojnë në përmirësimin urban e mjedisor të qyteteve (Aliaj, 2008). Ai theksonte se proceset planifikuese në Shqipëri kërkojnë të paktën konsultimin me të gjithë aktorët kyç. Sikurse shprehej, nuk ka asnjë banor në Tiranë që nuk është i interesuar që shërbimet e infrastrukturës dhe ato sociale, transportit, gjelbërimit etj, të sigurohen brenda standarteve; që investimi, pasuria e tij e vogël apo e madhe të jetë e qëndrueshme; që apartamenti i blerë me shumë mundim të bëhet i pabanueshëm apo të humbasë vlerën nga një pallat i ndërtuar abuzivisht ngjitur me të; që investimet që bëhen të marrin në konsideratë ata dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre (Aliaj, 2008, 109).

Banka Botërore, gjithashtu, ndërsa do të theksonte domosdoshmërinë e një ligji të ri për planifikimin e territorit, do të nënvizonte se “Qeveria qëndrore do të ketë nevojë të gjejë mënyra për të mbështetur fuqizimin e kompetencave të qeverisë vendore në atë zonë për kontrollin e zhvillimit urban, ashtu si dhe në funksione të tjera të decentralizuara.” (BB, 2007: 84).

Për procesin e miratimit të instrumenteve të planifikimit, BB do të theksonte se do të ishte e vlefshme që miratimi i nevojshëm ligjor i planeve bashkiake të bëhej më formal nga KKT nëse ai nuk mund të shmangej plotësisht, me synim “për të minimizuar vonesat dhe mundësitë për ndëhyrje të panevojshme në planifikimin bashkiak.” (BB, 2007: 84).

Sipas BB ligji duhet të kërkonte përfshirjen e grupeve të interesit dhe qytetarët e thjeshtë, kur shprehej se “Qeveritë vendore nga ana e tyre duhet të kenë përgjegjësinë për të përcaktuar nëpërmjet një procesi lokal demokratik dhe pjesmarrës, vizionin e llojit të qytetit që aktorët lokalë dëshirojnë të krijojnë.” (BB, 2007: 86). Për të “qeveritë qendrore dhe vendore, si dhe sektori privat, të gjithë së bashku kontribuojnë në përcaktimin dhe plotësimin e vizionit për qytetet, por është e rëndësishme të theksohet se qeveritë nuk ndërtojnë qytete – qytetet i ndërton sektori privat.” (BB, 2007: 86)

6.2.2. Vlerësim i legjislacionit aktual të planifikimit të territorit dhe domosdoshmëria për një reformë të thellë në këtë sektor.

Një nga nismat e qeverisë qendrore të fazës së katërt të qeverisjes territoriale, 2013-2020, në lidhje me territorin dhe zhvillimin e planifikuar të tij, është ligji nr. 107/2014 ‘*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*’ (QBZ, 2019).

Ky ligj përfaqësoi një kthim të fortë mbrapa në procesin e modernizimit të vendit dhe tranzicionit nga një shoqëri me qeverisje të centralizuar në një shoqëri që organizohet dhe funksionon në një sistem demokratik dhe një qeverisje shumëlivelëshe. Shumë nga parimet e *Qeverisjes së Mirë* (UNECE, 2008), u shkelën në mënyrë të dukshme nga dispozitat e këtij ligji. Ai prezantohet si një kthim mbrapa, jo vetëm krahasuar me legjislacionin e periudhës së tranzicionit, por edhe me ligjin komunist të vitit 1978 ‘*Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve Rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave*’ (FZ, nr. 3, 1978).

Ky kthim mbrapa dallohet veçanërisht në aspektin centralizimit të autoritetit miratues të instrumentave të planifikimit dhe autoritetit të lejedhënies ndërtimore. Si një thellim i dëshirës së ekzekutivit për të kontrolluar çështjet urbane, që i përkasin nivelit lokal të qeverisjes, gjatë periudhës në vijim, ligji pësoi disa ndryshime, nëpërmjet ligjit nr. 73/2015; ligjit nr. 28/2017; dhe ligjit nr. 42/2019 (QBZ, 2019).

Përveç karakteristikës së hiper-legjislacionit, që e kemi identifikuar në legjislacionin e të gjitha fazave të qeverisjes territoriale, ky legjilacion paraqet problematika të tjera etatiste.

Së pari, dallueshëm mund të identifikohet centralizimi i pushtetit qeverisës në dimensionin e planifikimit territorial. Nëse i referohemi pikës 1 të nenit 6, të këtij ligji, *‘Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave’* pika ‘c’ e tij i ngarkon Këshillit të Ministrave përgjegjësinë për “detajimin e planit të Përgjithshëm të Territorit përmes hartimit të planeve të përgjithshme vendore” (QKB, 2019). Kjo dispozitë dëshmon mentalitetin etatist të hartuesve dhe miratuesve të tij, sipas të cilit instrumenti vendor i planifikimit nuk është gjë tjetër veçse detajim i instrumentit kombëtar të planifikimit, pa kuptuar se dy nivelet e qeverisjes kanë funksione dhe kompetenca të ndryshme në qeverisje.

Nëse vijojmë më tej në dispozitën 1 të nenit 7 të këtij ligji *‘Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Territorit’*, pika ‘a’ e tij i ngarkon KKT-së përgjegjësinë ligjore për të vendosur mbi “miratimin, miratimin me ndryshime ose shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të dokumenteve të planifikimit, kërkuar për miratim nga autoritetet e planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji” (QBZ, 2019). Në këtë kuptim etatist të qeverisë së fazës së katërt, 2013-2020, të gjitha Planet e Përgjithshme Territoriale të bashkive duhet të miratohen në KKT-ë. Ky rregullim ligjor kthen mbrapsht edhe atë proces decentralizimi që ishte arritur deri në atë kohë, në fushën e planifikimit vendor të territorit.

Kjo frymë etatiste shkon edhe në fushën e projektimit urban të njësive strukturore të një qyteti. Sipas pikës 7 të nenit 22 *‘Plani i detajuar vendor’*, detyra dhe përgjegjësia për të miratuar instrumenta planifikimi territorial e kryetarëve të votuar politikisht të bashkive përmbledhet në “vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor” (QBZ, 2019). Pra detyra e kryebashkiakut ka të bëjë vetëm me miratimin e projekteve urbane, sikurse janë studimet pjesore, që detajojnë për pjesë të caktuara të territorit përcaktimet që ka bërë Plani i Përgjithshëm Territorial i miratuar nga KKT-ë.

Në aspektin e miratimit të instrumenteve territorial vendorë, ligji nr. 107/2014 tejkalon në centralizim fushëveprimtarie edhe qeverinë komuniste të viteve 1944-1990. Referuar nenit 6 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, *‘Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave’*, edhe në regjimin komunist Planet Rregulluese miratoheshin nga “Kryesia e Këshillit të Ministrave për të gjitha qytetet” (GZ, nr. 3, 1978).

Në të njëjtin kuptim, detyra për ta paraqitur në qeveri, instrumentin e përgjithshëm vendor, e ka Bashkia përkatëse për të cilën është hartuar ky instrument, sikurse do ta përcaktonte edhe

neni 6 i ligjit komunist, planet rregulluese “paraqiten nga Komiteti Ekzekutiv” (GZ, nr. 3, 1978).

Ndërkohë që Dekreti nr. 5747/1978, ndryshe nga ligji nr. 107/2014, i njeh Komitetit Ekzekutiv të Rrethit edhe funksionin miratues të Planeve Rregulluese për “fshatrat me qendrat e tjera të banuara brenda tyre” përveç “studimeve urbanistike pjesore” (GZ, nr. 3, 1978), të cilën gjithashtu ligji 107/2014 ja njeh Bashkisë funksionin për të miratuar “Planin e detajuar vendor” (QBZ, 2019).

Përtej hiper-legjislacionit dhe centralizimit për fushëveprimin qeverisës të miratimit të instrumentëve të përgjithshëm vendorë të territorit, qeverisja territoriale e fazës së katërt, 2013-2020, paraqit edhe një karakteristikë tjetër antidemokratike. Nëpërmjet ligjit nr. 107/2014, qeverisja territoriale e fazës së katërt, krijon një institucion në varësi të saj, Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), të cilit i jep funksione të sistemit të drejtësisë. Referuar nenit 9 të këtij ligji, *‘Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit’*, sipas pikës 2 të tij, AKPT “siguron që hartimi i dokumenteve të planifikimit të territorit dhe kontrolli i zhvillimit, në nivel qendror dhe vendor, është në përputhje me dispozitat e këtij ligji” (QBZ, 2019).

Kjo qasje antikushtetuese e qeverisë territoriale të fazës së katërt, bie në kushdështim të drejtpërdrejtë të ‘Parimit Demokratik’ që të gjitha institucionet ndërkombëtare i vënë një rëndësi të veçantë, për vendet në tranzicion dhe në zhvillim si Shqipëria (UNECE, 2008). Komisioni Ekonomik Europian i UN, në dokumentin e saj *‘Planifikimi Hapsinor; Instrumentët Kyç të Zhvillimit dhe Qeverisja Efektive me Referencë të Veçantë për Vendet në Tranzicion’*, do të theksonte si parimin e parë në planifikimin territorial, parimin demokratik. Për të “Sistemi gjyqësor kontrollon që ligji është zbatuar [ose jo] në vendimmarrje.” (UNECE, 2008: 11).

Po sipas këtij ligji, një institucion në varësi të qeverisë dhe e krijuar nga kjo nëpërmjet përzgjedhjes preferenciale të punojnësve dhe pa asnjë filtër demokratik, si AKPT, i mbivendoset në hirearkinë shtetërore një institucioni Kushtetues të dalë nga zgjedhjet administrative, sikurse është Kryebashkiaku dhe Këshilli Bashkiak i njësisë së qeverisjes lokale. Sipas nenit 23 të ligjit 107/2014, ‘Bashkërendimi’, në pikën 2 të tij shtrëngon Kryebashkiakun dhe Këshillin Bashkiak të çdo qyteti, të raportojë dhe të informojë AKPT-në sikurse do të theksonte se “Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit

[Kryebashkiaku dhe Këshilli Bashkiak] këshillohet rregullisht me AKPT-në dhe palët e interesuara dhe i informon ato çdo muaj mbi ecurinë e procesit” (QBZ, 2019).

Po nëpërmjet këtij neni, qeverisja territoriale e fazës së katërt, i jep AKPT-s edhe funksione të bashkë-qeverisjes lokale me autoritet lokale, në pikën 3 të tij ai detyron që “AKPT-ja shqyrton përputhshmërinë e projektaktit të dokumentit të planifikimit me dispozitat ligjore e nënligjore të zbatueshme në fushën e planifikimit të territorit, si dhe me dokumentet e planifikimit në fuqi. Në përfundim të shqyrtimit, AKPT-ja i përcjell autoritetit përgjegjës përfundimet dhe propozimet përkatëse për trajtimin e mangësive” (QBZ, 2019).

Kjo frymë është në kundërshtim të plotë me udhëzimet e UNECE, sipas të cilës:

“është e një rëndësie të veçantë që vendimet e planifikimit të merren nga autoriteti legjitim i njerëzve të ngarkuar me përgjegjësi nga proceset demokratike. Në shumicën e vendeve, kjo nënkupton se vendimet merren formalisht nga politikanët e votuar të niveleve të ndryshme, duke u mbështetur në rekomandimet e bëra nga ekspertët e rëndësishëm” (UNECE, 2008: 11).

Pra ky ligj, përveçse e përforcoi më shumë karakterin etatist të qeverisjes shqiptare, solli edhe një risi tjetër antidemokratike, atë të zëvendësimit të vendimarrjes së politikanit të votuar me vendimarrjen e një zyrtari publik që nuk përfaqëson asgjë politikisht.

Faza e katërt e qeverisjes territoriale nuk solli reformim e përmirësim as në aspektin e përfshirjes qytetare në proceset e hartimit dhe miratimit të instrumentave të planifikimit. Së pari në aspektin ligjor, ku sipas nenit 24 të ligjit 107/2014, *‘Këshillimi dhe takimi publik’*, në pikën 1 të të cilit theksohet se “Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit organizon një ose më shumë seanca takimi publik dhe këshillimi, përpara çdo vendimmarrjeje që ka lidhje me dokumentet e planifikimit në nivel qendror dhe me planin e përgjithshëm vendor”, kurse pika 2, detyron që palët e interesuar të njihen me dokumentet që përmban instrumenti i planifikimit “të paktën 30 ditë përpara takimit” (QBZ, 2019). Njëtrajtshmërisht me përcaktim e Dekretit nr. 5747/1978, *‘Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe fshatrave’*, të regjimit komunist, ku sipas nenit 6 të tija “Planet rregulluese të qyteteve dhe fshatrave me qendrat e tjera të banuara brenda tyre, të qendrave turistike kombëtare dhe studimet pjesore urbanistike, para të miratohen, i nënshtrohen gjyqimit të masës për një periudhë kohe deri në një muaj” (GZ, nr. 3, 1978).

Përkeqësim të nivelit të demokracisë dhe lirive të qytetarëve, qeverisja territoriale e fazës së katërt do të sillte edhe në funksionin qeverisës të kontrollit të zhvillimit, në të dyja aspektet.

Së pari, përsa i përket kontrollit të territorit për zhvillime informale kjo qeverisje, nëpërmjet ndryshimeve me ligjin nr. 176/2014, të Kodin Civil, në nenin 199 ‘*Shpërdorimi i tokës*’, në pikën ‘a’ të tij përcaktoi se:

“Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet” (QKB, 2019).

Kurse pika ‘b’ e nenit 199, përcaktonte “Cilido që ofron dhe kryen shërbime sipërmarrjeje, mbikëqyrjeje, zbatim punimesh në një ndërtim të paligjshëm, dënohet me burgim deri në 3 vjet” (QKB, 2019). Ky legjislacion prezantohet shumë më shtërgues se legjislacioni komunist, sipas të cilit, personat që kryenin ose lejojnë ndërtime, shtesa dhe meremetime në kundërshtim me dispozitat e Dekretit nr. 5747/1978, referuar nenit 16 të tij përcaktonte se “dënohen për kundravajtje administrative nga gjykatat e fshatrave, të qyteteve ose lagjeve të qyteteve me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 1.000 lekë” (GZ, nr. 3, 1978).

Së dyti, përsa i përket procesit të lejedhënies ndërtimore, për një kohë të caktuar gjatë kësaj qeverisje ‘lejet e zhvillimit’ dhe ‘lejet e ndërtimit’ jepen vetëm nga KKT, apo më sakt vetëm nga Kryeministri që është drejtuesi i tij (QBZ, 2019). Kryeministri drejton KKT-n e cila përbëhet nga ministra të kësaj qeverisje, dhe në mbledhjen e datës 09. 09. 2015 të këtij institucione merret vendimi që askush nga Bashkitë e Republikës nuk mund të japi më leje ndërtimi, ndërkohë që duke ju referuar vendimeve të saj të metejshme, KKT me nënshkrimin e Kryeministrit vijon ta ushtroj këtë funksion qeverisës vendor (AKPT, 1993-2017).

Më tej, pas miratimit të Planeve të Përgjithshëm Territorial, çdo bashki fitoi të drejtën ta ushtroj vet këtë kompetencë, por qeverisja e fazës së katërt, nëpërmjet botimit në Regjistrin Kombëtar të Territorit nga AKPT-ë mban të drejtën e vlerësimit nëse një leje ndërtimi është apo jo në përputhje me ligjin (QBZ, 2019). Ky standart i lejedhënies ndërtimore është akoma më i centralizuar se standarti komunist, sipas të cilit, të përcaktuar nga Dekreti nr. 5747/1978, në nenin 8 të tij, lejet e ndërtimit jepen nga “komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit ose këshilli popullor i qytetit, kur nuk ka komitet ekzekutiv ose të lagjes për qytetin e Tiranës”, “këshilli popullor i fshatit të bashkuar” apo “njësia e bashkuar ushtarake” (GZ, nr. 3, 1978).

Qeverisja territoriale e fazës së katërt, 2013-2020, ka kaluar çdo standart demokratik duke sjellë një kthim në kohërat e hershme të historisë apo në antikitet, ku nënshtetasit sundoheshin nga

një sundimtar. Sikurse do ta prezantonte Mill, Sundimtari nuk zbatonte rregullat që ishin shkruajtur për të gjithë nënshtetasit, por ishte i përjashtuar prej tyre sepse “bëhet fjalë për qeverisjen e Njëshit, të fisit apo kastës, të cilët pushtetin e përftonin nga trashëgimnia ose pushtimi, që, gjithësesi, nuk e ushtronin për të mirën e të qeverisurve” (Mill, 2005: 6).

Njëtrajtshmërisht, qeverisja territoriale fazës së katërt, prodhoi VKM nr. 231/2017, sipas pikës 12 të nenit 23, të të cilit “Për objektet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas nenit 19, të kësaj rregulloreje, distancat midis objekteve mund të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme, të miratuar prej tij” (KM, 2017). Që do të thotë se, për lejet që japin bashkitë, qytetarët dhe sipërmarrjet private duhet të zbatojnë kushtëzime dhe normative urbanistike të caktuara kur zhvillojnë një pronë, kurse për lejet që jep KKT për qytetarë dhe sipërmarrje të tjera do ketë kushtëzime dhe normativa të tjera dhe të ndryshme nga ato për qytetarët dhe sipërmarrjet private, të cilat, gjithashtu do ti miratoj vet KKT-ë. Gjykata Administrative e Apelit, me Vendim nr. 111 dt. 06.05.2019 bëri shfuqizim të pjesshmë të kësaj VKM-je, pikërisht në pikën 12 të nenit 23 (GjAA, 2019).

Në përgjigje të kësaj situate, qeveria e ktheu në ligj këtë iniciativë të saj. Nëpërmjet Vendimit nr. 73/2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 42/2019, e ligjëroi këtë pabarazi midis një kryebashkiaku dhe Kryeministrit si kryetar i KKT-së, duke shkelur edhe vendimin e një gjykate. Për më tepër, duke e vendosur Kryeministrin në një nivel “më të lartë barazie” se kryebashkiakët, dhe duke na kujtuar shprehjen oruelliane se “Të gjitha kafshët janë të barabarta por disa kafshë janë më të barabarta se të tjerat” (Orwell, 2017: 113).

Përkeqësim të lirive të qytetarëve, kjo qeverisje dhe legjislacioni i saj ka sjellë edhe në sektorin e menaxhimit të zhvillimit urban. Referuar nenit 32 të ligjit 107/2014, në gërmën ‘a’ të pikës 2 të tij autoriteti vendor i planifikimit “rishpërndan të drejtën e zhvillimit të përcaktuar nga plani i përgjithshëm vendor në parcelat e këtyre pronarëve të parcelat fqinje dhe/ose njësi strukturore të tjera” (QBZ, 2019), kur një apo disa pronarë të pronave të paluajshme nuk dakortësojnë me përcaktimet e Planit të Detajuar Vendor që përfshin edhe pronësitë e tyre. Që do të thotë se, nëse dikush nga qytetarët nuk është dakort që prona e tij të zhvillohet në një mënyrë të caktuar, sikurse e ka përcaktuar një instrument planifikimi vendor, i merren të drejtat e zhvillimit të pronësisë së tij, të cilat i kalojnë një ose disa pronarëve të pronësive kufitare, ndërsa prona e tij mbetet e pazhvilluar, të paktën derisa të hartohet një instrument tjetër planifikimi vendor.

6.2.3. Propozimi për një reformë libertariane për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Ky kontekst gjerësisht antidemokratik dhe përqëndruar i sistemit ligjor ekzistues, por edhe domosdoshmëria për një legjislacion modern gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, kërkojnë një sistem të ri planifikimi dhe zhvillimi të mbështetur mbi parime demokratike (IHS Alumni et al, 1998; Imami et al, 2008; Aliaj, 2008). Në këtë pjesë të punimit ne do të prezantojmë qasjen tonën modeste për një sistem të ri ligjor në këtë sektor.

Sistemi i ri i propozuar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit mbështetet në tre parimet bazike libertariane: zvogëlim të rolit dhe të madhësisë së fushëveprimtarisë së qeverisjes si një e tërë, që do të thotë të treja nivelet e qeverisjes; decentralizim të funksioneve dhe përgjegjësi qeverisëse, nga nivelet më qendrore në nivelet më vendore; dhe fuqizimin e qytetarit në qeverisjen territoriale nëpërmjet përfshirjes së mendimit dhe opinionit të tij në proceset planifikuese, zgjerimin e mundësive të tij për tu njohur me vendimarrjen qeverisëse në fushën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit dhe përfshirjen e tij në procesin e kontrollit të territorit për zhvillime informale.

Parimet e vendosura nga dokumentet e institucioneve të Bashkimit Europian apo të organizatave të rajoneve më të gjera, deri në globale do të frymëzojnë çdo element të këtij sistemi të propozuar. Të gjitha propozimet e dokumenteve politike të institucioneve ndërkombëtare, të përmendura, të referuara dhe të cituara në këtë punim, por edhe të tjera që nuk janë përmendur në këtë punim me synimin për të mos rënë në përsëritje, kanë frymëzuar këtë propozim. Gjithashtu përvoja teorike e profesionistëve shqiptar, të përmendur, referuar apo cituar në këtë punim, kanë kontributur e tyre në formësimin e këtij propozimi.

Vend të veçantë do të kenë në këtë sistem të propozuar, parimet për një planifikim territorial dhe urban të një qeverisje të mirë të prezantuara nga dokumenti i Komisionit Ekonomik Europian të UN, të vitit 2008 *‘Planifikimi Hapsinor: Instrumentët kyç të zhvillimit dhe qeverisja efektive, me referencë të vecantë për vendet në tranzicion’* (UNECE, 2008).

Sistemi i propozuar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit diferencon dy konceptet bazë: nga njëra anë, atë të strukturave organizativo-funksionale të sistemit, pra llojet e instrumentave të planifikimit, autoritetet e planifikimit dhe proceset e procedurat administrative ku prodhohen këto instrumenta; dhe, nga ana tjetër, atë të politikave, planeve dhe rregulloreve të zhvillimit, pra çfarë është politike dhe tekniko-shkencore, që sikurse në çdo shkencë tjetër sociale, ndryshon e zhvillohet çdo ditë.

Ky sistem i propozuar nuk futet në dimensionin politik, sepse secila qeverisje, në kohë të ndryshme apo në territore të ndryshme, ka të drejtën të përzgjedhi qasjen që do të përfshijë, në përputhje me vullnetin politik që përfaqëson. Ai fokusohet dhe normon strukturën organizative dhe funksionale të fushëveprimtarisë qeverisëse të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit territorial dhe urban, në përputhje me qasjen libertariane të “qeverisjes si caktuese rregullash dhe arbitre” (Friedman, 2005).

Sistemi i propozuar konsiderohet si një sistem gjeneral me dy komponentë kryesor, atë të planifikimit territorial, dhe atë të kontrollit të zhvillimit në territor. Në këto dy komponentë ndërveprojnë tre ingranazhe të mëdha, së pari janë instrumentat e planifikimit territorial dhe instrumentat e kontrollit të territorit, së dyti janë autoritetet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, dhe së treti janë proëset nëpërmjet të cilave këto instrumenta planifikimi dhe kontrolli zhvillimi hartohen, miratohen dhe implementohen, nga këto autoritete planifikimi dhe zhvillimi territorial.

Palët e interesuara dhe qytetarët e prekur nga zhvillimi, sikurse do ta vërejmë më tej, janë një autoritet vullnetar i planifikimit, sepse përfshirja e tyre shkon në përputhje me të drejtat e tyre kushtetuese dhe ligjore, dhe jo në zbatim të ndonjë përgjegjësie detyruese nga ligji. Megjithatë ligji do të krijojë hapsirat ku qytetarët ta ushtrojnë këtë të drejtë kushtetuese.

Instrumentët e planifikimit i ndajmë në tre lloje: politikat, planet dhe rregulloret; të cilat janë në marrdhënie hirearkike midis tyre. Parimi i ‘*shumllojshmërisë*’ së instrumentave të planifikimit është një nga parimet bazë të sistemit të ri. Ai kërkon që, për së pari, të vendosen synimet politike që kemi mbi një territor të caktuar apo mbi një sektor të caktuar zhvillimi, dhe më tej t’ju japim kuptim gjeografik konkret këtyre politikave, nëpërmjet përcaktimeve grafike në harta, sikurse janë planet, dhe në përcaktime të rregullave të shkruara, sikurse janë rregulloret.

Secila nga të treja llojet e instrumenteve të planifikimit territorial ndahen në tre klasifikime të instrumentave të planifikimit: sektorialë, ndërsektorialë dhe të përgjithshëm, që ka lidhje me faktin nëse ato janë vetëm për një sektorë, për disa sektorë, apo për të gjithë sektorët e zhvillimit. Instrumentat e planifikimit në zbatim të parimit të ‘*subsjaritetit*’ që është një parim shumë i rëndësishëm i sistemit të ri dhe shprehet nëpërmjet decentralizimit të funksioneve qeverisëse ndahen në tre nivele: instrumenta kombëtare të planifikimit, të cilat hartohen për gjithë territorin kombëtar; instrumenta rajonalë planifikimi, të cilat hartohen për territorin e

një rajoni; dhe instrumenta vendorë të planifikimit të cilat hartohen për territorin e një njësie vendore administrative.

Një parim tjetër i sistemit të propozuar është parimi i *‘domosdoshmërisë së planifikimit’*, që do të thotë se zhvillimi nuk mund të lejohet në një territor të caktuar nëse nuk janë miratuar më parë instrumenta planifikimi për këtë territor. Sidoqoftë, parimi i *‘domosdoshmërisë së planifikimit’* nuk nënkupton se çdo nivel qeverisës duhet ti hartoj me domosdoshmëri të gjitha llojet apo klasifikimet e instrumentave të planifikimit.

Përveç parimit të *‘domosdoshmërisë së planifikimit’* sistemi i propozuar i jep një rëndësi të veçantë edhe parimit të *‘planifikimit fleksibël’*, i cili do të thotë se instrumentat e planifikimit mund të përbëhen nga komponentë normative për tu zbatuar, dhe nga komponentë orientues. Pra ka pjesë të instrumentave që duhet të zbatohen detyrimisht nga operatorët në tregun e zhvillimit territorial dhe urban, dhe ka pjesë të tjera të instrumentave të planifikimit që tentojnë të orientojnë veprimet e operatorëve, dhe moszbatimi i tyre nuk përben shkelje të ndonjë lloji.

Instrumentët sektorialë të planifikimit, në kuptim të një zhvillimi të shpejtë por paraprirë nga planifikimi, janë në kontradita mes njëra-tjetrës, përsa i përket, nevojave që ato kanë për territor ku të adresojnë synimet e tyre politike, programet dhe projektet konkrete. Por, mbi të gjitha ato janë në kontraditë me sektor të tjerë që synojnë konservimin dhe mbrojtjen nga zhvillimi i territoreve, si përshebull, por jo vetëm, sektorët e mbrojtjes së monumenteve natyrorë dhe kulturorë dhe në mënyrë të veçantë me parimin e qëndrueshmërisë, atë të *‘zhvillimit të qëndrueshëm’* e ndërbrezor.

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndërbrezor, është një parim shumë i rëndësishëm për sistemin e ri të planifikimit të territorit. Për këto arsye, instrumentet sektorial të planifikimit të territorit kanë nevojë të integrohen dhe të koordinohen mes tyre. Në vijim do të prezantojmë sesi do të ndodhi ky proces në sistemin e propozuar, mbështetur në dy koncepte shumë të rëndësishme, i integritetit dhe koordinimit, të përmbledhura në parimin e *‘bashkërendimit’* të instrumenteve të planifikimit territorial.

Instrumentët e kontrollit të zhvillimit, në sistemin e ri janë vetëm dy, dhe zhvillohen në treja nivelet e qeverisjes. Instrumentët e kontrollit të zhvillimit janë rregulloret që përcaktojnë procesin e lejdhënies ndërtimore, dhe procedurat për kontrollin e territorit për ndërtime informale, dhe janë të ndara sipas nivelit qeverisës.

Kontrolli i zhvillimit të territorit, sipas sistemit të propozuar, është një procedurë e thjeshtë administrative. Kjo procedurë nënkupton vlerësimin administrativ nëse një kërkesë specifike e

iniciativës private ose publike është, apo jo, në përputhje me instrumentët e planifikimit në fuqi dhe akte ligjore apo nënligjore të ndërtimit. Rregulloret e kontrollit të zhvillimit, sipas nivelit konkret qeverisës, përcaktojnë rregullat sipas të cilave kryhet ky verifikim mbi përputhshmërinë ose jo të kërkesës specifike. Ky verifikim kryhet nga pjesa administrative dhe teknike e qeverisjes, sipas nivelit qeverisës, por në formën e aktit juridik të ‘lejes së ndërtimit’ nënshkruhet nga titullari politik i institucionit qeverisës. Parimi ‘*demokratik*’ i udhëzuar nga UNECE, që do të thotë parimi i ndarjes çfarë është teknike dhe administrative dhe çfarë është politike, është një parim shumë i rëndësishëm i sistemit të propozuar. Në respektim të këtij parimi, akti juridik i ‘lejes së ndërtimit’ duhet të nënshkruhet nga titullari politik, i cili mban përgjegjësin ligjore por edhe politike përpara qytetarëve që e kanë përzgjedhur e votuar në zgjedhje.

Akti juridik i ‘lejes ndërtimore’, sipas sistemit të propozuar, nënshkruhet konkretisht, nga: kryebashkiaku, për njësinë administrative lokale, në fushëveprimtarinë lokale qeverisëse dhe në territorin në juridiksionin e të cilës lejohet ky zhvillim i kërkuar; titullari i rajonit, për njësinë administrative rajonale, në fushëveprimtarinë rajonale qeverisëse dhe në territorin në juridiksionin e të cilës lejohet ky zhvillim i kërkuar; dhe ministri, në fushëveprimtarinë sektoriale që ministria e tij mbulon dhe në territoret që më parë janë shpallur më parë si territore të ‘rëndësishme kombëtare’.

Territoret e ‘rëndësishme kombëtare’ në planifikim shpallen të tilla nga instrumentët kombëtarë të planifikimit dhe janë ato territore ku zhvillohen struktura apo infrastruktura të cilat janë funksion i qeverisjes kombëtare. Si përshembull, por jo vetëm këto: portet, aeroportet, hekurudhat, rrugët kombëtare. E rëndësishme për sistemin e propozuar është parimi ‘*demokratik*’ në lidhje me nivelin qeverisës, që do të thotë se në një nivel i caktuar qeverisës mund të ushtroj detyra në hartimin dhe miratimin e instrumentave të planifikimit territorial dhe të kontrollit të zhvillimit të kryhet vetëm në përputhje me funksionet e përcaktuara nga legjislacioni për ‘*Organizimin dhe Funksionimin*’ e secilit nivel qeverisës.

Në të njëjtën kuptueshmëri duhet të shkoj edhe procedura e inspektimit për ndërtime informale. Pra, secili nivel qeverisës, duhet të ushtroj inpektime dhe në këtë kuptim të ketë administrata për të kryer këtë funksion qeverisës. Sistemi i ri i legjislacionit të planifikimit të territorit, propozon parimin e ‘*delegimit*’ të këtij funksioni, që do të thotë se, nivelet qendore dhe rajonale, mund tja delegojnë funksionin e inspektimit të territorit për zhvillime informale, nivelit lokal të qeverisjes, përderisa ky nivel është më afër territorit.

Sistemi i propozuar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit kërkon dy lloje autoritetesh të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit: këshilluesit politik, në të cilin hyjnë profesionistët, ekspertët dhe zyrtarët që punojnë në qeverisje në këtë sektor; dhe vendimmarrësit politik, në të cilin hyjnë politikanët e votuar. Këto dy lloje autoritetesh gjejnë zbatim në të treja nivelet e qeverisjes, kombëtare, rajonale dhe vendore.

Në implementim të parimit të *'bashkërendimit'* horizontal dhe vertikal dhe parimit të *'transparencës'* në planifikim dhe zhvillim, sistemi i propozuar kërkon një institucion të nivelit kombëtar jo vendimmarrës dhe jo politik bërës. Ky institucion shërben për të ndihmuar në koordinimin e instrumentave sipas nivelit, kombëtar, rajonal dhe vendor. Pranë këtij institucioni duhet të gjendet baza elektronike e të dhënave të planifikimit dhe zhvillimit territorial dhe urban të Republikës, dhe është ky institucion që e mirëmban atë. Çdo autoritet i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit boton në këtë bazë elektronike të gjitha instrumentet e planifikimit dhe kontrollit zhvillimit, dhe çdo vendimarrje për lejedhënie ndërtimore dhe çdo ndërtim informal që ka inspektuar.

Autoriteti Kombëtar i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit është Këshilli i Ministrave dhe çdo Ministri, sipas fushës së kompetencës dhe sektorëve të zhvillimit që ato hartojnë politika. Këshilli i Ministrave harton Planin e Përgjithshëm Territorial dhe e dërgon për miratim në Kuvendin e Republikës. Ministri është niveli vendimmarrës në sektorin specifik që mbulon Ministria që ai drejton, kurse zyrtarët e strukturës organizative të Drejtorisë së Politikave Territoriale janë këshilluesit politik të tij. Ministri dërgon instrumentët e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të sektorëve në varësi të tij, për miratim në Këshillin e Ministrave, sikurse bën për çdo Vendim të Këshillit të Ministrave që propozon. Ministri miraton të gjitha lejet e ndërtimit dhe infrastrukturës, që janë në zbatim dhe në përputhje me instrumentet e planifikimit që ka propozuar dhe janë miratuar më parë me Vendim të Këshillit të Ministrave. Sistemi i ri propozon që funksioni i kontrollit të territoreve *'të rëndësisë kombëtare'* në planifikim, ministritë tja delegojnë njërive të pushtetit vendor. Parimi i *'delegimit'* të funksioneve në nivele më lokale qeverisëse, është një parim i rëndësishëm i sistemit të propozuar.

Autoriteti Rajonal i planifikimit është çdo Rajon, sipas juridiksionit territorial dhe fushëveprimtarisë qeverisëse që është përcaktuar në legjislacinin *'Për organizimin dhe funksionimi e Qeverisjes Rajonale'*. Ky legjislacion, sikurse do ta shohim më tej në këtë punim, duhet të hartohet në funksion të Reformës Territoriale-Administrative të re. Titullari i Rajonit është autoriteti vendimmarrës kurse zyrtarët e strukturës organizative të Drejtorisë së Politikave

Territoriale janë këshilluesit politik të tij. Titullari i Rajonit dërgon për miratim në Këshillin Rajonal instrumentat e planifikimit të territorit dhe kontrollit të zhvillimit dhe miraton lejet e ndërtimit në përputhje me instrumentat e planifikimit të miratuara më parë nga Këshilli Rajonal. Sikurse do ta shohim më tej në këtë punim, Këshilli i Rajonit do të formohet nga zgjedhje lokale. Sistemi i ri propozon që funksioni i kontrollit të territoreve për zhvillime informale, rajonet tja delegojnë njësive të pushtetit vendor.

Autoriteti Vendor i planifikimit është çdo Njësi e Qeverisjes Vendore, sipas juridiksionit territorial dhe fushëveprimtarisë qeverisëse që është përcaktuar në legjislacionin *‘Për organizimin dhe funksionimi e Qeverisjes Vendore’*. Kryebashkiaku është autoriteti vendimarrës kurse zyrtarët e strukturës organizative të Drejtorisë së Politikave Territoriale janë këshilluesit politik të tij. Kryebashkiaku dërgon për miratim në Këshillin Bashkiak instrumentat e planifikimit të territorit dhe kontrollit të zhvillimit dhe miraton lejet e ndërtimit në përputhje me instrumentat e planifikimit të miratuara më parë nga Këshilli Bashkiak.

Sikurse e prezantuar më sipër, çdo autoritet boton në bazën elektronike të të dhënave të gjithë vendimarrjen që ka kryer dhe proceset e planifikimit në të cilat ndodhet. Kushdo, nga këto autoritete, por edhe palët e interesuara, apo qytetarët e prekur nga zhvillimi i propozuar apo i lejuar, ka akses të plotë në këtë bazë të dhënash, dhe të drejtën të kundërshtoj administrativisht dhe juridikisht këto vendimarrje kur ndihet i prekur prej tyre. Parimi i *‘bashkërendimit’* ndërmjet autoriteteve dhe *‘transparencës’* me publikun dhe *‘llogaridhënies’*, që përmbush ky proces dhe kjo bazë elektronike të dhënash, janë dy parime shumë të rëndësishme të sistemit të propozuar.

Proceset e hartimit dhe miratimit të instrumentave të planifikimit, në sistemin e propozuar të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, janë procese plotësisht të hapura për palët e interesuara dhe qytetarët e prekur nga zhvillimi potencialisht i propozuar prej tyre. Veçanërisht proceset e planifikimit vendor ku çështjet që trajtohen janë më të prekshme nga qytetari dhe e prekin atë në mënyrë të drejtëpërdrejtë, do të kthehen në një axhendë kuvendimesh të palëve të interesuar dhe qytetarëve pjesmarrës, sipas temave specifike duhej hartuar dhe bërë publike. Salla e mbledhjeve të Këshilli Bashkiak, ku duhet të zhvillohen takimet për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit, do të hapen për të përfshirë të gjitha organizatat shoqërore të tematikave të ndryshme, si trashëgimisë, ekonomike, kulturore, mjedisore, shëndetsore, artistike e sportive. Sistemi i propozuar kërkon tërhiqjen në debatet tematike të gjitha departamentet shkencore të universiteteve dhe intelektualët e qytetit. Dhe paralelisht me këto, administrata e bashkisë që kryen rolin e moderatorit të kuvendimeve, të ofruesit të informacioneve dhe të

dhënave zyrtare, si përfaqësues të interesave të grupeve minoritare dhe të papërfshira, si sekretariat teknik që protokollon të gjitha dakortësitë e arritura në kuvendime, duke i kthyer ato ose në harta ose në materiale të shkruara.

Ngjashmërisht edhe në nivelin Rajonal dhe Kombëtar, proceset e hartimit të instrumentave të planifikimit do të jenë të hapura për palët e interesuara, si përshtembull por jo vetëm, organizatat qeveritare apo jo qeveritare, fitimprurëse apo jo fitimprusë dhe në mënyrë të veçantë organizatat e sipërmarrjes në atë fushë zhvillimi për të cilin po hartohet ai instrument planifikimi.

6.3. Reforma administrative-territoriale e rikonceptuar sipas parimeve libertariane.

Në këtë seksion do të vlerësojmë dinamikat e reformës administrativo-territoriale dhe do të propozojmë disa parime për një reformë të re.

6.3.1. Reformat territorialo-administrative në tre fazat e para të qeverisjes territoriale.

Reforma e parë territorialo-administrative u miratua në qershor të vitit 1992 nga qeveria e parë demokratike (Biberaj, 2000; Meksi, 1997). Ajo u projektua si një domosdoshmëri e demokracisë që po përfshinte vendin që ditët e para të qeverisë së re. Meksi, në programin e qeverisë 1992-1996, do të theksonte se “Reformat administrative dhe përmirësimet cilësore duhet, gjithashtu, të kryhen edhe në nivelin lokal, në mënyrë që politika ekonomike e Qeverisë qendrore të zbatohet në tërë vendin” (Meksi, 1992).

Po kështu Çili do të nënvizonte se Qeveria Meksi bëri reforma të mëdha dhe të guximshme në fazën e parë, për të nënvizuar edhe në lidhje me luftën që bëri qeveria Meksi kundër centralizimit të thellë të regjimit komunist. Sipas Çilit ajo “hoqi shumë prej institucioneve ekonomike dhe praktikave që kishte lënë shteti i centralizuar” (Çili, 2013: 42).

Në prezantimin e Programit Qeverisës, 1992-1996 Meksi do të nënvizonte se pa kryer reformën administrative dhe demokratike në nivel lokal, revolucionin politik dhe ekonomik nuk do të jetë i plotë (Meksi, 1992).

Në zbatim të kësaj prerogative u miratua ligji nr. 7572/1992 ‘*Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal*’” sipas të cilit Shqipëria ndahej në 36 rrethe, 44 bashki dhe 313 komuna

(INSTAT, 2014: 13). Në nivel rrethi, bashkie dhe komune u ngritën këshillat lokalë me të zgjedhur nga populli dhe kryetarët e bashkive dhe komunave si organ ekzekutiv të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli (FZ, nr. 3, 1992).

Sidoqoftë, decentralizimi nuk eci me shpejtësinë e kërkuar, për arsye të bllokimit të shpeshtë që i bënte këtij procesi Partia Socialiste nën frymëzimin centralist të ideologjisë Parti-Shtet (HIS Alumni et al, 1998; Biberaj, 2000). Sikurse do të shprehej Aliaj dhe Aliaj “megjithëse autoritetet qendrore kanë nisur një proces decentralizimi në drejtim të pushtetit lokal, praktikisht ky proces është i ngrirë për arsye politike” (HIS Alumni et al, 1998: 103).

Më pas, në bazë të ligjit nr. 7608/1992 ‘*Për prefekturat*’ u krijuan 12 prefektura, si njësi që drejtohen nga prefekti i emëruar nga Këshilli i Ministrave. Çdo prefekturë përfshinte nga 2 deri në 4 rrethe (FZ, nr. 9, 1993). Nga viti 1992 deri në vitin 2000 janë bërë disa ndryshime të pjesshme në ndarjen administrativo-territoriale pa ndryshime strukturore (INSTAT, 2014: 13).

Faza e dytë e qeverisjes territoriale, 1997-2005, ka një rëndësi të veçantë për reformimin e dimensionit territorialo-administrativ të vendit. Për tu fokusuar në politikat në lidhje me territorin dhe administrimin e tij, në këtë periudhë ishte reforma territoriale që u konkretizua me ligjin nr. 8652/2000 ‘*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*’, shpallur me Dekretin nr. 2729, datë 7.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Rexhep Meidani (FZ, 2000). Kjo reformë nuk preku konceptin e ndarjes gjeografike dhe shtrirjes territoriale të njësive të Qeverisjes Vendore (Fuga, 2019). Të cilat referuar pikës 4, të nenit 5, të Kreut II-të, të ligjit nr. 8652/2000 ishin tre lloje: qark, niveli i dytë i qeverisjes vendore dhe bashki dhe komunë, njësiti bazë të qeverisjes vendore (FZ, 2000).

Së bashku me ligjin nr. 8653/2000 ‘*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të Qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*’ shënuan fundin e Këshillave të mëparshëm të Rretheve (INSTAT, 2014: 13), duke zvogëluar kështu ndikimin e drejtëpërdrejtë politik të shtetit mbi veprimtaritë e pushtetit vendor. Kjo krijoi një kuadër të qëndrueshëm ligjor që do të mundësonte funksionimin e strukturave administrative dhe fiskale të decentralizuara (BB, 2007, 2012). Referuar BB “Një pjesë e rëndësishme përgjegjësisë qeverisëse, përfshi sigurimin e shërbimeve publike, u transferuan në nivelet e qeverisjes vendore.” (BB, 2007: 26)

Me gjithë disa elementë pozitiv për kohën, në lidhje shpërndarjen e funksioneve qeverisëse, aritjet e reformës së vitit 2000 u vjetëruan shumë shpejt (BB, 2007; Aliaj, 2008). Kjo për dy arsye, së pari decentralizimi i funksioneve qeverisëse ishte minimalist dhe së dyti, ndarja territoriale ishte një konfirmim i ndarjes territoriale të vitit 1992 (Fuga, 2019).

Kështu që në diskursin politik dhe publik lindi nevoja e ndërmarrjes së një reforme të re. Aliaj në vitin 2008 do të theksonte se “Vitet e fundit është prekur gjithmon e më shumë opinionin se Shqipëria ka nevojë për një reformë të thellë territoriale në funksion të një qeverisjeje më të mirë të vendit” (Aliaj, 2008: 127).

Reforma ishte bërë e domosdoshme për të adresuar problemet e mëdha të krijuara nga fragmentarizimi i tepruar i territorit të vendit, për ta thelluar procesin e decentralizimit në Shqipëri, duke përfshirë decentralizimin fiskal, si dhe për marrjen e përgjegjësisë të planifikimit dhe administrimit të territorit prej qeverisjes vendore (INSTAT, 2014).

Miratimi i një ligji me karakteristika të qarta decentralizuese, sikurse ishte ligji 10119/2009 ‘*Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial*’ ishte një kërkesë më tepër për një reformë të thellë dhe të plotë të territorial-administrative. Ky ligj decentralizonte një sërë funksionesh të planifikimit dhe zhvillimit territorial drejt pushtetit vendor, ndërkohë që popullsia ishte përqëndruar në Rajonin e Madh Tiranë – Durrës (INSTAT, 2004, 2014; King dhe Vulnetari, 2003; Vulnetari, 2007, 2012). Sipas BB “Vendosja e njerëzve në zonën Tiranë-Durrës dominon në shpërndarjen e popullsisë urbane.” (BB, 2007: 6).

Një reformë e vërtetë territorial-administrative duhet të mbështetet në zgjidhjen e kësaj problematike shumë të thellë (Aliaj, 2008: 128). Sikurse e kemi prezantuar edhe me parë në këtë punim, qytet e mëdha, të mbipopulluara dhe të densifikuara, dhe qendrat e vogla urbane, të nënpopulluara dhe me densitete të ulta banimi, janë dy llojet e qyteteve më të vështirat dhe më të kushtueshmet për tu administruar (HIS Alumni et al, 1998; BB, 2007). Këtë do ta dallonte edhe BB, sipas të cilës “Menaxhimi urban mungoi pothuajse krejtësisht, në termat e rolit të një qeverisjeje të aftë në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe një kuadri rregullator të mirë-fokusuar dhe fleksibël” (BB, 2007).

Në kuadër të domosdoshërisë, Aliaj në 2008, propozon nevojën e një reforme territoriale dhe administrative në respekt të vlerave, parimeve dhe praktikave perëndimore. Ai shprehej në vitin 2008 se “Tashmë realizimi i plotë i kësaj reforme është një domosdoshmëri urgjente” dhe do të vijonte më tej, edhe “bazuar në situatën dhe kushtet e krijuara sidomos për shkak të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe të procesit dinamik të urbanizimit” (Aliaj, 2008: 128).

Aliaj sillte tre hipoteza për një ndarje territorial-administrative. Hipoteza e parë, sipas rajonizimit të standarteve të BE-s, e cila krijonte 3-4 rajone me nga 800 mijë banorë, me përfitim ngashmërinë me rajonet e BE-s dhe mundësinë për financime në të ardhmen. Hipoteza e dytë ishte sipas data-bazës së INSTAT, e cila e ndan vendin në 4 rajone. Dhe hipoteza e tretë,

është ndarja sipas pellgjeve ujore dhe respekton maksimalisht lidhjen me territorin dhe resurset natyrore, si dhe mbrojtjen e ekosistemeve. Referuar kësaj hipoteze mund të zhvillohen 3 rajone që përafrohen shumë me konceptimin e BE-së (Aliaj, 2008: 132-134). Aliaj, preferon hipotezën e tretë, por synon mbajtjen e qarqeve, të cilat do të përputheshin me numrin e pellgjeve ujore, që në Shqipëri janë shtatë.

Një qasje tjetër interesante mbi një ndarje territorial-administrative, por kësaj radhe nga pikëpamja historiko-etnografike, na vjen nga studiuesi Rrok Zojzi në artikullin *'Ndamja krahinore e popullit shqiptar'* (Zojzi, 1962).

Në këtë artikull, Zojzi ka skicuar ndarjen krahinore të popullit shqiptar, që sipas tij është formuar si rezultat i një ndarje kryesore, midis veriut i Shqipërisë që quhet “Gegni” ose “Gegëri” dhe jugut që quhet “Toskëni” ose “Toskëri”. Këto dy krahina identifikohen vetëm në shekullin e XVIII si grupe të mëdha etnografike duke i paraprirë formimit kombëtar shqiptar që kulmon me shekullin e XIX. Kufiri ndarës i këtyre dy krahinave merret lumi Shkumbin (Zojzi, 1962: 23).

Krahinat paraardhëse të Gegnisë, sipas Zojzit, qenë: Gegnia, që i dha emrin këtij grupi të madh dhe që ndodhet në jug të tij, gjatë bregut verior të Shkumbinit; Leknia ose Dukagjini, që shtrihet si një breg i gjanë, gjatë bregut jugor të Drinit; Fushat begdetare të Shqipërisë së Veriut, të cilat nuk formojnë një unitet etnografik, por paraqiten si njësi të vogla të shkëputuna në mes të tyre; Fushat lindore, që përfshijnë Rrafshin e Dukagjinit dhe fushën e Kosovës (Zojzi, 1962: 23). Grupet dhe krahinat etnografike që u përfshinë në formimin e Toskënisë janë: Toskënia, që shtrihet në lindje të Shqipërisë së jugut; Myzeqeja, që shtrihet në perëndim; Labëria, që shtrihet në jugperëndim; por edhe Çamëria, që shtrihet fare në jug, përtej kufinjve politik (Zojzi, 1962: 49).

Ky propozim i Zojzit, megjithëse shumë interesant, nuk mund të shërbej në praktikë pas zhvendosjeve masive të popullsisë shqiptare nga rajonet verior dhe jugore drejt rajonit qendror të vendit përgjatë viteve të tranzicionit. Karakteristikat historike dhe etnografike të popullsisë, tashmë, nuk qëndrojnë më si më parë. Por sidoqoftë mund të ndihmojnë, nëse shikohet si një nga dimensionet e ndryshme për ndarjen territorialo-administrative.

6.3.2. Reforma territorialo-administrative 2014 dhe nevoja për një reformë të re.

Një nga nismat më të rëndësishme politike, të fazës së katërt të qeverisjes në lidhje me territorin, ishte Reforma administrative-territoriale. Këtë reformë, ajo, e strukturroi në dy ligje specifike (QBZ, 2018).

Së pari, ligji nr. 115/2014 *‘Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë’*, i cili formësoi një ndarje të re administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë, duke shfuqizuar ndarjen e mëparshme të përcaktuar me ligjin nr. 8653/2000, *‘Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë’* (FZ, nr. 137, 2014).

Së dyti, ligji nr. 139/2015 *‘Për Vetëqeverisjen Vendore’*, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e organeve përkatëse, dhe shfuqizon nr. 8652/2000 (FZ, nr. 249, 2016).

Kjo reformë, sikurse do ta argumentojmë në vijim, dëmtoi demokracinë lokale në dy mënyra, së pari duke larguar politikanin e votuar nga qytetarët dhe në vend të tij solli administratorin e emëruar, dhe së dyti duke zvogëluar ‘funksionet e veta’ të Njësive të Qeverisjes Vendore. Në kuptimin administrativ, ndarja e re administrativo-territoriale ul numrin e bashkive nga 65 sipas ligjit nr. 8653/2000 *‘Për ndarjen administrative dhe territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë’* (FZ, 2000) dhe nuk prek konceptin qark, si njësi e qeverisjes vendore, si dhe numrin e tyre që mbeten 12 (FZ, nr. 137, 2014).

Sikurse do të theksonte raporti shoqërues i projekt ligjit “Ndarja administrative-territoriale në nivelin e qarqeve mbetet e pandryshuar, me 12 qarqe. Rrethi si njësi territoriale dhe nën-ndarje e qarkut është suprimuar në kushtet kur numri i bashkive është zvogëluar në 61 të tilla” (MB, 2014: 5).

Ligji i ri zhduk konceptin komunë si Njësi e Qeverisjes Vendore duke sjellë një koncept të ri, atë të ‘Zonave Funksionale’ që përfshijnë të dyja tipologjitë e Njësive të Qeverisjes Vendore. Raporti shoqërues i tij do të prezantonet se “Kriteri kryesor i zonave funksionale parashikon ndërthurrjen e zonave urbane dhe rurale në një njësi të vetme administrative, duke bashkuar bashkitë dhe komunat” (MB, 2014: 6).

Sipas ligjit të vitit 2000, ndarja administrative-territoriale e Shqipërisë bazohej në 12 qarqe, 65 bashki dhe 308 komuna; kurse ndarja e re territoriale ndryshon konfigurimin administrativ të ndarjes së vjetër, dhe ky ndryshim konsiston në tre pika kryesore.

Së pari, zvogëlohet numri i njësive vendore të nivelit të parë, ndërsa mbetet pa prekur koncepti dhe numri prej 12 i njësive vendore qark, të cilat tashmë kanë nga 5-6 bashki të reja. Gjithashtu hiqen ndarja e territorit në rrethe, kurse numri i bashkive që ishte sipas ndarjes së vitit 2000, të rritur gjatë viteve deri në 65, zbret nga ndarja e re në 61 bashki (MB, 2014). Sikurse do të theksohej në relacionin që shoqëroi ligjin:

“Rrethi si njësi territoriale dhe nëndarje e qarkut është suprimuar në kushtet kur numri i bashkive është zvogëluar në 61 të tilla. Në disa raste territori i bashkive të reja përkon edhe me kufinj të rretheve dhe mesatarisht çdo qark përbëhet nga 5 deri në 6 bashki” (MB, 2014: 6).

Së dyti, suprimohet koncepti “komuna”, si një nëndarje territoriale dhe këto territore përfshihen nga bashkitë e reja, dhe lind koncepti “zona funksionale”. Në kuptim praktik, ky suprimim do të thotë shkrirja e territoreve të komunave në territoret e bashkive ekzistuese. Sikurse Relacioni që shoqëroi ligjin do të theksonte “Kriteri kryesor i zonave funksionale parashikon ndërthurjen e zonave urbane dhe rurale në njësi të vetme administrative, duke bashkuar bashkitë (si rregull zona urbane) dhe komunat (si rregull zona rurale)” apo më tej në këtë raport “Komunat dhe bashkitë ekzistuese që përthithen nga njësia e re vendore, do të konsiderohen me ligj si nëndarje të bashkisë të quajtura njësi administrative, të cilat do ruajnë kufijtë e tanishëm ekzistues” (MB, 2014: 6).

Kjo solli ndryshimin e tretë, në ndryshim me ndarjen e vjetër komunat dhe 11 njësitë administrative të Tiranës që gjithashtu u suprimuan, nuk do të drejtohen më politikanë të votuar por nga të “administratorë” të emëruar nga Kryebashkiaku përkatës (MB, 2014).

Nga njësi që votonin për këshillin e tyre komunar dhe kryekomunarin e tyre, përfshirë njësitë administrative të Tiranës, ato do të drejtoheshin nga kryetarët e bashkive që i kishin përfshirë dhe do të përfaqësohen nga këshillat bashkiakë. Sikurse raporti shoqërues i ligjit do të nënvizonte “Projektligji parashikon që riorganizimi administrativo-territorial i Bashkisë Tiranë të bëhet duke bashkuar Bashkinë Tiranë me 11 njësitë e saj bashkiake, me 13 komuna ekzistuese. Bashkia e re Tiranë propozohet të përfshijë 14 njësi vendore aktuale” (MB, 2014: 6).

Dy ishin produktet e kësaj reforme dhe të dyja negative, së pari ishte kthimi mbrapsht në proceset decentralizuese (Fuga, 2019: 228-232), dhe së dyti i shpërdorimi i një mundësie të veçantë që vendi të kishte një ndarje territoriale që do të mundësonte atij një model të ri territorial.

Reforma territoriale e vitit 2014 që në filesat e projektimit politik të saj nisi si një reformë me synime thjeshtë ekonomike. Diskursi i bollshëm politik mbi të mundohej të prezantonte këtë nismë politike, si një përfitim të madh ekonomik për vendin dhe veçanërisht për qeverisjen vendore. Ne do të fokusohemi te ‘*Relacioni për projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*’, i cili do të theksonte se “mazhoranca qeverisëse caktoi si një nga prioritetet kryesore të programit të saj kryerjen dhe zbatimin e reformës administrativo-territoriale, me synim rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike vendore dhe fuqizimin e njësive të qeverisjes vendore” (MB, 2014: 6).

Sipas relacionit:

“Ndërkohë që argumenti i demokratizimit të qeverisjes teorikisht shkon në linjë me njësitet vendore të vogla dhe të përfaqësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, niveli i lartë i fragmentimit në njësitet vendore rezulton të jetë bërë pengesë për decentralizimin e plotë të shërbimeve e përgjegjësi si rezultat i mungesës së kapaciteteve e mos garantimit të ekonomisë së shkallës, pra efikasitetit ekonomik në ofrimin e funksioneve, duke shërbyer kështu edhe si kundër argument për demokratizimin” (MB, 2014: 14).

Pra, qartësisht dhe pa asnjë shqetësim ‘*Relacioni*’ shpalos qasjen antidemokratike të Reformës, e cila vendoste efikasitetin ekonomik mbi demokratizimin. Të njëjtin vlerësim do të prezantonte për këtë reformë edhe Fuga, sipas të cilit “reforma udhëhiqet në të vërtetë nga ideja se midis parimit të demokracisë dhe parimit të efikasitetit, parimi i dytë është kryesori: sikur u dashka të sakrifikohet demokracia për efikasitetin funksional” (Fuga, 2019: 228).

Për fazën e katërt të qeverisjes territoriale, parimi i demokracisë dhe parimi i efikasitetit janë në kundërshtim të njëri-tjetrit dhe kjo vjen nga mendësitë e vjetra etatiste të kësaj qeverisje. Në përputhje me këtë, Fuga do të gjente fajtorë “mendësi unitariste, piramidale, vertikale e menaxhimit të së mirës publike” (Fuga, 2019: 231), të kësaj qeverisje, e cila kishte vendosur të zhvillonte një reformim të ndarjes territorial që prioritetizonte efikasitetin ekonomik, mbi demokracinë.

Kjo reformë e shikon pushtetin vendor si një qeverisje të lidhur vetëm me aspektin e realizimit të funksioneve ekonomike dhe nuk dallon te ky nivel qeverisës dimensionin e shprehjes në nivelin lokal të vullnetit politik të sovranit.

Në ‘*Relacionin*’ shoqëruar gjejmë edhe argumentimin pse autorët e saj e ndërmorën këtë proces reformues mbi parime anti-demokratike dhe pro-efikasitetit të njësive vendore “komunë”.

Së pari, ata sjellin faktin se “niveli i lartë i fragmentimit në njësitë vendore rezulton të jetë bërë pengesë për decentralizimin e plotë” (MB, 2014: 14). Që decentralizimi të ecte me hapat e duhura, sipas hartuesve të reformës, duhej larguar nga qytetari pushteti për të zgjedhur Kryekomunarin dhe Këshillin Komunar.

Një argument tjetër që sjellin hartuesit e reformës, ishte se fragmentarizimi i lartë sillte kosto të larta për mbajtjen e punonjësve të administratës dhe nivele të ulta investimesh publike. Në relacion nënvizohej se “Mesatarisht NJQV-të në Shqipëri shpenzojnë 27% të buxhetit të tyre për investime kapitale dhe 37% për pagat e punonjësve” (MB, 2014: 15).

Në të kundërt, reforma territoriale nuk shkurtoi nivelin administrativ, por politik, sepse administrata e komunave tashmë konsiderohet si administrata e ‘Njësisë Administrative’. Këtë mund ta dallojmë në relacionin shoqëruar, i cili do të shprehej se “Komunat dhe bashkitë ekzistuese që përthithen nga njësia e re vendore, do të konsiderohen me ligj si nëndarje të bashkisë të quajtura njësi administrative, të cilat do ruajnë kufijtë e tanishëm ekzistues” (MB, 2014: 6).

Ajo që ndodhi kishte të bënte vetëm me suprimimin e rolit të “kryekomunarëve” dhe “këshillave komunare”, të cilët më parë shprehin vullnetin politik të qytetarëve. Kjo do të thotë se, reforma jo vetëm nuk rregulloi aspektin e efikasitetit ekonomik, por thjeshtë dëmtoi aspektin demokratik të saj. Këtë fenomen do ta nënvizonte shumë fortë edhe Fuga në vitin 2019, i cili do të nënvizonte se “Përfaqësuesit e banorëve të një komune janë të pazëvendësueshëm për të shprehur e përfaqësuar vullnetin e elektoratit lokal përpara pushtetit qendror” (Fuga, 2019: 231).

Në të kundërt të synimeve të reformës, performanca ekonomike e bashkive të reja është përkeqësuar ndjeshëm. Nëse i referohemi raport vlerësimit të saj nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, do të shohim shifra të tjera nga ato të synuarat. Referuar këtij raporti:

“Me implementimin e reformë administrative territoriale, raporti mes shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve korrente është i njëjtë me raportin e vitit 2010-2011, me ndryshime të papërfillshme. Në një analizë karahasimore, kjo tregon se 300 komunat dhe 60 bashkitë e mëparshme kanë të njëjtin raport shpenzime korrente-shpenzime kapitale me 61 bashkitë e reja të reformës administrative territoriale.” (KLSH, 2018: 81).

Për më tepër “Rritja e shpenzimeve të personelit (në vitin 2017 janë dy herë më të larta se 2013) dhe atyre operative nuk pajtohet me objektivin madhor të reformës administrative dhe

territoriale, rritjes së eficiencës operacionale dhe tkurrjes së kostove administrative” (KLSH, 2018: 81).

Por as argumenti i dytë i reformës, nënvizuar në relacionin shoqërues “Shumica e studimeve dhe analizave për qeverisjen vendore në Shqipëri pas viti 2000, evidentojnë fragmentimin e madh të territorit dhe numrin shumë të madh të NJQV-ve, që kanë popullsi shumë të vogël dhe burime dhe kapacitete shumë të ulta” (MB, 2014: 5), nuk qëndron. Kjo sepse, sikurse e përmendëm më parë, reforma nuk e ndryshoi administratën dhe në këtë kuptim të shpresonim për një rritje të nivelit të saj. Reforma thjeshtë, hoqi nivelin politik të përfaqësimit dhe i ndryshoi emrin këtij niveli të qeverisjes vendore nga “komunë” në “njësi administrative” (FZ, nr. 137, 2014; QBZ, 2018).

Argument i tretë dhe i fundit për të cilën është preferuar të suprimohet pushteti politik i përfaqësimit të qytetarëve në pushtetin vendor të nivelit komunë qëndron në pabarazinë në të drejtat qytetare dhe në shkallën e përfaqësimit të tyre (MB, 2014). Refruar *‘Relacionit’* në komuna që ka pak banorë, një antar i këshillit bashkiak zgjidhet të përfaqësoj më pak qytetarë sesa në një bashki ku meqë ka shumë herë më shumë banor, përfaqësuesit në këshillin bashkiak përfaqësojnë më shumë banorë, çka do të thotë se një qytetar në një bashki është më pak i përfaqësuar se një qytetar në një komunë (MB, 2014). Në të nënvizohej se “Madhësia nga pikëpamja e popullsisë e bashkive/komunave luhetet shumë” (MB, 2014: 12).

Ky argument në terma numerik qëndron, sikurse e kemi ngritur edhe në këtë punim, çështja e shpërndarjes së popullsisë ka krijuar modelin territorial të koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia. Porse, demokracia, veçanërisht ajo lokale, nuk ka për bazë dimensionin numerik, por dimensionin përfaqësues dhe përfshirës në procese politike dhe administrative (EU, 1994, 1999, 2003, 2007, 2011; UNECE, 2008; CNW, 1996; Boonstra dhe Boelens, 2011; Arnstein, 1969; Fuga, 2012, 2019; Aliaj, 2008).

Në këtë kuptim, zgjidhja nuk mund të jetë zvogëlimi i nivelit të demokracisë, në të kundërt duhet fuqizuar demokracia e përfaqësimi lokal në kuadër të decentralizimit, në mënyrë që të kemi një shpërndarje më të drejtë të popullsisë nëpër territorin kombëtar (Meijers, 2005, 2007; Vasanen, 2013; Davoudi, 2003, 2008).

Për më tepër, ky argument bie në kundërshtim me argumentet e para. Sipas relacionit, argument i dytë ishte paaftësia dhe niveli i ulët i administrative lokale në komuna për ti shërbyer komuniteteve të banorëve të komunave, çfarë bie në kundërshtim me argumentin se komunitet qytetare qënkas mbi përfaqësuar në qeverisjen vendore.

Fuga në vitin 2019 do të na jepte një argument sociologjik që e rëzon këtë argument qeverisës. Sipas tij, një komunitet rural, megjithëse mund të jetë më i vogël në numër ka më shumë problematika të cilat duhet të adresohen nga qeverisja lokale sesa një komunitet më i madh në qytet. Ai do të prezantonte se, nëse një komunitet prej 100 familjesh në qytet mund të jetojnë në një pallat të vetëm, kurse 100 familje në fshat janë 100 banesa të shpërndara nëpër një territor shumë të gjerë. Përveç kësaj problematikë që ndesh një pallat nuk mund të barazohen me pafundësinë e problematikave që ndeshen në një fshat megjithëse bëhet fjalë për të njëjtin numër qytetarësh dhe familjesh (Fuga, 2019: 233-237).

6.3.3. Propozimi për një reformë administrativo-territoriale nga qasja libertariene.

Reforma administrativo-territoriale e cila përcakton aktualisht nivelet e qeverisjes vendore dhe fushëveprimtarinë e secilës prej tyre, dukshëm ka dështuar (Fuga, 2019; KLSH, 2018). Referuar Raportit të KLSH, dallohet qartë se reforma ka dështuar në të gjitha synimet e saj ekonomike (KLSH, 2018).

Synimet ekonomike ishin bazike për këtë reformë, kurse synimet në fushën e demokracisë, dhe veçanërisht të demokracisë lokale nuk kishin rëndësinë e duhur. Vet relacioni shoqëruar i ligjit pranon se preferon parimin e efikasitetit ekonomik mbi parimin e demokratik (MB, 2014).

Në këtë kuptim, mbetet nevojë në dimensionin e domosdoshmërisë një reformë tjetër administrativo-territoriale. Autorë të rëndësishëm e vlerësojnë të domosdoshme një reformë të tillë në vite të ndryshme të rtranzicionit (IHS Alumni et al, 1998; Aliaj, 2008; Immi et al. 2008) dhe e vlerësojnë si një dështim të rëndë tentativën e fazës së katërt të qeverisjes territoriale për të bërë një reformë të tillë (Fuga, 2019: 228-237).

Ky punim do të guxojë modestisht të japi disa shtylla për një reformë administrativo-territoriale mbështetur në parimet libertariene. Ne i kemi prezantuar ato më parë në këtë punim, dhe janë parimi i subsidiaritetit, apo procesi i decentralizimit të funksioneve qeverisëse drejt pushtetit vendor dhe parimin e fuqizimit të qytetarit në qeverisjen vendore.

Parimi i parë, ai i subsidiaritetit, synon të afrojmë vendimarrjen për planifikime apo zhvillime urbane dhe ndërtimore sa më afër qytetarëve dhe komuniteteve, cilësinë e jetës së të cilëve këto zhvillime prekin apo ndikojnë. Ai synon gjithashtu zhvillimin lokal të mbështetur në specifikën dhe karakteristikat gjeografike, territoriale, natyrore dhe kulturore të çdo njësie të qeverisjes vendore. Diversifikimi i mundësive të zhvillimit mbështetur në specifikën lokale është një

domosdoshmëri për një zhvillim të zgjuar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, sepse prodhon një shumësi mundësisht për zhvillim lokal dhe një sinergji për zhvillimin kombëtar (Meijers, 2005, 2006, 2007; Vasanen, 2013; Parr, 2004; Davoudi, 2003, 2008).

Kurse parimi i dytë, ai i fuqizimit të qytetarëve në qeverisjen vendore synon përfshirjen e qytetarëve dhe komuniteteve në proceset e planifikimit dhe procedurat e lejimit të zhvillimit në territoret ku këta jetojnë dhe punojnë. Kjo prodhon një zhvillim të zgjuar të qëndrueshëm, por veçanërisht gjithëpërfshirës, sepse vetëm qytetarët e përfshirë në proceset e planifikimit të zhvillimit mund të përfshijnë interesat e tyre në zhvillimin e ardhshëm (Boonstra dhe Boelens, 2011; UNECE, 2008; Arnstein, 1969).

Mbi këto parime të rëndësishme për libertarianizmin ne kemi folur gjerësisht më parë në këtë punim (Mill, 2005; Locke, 2005; Spencer, 2005; Friedman, 2005). Ne gjithashtu kemi argumentuar se këto parime janë shumë të rëndësishme edhe për institucionet politike dhe teknike (planifikimit dhe zhvillimit territorial) të Bashkimit Europian apo të organizatave të rajoneve më të gjera, deri në globale (EC, 1994, 2005, 2011, 2015; EU, 1999, 2003, 2004, 2007, 2009, 2010; ECTP, 2003; UNECE, 2008).

Të gjitha propozimet e dokumenteve politike të institucioneve ndërkombëtare, të përmendura, të referuara apo të cituara në këtë punim, por edhe të tjera që nuk janë përmendur në këtë punim, me synimin për të mos rënë në përsëritje, kanë frymëzuar propozimin tonë modest për një reformë të re. Ai limitohet vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe funksioneve qeverisëse që lidhen me të, dhe vjen si komplementar i propozimit për një sistem ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit territorial.

Propozimi ynë për një reformë të re administrativo-territoriale e vendos qeverisjen në tre nivele qeverisëse: nivelin kombëtar; nivelin rajonal dhe nivelin vendor. Këto nivele duhet të jenë plotësisht autonome nga njëra-tjetra por në bashkërendim të plotë me njëra tjetrën, përsa i përket funksioneve që secila prej tyre ushtron në qeverisjen territoriale. Në lidhje me funksionet në qeverisjen territoriale, ky bashkërendim është prezantuar më parë në këtë punim, kur kemi prezantuar propozimin tonë për një reformë në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial.

Kjo reformë e re do të kërkojë një strukturim të fortë të fushëveprimtarisë së qeverisjes qëndrore. Shoqëria shqiptare një tranzicioni të gjatë dhe ecejakesh me shumë kthesa, shpesh të pakuptimta dhe të pajustificuara, ka nevojë për një qasje tjetër ndaj organizimit të saj politik e

institucional (Biberaj, 2000; Fuga, 2003, 2004; Aliaj, 2008; Imami et al, 2008; Krasniqi, 2008, 2009).

Në këtë kuptim të gjerë, Shqipëria ka domosdoshmëri për një qasje shumë më të thjeshtë dhe më racionale në marrdhënien individ-shoqëri-shtet. Kjo, më së pari, nënkupton një përcaktim të ri se çfarë funksionesh i ngarkon shoqëria qeverisjeve, të treja së bashku (kombëtare, rajonale, lokale) si fushë të veprimtarisë së tyre, dhe çfarë e mban të sferës private për ti ushtruar nëpërmjet mekanizmave të tregut të lirë. Dhe do të sjelli më shumë hapsira lirie për qytetarët në procesin e bërjes dhe ribërjes së hapsirave dhe territoreve ku jetojnë; dhe një ngushtim të aktivitetit qeverisës në këta sektorë.

Kjo e dyta do të siguroj edhe fokusimin e burimeve njerëzore, legjislative dhe financiare të qeverisjesjeve, në ato çështje ku roli i saj është i domosdoshmë dhe i nevojshëm, çfarë rit performancën qeverisëse dhe ul nivelin e korrupsionit (Spencer, 2005; Friedman, 2005).

Proçesi i dytë, i cili ka lidhje me reformën e propozuar modestisht nga ne, është ai i shpërndarjes së pushtetit qeverisës në secilën nga tre nivelet e qeverisjes. Ky proçes duhet të frymëzohet nga parimi i *subsjaritetit*, i cili shprehet nga qasje decentralizuese e funksioneve qeverisëse. Ai mbështetet në logjikën se nëse shoqëria i kalon qeverisjeve ca pushtet është më mirë që ky pushtet të ushtrohet në nivelin sa më afër qytetarit dhe territorit (Friedman, 2005).

Vetëm pasi kalohen këto dy hapa thelbësorë, mund të kalojmë në përcaktimin sasiar të njësive të çdo niveli lokal dhe hartimin e një harte me kufinj të administrative të njësive të pushtetit vendor. Sepse nuk mund të përcaktojmë madhësinë gjeografike apo demografike të një moduli njësie qeverisje vendore nëse nuk dimë çfarë fushëveprimtarie qeverisëse do të ushtrojnë ato. Sikurse, nuk mund të përcaktojmë se çfarë pushteti do ti lëmë secilit nivel qeverisës nëse nuk përcaktojmë më parë se, çfarë pushteti do të kenë qeverisjet si një unitet i vetëm.

Për këtë arsye dhe brenda kufinjve të punimit, të cilat janë rreptësisht në kuptim të çështjeve territoriale dhe të zhvillimit të tij, ky propozim nuk hyn në detaje të ndarjes së funksioneve midis tre niveleve të qeverisjes. Por i qëndron propozimit se kush do jetë fusha e veprimtarisë së secilit nivel qeverisës në fushën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, sikurse i kemi prezantuar më parë në këtë punim, kur folëm për reformën e planifikimit dhe zhvillimit territorial.

Nisur nga niveli vendor, propozimi synon të mbahet modeli i bashkive por të studijohet më tej numri i tyre, kjo me referencë nivelin e funksioneve qeverisëse që do ti kalohen këtij niveli.

Përsa i përket nivelit rajonal, ne mbështesim modelin policentrik europian të Rajoneve Policentrike Urbane (Meijers, 2005, 2006, 2007; Davoudi, 2003, 2008; Kloosterman dhe Musterd, 2001; Parr, 2004).

Propozimi preferon skemën e rajonalizimit sipas standarteve të BE-së, për 3-4 Rajone me popullsi të projektuar për të ardhmen prej 800 mijë deri në 1 milion banorë. Duke qenë se modeli aktual territorial i koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia, prezanton vetëm rajonin Tiranë-Durrës; dhe rajoni i mesëm Fier-Vlorë, ndërkohë që tetë qarqet e tjera të vendit janë në shpopullim të thellë ose janë duke u shpopulluar, nuk e mundëson një ndarje të drejtë të territorit respektuar shpërndarjen aktuale të popullsisë. Në këtë kuptim, punimi prezanton rajonizimin territorial mbështetur në pëllgjet ujëmbledhëse të vendit, të cilat duke qenë se janë 7 (Aliaj, 2008) duhet të grupohen për të krijuar 3-4 rajone territoriale.

Një reformë administrative-territoriale e mbështetur në këto shtylla të propozuara, së bashku me sistemin e propozuar në këtë punim të legjislationit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit do të mund të krijojnë premisat që çështjet territoriale që kanë lidhje me zhvillimin e tij të hyjnë në rrugën e duhur për të siguruar një zhvillim të zgjuar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të territorit kombëtar.

Ndërsa përfundimi i reformës së formalizimit të ndërtimtarisë informale do të mbylli njëherë e përgjithmon plagën e ndërtimtarisë paleje, dy reformat e tjera do të sigurojnë mundësitë konkrete që asnjë individ të mos ketë nevojë të ndërtoj në rrugë informale.

Për më tepër, decentralizimi i funksioneve të qeverisjes territoriale në qeverisjen rajonale dhe vendore, sipas këtyre propozimeve për reformim, do të krijonte parakushtin thelbësor që Shqipëria territoriale të formësohet në tre rajone policentrike urbane, të përbëra nga bashki policentrike urbane.

Ky model territorial do të shërbejë për të krijuar rajone policentrike të formësuara nga qytetet të ndryshme përsa i përket specifikave të tyre, në sinergji me njëra tjetrën, duke maksimizuar prodhimin rajonal. Qeverisjet rajonale autonome që konkurojnë me specifikën e tyre të ndryshme territoriale dhe kulturore në komplemetaritet me njëra tjetrën do të mund të konkuronin më mirë, me prodhimet e tyre, në hapsirën e Bashkimit Europian. Së bashku me fuqizimin e qytetarëve në të treja nivelet e qeverisjes, që mundësojnë këto tre reforma të propozuara dhe zvogëlimin e rolit dhe madhësisë së qeverisjes, rruga e Shqipërisë për tu integruar në Bashkimin Europian do të jetë më e shpejtë dhe më e lehtë.

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.

Në këtë kapitull do të prezantojmë gjetjet e punimit dhe do të ofrojmë disa rekomandime modeste institucioneve politike dhe qeverisëse

7.1.Përfundime.

Në këtë seksion do të prezantojmë përfundimet e punimit.

7.1.1. Qeverisja territoriale e Shqipërisë ka nevojë për një qasje libertariane depërqëndruese.

Modeli i qeverisjes territoriale të viteve pas ndryshimit të sistemit politik karakterizohet nga një qasje përqëndruese. Tre karakteristikat e etatizmit: fushëveprimi i gjerë qeverisës në çështjet territoriale, koncentrimi i fushëveprimit qeverisës në nivelin qëndror të qeverisjes dhe përjashtimi i individit nga proceset dhe procedurat e planifikimit dhe zhvillimit territorial, prezantohen shumë të përfshira në legjislacionin shqiptar të viteve të tranzicionit. Ato dallohen më qartë në praktikën qeverisëse.

Ajo që i duhet qeverisjeve territoriale të së ardhmes është të implementojnë në ushtrimin e aktivitetit qeverisës qasjen e liberalizmit klasik, apo libertarianizmit, si një qasje politike e cila në përputhje me parimet e saj të origjinalizuara nga liria e individit si parim bazik nga ku frymëzohen të gjitha parimet e tjera.

7.1.2. Shqipëria ka nevojë për një reformë në fushën e formalizimit të ndërtesave informale.

Fenomeni i ndërtimitarisë informale ka qenë një fenomen gjerësisht i shpërndarë në dimensionin territorial dhe kohor në Shqipërinë e tranzicionit. Ai ka ndikuar gjerësisht në formësimin e modelit territorial të koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia. Fenomeni i ndërtimitarisë informale ka ardhur si një konsekuencë logjike e qeverisjeve me mentalitet dhe praktikë etatiste të viteve të tranzicionit. Kjo është shprehur gjerësisht në hiper-legjislacion, hiper-administratë, si aspekte të shtetit të madh dhe shtrëngues në çështjet e planifikimit dhe zhvillimit territorial dhe urban, veçanërisht në procedurat e pajisjes së shtetasve me leje formale ndërtimi.

Karakteristikat etatiste të qeverive të tranzicionit në përballjen me këtë problematikë shprehen në, fuqizimin e rolit të qeverisë në procesin e legalizimit të ndërtesave, duke përfshirë në një proces të thjeshtë njohje ligjore të një ndërtimi të kryer informalisht, edhe të një procedure shpronësimi-privatizimi për truallin mbi të cilin ishte zhvilluar kjo ndërtesë.

Një formë tjetër e prezantimit të karakteristikës përqëndruese është centralizimi i funksionit urban të legalizimit të ndërtesave informale, pranë qeverisë qëndore. Këto janë arsytet pse procesi i legalizimeve vijon prej 16 vitesh, kur u hartua ligji i parë për këtë problematikë, dhe nuk dëshmon se do të ketë përmbyllje të shpejtë.

Kjo është arsyeja pse, Shqipëria ka domosdoshmëri rformatimin e legjislacionit dhe praktikave për të përmbyllur këtë problematikë të rëndësishme urbane mbi parime libertariane.

7.1.3. Shqipëria ka nevojë për një reformë të re të sistemit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Përgjatë tranzicionit struktura urbane e vendit dhe gjendja urbane e qëndrave të banuara shqiptare është përkeqësuar në shumë komponentë. Modeli territorial i koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia, dhe gjithë dëmet urbane dhe territoriale, nuk erdhën rastësisht. Ato ishin kosequencë logjike e mënyrës së zhvillimit që qeverisjet territoriale kanë lejuar gjatë këtyre dekadave.

Një aspekt i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit është krijuar ky realitet urban dhe territorial, është edhe legjislacioni në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban dhe territorial të vendit. Qeveritë shqiptare të tranzicionit kanë prodhuar katër legjislacione të ndryshme, sipas fazave të ndryshme të qeverisjes, të cilat i janë nënshtruar ndryshimeve të shpeshta.

Përveç karakteristikës së hiper-legjislacionit, që sikurse e kemi identifikuar në legjislacionin e të gjitha fazave të qeverisjes territoriale, ky legjilacion paraqet problematika të tjera etatiste. Në shumë aspekte të proceseve të hartimit dhe miratimit të instrumentave të planifikimit, legjislacioni ekzistues prezantohet po aq antidemokratik dhe centralizues, në disa raste edhe më shumë, se legjislacioni sektorial i regjimit komunist 1945-1991.

Centralizimi i pushtetit në çështjet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, sipas legjislacionit ekzistues, prezantohet edhe në forma të pa njohura më parë si: krijimi i legjislacionit në kundërshtim me vendimet e gjykatave; vendosja i një hirearkie ku institucionet dhe politikanët e votuar të qeverisjes vendore vihen nën varësinë e institucioneve në varësi të qeverisjes

qëndrore dhe zyrtarëve të emëruar prej saj; institucioneve në varësi të qeverisë qëndrore i jepen funksione të sistemit të drejtësisë, të vlerësimit të legjitimitetit të vendimarrjes së pushtetit vendor; Kryeministrit në rolin e Kryetarit të KKT-s i jepet funksioni për të dhënë leje ndërtimi, etj.

Në këtë kontekst, Shqipëria ka domosdoshmëri ndërmarrjen e një reforme për hartimin e një legjislacioni sektorial në përputhje me parimet libertariane dhe kërkesat dhe udhëzimet e institucioneve të Bashkimit Europian. Kjo reformë është e domosdoshme, edhe për të krijuar parakushtet për të zhvilluar modelin europian territorial të Rajoneve Policentrike Urbane, i cili premtonte ngjashmëri me modelet territoriale të vendeve antare të Bashkimit Europian dhe Bashkimit Europian si një i tërë, dhe gjithë përfitimet që vijnë nga kjo, në procesin e integritetit të vendit në këtë Bashkësi vendesh të demokracisë liberale. Por gjithashtu, edhe për të zhvilluar qyteteve me cilësi të lartë të jetës së qytetarëve që do jetojnë në to.

7.1.4. Shqipëria ka nevojë për një reformë të re administrativo-territoriale.

Në vitet e tranzicionit janë kryer tre reforma administrativo-territoriale të cilat kanë synuar një decentralizim të funksioneve qeverisëse drejt njësive të pushtetit.

Reforma e fazës së parë të qeverisjes 1992-1997, solli ndryshime të forta pozitive në lidhje me demokracinë lokale, sepse promovoi politikanë të votuar në drejtim të Njësive të Qeverisjes Vendore. Kurse reforma e fazës së dytë të qeverisjes 1997-2005, kishte meritën se se vijoi më tej decentralizimin e funksioneve qeverisëse urbane drejt pushtetit vendor. Të dyja nuk mundën të ofrojnë një ndarje territoriale që do të pengonte krijimin e modelit territorial të koncentrim-braktisjes së territorit nga popullsia, dhe të promovonte një zhvillim rajonal të përputhshëm me modelin europian territorial të Rajoneve Policentrike Urbane.

Kurse reforma e ndërmarrë nga qeverisja e fazës së katërt 2013-2020, ishte një mbrapa kthim i theksuar. Ajo ishte një zhbërje e plotë e demokracisë lokale të deri atëherësh, dhe një koncentrim i pushtetit politik në qeverisjen qëndrore. Kjo reformë suprimoi zgjedhjen demokratike të politikanëve të votuar, si kryekomunar dhe antarë të këshillit komunar, dhe i zëvendësoi ata me zyrtarë të emëruar nga partia fituese e zgjedhjeve vendore, të cilat zhvillohen vetëm në 61 Njësi të Qeverisjes Vendore nga 380 të tilla që zhvilloheshin me legjislacionin e vitit 2000-jë.

Në këtë kontekst, është domosdoshmëri për Shqipërinë, marrja e një reforme të re administrativo-territoriale në përputhje me parimet libertariane dhe udhëzimet e kërkesat e Bashkimit Europian për një qeverisje shumë nivelëshe me bazë parimet e demokracisë dhe zhvillim në baza të Rajoneve Policentrike Urbane.

7.2.Rekomandime.

Në këtë seksion perzantojmë disa rekomandime për institucionet politike dhe qeverisëse.

7.2.1. Rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për një reformë ligjore për formalizimin e ndërtesave informale.

Bazuar në gjetjet e këtij punimi modes i rekomandoj Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet qeverisë qendrore të marri nismën e rikonceptimit të legjislacionit në lidhje me legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtesave dhe zonave informale.

Ky rekomandim vlen edhe për partitë që aspirojnë pushtetin politik në të ardhmen, të cilat mund ta vlerësojnë këtë reformë si një pjesë e rëndësishme e programit të tyre qeverisës.

Legjislacioni i ri duhet të mbështetet në dy parime bazike libertariane: zvogëlim i rolit dhe madhësisë së qeverisë dhe rritjen e lirisë së individëve për të kryer transaksione private mes njëri- tjetrit’.

Ai mbështetet në tre shtylla kryesore. Së pari, legalizim i ndërtesës, njohja formale që ky volum ndërtimor ekziston dhe i njihet si pronë ndërtuesit apo ndërtuesve të paligjshëm. Së dyti, kthimi te pronari legjitim, toka mbi të cilin është bërë ndërtimi informal, duke e lejuar atë të përfitoj nga shitblerja e saj apo nga rihzhvillimi i saj në një moment të dytë. Dhe së treti, lënia e mekanizmave të moralshëm të tregut të lirë të veprojnë duke rregulluar marrdhëniet e pronësisë midis dy pronarëve.

Këto tre shtylla do të përshpejtonin procesin e legalizimeve, do ta bënin atë më të drejtë dhe do të zvogëlonin kostot ndaj taksapaguesit publik si për institucione qeverisëse edhe për financim publik. Një mënyrë tjetër për ta përshpejtuar formalizimin e ndërtesave paleje mbështetet në një parim tjetër libertarian, duke e kaluar funksionin qeverisës të legalizimit, integrimin dhe urbanizimin e ndërtesave dhe zonave informale, drejt pushtetit vendor.

7.2.2. Rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për një reformë ligjore për planifikimin dhe zhvillimin territorial.

I rekomandojmë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet Këshillit të Ministrave të hartoj një sistem të ri ligjor për planifikimin dhe zhvillimin territorial dhe urban.

Ky rekomandim mbështetet në përfundimet e këtij punimi modest dhe i drejtohet edhe partive opozitare që synojnë pushtetin, dhe që mund ta vlerësojnë nevojën e një sistemi të ri ligjor për planifikimin dhe zhvillimin territorial dhe urban si pjesë të programit të tyre qeverisës në të ardhmen.

Legjislacioni i ri duhet të jetë në përpythje me parimet libertariane dhe qasjet e Bashkimit Europian për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit territorial dhe urban. Ai duhet të diferencojë dy konceptet bazë: atë të strukturave organizativo-funksionale të sistemit, pra llojet e instrumentave të planifikimit, autoritetet e planifikimit dhe proceset e procedurat administrative ku prodhohen këto instrumenta; dhe, atë të politikave, planeve dhe rregulloreve të zhvillimit.

Legjislacioni i ri duhet të konsiderohet si një sistem gjeneral me dy komponentë kryesor, atë të planifikimit territorial, dhe atë të kontrollit të zhvillimit. Në këto dy komponentë ndërveprojnë tre ingranazhe të mëdha: së pari janë instrumentat e planifikimit territorial dhe instrumentat e kontrollit të territorit; së dyti janë autoritetet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, dhe së treti janë proceset nëpërmjet të cilave këto instrumenta planifikimi dhe kontrolli zhvillimi hartohen, miratohen dhe implementohen.

Palët e interesuara dhe qytetarët e prekur nga zhvillimi, duhet të jenë një autoritet vullnetar i planifikimit, sepse përfshirja e tyre shkon në përputhje me të drejtat e tyre kushtetuese dhe ligjore, dhe jo në zbatim të ndonjë përgjegjësie ligjore. Autoritetet e planifikimit duhet të jenë në përputhje të plotë me funksionet e niveleve të ndryshme qeverisëse, për territorin në juridiksion të tyre. Ato duket të kenë legjitimitet të plotë mbi vendimarrjet e tyre për miratim të instrumenteve të planifikimit dhe lejedhënies ndërtimore në territorin në juridiksion të tyre.

Në legjislacionin e ri duhet që proceset e hartimit dhe miratimit të instrumentave të planifikimit të jenë procese plotësisht të hapura për palët e interesuara dhe qytetarët e prekur nga zhvillimi potencialisht i propozuar prej tyre. Sipas nivelit qeverisës, dhe në këtë kuptim edhe të

fushëveprimtarisë të secilës prej tyre, të përcaktuar më parë me ligje për secilin nivel qeverisës, do të përcaktohet niveli i pjesëmarrjes publike.

7.2.3. Rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për një reformë administrativo-territoriale.

Në kufinj të modestë të përfundimeve të këtij punimi, dhe të fokusuar vetëm në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial dhe urban, i rekomandoj Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet këshillit të Ministrave të ndërmarri një reformë të re administrativo-territoriale.

Ky rekomandim shkon edhe për partitë opozitare që synojnë pushtetin politik në të ardhmen, ta vlerësojnë si një domosdoshmëri një reformë të tillë dhe të mbështesin politikisht nismën potenciale të maxhorancës në Kuvendin e Shqipërisë për të miratuar një reformë të re, ose ta konsiderojnë si pjesë të programit të tyre qeverisës.

Ky rekomandim synon të mbështetet në disa shtylla për një reformë administrativo-territoriale mbështetur në parimet libertariane, të decentralizimit të funksioneve qeverisëse drejt pushtetit vendor dhe të fuqizimit të qytetarit në qeverisjen vendore.

Legjislacioni i ri duhet të jetë në përputhje me parimet e decentralizimit dhe fuqizimit të qytetarit. Parimet e vendosura nga dokumentet e institucioneve të Bashkimit European apo të organizatave të rajoneve më të gjera, deri në globale do të frymëzojnë çdo element të këtij propozimi minimalist për një reformë administrativo-territoriale.

Propozimi e vendos qeverisjen në tre nivele qeverisëse: nivelin kombëtar; nivelin rajonal dhe nivelin vendor. Këto nivele duhet të jenë plotësisht autonome nga njëra tjetra, përsa i përket funksioneve që secila prej tyre ushtron në qeverisjen territoriale, por në bashkërendim të plotë me njëra tjetrën.

BIBLIOGRAFIA.

- [1]. Aldous, J., Durkheim E. and Tonnies F., (1972), '*An Exchange Between Durkheim and Tonnies on the Nature of Social Relations, with an Introduction by Joan Aldous*', American Journal of Sociology, Vol. 77, No. 6 (May, 1972), pp. 1191-1200
- [2]. AIDA, (2019), '*Shqipëria thërret-një vend mundësish*', Tiranë, <http://aida.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Albania-Calls.pdf?fbclid=IwAR2NG61nuerA28iunot23fLbviX8pDgbacCUqm2EbvXtWCabu0loZ0ojU7k>
- [3]. Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, [AKPT], (1993-2017), '*Buletini i Vendimeve të KRRTRSH dhe KKT, 1993-2017*', Tiranë, <http://www.azht.gov.al/al/legjislacioni/legjislacioni/buletini-i-vendimeve-te-krtrsh-kkt-1993-2017/buletini-i-vendimeve-te-krtrsh-kkt-1993-20171496402173>
- [4]. Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, [AKPT], (2015) '*Plani i Integruar Ndërsëktorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës; Draft Konsultimi Mbi Dokumentin e Politikave*', Tiranë 2015 http://www.azht.gov.al/files/pages_files/17-03-23-02-20-53DRAFT_PINS_Tirane_Durres_20_06_2016.pdf
- [5]. Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, [AKPT], (2015-2020), '*Plane të Përgjithshme Vendore*', Tiranë, <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>
- [6]. Aliaj, B., (2003), '*Planifikimi Urban*', Volumi 1, Tiranë: Co-Plan, Institute for Habitat Development,
- [7]. Aliaj, B., (2003), '*Planifikimi Urban*', Volumi 2, Tiranë: Co-Plan, Institute for Habitat Development,
- [8]. Aliaj, B., (2008), '*Misteri i Gjashtë*', Tiranë: shtëpia botuese Botime Afrojdit,
- [9]. Arnstein, Sherry R., (1969) '*A Ladder Of Citizen Participation*', Journal of the American Planning Association, Vol. 35, No. 4, 216-224
- [10]. Banka Botërore, [BB], (2004), '*Shqipëria: Decentralizimi në Tranzicion*', <http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/DecentralizimiNeTranzicionV1.pdf>
- [11]. Banka Botërore, [BB], (2007), '*Vlerësim i Sektorit Urban në Shqipëri*', Tiranë, <http://docplayer.net/37925061-Vleresim-i-sektorit-urban-ne-shqiperi.html>

- [12]. Banka Botërore, [BB], (2007), '*Shqipëria: Zhvillimi Urban, Migrimi dhe Ulja e Varfërisë*', Tiranë,
<http://documents.worldbank.org/curated/en/547941468004218271/pdf/400710ESW0P0961Dec0310200701public1.pdf>
- [13]. Banka Botërore, [BB], (2012), '*Qeverisja në mbrojtjen e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në Shqipëri: sfidë e vazhdueshme*', Tiranë,
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/735421468003297969/pdf/625190EGR0ALBA00Property0Rights0ALB.pdf>
- [14]. Banka e Shqipërisë, [BSH], (2018), '*Remitancat: një mbështetje për zhvillim*', Tiranë:
https://www.bankofalbania.org/Botime/Remitancat_Nje_mbeshtetje_per_zhvillim.html
- [15]. Banka e Shqipërisë, [BSH], (2019), '*Vrojtim mbi "Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve në Shqipëri"*', Tiranë:
https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Analiza_dhe_studime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Gjendjen_Financiare_dhe_Huamarrjen_e_Familjeve_ne_Shqiperi.html
- [16]. Bashkia Tiranë, [BT], (2019), '*Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë, 2018-2022*', Tiranë,
https://www.tirana.al/uploads/2019/3/20190304142936_szhqbt-2018-2022-30-e-miraturar-per-web-finale.pdf
- [17]. Bashkia Tiranë, [BT], (2020), '*Struktura organizative*', Tiranë,
<https://tirana.al/struktura-organizative>
- [18]. Bardet, G., (1951), '*An Analytico-Synthetic Understanding of the Urban Texture*', The Town Planning Review, Vol. 22, No. 3, pp. 237-260
- [19]. Bairoch, P., (1988), '*Cities and Economic Development From the Dawn of History to the Present*', Chicago: The University of Chicago Press, Originally published in Paris under the title DeJericho a Mexico: Villes et economie dans l'histoire, © Editions Gallimard, 1985.
- [20]. Bess, P., (2006), '*Till we built Jerusalem*', Duke University,
- [21]. Bertaud A. and Malpezzi S., (2001) '*The Spatial Distribution of Population in 35 World Cities: The Role of Markets, Planning, and Topography*',

<https://www.researchgate.net/publication/23741829> The Spatial Distribution of Population in 35 World Cities The Role of Markets Planning and Topography

- [22]. Bërxfholi, A., (2000), '*Rregjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë në Shqipëri*', Tiranë: Botime ASHSH
- [23]. Biberaj, E., (2000), '*Shqipëria në Tranzicion; Rruga e vështirë drejt demokracisë*', Tiranë: botimet Ora
- [24]. Brammah, M., Ros, E., Schweiger, F., Conway, F., Brogger-Jensen, S., Bianchini, R. dhe Hoxha, A., (2010), '*Plani i zhvillimit të jugut; Pjesa planifikuese*', Tiranë: Media Print
- [25]. Brennan, J., (2007), '*Rawls' Paradox*', Springer Science+Business Media, LLC 2007, Constit Polit Econ (2007) 18: 287–299
- [26]. Brooks, A., (2007), '*Who really cares; the surprising truth about compassionate conservatism*', New York: Basic Books
- [27]. Bullock, N., (2010), '*Gaston Bardet: post-war champion of the mainstream tradition of French urbanisme*', Planning Perspectives, Vol. 25, No. 3, July 2010, 347–363
- [28]. Bobbio, N., (1963), '*Locke e il diritto naturale*', Italy: Aboco Edizioni
- [29]. Boonstra, B. and Boelens, L., (2011), '*Self-organization in urban development: towards a new perspective on spatial planning*', Urban Research & Practice, Vol. 4, No. 2, July, 99-122
- [30]. Civici, A., (2009), '*Globalizimi....Ante Portas*', Tiranë: Shtëpia Botuese UET Pres,
- [31]. Civici, A., (2013), '*Tregu apo Shteti*', Tiranë: Shtëpia Botuese UET Pres,
- [32]. Çili, H., (2013), '*Kundër-Reforma*', Tiranë: Shtëpia Botuese UET Pres,
- [33]. Congres for the New Urbanism, [CNW], (1996), '*Charter of the New Urbanism*', Vankuver, Kanada <https://www.cnu.org/who-we-are/charter-new-urbanism>
- [34]. Co-Plan dhe Polis University, (2010), '*Të kuptosh vlerën e aseteve-Administrimi i Bashkëpronësisë*', Tiranë: Botime Afrojdit
- [35]. Davoudi, S., (2003), '*European briefing: Polycentricity in European spatial planning: from an analytical tool to a normative agenda*', Taylor & Francis Ltd: European Planning Studies, Vol. 11, No. 8, December 2003, pp. 979- 999

- [36]. Davoudi, S., (2008), '*Conceptions of the city-region: a critical review*', Urban Design and Planning 161, June 2008, Pages 51–60
- [37]. De Soto, H., (1989), '*The Other Path: The Invisible Revolution in the Third World*', Harper & Row Publishers,
- [38]. De Soto, H., (2001), '*The Mystery of Capital: Why Capitalism Triumphs in the West and Fails Everywhere Else*', Black Swan published
- [39]. De Soto, H., (2007), '*Misteri i Kapitalit: Pse kapitalizmi triumfon në perëndim dhe dështon kudo tjetër*', Tiranë: Co-Plan
- [40]. Duma, G., (2014), '*12 ide përtej 2013*', Tiranë: Fondacioni për Liri Ekonomike
- [41]. European Commission, [EC], (1994), '*Charter of European Cities & Towns Towards Sustainability*', Aalborg, Danimarkë:
https://sustainablecities.eu/fileadmin/repository/Aalborg_Charter/Aalborg_Charter_English.pdf
- [42]. European Commission, [EC], (2005), '*Acquis Urban; Using Cities' Best Practises for European Cohesion Policy*', Saarbrücken, Gjermani
https://ec.europa.eu/regional_policy/archive/newsroom/document/pdf/saarbrucken_urban_en.pdf
- [43]. European Commission, [EC], (2010), '*A strategy for smart, sustainable and inclusive growth*' <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>
- [44]. European Commission, [EC], (2015), '*Territorial Cooperation A Historical Perspective*', Luxembourg: Publications Office of the European Union,
- [45]. European Union, [EU], (1999), '*ESDP European Spatial Development Perspective: Towards Balanced and Sustainable Development of the Territory of the European Union*', Potsdam: Published by the European Commission
- [46]. European Union, [EU], (2003), '*The role, specific situation and potentials of urban areas as nodes in a polycentric development*', ESPON Project 1.1.1
https://www.espon.eu/sites/default/files/attachments/3.ir_1.1.1-full_0.pdf
- [47]. European Union, [EU], (2004), '*Urban Acquis*', Rotterdam,
https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_04_278

- [48]. European Union, [EU], (2007), '*Karta e Leipcigut*', Leipcig,
https://ec.europa.eu/regional_policy/archive/themes/urban/leipzig_charter.pdf
- [49]. European Union, [EU], (2009), '*White paper - Adapting to climate change: towards a European framework for action*' <https://www.eea.europa.eu/policy-documents/white-paper-adapting-to-climate>
- [50]. European Union, [EU], (2010), '*Territorial Agenda of the European Union 2020: Towards an Inclusive, Smart and Sustainable Europe of Diverse Regions*', Godollo, Hungari,
https://ec.europa.eu/regional_policy/en/information/publications/communications/2011/territorial-agenda-of-the-european-union-2020
- [51]. European Union, [EU], (2012), '*Climate change and Europe's regions*', ESPON
<https://www.espon.eu/climate-2012>
- [52]. European Council of Town Planners, [ECTP], (2003) '*The New Charter of Athens 2003; Vision for Cities in the 21st century*', Lisbon <http://www.ceu-ectp.eu/images/stories/download/charter2003.pdf>
- [53]. Eurostat, (2019), '*Population statistics at regional level*'
https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Population_statistics_at_regional_level#Fertility
- [54]. Engels, F., (1872), '*The housing question*',
<https://www.marxists.org/archive/marx/works/1872/housing-question/>
- [55]. Forbes, S. dhe Ames, E., (2015), '*Riviving the Amerika*', USA: McGraw-Hill Education
- [56]. Faja, E. dhe Alimehmeti, F., (1983) '*Urbanistika 1*', Tiranë: botim i Universiteti Tiranës
- [57]. Faja, E. dhe Alimehmeti, F., (1983) '*Urbanistika 2*', Tiranë: botim i Universiteti Tiranës
- [58]. Faja, E., (2008), '*Urbanistika; teknika dhe kompozimi*', Tiranë: Ufo University Pres,
- [59]. Fuga, A., (2001), '*Shtigje drejt guvës së gjarprit; Mbi filozofinë e sistemeve politike*', Tiranë: Botime Ora,

- [60]. Fuga, A., (2003), '*Majtaj jo djathtas*', Tiranë: Botime Ora,
- [61]. Fuga, A., (2004), '*Shoqëria periferike*', Tiranë: Botime Ora,
- [62]. Fuga, A., (2012), '*Rënia e Qytetit*', Tiranë: shtëpia botuese Papirus,
- [63]. Fuga, A., (2019) '*Shoqëria Piramidale*', Tiranë: shtëpia botuese Papirus,
- [64]. Friedman, M., (2005), '*Kapitalizmi dhe Liria*', Tiranë, 2005: shtëpia botuese IPLS dhe Dita, përkthim nga Adri Nurellari,
- [65]. Gilbert, A., (2002), '*On the mystery of capital and the myths of Hernando de Soto: What difference does title make?*', Internation Development Planning, Volume 24
- [66]. Gjuraj. T., (2003), '*Hyrje në Sociologji*', Shkodër: Camaj-Pipaj
- [67]. Gjuraj, T., (2015), '*Nova Demokratia*', Tiranë: shtëpia botuese UET press
- [68]. Gottmann, J., (1961) '*Megalopolis, The Urbanized Northeastern Seaboard of the United States*', New York: The Twentieth Century Fund,
- [69]. Habermas, J., (1976), '*Communication and the Evolution of Society*', Boston: Beacon Press
- [70]. Habermas, J., (1995), 'Reconciliation Through the Public use of Reason: Remarks on John Rawls's Political Liberalism', The Journal of Philosophy, Vol. 92, No. 3 (Mar., 1995), pp. 109-131
- [71]. Habermas, J., (2006), '*Intuita avangardë për relevancat*', Tiranë: Polis, Dita 2000, pp. 144-153
- [72]. Habermas, J., (2006), '*Political Communication in Media Society: Does Democracy Still Enjoy an Epistemic Dimension? The Impact of Normative Theory on Empirical Research*', Communication Theory, Vol. 16 (2006), pp. 411–426
- [73]. Habermas, J., (2010), '*The concept of human dignity and the realistic utopia of human rights*', USA: Metaphilosophy LLC and Blackwell Publishing Ltd, Vol. 41, No. 4, July 2010, pp. 464-480
- [74]. Halilaj, A., (2017), '*Organizimi farefisnor në zonat paraurbane*', Tiranë:
<https://drive.google.com/file/d/0Bz1NpApIa1A6NW9XQzcxOTlObFE/view?fbclid=IwAR2PREwXOsPt0ieqbxcnZVQIT95mo04uJkm5KUxDTeFghammSCz6KIrS4BU>

- [75]. Harris, D., Ch. and Ullman, L., E., (1945), *'The Nature of Cities'*, Annals of the American Academy of Political and Social Science, Vol. 242, Building the Future City (Nov., 1945), pp. 7-17
- [76]. Hoyt, H., (1962), *'Homer Hoyt on Development of Economic Base Concept'*, Land Economics, Vol. 30, No. 2 (May, 1954), pp. 182-186
- [77]. Hoyt, H., (1962), *'Homer Hoyt and the Dilemma of Urban Economic Base Analysis'*, Land Economics, Vol. 38, No. 1 (Feb., 1962), pp. 70
- [78]. Higgs, Robert, (2004), *'Against Leviathan: Government Power and a Free Society'*, The Independent Institute
- [79]. Hoxha, C., (2017), *'Dinamikat e zhvillimeve demografike në Shqipëri në periudhën 1960-1980'*, Revista Politikja, Nr. 2
- [80]. IHS Alumni, IHS, Co-Plan, (1998), *'Qyteti i ndërtuar nga njerëzit; Ide për të menaxhuar realitetin urban në Shqipëri'*, Tiranë: Shtëpia Botuese Eurorilindja,
- [81]. IFC, (2010), *'Eficienca e energjisë në ndërtesa'*, Tiranë: International Finance Corporation, Antare e Grupit të Bankës Botërore
- [82]. Imami, A., Dharmo, S., Derraj, E., Kulluri., Lelaj, O., dhe Aliaj, B., (2008), *'Hapësira qytetare drejt fundit të tranzicionit ?!, Këndvështrime filozofike dhe teknike'*, Tiranë: Botime Afroidit
- [83]. INSTAT, (2004), *'Migracioni në Shqipëri; Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2001'*, Tiranë http://www.instat.gov.al/media/3117/migracioni_n_shqiperi.pdf
- [84]. INSTAT, (2011), *'Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011, Rezultatet paraprake'*, Tiranë: Media Print
- [85]. INSTAT, (2013), *'Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011'*, Tiranë: Adel Print
- [86]. INSTAT, (2014) *'Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare'*, Tiranë: Botimet Pegi
- [87]. INSTAT, (2014) *'Karakteristikat ekonomike'*, Tiranë: Adel Print
- [88]. INSTAT, (2014) *'Migracioni në Shqipëri'*, Tiranë: shtypshkronja Gentgrafik,
- [89]. INSTAT, (2014) *'Kushtet e banimit dhe jetesës'*, Tiranë: shtypshkronja Gentgrafik,

- [90]. INSTAT, (2014) '*Projeksionet e popullsisë, 2011-2031*', Tiranë: shtypshkronja Gentgrafik,
- [91]. INSTAT, [INSTAT], (2014) '*Popullsia dhe dinamikat e saj-Horizonte të reja demografike*', Tiranë: shtypshkronja Gentgrafik,
- [92]. INSTAT, (2015), '*Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2015*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2015/njoftim-p%C3%ABr-media-popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2015/>
- [93]. INSTAT, (2016), '*Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2016*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2016/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2016/>
- [94]. INSTAT, (2017), '*Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2017*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2017/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2017/>
- [95]. INSTAT, (2018), '*Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2018*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2018/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2018/>
- [96]. INSTAT, (2019), '*Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2019*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2019/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2019/>
- [97]. INSTAT, (2020), '*Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2020*', Tiranë:
http://www.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf
- [98]. INSTAT, (2019), '*Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/media/5793/pbb-rajonale-2017.pdf>
- [99]. INSTAT, (2018), '*Lejet e Ndërtimit; tremujori i parë 2018*', Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/media/4082/lejet-e-nd%C3%ABrtimit-t1-2018.pdf>

- [100]. INSTAT, (2019), *'Lejet e Ndërtimit; tremujori i parë 2019'*, Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/media/5815/lejet-e-nd%C3%ABrtimit-t1-2019.pdf>
- [101]. INSTAT, (2020), *'Lejet e Ndërtimit; tremujori i parë 2020'*, Tiranë:
<http://www.instat.gov.al/media/7056/lejet-e-nd%C3%ABrtimit-t1-2020.pdf>
- [102]. Jacobs, J., (1961), *'The death and life of great american cities'*, New York: Random House, Inc., and Toronto, Canada: Random House of Canada, Limited
- [103]. Jacobs, J., (1970), *'The Economy of Cities'*, New York: Vintage Books, a division of Random House
- [104]. Katarzyna, J., (2019), *'With Habermas against Habermas. Deliberation without Consensus'* *Journal of Public Deliberation*: Vol. 15: Iss. 1, Article 13
- [105]. Këshilli i Ministrave, [KM], (2013), *'Programi Rilindja Urbane'*, Tiranë:
<https://kryeministria.al/newsroom/program-kombetar-per-rilindjen-urbane/>
- [106]. Këshilli i Ministrave, [KM], (2013), *'Programi i Qeverisë Rama 2013-2017'* Tiranë:
https://docs.google.com/viewerng/viewer?url=http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2017/09/Programi-i-Qeverise.pdf&hl=en_US
- [107]. King, R., and Vullnetari, J., (2003), *'Migration and Development in Albania'*,
[file:///C:/Users/Planet/Downloads/Migration and Development in Albania.pdf](file:///C:/Users/Planet/Downloads/Migration%20and%20Development%20in%20Albania.pdf)
- [108]. King, R., (2010), *'Shqipëria si një laborator për studimin e migrimit dhe zhvillimit'*, Tiranë: Revista Përpjekja, Viti XVII, nr. 26-27, pranverë-vjeshtë 2010, fq. 11-28
- [109]. Kloosterman, R.C and Musterd, S., (2001), *'The Polycentric Urban Region: Towards a Research Agenda'*, *Urban Studies*, Vol. 38, No. 4, pp. 623-633.
- [110]. Krasniqi, A., (2008), *'(Mbi)pushteti i partive'*, Tiranë: Shtypshkronja Gjergj Fishta
- [111]. Krasniqi, A., (2009), *'Sistemet politike në Shqipëri'*, Tiranë: Ufo University Press
- [112]. Kotmilo, Gj., and Kotmilo, E., (2017) *'IFAU Tirana- 1st International Forum on Architecture and Urbanism'*, Tiranë: Publisher faculty of Architecture and Urbanism (FAU)-Polytechnic University of Tirana (PUT)
- [113]. Kontrolli i Lartë i Shtetit, [KLSH], (2018), *'Raport Auditimi Performance "Funksionimi i Bashkive, në kuadër të reformës administrative-territoriale"'* Tiranë: botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit

- [114]. Konica, F., (1993), *'Shqipëria; Kopështi shkëmbor i Europës Juglindore'*, Tiranë: shtëpia botuese Marin Barleti,
- [115]. Lami, R., (2013), *'Paqartësia e strukturimit të raporteve; Parti Politike-Ideologji'*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Sociologjisë, Programi i Studimit të Doktoraturës <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/12/Doktorature-Roland-Lami-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Sociologjise.pdf>
- [116]. Lami, R., (2010), *'Mungesa e ideologjive tek partitë politike në Shqipëri'*, Tiranë: Revista 'Aktet', Vol. 3, Nr. 4, pp. 488-494 http://alpa.mali-it.eu/journal/aktet/vol/vol3/Aktet_Vol_III_Nr_4_pp_488_494.pdf
- [117]. Laskar, M., (2013), *'Summary of Social Contract Theory by Hobbes, Locke and Rousseau'* LL.M Symbiosis Law School, Pune Electronic copy available at: <http://ssrn.com/abstract=2410525>
- [118]. Locke, J., (2005), *'Traktati i Dytë i Qeverisjes'*, Tiranë; IPSL & Dita 2000, përkthyer nga Aleko Minga
- [119]. Marks, K. dhe Engels, F., (1983), *'Ideologjia Gjermane'*, Tiranë: Shtëpia Botuese 8 Nëntori
- [120]. Meijers, E., (2005), *'Polycentric Urban Regions and the Quest for Synergy: Is a Network of Cities More than the Sum of the Parts?'*, Urban Studies, Vol. 42, No.4, pp. 765-781.
- [121]. Meijers, E., (2006), *'From central place to network model: theory and evidence of a paradigm change'*, Published by Blackwell Publishing Ltd, Tijdschrift voor Economische en Sociale Geografie, 2007, Vol. 98, No. 2, pp. 245 –259
- [122]. Meijers, E., (2007), *'Synergy in Polycentric Urban Regions Complementarity, organizing capacity and critical mass'*, Amsterdam, Holand: IOS Press BV.
- [123]. Meksi A., (1992), *'Programi i Qeverisë së Aleksandër Meksit, 1992-1996'*, <http://shtetiweb.org/2015/09/13/programi-qeverise-aleksander-meksi-1992-1996/>
- [124]. Meksi, A., (1997), *'Përmes fjalës së tij'*, Tiranë: shtëpia botuese Luarasi,
- [125]. Meksi, A., (2015), *'Rrugë e vështirë 1'*, Tiranë: shtëpia botuese Botimet Barleti,

- [126]. Meksi, A., (2015), *‘Rrugë e vështirë 2’*, Tiranë: shtëpia botuese Botimet Barleti,
- [127]. Meksi, A., (2019), *‘Fjalime në Kuvendin e Shqipërisë’*, Tiranë: Shërbimi i Botimeve Parlamentare,
- [128]. Mercer, (2019), *‘Quality of living city ranking’*
<https://mobilityexchange.mercer.com/Insights/quality-of-living-rankings>
- [129]. Misja, V dhe Misja, A. (2004) *‘Vështrim mbi situatën e banesave në Shqipëri’*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
- [130]. Ministria e Brendshme, [MB], (2014), *‘Relacion për Projektligjin “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”’*, Tiranë, https://reformaterritoriale.qeverisjavevendore.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/RELACION-PROJEKTLIGJ-NDARJA-ADMINISTRATIVO_TERRITORIALE.pdf
- [131]. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjinë, [MIE], (2000), *‘Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin’* <https://www.infrastruktura.gov.al/plani-i-integruar-ndersektorial-per-bregdetin>
- [132]. Mill, J., S., (2005), *‘Mbi Lirinë’*, Tiranë, 2000: shtëpia botuese Julvin 2, përkthyer Gëzim Banushi dhe Luan Banushi,
- [133]. Mises V., L., (2005) *‘Veprimi Njerëzor’*, Tiranë: shtëpia botuese Dita 2000, përkthyer nga Edlira Shuli,
- [134]. MPPT, (2006), *‘Politikat dhe strategjia për zbatimin e kuadrit të ri ligjor të planifikimit hapsinor në Shqipëri; Dokumenti i Politikave’*, Tiranë
- [135]. MPPT, (2010), *‘Plani i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut’*, Tiranë: shtëpia botuese Mediaprint,
- [136]. Mouffe, Ch., (2009), *‘The Limits of John Rawls’ Pluralism’*, Theoria, March 2009, pp. 1-15
- [137]. Muçaj, A., (2013), *‘Sociologjia rurale dhe urbane’*, Tiranë: AlbPAPER,
- [138]. Nussbaum, M., (2011), *‘Rawls’s Political Liberalism. A Reassessment’*, Ratio Juris. Vol. 24 No. 1, March 2011, pp. 1–24

- [139]. Numbeo, (2019), '*Quality of Life Index by City 2020*'
<https://www.numbeo.com/quality-of-life/rankings.jsp>
- [140]. Nisbet R., (1953), '*The Quest for Community: A Study in the Ethics of Order and Freedom*', Penguin Books,
- [141]. Orwell, G., (2017), '*Ferma e kafshëve*', Tiranë; Shtëpia Botuese Pema, përkthyer nga Klodian Briçi
- [142]. Libertarian Party [LP], (2018), '*Libertarian Party Platform; Statement of Principles*', USA, New Orleans, Louisiana: <https://www.lp.org/wp-content/uploads/2018/09/Libertarian-Party-Platform-2018.pdf>
- [143]. Parr, J.B., (2004) '*The Polycentric Urban Region: A Closer Inspection*', Regional Studies, 38, pp. 231-240.
- [144]. Parker, E., R., Burgess, E., W., and McKenzie, D., R., (1984), '*The City, Suggestions for Investigation of Human Behavior in the Urban Environment*', Chicago and London: The University of Chicago Press
- [145]. Pandelejmoni, E., (2019) '*Shkodra Family and Urban life (1918-1939)*', Vjenë; Lit Verlag GmbH & Co KG
- [146]. Payne, G., (2004), '*Land tenure and property rights: an introduction*', Habitat International, Vol.28; Iss.2
- [147]. Pierson, P., (2004) '*Politics in Time: History, Institutions, and Social Analysis*', Princeton University Press
- [148]. Përmbledhëse e Përgjithshme e Legjislacionit, [PL], (1979), '*Përmbledhëse e Përgjithshme e Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë 1945-1979*', Tiranë: botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare
- [149]. Rawls, J., (1955), '*Justice as Fairness: Political not Metaphysical*', Philosophy & Public Affairs, Vol. 14, No. 3 (Summer, 1985), pp. 223-251
- [150]. Rawls, J., (1975), '*Fairness to Goodness*', The Philosophical Review, Vol. 84, No. 4 (Oct., 1975), pp. 536-554
- [151]. Rawls, J., (1995), '*Political Liberalism: Reply to Habermas*', The Journal of Philosophy, Vol. 92, No. 3 (Mar., 1995), pp. 132-180

- [152]. Rawls, J., (1997), '*The Idea of Public Reason Revisited*', The University of Chicago Law Review, Vol. 64, No. 3 (Summer, 1997), pp. 765-807
- [153]. Rawls, J., (2007), '*Drejtësia si paanshmëri*', Tiranë: ISP & Dita 2000, përkthim nga Bashkim Shehu
- [154]. Revista Monitor, [RM], (2018), '*Tranzicioni tkurr me 35% sektorin e arsimit*', Tiranë: <https://www.monitor.al/tranzicioni-tkurr-35-sektorin-e-arsimit/>
- [155]. Reiter O., Schwarzhappel M. and Stehrer R., (2020), '*Productivity and Competitiveness of the Western Balkan countries*', Vienna: The Vienna Institute for International Economic Studies <https://wiiw.ac.at/productivity-and-competitiveness-of-the-western-balkan-countries-an-analysis-based-on-the-wiiw-western-balkan-productivity-database-dlp-5340.pdf>
- [156]. QBZ, (1998) Ligj nr. 8417, dt. 21. 10. 1998, '*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*', Tiranë: Fletore Zyrtare nr. 28/ 1998,
- [157]. QBZ, (2010), '*Përmbledhëse Legjislacioni për Ndërtimet*', Tiranë: botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, <https://qbz.gov.al/preview/ba544cc3-052a-4e95-8537-0c7c4547c1c8>
- [158]. QBZ, (2018), '*Përmbledhëse Legjislacioni për Legalizimet*', Tiranë: botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, <https://qbz.gov.al/preview/3798772f-34ab-4cac-bc5d-d3f9ef54cafd>
- [159]. QBZ, (2018), '*Përmbledhëse Legjislacioni për Vetqeverisjes Vendore*', Tiranë: botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, <https://qbz.gov.al/preview/1ec6b252-f349-4746-af50-22980461712c>
- [160]. QBZ, (2019), '*Përmbledhëse Legjislacioni për Urbanistikën*', Tiranë: botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, <https://qbz.gov.al/preview/35686c1e-88ba-46c4-948e-30d619f28c98>
- [161]. QBZ, (2019), '*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*', Tiranë: shtypur në Shtypshkronjën e Qendrës së Botimeve Zyrtare,
- [162]. Schmid, D., (2018), '*Total number of employed persons in the building construction industry in the European Union (28 countries) from 2008 to 2016*' <https://www.statista.com/statistics/763219/total-employed-persons-in-building-construction-industry-eu/>

- [163]. Steiner, F., Butler, K., dhe Sendich, E., (2010), '*Standartet e Planifikimit dhe Projektimit Urban*', Tiranë: shtëpia botuese Universitare U.F.O Press, përkthyer nga Jamarbër Malltezi dhe Tritan Verteniku, titulli origjinal '*Planning and Urban Desing Standarts, Student Edition*'
- [164]. Sted, J., (2000), '*Çfarë i nevojitet një shoqërie demokratike që të lulëzojë dhe të mbijetojë*', Tiranë: Fondacioni "Abraham Linkoln" i Shqipërisë, shtypshkronja Pegi
- [165]. Simmel, G., (2011), '*Le metropoli e la vita dello spirito; a cura di Paolo Jedlowski*', Roma, Italy: Armando Editore
- [166]. Shtëpani, V., (2007), '*Sociologjia Urbane*', Tiranë: Botime Ora
- [167]. Smith, A., (2005), '*Pasuria e Kombeve*', Tiranë: Dita 2000, përkthyer nga Gjergj Peçi
- [168]. Talmon, J., (1960), '*The Origins of Totalitarian Democracy*', Secker & Warburg, vol. 1, London
- [169]. Thompson, J., M (2007), '*The suburban assault on democracy*', The Urban Reinventors Issue 2 November 07, The Urban Reinventors Paper Series 2005-2007, <http://www.urbanreinventors.net/2/thompson/thompson-urbanreinventors.pdf>
- [170]. Tokëvill, A., (2002), '*Demokracia në Amerikë*', përkthyer nga Kristaq Traja, Tiranë: Kristalina-KH
- [171]. Tonnies, F. (1941), '*Fundamental Concepts of Sociology (Gemeinschaft und Gesellschaft)*', Ocsford; Social Forces, Vol. 20, No. 2 (Dec., 1941), pp. 272-273
- [172]. Tonnies, F. (2001), '*The theory of Gemeinschaft. In J. Harris (Ed.) & M. Hollis (Trans.), Tönnies: Community and Civil Society (Cambridge Texts in the History of Political Thought, pp. 22-51)*', Cambridge: Cambridge University Press.
- [173]. Toska, M., (2020), '*Financat Publike Vendore*', Tiranë: https://drive.google.com/file/d/1LcXbcBzIQiO1iujoX2Yo6F_hSQUQEuiA/view
- [174]. Top Channel Albania (2016), '*Miratohet Plani Urbanistik për Tiranën*', Tiranë <https://www.youtube.com/watch?v=6xSQG9JQET8>
- [175]. United Nation, [UN], (1976), '*The Vancouver Declaration On Human Settlements*', from the report of Habitat: United Nations Conference on Human Settlements Vancouver,

Canada, 31 May to 11 June

1976 https://mirror.unhabitat.org/downloads/docs/The_Vancouver_Declaration.pdf

- [176]. UNDP, (2019), *'Land Degradation Neutrality Target for Albania and Soil Erosion Measurement Norms and Standards'*, Tiranë:
file:///C:/Users/Hp/Downloads/WEB_final_report.pdf
- [177]. United Nation, Economic Commission For Europe, [UNECE], (2002), *'Profili i vendit në sektorin e strehimit'* <https://digitallibrary.un.org/record/487965?ln=en>
- [178]. United Nation, Economic Commission For Europe, [UNECE], (2008), *'Spatial Planning; Key Instrument for Development and Effective Governance with Special Reference to Countries in Transition'*, United Nations Publication, Printed at United Nations, Geneva, Switzerland
- [179]. Vasanen, A., (2013), *'Spatial integration and functional balance in polycentric urban systems: a multi-scalar approach'*, Tijdschrift voor Economische en Sociale Geografie – 2013, Vol. 104, No. 4, pp. 410–425
- [180]. Vizion Plus, (2016), *'Debate për Planin Urbanistik'*, Tiranë
<https://www.youtube.com/watch?v=pm2dz0GGAMQ>
- [181]. Vullnetari, J., (2007), *'Albanian migration and development: state of the art review'*,
file:///C:/Users/Planet/Downloads/Albanian_Migration_and_Development_State.pdf
- [182]. Vullnetari, J., (2010), *'Nga "gulak" komunist në geto ballkanike: Shqipëria dhe politikat migratore në vite'*, Tiranë: Revista Përpyjekja, Viti XVII, nr. 26-27, pranverë-vjeshtë 2010, fq. 11-28
- [183]. Vullnetari, J., (2012), *'Albanian on the Move: Links between Internal and International Migration'*; Amsterdam: Amsterdam University Press
- [184]. Zojzi, Rr., (1962), *'Ndamja krahinore e popullit shqiptar'*, Tiranë: Revista "Etnografia shqiptare", Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Sektori i Etnigrafisë, fq 16-62
- [185]. Wallace, M. J., (1980), *'The Date of Sir Robert Filmer's Patriarcha'*, The Historical Journal, Vol. 23, No. 1 (Mar., 1980), pp. 155-165
- [186]. Wallison, P., (2016), *'Hidden in Plain Sight: What Really Caused the World's Worst Financial Crisis and Why It Could Happen Again'*, Encounter Books

- [187]. Webber, M., (2008), 'Qyteti', Tiranë: Shtëpia Botuese Fan Noli, titulli i origjinalit: 'Die Stard, Tubingen', 1922
- [188]. Wirth, L., (1938), '*Urbanism as a Way of Life*', Chicago: American Journal of Sociology, Vol. 44, No. 1 (Jul., 1938), pp. 1-24
- [189]. Wolff, J., (1994), '*Hobbes and the motivations of social contract theory*', International Journal of Philosophical Studies, Volume 2, Issue 2, pp. 271-286
- [190]. World Bank, [WB], (2007), '*Albania Urban Sector Review*', Tiranë,
<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/19622/372770ENGLISH01iew1P09932501PUBLIC1.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
- [191]. World Bank, [WB], (2017), '*Cities in Eastern Europe and Central Asia: a story of urban growth and decline*', Paula Restrepo Cadavid, Grace Cineas, Luis E. Quintero and Sofia Zhukova
<http://documents.worldbank.org/curated/en/319131510892209158/pdf/AUS12288-REVISED-PUBLIC-ECABRIEFALLWEB.pdf>
- [192]. World Bank, [WB], (2019), '*Western Balkans and Croatia Urbanization and Territorial Review*', <https://elibrary.worldbank.org/doi/abs/10.1596/32308#>
- [193]. World Bank, [WB], (2015), '*Doing Business, 2016*'
<https://www.doingbusiness.org/en/reports/global-reports/doing-business-2016>
- [194]. World Bank, [WB], (2018), '*Doing Business, 2019*'
<https://www.doingbusiness.org/en/reports/global-reports/doing-business-2019>
- [195]. World Bank, [WB], (2019), '*Doing Business, 2020*'
<https://www.doingbusiness.org/en/reports/global-reports/doing-business-2020>
- [196]. World Planners Congress, [WPC] (2006), '*Vancouver Declaration*', Kanada
<http://www.globalplannersnetwork.org/wp-content/uploads/2017/08/WPC-declaration-2006-updated-June-2017.pdf>

Për realizimin e këtij punimi janë konsultuar një numër i madh Fletorësh Zyrtarë në vitet e tranzicionit dhe shumë dokumenta vlerësimesh dhe raportesh këshilluese të ekspertëve ndërkombëtarë për seksin e zhvillimit urban, për shkak të volumit nuk janë bashkëngjitur bibliografisë. Këto të dytat nuk janë cituar apo perifrazuar në punim, megjithëse përbënin një

bazë shumë të mirë argumentuese dhe provuese të tezës tonë, për arsyen se nuk janë të botuara për publikun e gjerë. Ato janë ekspertizë ndërkombëtare në shërbim të qeverive shqiptare, me synim përmirësimin e situatës urbane të vendit dhe parapërgatitjen e tij për integrimin euro-atlantik. Këto vlerësime teknike janë në njohje të autorit të punimit përshkak të detyrave dhe funksioneve teknike të tij në këtë sektor për shumë vite. Gjetjet dhe rekomandimet e tyre, në mënyrë përgjithësuese, vërejnë nivelin e lartë të përqendrimit politik të funksioneve, detyrane dhe përgjegjësi në çështjet e qeverisjes urbane.